RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

"Auditim përputhshmërie"

Tiranë, më 15.12.2017

Nr	Përmbajtja	Faqe
	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1	HYRJA	2 - 2
2	Objektivat dhe qëllimi.	2 – 2
3	Identifikimi i çështjes.	3 – 3
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.	3 – 5
5	Përgjegjësitë e audituesve.	5 - 5
6	Kriteret e vlerësimit.	5 - 6
7	Standardet e auditimit.	6 - 6
8	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.	7 - 105
	1. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.	7 - 7
	2. Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm.	7 - 16
	3. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.	17 - 22
	4. Dispozitat ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës .	23 - 44
	5. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.	44 - 52
	6. Auditim mbi prokurimin e fondeve publike për mallra, ndërtime e shërbime.	53 - 63
	7. Mbi funksionimin e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë.	63 - 105
	8. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.	
9	GJETJET DHE REKOMANDIMET.	106-117
10	KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT.	118-120
11	ANEKSE	120-127
12	DOKUMENTE SHOQËRUESE	

I. HYRJA

KLSH auditoi Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, etj.
Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 980/1, datë 28.08.10.2017 miratuar nga Kryetari i KLSH, shtesës së programit nr. 890/2, datë 06.10.2017 dhe shtesës nr. 890/3, datë 31.10.2017, nga data 01.01.2013 deri në datë 30.09.2017, në subjektin Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, për periudhën nga 28.08.2017 deri ne 17.11.2017 u krye auditimi "Mbi përputhshmërinë dhe rregullueshmërinë", nga Grupi i Auditimit me përbërje:

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

- Objekti i auditimit. –Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), me auditim përputhshmërie, auditoi Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me: Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike dhe komisionin e vlerësimit të titujve të pronësisë. Gjatë auditimit të aktivitetit të Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, për periudhën 01.01.2013 deri më 30.09.2017.

- Qëllimi i auditimit. Që nëpërmjet një pune audituese sistematike dhe me zgjedhje janë evidentuar shkeljet dhe parregullsitë si në drejtim të transaksioneve financiare ashtu dhe në

zbatimin e procedurave ligjore nga strukturat e subjektit të audituar me qëllim që ky auditim t'i shërbej subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës për të ardhmen në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan, me qëllim marrjen e masave në një kohë sa më të shpejtë për përmirësimin e gjendjes.

- Identifikimi i çështjes.

1. Auditim mbi zbatimin e detyrave të lëna në auditimet e mëparshme.
2. Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.
3. Auditim mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.
4. Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës.
5. Auditim mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.
6. Auditim mbi prokurimin e fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime.
7. Auditim mbi funksionimin e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë.
8. Të tjera që rezultojnë gjatë auditimit.

-Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në standartet e INTOSAI-t dhe Manualit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan, rezultuan sa vijon:

- Për **7 vendime** me sipërfaqen e pavlefshme te titujve te pronesise e zbritur prej 16201 m^2 dhe kthyer "shtet" nga KVVTP nuk janë dërguar për njoftim dhe nuk janë marrë në dorëzim me proces verbal, pra nuk është vënë nën administrim të përfaqësuesit shtetëror sipërfaqja e kthyer "shtet".
- Për **3 vendime** të KVVTP, marrë forme të prerë nga Gjykata, shfuqizimi i titujve të pronësisë është llogaritur me zbritje më pak për sipërfaqen - 4746 m^2 (2611 m^2+563 m^2+1572 m^2) (pra janë zbritur 3836 m^2 kundrejt 8582 m^2 që duheshin zbritur). Ky veprim është pasojë nga moskonfirmimet e sakta të ZVRPP-ve dhe mosmarrja parasysh e gjendjes juridike sasiore ndermjet siperfaqes ligjore percaktuar ne AMTP dhe sipërfaqes faktike shprehur ne Librin e Ngastrave ne terren (AMTP-LN-PIII).
- Nga auditimi i 18 dosje-Vendimet të KVVTP për shfuqizim të AMTP-ve, të cilat ndodhen në proces shqyrtimi gjyqësor në Gjykata, rezulton se ***7 vendime*** u gjetën me mangësi dhe parregullsi që lidhen me sipërfaqe të zbritura me pak në ***3 raste për sipërfaqen -3314 m^2, ku*** shfuqizimi i titujve të pronësisë është llogaritur zbritje më pak për - 3314 m^2 (608 m^2+1278 m^2+1428 m^2) (pra janë zbritur 3721 m^2 kundrejt 7035 m^2 që duheshin zbritur), me shkakun për konfirmime të parregullta të gjendjeve juridike fizike të pasurive konfirmuar nga ZVRPP, ***1 rast*** per mosverifikim e hetim administrativ të plotë pas ndryshimit të emrit, ***1 rast*** me konfirmime të pasakta të rrjedhura nga bashkëpronësia e paligjshme, si dhe ***2 raste*** me mungesë përcaktimi për shlyerjen e detyrimit financiar.
- Në Vendimin nr. 119/1, datë 30.10.2015 në proces, dërguar kërkesë padia në Gjykatën Administrative Durrës me datë 3.11.15, kthyer për të meta e plotësim, kërkuar shfuqizim në sipërfaqen tepër **prej 8220 m^2,** për shkak të mungesës dokumentit provë të qenit themelues dhe konfirmimi i pa plotë ZVRPP Elbasan, përveç sa sipër KV nuk ka shtrirë hetimin administrativ në kërkim të konfirmimit të pajisjes ose jo me AMTP tjetër të lëshuar në emrin e ndryshuar të personit Q.H.F.
- KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan në **2 vendime** me shlyerje detyrimi në vlerën **7,228,568 lekë** për sipërfaqen e tjetërsuar **4746 m^2** nuk përcaktohet institucioni, llogaria dhe mënyra e derdhjes, gjë që sjell pamundësinë e ekzekutimit të Vendimit dhe të derdhjes së detyrimit financiar të mësipërm tek Shteti përkatësisht për vendimin nr. 157, datë 04.05.2015 me sipërfaqen 1709 m^2

me vlerën 6,974,837 lekë dhe vendimi nr. 193, datë 14.12.2015 për sipërfaqen 3037 m^2 për vlerën prej 253,731 lekë.

- Për **26 kërkesë padi** të KVVTP drejtuar gjykatave, ndarë 15 në Gjykatën e shkallës I-rë dhe 11 në shkallën e dytë të gjykimit; konstatohen vonesa e zgjatje procedurash me shtrirje mesatare kohore 2-3 vjet, me pasoja përveç zgjatjes kohore të trajtimit të kërkesave, dhe ecurisë së marrjes së formës përfundimtare të Vendimeve të KVVTP-së, por dhe shkelje të afateve të përfundimit të vetë procesit të vlerësimit të titujve të pronësisë së tokës bujqësore.

- Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefekturës së Qarkut Elbasan në periudhën 2013-30.9.2017 ka marrë 11 vendime shfuqizimi të AMTP-ve për sipërfaqen 93671 m^2, të cilat ndodhen në proces shqyrtimi e ankimimi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit nga të cilat 2 vendime ankimuar nga pala mbajtëse e AMTP-ve dhe 9 vendime ankimuar nga KVVTP Elbasan. Lidhur me ecurinë e procesit të shqyrtimit dokumentacionin të kërkesave ankimore për këto vendime u konstatuan mangësi si në dokumentacion, ashtu dhe në marrëdhëniet në plotësim të detyrimit ligjor ndërmjet Gjykatës dhe KVVTP.

- KVVTP në Vendimin nr. 178, datë 30.10.2015, i ankimuar pranë GJAA Tiranë nga mbajtësi i AMTP nr. 623, datë 3.3.1998, me 3500 m^2 tokë arë, fshati Shtërmen Komuna Gostimë, ka mjaftuar vetëm me certifikatën gjendje datë 27.09.1991, pra që nuk ka qenë banor më datë 01.08.1991 dhe për pasojë nuk ka qenë subjekt i ligjit nr.7501, pra KVVTP por nuk ka bërë të plotë hetimin administrativ lidhur me faktin nëse ka trajtim me tokë bujqësore në fshatin Rrasë .

- KVVTP Qarku Elbasan për vendimin nr. 178, datë 30.10.2015, me sipërfaqe 3500 m^2,dhe Vendimin nr. 209, datë 23.09.2016, me 7000 m^2 ullishtë si dhe për gjithë vendimet e tjera nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj anëtarëve të Komisionit të Ndarjes së tokës të fshatit Shërmen Komuna Gostimë, Komisionit të Ndarjes së tokës të Sektori Karroq ish-NB Elbasan dhe komisionet e tjera pasi kanë tejkaluar kompetencat ligjore me trajtimin me tokë bujqësore pa qenë subjekt i ligjit nr.7501, gjendje datë 1.8.1991 mbi normën për frymë

- Nuk dokumentohet dhe relatohet ecuria ndjekja e proceseve gjyqësore; ndërsa lidhur me Vendimin nr. 209, datë 23.09.2016 për verifikim të AMTP nr. 274, pa datë, me sipërfaqe 16000 m^2 Ullishte në emër të A. H. Q., ecuria është mbajtur me shënime fletushka, nuk ka asnjë informacion për titullarin, megjithëse nga shënimet tregohet se janë zhvilluar 4 seanca gjyqësore pranë GJA Durrës.

- Në 43 dosje të vendimeve për mosshqyrtim të kërkesave **mungonin relacionet e komisionit**, dhe ka mangësi **në inventarizimin e dokumentacionit,** gjendje kjo në mospërmbushje të pikës 3, neni 14 "Afatet dhe dokumentimi i veprimeve" të Rregullores "Për Organizimin dhe Funksionimin e KVVTP-ve", miratuar me Vendimin nr.1, datë 27.3.2009 të KQT si dhe në kundërshtim me germën "dh" nenet 9, 36, 40, 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.01.1993 .

- Në **3 raste** nga Komisioni vendor janë marrë vendime për shfuqizim të AMTP-ve në sipërfaqen prej 62.900 m^2, pas shqyrtimit gjyqësor nga gjykata administrative këto vendime janë shfuqizuar për sipërfaqen 42.700 m^2 me shkakun e provimit faktik të çështjes, duke mos marrë parasysh përcaktimet e shprehura në vendimet e KVVTP të bazuara në aktet ligjore të fitimit të titullit të pronësisë siç janë vendimi nr. 151, datë 30.03.2015, vendimi nr. 164, datë 30.06.2015 dhe vendimi nr. 221, datë 19.04.2017, mos konfirmime të sakta të gjendjes juridike nga ZVRPP për faktorët AMTP-LN dhe të përfituar në kundërshtim me ligjin nuk e ka kaluar në pronësi shtet.

- Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë për periudhën 01.01.2013 deri 30.09.2017 nuk ka mbajtur në rregull protokollin dhe procesverbalin e mbledhjeve nuk është mbajtur në një libër të sekretuar. Prefekti, nuk ka thirrur në mbledhjen e komisionit drejtues të institucioneve shtetërore, që ushtrojnë veprimtari në juridiksionin e qarkut, drejtues të qeverisjes vendore, të cilët kanë lidhje dhe informacion me çështjet konkrete, që shqyrtohen të vlefshmërisë të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore.

- Nga Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, **janë shkelur afatet** e zbatimit të procedurave të trajtimit të kërkesave kohëzgjatjes në nxjerrjen e Vendimeve nga mosshqyrtimi i tyre nga 1 muaj deri në 6 vjet dhe për 1528 kërkesa janë marrë 235 vendime.
- Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në 235 raste, nuk ka bërë inventarizimin e dosjeve të dorëzuar në zyrën e arkivës, si dhe nuk ka përcaktuar dorëzuesin dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën "dh" nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat".
- Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, në ish-NB-të e juridiksionit të kësaj Prefekture, për periudhën nga data 01.01.2013 deri me datë 30.09.2017, nuk ka marrë asnjë vendim në lidhje me kontrolle të drejtpërdrejta, të ushtruara me nismën e vet.
- Në **3 raste** janë larguar ish-punonjësit nga puna pa bërë dorëzimi i detyrës me procesverbal, dokumentacionin shkresor, elektronik, ndërprerë marrëdhëniet e punës dhe trajtuar në vendimet e gjykatave respektive.
- Nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, për vitet 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 9 mujorin e 2017 në **25 raste**, janë kryer pagesa me një **vlerë me efekt financiar prej 20,806,409 lekë,** ndaj ish-punëmarrësve, në bazë të vendimeve gjyqësore, të Shkallës Parë dhe të Apelit, pa kaluar tri shkallët e gjykimit. Gjithashtu në **1 rast** është kryer pagesa prej 1,379,235 lekë ndaj 6 operatorëve ekonomikë, për sasinë e 10.329 litra gazoil, me vendim të Gjykatave por kjo sasi karburanti nuk është bërë hyrje, dalje në magazinë si dhe nuk janë zbatuar procedurat e tenderimit në bazë të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar.
- **3 nënprefekturat** nuk kanë bërë regjistrimi në hipotekë dhe marrjen në evidencë të pasurive përkatësisht; nënprefektura Librazhd, truall dhe garazhe lagja nr. 1, Librazhd me sipërfaqe 216 m^2, 3 ambjente të dhëna me qira; Nënprefektura Gramsh 15 objekte me sipërfaqe 281 m^2, dhe nga Nënprefektura Peqin, janë regjistruar me diferencë prej 221.20 m^2 ndërtesë, dhe nuk janë transferuar 300 m^2 truall dhe 110 m^2 ndërtesë zyrat e PMNZSH-së tek Bashkia Peqin.

Që nën gjykimin profesional për dhënien e një opinioni të kualifikuar nga ana audituesve të pavarur të KLSH, vlerësojmë se përgjithësisht Institucioni ka përmbushur funksionet, detyrat e qëllimet ligjore dhe ka përdorur burimet duke i menaxhuar ato brenda kuadrit ligjor, rregullativ; ndërsa rastet sporadike të divijimeve të konstatuara nga rregullat dhe rregulloret, konstatuar kryesisht në aktivitetin e KVVTP (si aktivitet dytësor, diskret në kohë dhe i kushtëzuar me bashkërendimin e punës me institucione të tjera) vlerësojmë se nuk janë materiale dhe të pa riparueshme.

- Përgjegjësitë e audituesve. Grupi i auditimit të KLSH-së, për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, pasi u njoh me bazën ligjore e nënligjore dhe me Vendimet e Prefektit të Qarkut Elbasan, si dhe duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, grupi i auditimit ka zbatuar Kodin e Parimet Etike të cilat drejtojnë përgjegjësitë profesionale të audituesit, si dhe Standardet e Miratuara të Auditimit.

- Kriteret e vlerësimit.
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
- (ISSAI), të INTOSAI-t.
LIGJE:
Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, i ndryshuar; ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të e Lartë të Shtetit"; ligji nr. 8927, datë 25.07.2002 "Për Prefektin"; ligj nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", të ndryshuar; ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar; ligj nr. 8337, datë 30.04.1998 "Për kalimin

në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave"; ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995 "Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore", të ndryshuar; ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar; ligji nr. 8503, datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", të ndryshuar; ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të RSH", të ndryshuar; ligj nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar. Ligj nr. 7665, datë 21.01.1993 "Për zhvillimin e zonave, që kanë përparësi turizmin", të ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr. 10294, datë 01.7.2010 "Për inspektimin financiar"; Ligji nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; ligji nr. 152/2013, datë 01.10.2013 "Për Nëpunësit Civil"; ligji nr. 9720, datë 23.4.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"; ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; ligji nr. 8503, datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare"; ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 "Për kompetencat caktimin pagave e të shpërblimeve".

Vendime të Këshillimit të Ministrave (VKM)

- VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 "Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar; VKM nr. 224, datë 19.02.2009 "Për procedurat e krijimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve, të kryera nga komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë (KV)"; VKM nr. 255, datë 02.08.1991 "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore", të ndryshuar; VKM nr. 868, datë 18.06.2008 "Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi i tokës bujqësore", kur toka bujqësore e liruar rezulton me prejardhje nga ish-ndërmarrjet bujqësore (NB), sipas gjendjes më 01.10.1992; VKM nr. 230, datë 22.07.1991 "Për krijimin e komisioneve të tokave", të ndryshuar; VKM nr. 432, datë 28.06.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore"; VKM "Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore" sipas viteve përkatëse të auditimit; VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar; VKM nr. 472, datë 02.07.2011 "Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore"; VKM nr. 1129, datë 5.08.2008 "Për mënyrën e përcaktimit të vlerës së truallit, të vënë nga pronarët e tij, në dispozicion të investitorëve të ndërtimit";

Rregullore, Udhëzues, Akte të tjera Administrative

- UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin aktiveve në njësitë e sektorit publik"; UMF nr. 35, datë 05.11.2008 "Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008"; UAPP nr. 1, datë 20.3.2007 "Për blerjet me vlera të vogla", i ndryshuar;

Standardet e auditimit.

Rregullorja e Brendshme "Mbi Organizimin dhe Funksionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit", miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. 85, datë 30.06.2015; Rregullorja e Brendshme "Për procedurat e auditimit të KLSH"; Udhëzimi i Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016" Mbi Procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit zbatimit rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t" (ISSAI), "Standardet e Kontrollit të KLSH", "Manualeve" si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre.

II. PËSHKRIMI AUDITIMIT

1. Auditim mbi zbatimin e detyrave të lëna në auditimet e mëparshme.

Nga auditimi dhe verifikimi i dokumentacionit të ofruar u konstatua se auditimi i fundit i ushtruar nga KLSH është kryer në zbatim të programit të Auditimit nr. 198/1, datë 01.04.2010, dërguar rekomandimet për zbatim me shkresë nr. 198/5, datë 16.07.2010, për të cilën është kryer verifikimi

i zbatimit të detyrave të lëna dhe masave të rekomanduara sipas program audititmit nr. 351/16, datë 05.11.2010, të cilat kanë rezultuar të realizuara në lidhje me sa trajtuar është mbajtur aktverifikim nr. 1, datë 27.11.2010.

2. Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur për periudhën objekt auditimi, në Prefekturën e Qarkut Elbasan, lidhur me implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.*2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",* i ndryshuar dhe konstatohet se:

-Janë evidentuar risqet, nëpërmjet regjistrit të riskut në të cilin pasqyrohen risqe të mundshme si:

- hartimi i projekt buxhetit sipas nevojave te evidentuara, keq menaxhimi i fondeve, mos pagimi në kohë i detyrimeve, aftësia profesionale e specialistëve, realizimi i procedurave të prokurimeve, kryerja e dobët e detyrës, mungesa e përcaktimit të qartë e ndarjes së detyrave e përgjegjësive për punonjësit etj.

Për menaxhimin e risqeve të evidentuara, është përcaktuar zotëruesi i riskut, niveli i ndikimit të riskut në vijimësinë e institucionit si dhe masat e nevojshme që do të ndërmerren në rast ndodhje të riskut.

- Lidhur me zbatimin e rregullave për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme, rezulton se në zbatim të vendimeve të KM të dala për menaxhimin e aktiveve, nga Prefektura Elbasan, janë përcaktuar, nëpërmjet nënshkrimit të dokumentave justifikuese e fletëve të inventarit, nga personat përgjegjës për të gjitha aktivet që disponon Institucioni i Prefektit. Verifikimi i administrimit dhe gjendjes fizike së aktiveve është bërë periodikisht nga komisione me përbërje të ndryshme të ngritura me urdhër të titullarit dhe në çdo rast janë nënshkruar rregullisht nga personat përgjegjës. Nuk janë evidentuar raste të mungesave apo dëmtimeve me dashje të aktiveve.

- Lidhur me procedurat për përcaktimin e gjurmëve të auditimit, zonave me risk, mbi bazën e të cilave duhet përpiluar strategjia për menaxhimin e riskut, rezulton se Gjurmët e auditit janë hartuar bazuar në Vendimet e KM, Udhëzimet përkatëse, objektivat e përcaktuara nga Institucioni sipas natyrës të objektit për të cilën hartohet gjurma e auditit.

Për evidentimin e zonave me risk, është mbështetur në raportet e auditimeve të ushtruara në Institucion dhe rekomandimeve të lëna për zbatim.

- Regjistri i riskut është hapur dhe rezulton konform formatit standard të përcaktuar në manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe për vitin 2016 është dërguar në MPB me shkresë nr. 351/1 prot, datë 18.01.2016, ndërsa për vitin 2017, është dërguar me shkresë nr. 253/1, datë 16.01.2016.

Lidhur me konstatimet për Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm.

Nga auditimi për implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar, udhëzimeve të Ministrisë së Financave në zbatim të tij dhe shkresës nr. 6082 datë 16.03.2011 të Ministrisë së Financave "*Hapat që duhen ndjekur nga njësitë publike për implementimin e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"*, i ndryshuar dhe konstatohet se :

- Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, sipas kërkesave të nenit 8, të ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 dhe konkretisht :

Grupi i Menaxhimit Strategjik është ngritur me Urdhër nr. 11, datë 13.02.2013; nr. 10, datë 20.01.2014; nr. 14, datë 02.02.2015; nr. 14, datë 08.02.2016; si dhe nr. 12, datë 13.01.2017; të titullarit të Institucionit i përbërë nga 5 anëtarë, me kryetar Sekretarin e Përgjithshme znj E. B., sekretare A. Ç. nëpunësi zbatues dhe anëtarë përgjegjësit e sektorëve A.G., E.S. dhe I.K., *(menaxherë të lartë të institucionit).*

Edhe për periudhën 9 mujore të vitit 2017 GMS është ngritur me Urdhërin nr. 12, datë 13.01.2017 *"Për ngritjen e komisionit për identifikim dhe menaxhimin e riskut, si dhe hartimin e regjistrit të*

riskut" i përbërë nga 5 anëtarë me kryetar Sekretarin e Përgjithshëm, sekretar nëpunësi zbatuas dhe anëtarë përgjegjësat e sektorëve *(menaxherë të lartë të institucionit).*

- Nga titullari i instuticionit, për çdo vit del se është përpiluar raporti për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe në zbatim të nenit 18, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" si dhe* sipas shkresës nr. 188/2 datë 23.3.2012, të Ministrisë së Financave, janë dërguar Ministrisë Brendshme dhe konkretisht:

- Me shkresën nr. 2532/1 prot, datë 13.12.2014, është dërguar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan për vitin 2013, Deklarata për cilësinë e kntrollit të brendshëm, pyetësori të vetëvlerësimit dhe regjistri i riskut për vitin 2013.

Me shkresën nr. 188/1 prot, datë 20.01.2015, është dërguar në Ministrinë e Punëve të Brendshme Raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan për vitin 2014, Deklarata për cilësinë e kntrollit të brendshëm, pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistri i riskut për vitin 2014.

Me shkresën nr. 351/1 prot, datë 18.01.2016 është dërguar në Ministrinë e Punëve të Brendshme Raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan për vitin 2015, Deklarata për cilësinë e kntrollit të brendshëm, pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistri i riskut për vitin 2015.

Me shkresën nr. 253/1 prot, datë 16.01.2017 është dërguar në Ministrinë e Punëve të Brendshme Raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan për vitin 2016, Deklarata për cilësinë e kontrollit të brendshëm, pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistri i riskut për vitin 2016.

Lidhur me kryerjen e vlerësimeve dhe rekomandimeve për funksionimin e sistemit të kontrollit me dy firma, si dhe përdorimin e mjeteve financiare dhe administrimin e pasurisë publike, konkretisht rezulton se:

Bazuar mbi gjetjet e evidentuara në raportin e vetëvlerësimit, është dhënë një vlerësim mbi pikat e forta kryesore, aspektet pozitive të zhvillimit të MFK si dhe fushat për zhvillim të mëtejshëm.

Gjithashtu janë evidentuar pikat e dobëta si dhe rekomandimet për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të MFK-së, ku një pikë e vlerësuar është sistemi me dy firma, i cili ka minimizuar nivelin e riskut mbi përdorimin e mjeteve financiare.

Lidhur me funksionimin e sistemit me dy firma, për urdhër shpenzimet, për daljet nga magazina dhe për blerjet me vlera të vogla, konstatohet se:

Në Institucionin e Prefektit ka funksionuar sistemi i firmës së dyfishtë, kështu :

Urdhër shpenzimet firmosen nga Nëpunësi Autorizues, Titullari i Institucionit dhe Nëpunësi zbatues, si dhe Përgjegjës i sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse;

Janë audituar me zgjedhje Listpagesat, për periudhën prill - qershor 2014, të cilat firmosen nga specialisti i shërbimeve i ngarkuar për hartimin e listprezencës, specialisti i financës, nënpunësi zbatues dhe titullari i institucionit.

Janë audituar daljet nga magazine, për periudhën shtator - nëntor 2015, të cilat janë lëshuar urdhër dorëzimet nga specialisti i shërbimeve, urdhër dorëzime të konfirmuara nga përgjegjësja e sektorit të financës dhe të firmosura nga kërkuesi i mallit, ky urdhër dorëzimi i përcillet specialistit të ngarkuar për përgjegjësi materiale i cili përpilon fletë daljen dhe bën dorëzimin e mallit tek personi kërkues.

Kontabilisti i vlerave materiale bën verifikimin dhe konfirmimin e lëvizjes së vlerave materiale dhe regjistrimin e tyre ne ditarët dhe partitarët përkatës.

Është audituar me zgjedhje procedurat për blerjet me vlerë të vogël, për periudhën janar-mars 2016, dhe pas përfundimit të procedurës së prokurimit fatura e blerjes firmoset nga komisioni i blerjeve me vlerë të vogël, përbërë nga 3 anëtarë, nëse malli merret në dorëzim nga komisioni i marrjes në dorëzim dhe më pas si kryhen hyrjet, nga specialisti me përgjegjësi materiale dhe doli

se janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"*.
- Lidhur me zbatimin e rregullave për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme, sipas kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* kap. III. *konstatohet se:*
Në Institucionin e Prefektit janë hapur regjistrat e aktiveve, në përputhje me dispozitat ligjore duke plotësuar rregullisht për çdo aktiv të dhënat e tij si: vitin e prodhimit, ndërtimit apo hyrjes në përdorim, tipin, markën, numrin e shasisë *(sipas rastit)*, vlerën fillestare, amortizimin vjetor dhe atë të akumuluar, bazuar ne normativat e amortizimit sipas llojit të tyre, vlerën e mbetur, personin përgjegjës si dhe gjendjen aktuale.
- Lidhur me rregullat e shkruara për ndjekjen dhe zbatimin e investimeve sipas kontratave me të tretët, për afatet e kryerjes së punimeve, ndjekjen e financimit etj, rezulton se:
Për periudhën objekt auditimi nuk ka patur investime në ndërtim dhe konstruksione.
- Lidhur me mbajtjen e programeve vjetore afat mesme dhe strategjike, rezulton se:
Çdo vit nga Institucioni janë hartuar projekt buxheti afat mesëm sipas programeve buxhetore (*Aparat, PMNZH, Gjendje civile*) të cilat janë dërguar në Ministrinë e Punëve të Brendshme sipas afate të përcaktuara. Programet afat mesme, në çdo rast janë hartuar nga Përgjegjësja e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, pasi për çdo vit buxhetor bazuar në udhëzimin për përgatitjen e projekt buxhetit afat mesëm të nxjerrë nga Ministria e Financës, me urdhër të titullari është ngritur komisioni për hartimin e projekt buxhetit afat mesëm dhe pasi është ngritur komisioni është bërë hartimin i projekt buxhetit, sipas këtyre urdhrave.
1. Urdhër i Brendshëm nr. 96, datë 04.09.2014 "Për ngritjen e komisionit për hartimin e Projekt Buxhetit për vitin 2015-2017";
2. Urdhër i Brendshëm nr. 25, datë 25.03.2015 "Për ngritjen e komisionit për hartimin e Projekt Buxhetit për vitin 2016-2018";
3. Urdhër i Brendshëm nr. 44, datë 02.08.2016 "Për ngritjen e komisionit për hartimin e Projekt Buxhetit për vitin 2017-2019";
4. Urdhër i Brendshëm nr. 23, datë 24.03.2017 "Për ngritjen e komisionit për hartimin e Projekt Buxhetit për vitin 2018-2020".
- Lidhur me faktin se si nga ana e Titullarit të njësisë publike, në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, hartimin e politikave për miratimin dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ka në administrim prefektura, si dhe strukturën e auditimi të brendshëm, rezulton se :
- Nga menaxhimi i lartë Institucionit, ç`do muaj kërkohet pasqyrim i punës së kryer dhe përputhja e saj me objektivat e vendosura.
Në fund të ç`do viti buxhetor hartohet raporti i veprimtarisë institucionale për realizimin e objektivave të vendosura si dhe lihen detyra për zbatim për vitin pasardhës.
Për sa më sipër është mbajtur akt-verifikimi nr. 1, datë 13.11.2017 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, përfaqësuar nga znj. A. Ç. me detyrë përgjegjëse e sektorit të financës, me shkresë nr. 1299/25, datë 24.11.2017 ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:
-Lidhur me mbajtjen e programeve vjetore afat mesme dhe strategjike rezulton se:
Çdo vit nga institucioni ka hartuar projekt buxhetin afat mesëm sipas programeve buxhetore (Aparat, PMNZSH, Gjendje Civile) të cilat janë dërguar në Ministrinë e Punve të Brendshme sipas afateve të përcaktuara. Programet afat mesme, në çdo rast janë hartuar nga përgjegjësja e Sektorit Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, **por nuk janë ngritur komisione apo ekipe menaxhimi.**
Përsa i përket kësaj pike ne paraqesim kundërshtimin tonë pasi për çdo vit buxhetor bazuar në udhëzimin për përgatitjen e projekt buxhetit afat mesëm të nxjerrë nga Ministria e Financës, me urdhër të titullari është ngritur komisioni për hartimin e projekt buxhetit afat mesëm dhe pasi është ngritur komisioni është bërë hartimin i projekt buxhetit, sipas fotokopje të urdhrave.

Qëndrimet e auditusve.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se nga ana e grupit të auditimit merret në konsideratë, duke u bërë reflektimi në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Auditimi për organizimin e funksionimin e auditit të brendshëm.

Funksioni i auditit të brendshëm, është realizuar nga Sektori i Auditimit, i ngritur pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, bazuar në Ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", të ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010, "Manualin e Auditimit të Brendshëm" të miratuar me Urdhërin nr. 69, datë 29.09.2010 të Ministrit të Financave, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 212, datë 30.03.2012 "Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik" si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 12, datë 05.06.2012 *"Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik"*.

Në Prefekturën e Qarkut Elbasan, struktura është organizuar në nivel Sektori, me varësi të drejtpërdrejtë nga Prefekti i Qarkut Elbasan dhe përbëhej nga një përgjegjës dhe 4 auditues që mbulonin me auditim 5 Bashki, 44 Komuna dhe Këshillin e Qarkut Elbasan.

Detyra dhe misioni i këtij sektori ishte të ushtronte auditime për vlerësimin e zbatimit të ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe eficencës për miradministrimin e fondeve të buxhetit dhe veprimtarisë ekonomiko-financiare të Njësive të Qeverisjes Vendore të Qarkut Elbasan, duke dhënë rekomandime për titullarin e njësisë në drejtim të përmirësimit të veprimtarisë së subjektit dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Audituesit e këtij Sektori janë kryesisht ekonomistë dhe me përvojë pune.

Sektori i Auditimit gjatë viteve 2014 dhe 2015 ka funksionuar me 4 auditues, pra me 1 më pak nga struktura e miratuar, ku për çdo rast është shpallur vendi vakant nga Departamenti i Administratës publike për plotësimin e këtij pozicioni, por nuk është plotësuar.

Emërimet nga Prefekti i Qarkut dhe konfirmimet e Statusit të Nëpunësit Civil nga Departamenti i Administratës Publike, për audituesit e këtij Sektori, janë si më poshtë:

- B. Sh., Përgjegjësi i Sektorit, emëruar me urdhrin nr. 64, datë 18.11.2013 të Prefektit të Qarkut largohet me dorëheqje sipas shkresës nr. 64, datë 15.09.2015.
- Xh. K., Inspektor Auditi, emëruar me Urdhërin nr. 32/1, datë 25.02.2014 nga Prefekti i Qarkut, larguar sipas urdhërit nr. 133, datë 17.11.2014 "Për mosplotësim të kritereve për të qenë nënpunës civil", miratuar me shkresë të DAP Tiranë nr. 3272/25, datë 30.10.2014.
- Xh. K., Inspektor Auditi, emëruar në vitin 2006 nga Prefekti i Qarkut, sipas Urdhrit nr. 80, datë 04.07.2006, larguar nga detyra me shkresë nr. 45, datë 08.10.2013, pension pleqërie.
- P. B., Inspektor Auditi, emëruar në vitin 2006 nga Prefekti i Qarkut, sipas Urdhrit nr. 80, datë 04.07.2006, larguar nga detyra me shkresë nr. 18, datë 23.01.2014, pension pleqërie, i cili zëvendësohet nga H. K., sipas urdhër emërimit përkatës.
- Xh. H., Inspektor Auditi, emëruar me urdhrin nr. 126, datë 16.11.2005 të Prefektit të Qarkut, konfirmuar si Nëpunëse Civile nga DAP me shkresën nr. 3272/28, datë 17.11.2014, kalim në sektorin e kompetencave vendore, sipas shkresë nr. 505/11, datë 12.04.2016.
- A. G., Inspektor Auditi, emëruar me urdhrin nr. 37, datë 24.03.2010 të Prefektit të Qarkut dhe konfirmuar si Nëpunëse Civile nga DAP me shkresën nr. 3272/11, datë 30.10.2014, transferuar në sektor tjetër detyrë juriste, sipas shkresë nr. 505/6, datë 12.04.2016.
- J. Sh., Inspektor Auditi, emëruar me urdhrin nr. 38, datë 19.06.2012 të Prefektit të Qarkut dhe konfirmuar si Nëpunëse Civile nga DAP me shkresën nr. 3272/32, datë 26.01.2016, kalim specialist në sektorin financiar, sipas shkresë nr. 505/21, datë 12.04.2016.
- H. K., Inspektor Auditi, emëruar me urdhrin nr. 18, datë 23.01.2014 të Prefektit të Qarkut dhe konfirmuar si Nëpunëse Civile nga DAP me shkresën nr. 7343/3, datë 23.01.2014, transferuar specialist në sektorin e kompetencave vendore, sipas shkresë nr. 505/10, datë 12.04.2016.

Të gjithë audituesit janë të pajisur me dëshminë "Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik", sipas përcaktimeve të bëra në Neni 19 "Punësimi" i ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 "për Auditimin e

brendshëm në Sektorin Publik" të ndryshuar, përjashtuar 1 rast të inspektorit Xheladin Karkini, i cili ka punuar 9 muaj, i pa konfirmuar si Nëpunës Civil nga DAP dhe larguar sipas urdhërit nr. 133, datë 17.11.2014 "Për mosplotësim të kritereve për të qenë nëpunës civil".

Hartimi dhe miratimi nga titullari i njësisë vendore të planit mujor dhe vjetor të auditimit.

Planet vjetore dhe strategjike, ishin hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 9720, Datë 23.04.2007 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*", i ndryshuar me Ligjin Nr. 10318, Datë 16.09.2010, neni 18 "*Detyrat e njësisë së auditimit të brendshëm*" pika 2, Urdhrit Nr. 69, Datë 29.09.2010 të Ministrit të Financave "*Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik*", kapitulli II "*Programimi i veprimtarive të auditimit të brendshëm*", Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 12, Datë 05.06.2012 "*Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik*", pika 2.3 si dhe shkresave të dërguara nga Njësia Qendore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm pranë Ministrisë së Financave.

Planifikimi vjetor ishte bërë duke u bazuar në vlerësimin e riskut dhe misionet e auditimit ishin orientuar në njësitë dhe në zonat me risqe më të larta që kishin ndikim të rëndësishëm në arritjen e objektivave të menaxhimit, duke përcaktuar prioritetet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm, në pajtueshmëri me qëllimet e organizatës.

Në procesin e hartimit të planit vjetor e strategjik është pasur parasysh: Vlerësimi i risqeve të përgjithshme me të cilat përballen njësitë dhe kuadri ligjor e rregullator ku ato operojnë, Raportet e mëparshme të audititmit në këto njësi, Vlerësimi paraprak i sistemeve të menaxhimit e kontrollit të brendshëm në këto njësi, duke identifikuar anët e forta dhe dobësitë e tyre si dhe shqyrtimi i masave të marra nga njësitë, për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të ushtruara.

Njësitë e vlerësuara me nivel të lartë risku, janë parashikuar me një frekuencë më të shpeshtë auditimi, një herë në vit, ndërsa njësitë e vlerësuara më nivel më të ulët risku, janë parashikuar me një frekuencë më të gjatë, deri në 18 muaj.

Auditimi mbi strukturën dhe aktivitetin të sektorit AB për periudhën 2013-2015.

Struktura e auditimit në Institucionin e Prefektit të qarkut Elbasan, për periudhën e audituar, është e organizuar në "**Sektori Auditimit të Brendshëm"**. Kjo strukturë përfshihet në administratën e Prefektit, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit "Për strukturën dhe organikën e administratës të Prefektit të qarkut Elbasan".

Struktura e auditimit në Prefekturën e qarkut Elbasan, për periudhën e audituar, është e organizuar në sektor, me emërtimin **Sektori Auditimit të Brendshëm**. SAB përfshihet në strukturën e administratës së Prefektit të qarkut Elbasan, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 87, datë 21.02.2014 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të qarkut Elbasan".

Përbërja e Sektorit të Auditimit, referuar organikes, ishte me 5 punonjës, si me poshtë:

-1 Përgjegjës Sektori (ekonomist)

-5 Inspektor Audit, nga të cilët 4 ekonomistë dhe 1 jurist.

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", janë certifikuar si "Audit i Brendshëm në Sektorin Publik" 3 punonjës të këtij sektori, ndërsa vazhdojnë frekuentimin e programit për certifikim pranë NJQH, 2 punonjës.

Aktivteti i kësaj strukture ka vazhduar deri në fund te vitit 2015. Më pas kjo strukture ka pushuar së funksionuari, bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr. 9, datë 12.01.2016 *"Mbi miratimin e strukturës dhe organikës të administratës të Prefektit të Qarkut Elbasan"*, urdhër i cili në strukturën për vitin 2016 dhe në vazhdim nuk ka parashikuar strukturë auditimi në ketë institucion.

Sektori i Auditimit të Brendshëm për periudhën e funksionimit vepronte si strukturë në vartësi të plotë administrative dhe pjesë përbërëse e Institucionit të Prefektit.

Ushtrimi i auditimeve nga inspektorët është bërë i mundur vetëm nëpërmjet miratimit me shkrim të programit të kontrollit dhe autorizimit përkatës nga Prefekti. Gjithashtu përfundimet e auditimit

(rekomandimet dhe detyrat) u njoftoheshin zyrtarisht subjekteve të audituara me shkresë të veçantë të Prefektit.
Në respektim të pavarësisë që ka pushteti vendor, auditimi i këtyre njësive rregullohej nëpërmjet akt-marrëveshjeve të lidhura me drejtuesit e njësive vendore, në zbatim të Udhëzimit nr. 12, datë 05.06.2012, "Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik".
Në mënyrë të përcaktuar aktivitetit i sektorit bazohej në planin vjetor të miratuar nga Prefekti. Rast pas rasti, në zbatim të këtij plani, hartoheshin në afatet respektive programet e auditimit të cilat pasi firmoseshin tek Prefekti u njoftoheshin subjekteve përkatese. E gjithë procedura nga njoftimi i subjektit deri në përfundim të raportit final të auditimit bëhej në respektim të manualit përkatës të auditimit. Nuk konstatohet ndonjë rast i kryerjes së procedurës audituese jashtë këtyre përcaktimeve.
Sektori Auditimit, në zbatim të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" , i ndryshuar dhe të planit vjetor të auditimeve, kishte objekt të aktivitetit të tij auditimet e plota apo tematike në subjektet e pushtetit vendor në qark, subjekte të cilat nuk e kishin të organizuar shërbimin e auditimit të brendshëm në institucionin e tyre. Në zbatim të ligjit në asnjë rast nuk rezulton që të kishte subjekte për të cilat nuk është kryer auditim për një periudhë më të madhe se 2 vjet.
Për ç'do auditim të kryer ishin evaduar në kohë raportet finale të auditimit dhe rekomandimet përkatëse. Për subjektet e audituara ndjekja e përmbushjes së rekomandimeve të lëna ishte planifikuar të kryhej gjatë kohës së kryerjes të auditimit të radhës. Në rastet kur afatet e përmbushjes së rekomandimeve konsideroheshin të prioritetit të lartë, ndjekja për zbatimin e tyre bëhej me tematikë të vecantë. Pasqyrimi i konstatimeve në lidhje me to, në rastin ku bëhej së bashku me aditimin e radhës, përfshihej në një rubrikë të veçantë të raportit përfundimtar të auditimit. Të gjithë treguesit mbi realizimin e planit vjetor si dhe zbulimeve të bëra gjatë procesit të auditimit ishin zbardhur në evidencat përkatëse të cilat ishin përcjellë në afatet e përcaktuara.
Nisur nga realizimet faktike, të planit të auditimeve si dhe të treguesve të tjerë të cilët kanë lidhje me zbulimet dhe treguesit e përformancës, konstatohet që objektivat dhe detyrat e Sektorit të Auditimit për periudhën e audituar janë realizuar në përputhje pritshmërisë në kuotat e planifikuara.
Për te gjithë periudhën e audituar, për çdo vit ishte ishin hartuar nga sektori planet vjetore dhe ato strategjike, me të gjitha përcaktimet dhe formatet e kërkuara nga Manuali i Auditimit të Brendshëm.
Në planet strategjike ishte përcaktuar puna që do të kryhej nga struktura AB. Planet ishin fokusuar në ato sisteme dhe fusha të NJQV objekti i veprimtarisë së të cilave vlerësohej më me risk, vlerësimi për të cilin bëhej sipas metodologjisë së përcaktuar në manualin e auditimit të brendshëm dhe manualin specifik të auditimit, dokument i cili ekzistonte ne institucion dhe ishte miratuar nga Prefekti i Qarkut.
Në Planin Strategjik ishin parashikuar veprimtaritë kryesore të shtrira në të gjitha aktivitetet e njësive të qeverisjes vendore. Sektori i Auditimit të Brendshëm, në Institucionin e Prefektit te qarkut do të ushtrojë veprimtarinë e tij audituese, në mbështetje të kërkesave të përcaktuara në zbatim të Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", në Ligjin nr. 8927, datë 25.07.2002 "Për Prefektin", Ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, Manualit të ri të auditimit të brendshëm sipas urdhrit të Ministrit të Financave nr. 69, datë 29.09.2010, dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 12, datë 05.06.2012 "Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik"
Vlerësimi i riskut ishte bërë mbi bazën e analizës së faktorëve të cilët kanë mundësinë më të madhe për të shkaktuar një ngjarje të papritur që mund të ketë ndikim në arritjen e objektivave të

organizatës dhe natyrisht duke i dhënë prioritet gjithashtu dhe fushave të cilat kanë mundësinë më të lartë për të patur një ndikim negativ nga ndodhja e kësaj ngjarjeje.
Në formularin standard bashkangjitur planeve strategjike paraqitej një analizë më e detajuar me faktorët evident që mund te rrezikojnë objektivat e organizatave të planifikuara për auditim.
Përcaktimi i frekuencës dhe i afateve kohore të misioneve të auditimit për njësite që janë planifikuar është bërë për të dhënë një vlerësim të konsiderueshëm të sistemeve dhe fushave ekzistuese. Në planin strategjik janë përfshijë të gjithë sistemet e identifikuara, me një frekuencë një herë në dy vjet. Nisur dhe nga kapacitetet e njësisë së auditimit jane parashikuar numri i auditimeve të plota brenda një viti kalendarik.
Bazuar në vlerësimin e riskut, në përcaktimin e prioriteteve të punës si dhe në përcaktimin e fushave prioritare të auditimit ishte ndërtuar grafiku i realizimit të auditimeve për ç`do vit.
Bazuar në planet vjetore lidhur me auditimet e planifikuara dhe ato te realizuara kemi situatën sa më poshtë:
-Viti 2013 ishin planifikuar të kryhen 24 auditime.
Janë kryer në fakt 23 auditime të plota dhe 3 auditime tematike.
Nga subjektet e planifikuara nuk ishte kryer auditim në bashkinë Belsh, sepse në të njëjtë periudhë, referuar planit, në këtë subjekt ishte duke kryer auditim KLSH.
Ne total dëmi ekonomik i zbuluar për këtë vit ishte 69.127.000 lekë nga i cili;
- Evazion fiskal 68.424.000 lekë
- Shkelje e disiplinës financiare 706.000 lekë.
-Viti 2014 jane planifikuar të kryhen 27 auditime.
Janë kryer në fakt 26 auditime të plota dhe 4 auditime tematike.
Nga subjektet e planifikuara nuk ishte kryer auditim në 3 subjekte dhe konkretisht:
- Këshilli i Qarkut Elbasan;
- Bashkia Peqin dhe
- Komuna Labinot Mal, pasi në kohën e planifikimit këto objekte ishin në auditim nga KLSH.
Ne total dëmi ekonomik i zbuluar për këtë vit ishte 104.142.000 lekë nga i cili;
- Evazion fiskal 103.108.000 lekë
- Shkelje e disiplinës financiare 1.034.000 lekë.
-Viti 2015 jane planifikuar të kryhen 21 auditime.
Auditimet për këtë vit kishin vazhduar normalisht deri në muajin qershor 2015 dhe më pas si rezultat i implementimit të ligjit të ri të reformës administrative ishte krijuar një situatë e re e cila kishte sjellë si rezultat ndalimin e aktivitetit të sektorit të auditimit.
Për periudhën 6 mujore ishin planifikuar 13 auditime dhe ishin kryer në fakt 13 auditime të plota.
Ne total dëmi ekonomik i zbuluar për këtë periudhë ishte 66.212.000 lekë nga i cili;
- Evazion fiskal 66.075.000 lekë
- Shkelje e disiplinës financiare 137.000 lekë.

Vlerësimi i dosjeve të auditimit.

Për të tre vitet e sudituara u përzgjodhe për tu audituar, 9 dosje, nga 3 për ç`do vit në këto subjekte:
- për vitin 2013 u përzgjodhën; bashkia Cerrik, komuna Shirgjan dhe komuna Bradashesh.
- për vitin 2014 u përzgjodhën; bashkia Belsh, komuna Rrajcë dhe komuna Gjocaj.
- për vitin 2015 u përzgjodhën; komuna Mollas, komuna Qukës dhe komuna Pajovë.

Konstatohet se dosjet e auditimit janë të plotësuara me elementet kryesorë të një dosje uditimi, përcaktuar nga manuali i Auditimit të Brendshëm.
Ç`do dosje ishte e plotësuar me fletën e inventarit, shkresën për ushtrim auditimi, raportin final, përfundimet e angazhimit të auditimit, shkresën përcjellëse të raportit final, memorandumin, njoftimin për ushtrim auditimi, autorizimin për fillimin e auditimit, urdhrin e shërbimit, propozimin për ndarjen e detyrave, tematikën e auditimit, deklaratat e pavarësisë te nënshkruara

nga audituesit, protokolli i takimit prezantues, projekt raporti, shkresa përcjellëse e projekt raportit raporti i vlerësimit dhe fletët e punës.
Në një vlerësim të raportit final të auditimit konstatohet që ai të jete ndërtuar sipas rubrikave përkatëse të përcaktuara për auditim dhe në asnjë rast nuk konstatohet që të ketë devijime nga programi i auditimit i cili për ç`do rast ishte i firmosur nga përgjegjësi i auditimit.
Në dosje gjendej projekt raporti i auditit me te gjitha rubrikat e audituara nga inspektorët pjesëmarrës në auditim dhe rubrikat e audituara ishin në përputhje me protokollin e ndarjes së detyrave.

Auditimi mbi vlerësimin e rekomandimeve te lëna.

Në të gjitha rastet, në përfundim të angazhimit të auditimit hartohej nga grupi i auditimit rubrika me rekomandimet, Përfundimet e angazhimit të auditimit janë përcjellë në subjektin e audituar me shkresë të veçantë e cila firmosej nga Prefekti.
Rekomandimet e lëna përgjithësisht ishin të studiuara dhe ato synonin përmirësimin e aktivitetit në njësinë e audituar.
Mangësi për këtë u konstatua se nuk ishin programuar në fund të çdo viti për tu verifikuar zbatimi i rekomandimeve të lëna.
Gjithashtu për periudhën nën auditim vitet 2013-2015, në lidhje me "*Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve*", nuk na u vu në dispozicion dosja për çdo vit të shkresave për raportimin e evidencave të AB.
Nga verifikimi i kryer për hartimin dhe miratimin e planeve vjetore e strategjike rezulton se ato janë hartuar në përputhje me dispozitat ligjore për Auditimin e Brendshëm. Për të gjithë periudhën objekt kontrolli janë të nënshkruara rregullisht nga të gjithë audituesit Deklaratat e Objektivitetit, Kompetencës dhe Paanësisë (Formulari Nr. 2). Gjithashtu janë plotësuar dhe nënshkruar nga Përgjegjësi i Sektorit për çdo vit Formatet Standard të përcaktuar për çdo Njësi të Qeverisjes Vendore të Qarkut, të parashikuar për t'u audituar:
Standart nr. 3 "Pyetësori për Planin Strategjik "të kuptosh procedurat e auditimit të brendshëm".
Formati Standard 4 "Identifikimi i Sistemit të Organizatës"
Formati Standard 5 "Lidhja midis riskut dhe punës të planifikuar të auditimit"
Formati Standard 7 "Pyetësor Vlerësimi për kontrollin e brendshëm".
Ishin hartuar çdo muaj, plane mujore si dhe informacione mbi punën e kryer gjatë muajit, të cilat ishin përpiluar nga përgjegjësi i Sektorit dhe miratuar rregullisht nga Prefekti i Qarkut Elbasan.
Për çdo auditim, ishin hartuar programe të veçanta auditimi, të cilat përmbanin: llojin e auditimit, objektin e auditimit, periudhën që do të auditohej, afatin për kryerjen e auditimit, grupin e punës, tematikën e auditimit, bazën ligjore si dhe ndarjen e detyrave nga audituesit. Programet ishin nënshkruar nga grupi i punës, ishin konfirmuar nga përgjegjësi i Sektorit si dhe ishin miratuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Zbatimi i planit të auditimit:

Plani i miratuar i auditimit është zbatuar plotësisht çdo vit nga Sektori i Auditimit, duke realizuar numrin e auditimeve të plota apo të pjesshme.
Për të gjithë periudhën e audituar, janë plotësuar pasqyrat e evidencave me të gjitha të dhënat e kërkuara sipas Formateve e konkretisht:
Formati 1 "Përbërja profesionale e niveli i kualifikimit të punonjësve".
Formati 2 "Realizimi i programit nga Njësia e Auditimit të Brendshëm".
Formati 3 "Gjetjet të ndara sipas sistemeve realizuar nga Sektori i Auditimit".
Formati 4 "Rekomandimet e dhëna nga SA sipas prioriteteve".
Raporti i Veprimtarisë së Sektorit, është miratuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan dhe përmban të dhënat e kërkuara si: përmbledhjen ekzekutive, bazën ligjore, organizimin, rezultatet e veprimtarisë se sektorit, rekomandimet, monitorimin e sistemit e sigurimin e cilësisë, analizën e kapaciteteve audituese dhe konkluzionet.

Zbatimi i procedurave standarde në kryerjen e auditimeve, gjetjet, masat dhe rekomandimet e lëna për përmirësimin e punës, ndjekja e zbatimit të tyre:
Nga Sektori i Auditimit, për çdo auditim të realizuar, ishte hapur dosje e veçantë, e cila ishte inventarizuar dhe dorëzuar në arkivin e Prefektit të Qarkut duke u nënshkruar nga përgjegjësi i Sektorit B. Sh., ndërsa arkiva ndodhet në ish-zyrën e auditit.
Çdo dosje përmbante dokumentacionin si: Fletën e inventarit, Përmbledhësen e gjetjeve, Formatin Standard 17 "Indeksi i sugjeruar për dosjet e auditimit", Formatet Standarde 3, 4, 5 e 7, Njoftimin për fillimin e Angazhimit, Autorizimin (sipas Aneksit 4), Urdhërshërbimin, Deklaratat e Pavarësisë (sipas Formatit Standard 2), Procesverbalin e Takimit Fillestar me njësinë (Formati Standart 9), Programin e Auditimit, Procesverbalin e Takimit Përmbyllës, Projekt Raportin, Raportin Final, Planin e Veprimit të nënshkruar rregullisht nga njësia që auditohej, Memorandumin, Shkresën e Prefektit "Mbi përfundimet e angazhimit të auditimit", Aneksin 7 "Përgjegjësitë e rishikimit të cilësisë së punës nga përgjegjësi i grupit e drejtuesi i njësisë" dhe Formatin Standard 14 "Lista verifikuese e evadimit të auditimit". Në dosje ndodheshin dhe shënimet e audituesve.
Janë hapur e plotësuar rregullisht, në formë elektronike, regjistrat e auditimeve të planifikuara e realizuar, me të gjitha të dhënat e rezultuara nga auditimet, për të gjithë periudhën objekt kontrolli.
Gjetjet e konstatuara, për periudhën 01.01.2013 – 31.12.2015, kanë ardhur për arsye të ndryshme, por kryesisht në fushën e zbatimit të akteve ligjore dhe proceduriale, deri në moszbatim apo keqinterpretim të VKM-ve apo ligjeve. Pjesën më të madhe të gjetjeve e përbëjnë konstatimet për evazion fiskal dhe shkelje të disiplinës financiare nga NjQV, sipas vlerave të rezultuara nga auditimi për çdo vit. Për këtë arsye arkëtimi i të ardhurave nga tatim taksat mbetet problem madhor, i cili është trajtuar thuajse në çdo raport auditimi duke përcaktuar qartë dispozitat ligjore por edhe personat përgjegjës.
Në përgjithësi, në të gjitha Njësitë e Qeverisjes Vendore të Qarkut Elbasan, sistemet e kontrollit të brendshëm kanë funksionuar pjesërisht dhe nga Sektori i Auditimit është theksuar nevoja që menaxhimi i lartë duhet të përcaktojë udhëzime dhe procedura të qarta të këtyre kontrolleve. Gjithashtu kontrollet e brendshme duhet të rishikohen dhe të përshtaten, pasi nuk ofrojnë sigurinë e duhur se objektivat e përcaktuara të njësisë po arrihen.
Vlerësimet e Sektorit të Auditimit përcaktojnë se kontrollet e brendshme të vendosura, nuk përmbushin mjaftueshëm objektivat e synuara nga menaxhimi dhe të përcaktuara në dispozitat ligjore. Sistemi i kontrollit të brendshëm në Njësitë e Qeverisjes Vendore të Qarkut Elbasan, shoqërohet ende me mangësi dhe nuk siguron se niveli i rrezikut për gabime dhe parregullsi është reduktuar në nivelin minimal.
Njësitë e audituara kanë reaguar pozitivisht dhe i janë përgjigjur rekomandimeve të auditimit për korrigjimin e parregullsive, të cilat kanë shërbyer për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe shtimin e vlerës së subjekteve. Përgjithësisht njësitë e audituara kanë bashkëpunuar me grupet e auditimit për të diskutuar, pranuar dhe zbatuar ato rekomandime që janë të bazuara në gjetjet e auditimit, si dhe ndihmojnë subjektin në përmirësimin e punës, ndreqjen e parregullsive, por edhe në evidentimin e përgjegjësive dhe shmangien e tyre në vijim.
Sektori i Auditimit ka pezulluar funksionimin e tij në datën 14.01.2016, në zbatim të shkresës Nr. 9 datë 12.01.2016 të Kryeministrit të Shqipërisë*, "Mbi miratimin e strukturës dhe organikës të administratës të Prefektit të Qarkut Elbasan".*
Problematika të konstatuara:
Sektori i Auditimit gjatë vitit 2013 ka funksionuar me 5 persona nga të cilët një përgjegjës sektori, për vitin 2014 struktura në bazë të Urdhrit të Kryeministrit me shkresë nr. 87, datë 21.02.2014 është miratuar me 6 veta nga këto një përgjegjës, por me datë 15.10.2014 largohet auditi Xh. K., për mos plotësim kriteresh për të qenë nëpunës civil dhe që nga ai moment nuk është plotësuar vendi vakant, megjithëse është shpallur nga Deparatmenti i Administratës Publike, sipas shkresës nr. 3465/4, datë 20.10.2015, pra nuk është plotësuar ky pozicion pune. Gjithashtu për vitin 2015,

me datë 15.09.2015 është dorëhequr përgjegjësi i sektorit z. B. Sh. dhe ky sektor ka funksionuar pa patur përgjegjës sektori prej datës 15.09.2015 e në vazhdim dhe me një audit më pak. Edhe për këtë pozicion është shpalluar nga Deparatmenti i Administratës Publike, por nuk është plotësuar deri në fund të funksionimit.
Bazuar në ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", Neni 10 "Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm" dhe në zbatim të shkresës nr. 9, datë 12.01.2016 të Kryeministrit "Mbi miratimin e strukturës dhe organikës të administratës të Prefektit të Qarkut Elbasan", Sektori i Auditimit ka pezulluar funksionimin e tij në datën 14.01.2016.
Në momentin e daljes të urdhërit të sipërpërmendur, Sektori i Auditimit nuk ka pasur raporte auditimi në proces.
Për problemet e trajtuar më sipër është mbajtur Akt verifikimin nr. 2, datë 13.11.2017.

Auditimi mbi verifikimin në vend nga Sektori Juridik, të akteve të qeverisjeve vendore, me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organet e qeverisjes vendore, si dhe në organizmat që krijohen pranë tyre.
Nga Sektori Juridik pranë Prefekturës së Qarkut Elbasan, për vitet 2015, 2016 dhe më parë në mbështetje të nenit 15 të ligjit nr. 8927, datë 25.07.2002 "Për Prefektin" dhe Kodit të Procedurave Administrative, janë verifikuar në çdo njësi të qeverisjes vendore, vendim-marrjet me karakter normativ drejtpërdrejt dhe sistematikisht në organet e qeverisjes vendore, si dhe në organizmat që krijohen pranë tyre, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan. Këto kontrolle ishin kryer mbi bazën e programeve të kontrollit të hartuara dhe të miratura nga Prefekti, në lidhje me:
Verifikimin e ligjshmërisë së akteve normative të nxjerra nga këshilli i bashkisë.
a. Respektimi i nenit 14 të ligjit nr. 8927 datë 25.07.2002 "Për Prefektin".
b. Respektimi i ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ndryshuar me ligjet nr. 9208, datë 18.03.2004, nr. 30/2015, datë 02.04.2015, ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", procedurat e ndjekura lidhur me thirrjen e këshilltarëve për mbledhje, dokumentacionet, afatet etj.
c. Respektimi i ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.03.2004, nr.30/2015, datë 02.04.2015, ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", procedurat e ndjekura lidhur me shpalljen e akteve të miratuara, dokumentacionet, afatet etj.
d. Zbardhja e akteve të miratuara është bërë në bazë të pasqyrimeve në proces-verbalin e mbledhjes dhe materialeve përkatëse të paraqitur në mbledhje.
e. Rregullorja e brendshme e funksionimit të këshillit. Respektimi i dispozitave të saj në lidhje me siglimin e proces-verbaleve të mbledhjeve etj.
f. Ligjshmëria e akteve normative që nuk janë dërguar për shprehje ligjshmërie tek Prefekti.
Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të nxjerra nga kryetari i bashkisë.
a. Respektimi i pikës 2/a, të nenit 14, të ligjit nr. 8927, datë 25.07.2002 "Për Prefektin".
b. Ligjshmëria e akteve normative që nuk janë dërguar për shprehje ligjshmërie tek prefekti.
Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të nxjerra janë kryer nga specialistët Juriste te Sektorit Juridik në Institucionin e Prefektit Qarkut Elbasan, në bashkitë Librazhd, Përrenjas, Peqin, Cërrik dhe Gramsh, ndërsa në bashkitë Belsh dhe Elbasan këto kontrolle për vitin 2016 nuk janë kryer, por janë parashikuar për vitin 2017.
- Ankesat qytetare të bëra gjatë vitit 2016.
- Në Institucionin Prefektit të Qarkut Elbasan gjatë vitit 2016 kanë ardhur 224 ankesa nga shtetas të ndryshëm. Problematika e tyre ka qene e natyrave të ndryshme si probleme pronësie, moszbatimin të ligjit nga organet e qeverisjes vendore, për leje të shfrytëzimit të ujit, kërkesa për strehim dhe punësim, etj.
Më hollësisht këto probleme janë trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit.

3. Mbi auditimin e zbatimit të buxhetit, për periudhën janar 2013 deri shtator 2017.

Planifikimi i Buxhetit për vitin 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 9 mujori 2017 i Prefekturës Qarkut Elbasan është bërë në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë",* ligjit nr. 185/2013 "Për buxhetin e vitit 2014" dhe udhëzimeve përkatëse të zbatimit të buxhetit të shtetit. Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo muaj. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. **Planifikimi dhe realizimi i buxhetit** i Prefekturës të Qarkut Elbasan për vitit 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 9/mujorin 2017**, sipas artikujve** paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin, sa vijon:

në 000/lekë

		2013		2014		2015		2016		9 muj 2017	
nr	**Emertimi**	**Pl**	**F**	**Pl**	**F**	**Pl**	**F**	**Pl**	**F**	**Pl**	**F**
1	600 -Paga	66,164	65,053	64,335	63,604	66,229	61,139	26,643	25,898	24,976	19,995
2	601 -Sig.Shoq	11,218	10,805	10,781	10,593	11,277	10,186	4,446	4,302	3,871	3,313
3	602 -Shp.Oper	10,931	10,259	28,327	26,701	13,153	12,437	7,110	7,110	6,440	5,362
4	606-Shperb fatk	404	396	554	374	4,573	211	184	184	237	237
5	231- Investime	0	0	536	302	0	0	0	0	0	0
6	604- Emerg.	0	0	0	0	775	774	0	0	0	0
7	466-Kreditore	0	0	0	0	1,112	1,112	1,412	1,412	792	792
	Shuma	**88,817**	**86,513**	**104,533**	**101,579**	**97,119**	**85,859**	**39,795**	**38,906**	**36,316**	**29,699**

Siç shihet nga pasqyra, zërat e buxhetit në total dhe sipas artikujve nuk/ose kanë tejkalime për 4 vite e 9 muaj nën auditim, pasi ato kanë qenë edhe nën mbikëqyrjen e degës thesarit Elbasan. Peshën kryesore e zënë shpenzimet për paga, ndërsa shpenzimet për investime pothuajse nuk ka patur fare. Shpenzimet operative paraqiten në raport të drejtë me shpenzimet për paga dhe nga viti 2013 deri në vitin 2017 kanë tendencë ulje si në planifikimin dhe realizimin e tyre, çka tregon efiçencë, efektivitetit dhe ekonomicitetit të shpenzimeve operative, në zbatim të VKM nr. 472, datë 02.7.2011 "Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore", UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde zbatimit të buxhetit", UMF nr. 1/1 datë 19.2.2013 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2013", UMF nr. 3, datë 17.01.2014 "Për zbatimin e buxhetit vitit 2014", të UMF nr. 2, datë 19.01.2015 "Për zbatimin e buxhetit vitit 2015" dhe ligjit nr. 10.296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Po kështu grafiku shpenzimeve në total dhe në zëra analitikë nga viti në vit është në rënie, përjashtuar vitin 2014 që ka rritje për efekt të rritjes së shpenzimeve operative. Ndikim në uljen e shpenzimeve ka dhënë dhe kalimi i sektorit të PMNZSH pranë pushtetit vendor, bashkive Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Peqin.

Fatura të palikuiduara të Institucionit të Prefekturës së Qarkut Elbasan paraqiten.

Pasqyra e detyrimeve të pa shlyera deri më 30.09.2017

në lekë.

nr	objekti	Firma fituese	V I T E T				Likujduar deri 30.09.2017		
			2013	2014	2015	2016	shuma	datë	Gjendje
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8
1	Taksa bashkie	Bashkia Librazhd	31,120	-	-	-	31,120	23.12.14	0
2	Bojra	Albprint shpk	93,600	-	-	-	93,600	04.08.14	0
3	Paisje për mj zjarrfik	"V.-A" shpk	312,840	-	-	-	312,840	04.08.14	0
4	Ruajtje fizike e obj Prefekt	Kushtrimi 2002 shpk	268,368	-	-	-	268,368	04.08.14	0
5	Taksa bashkie	Bashkia Elbasan	41,220	-	-	-	41,220	23.12.14	0
6	Shpen mirmb mjet transpor	B. K.	98,000	-	-	-	98,000	23.12.14	0

7	Shërbim telefonik	Albtelekom Sha	2,281	-	-	-	2,281	21.02.14	0
8	Shërbim telefonik	Albtelekom Sha	4,917	-	-	-	4,917	10.04.14	0
9	Vendime gjyqësore	18 raste ish-punonj	11,930,663	-	-	-	12,922,468	08.07.14	0
10	Vendime gjyqësore	"Ç" shpk	-	170,710	-	-	170,710	29.10.15	0
11	Vendime gjyqësore	E. G.	-	-	-	205,673	205,673	20.01.17	0
12	Vendime gjyqësore	Q. Xh.	-	-	-	433,631	433,631	22.02.17	0
13	Udhëtim i brendshëm	T. D.	-	-	-	7,500	7,500	06.01.17	0
	Gjithsej		**12,783,009**	**170,710**	**-**	**646,804**	**13,600,523**		**0**

Sipas analizës së pasqyrës së detyrimeve të pashlyera për gjithë periudhën nën auditim prej 13,600,523 lekë del se peshën kryesore e zënë pagesa e vendimeve gjyqësore për rastet e largimeve nga puna të ish-punonjësve për 12,748.177 lekë dhe pagesën e kanë fituar nëpërmjet vendimeve gjyqësore**,** pasi ato nuk janë kryer vullnetarisht por me anë të zyrës së përmbarimit, të cilës i janë paguar tarifat përmbarimore e cila përbën një shpenzim jo efikas për buxhetin e shtetit, veprim në kundërshtim me pikën 62 të Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, pika 38, të Udhëzimit Ministrisë së Brendshme nr.459, datë 16.08.2013 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit në sistemin e Ministrisë së Brendshme", për të cilën ngarkohen me përgjegjësi zyra juridike, nëpunësit autorizues dhe zbatues.

Shpenzimet e karburantit:

Shpenzimet e karburantit për vitin 2013 dhe 2017 paraqiten sipas pasqyrave të mëposhtme:

Për vitin **2013**.

Karburanti	Gjendje 01.01.2013	Hyrje gjatë vitit	Dalje gjatë vitit	Gjendje 31.12.2013
Naftë	1313	27260	24053	4520
Benzinë	1039	800	972	867

Institucioni ka pasur në administrim 18 mjete, nga të cilat 4 mjete në administrim të administratës së Prefektit dhe 14 mjete në administrim të PMNZSH-së. Nga 18 mjete në administrim të institucionit, janë furnizuar me karburant 14 mjete të PMNZSH së dhe 4 mjete në administrim të aparatit të Prefektit. Karburanti është justifikuar sipas fletë udhëtimeve të lëvizjeve dhe normës së konsumit /100 km. Norma e konsumit është përllogaritur sipas procesverbaleve të komisionit të ngritur për verifikimin e normës për çdo mjet, (i miratuar me urdhër të prefektit nr. 12, datë 15.02.2013 dhe urdhër të prefektit nr.13, datë 15.02.2013). Për çdo muaj janë përgatitur pasqyrat mujore të punës së mjeteve (furnizimit dhe konsumit) të cilat janë të konfirmuara nga komandantët e stacioneve dhe shefi sektorit të PMNZSH-së. Konsumi i karburantit të mjetit është llogaritur sipas normës së konsumit për km në lëvizje, minuta në punë, minuta në ndezje dhe për minuta në gadishmëri. Për të gjitha rastet e rënies së zjarreve është bërë regjistrimi dhe përputhet fleta e udhëtimit me librin e rënies së zjarreve. Lëvizjet e mjeteve janë të rakorduara edhe me fletë njoftimin dhe raportin e rënies së zjarreve, trajtuar në listën që makinat janë furnizuar me karburant për vitin 2013 që ndodhet tek anekse në fund të Raportin Përfundimtar.

Nga sasia e litrave të furnizuara janë dorëzuar me procesverbal në zbatim të aktmarrëveshjes nr. 3689, datë 06.12.2012, subjektit K.P. 600 litra të bëra hyrje me fletë hyrjen nr. 54, 07.12.2012 dhe bërë dalje me fletë daljen nr. 20, datë 31.01.2013 nga kontrata shtesë; ndërsa sasia e 4000 litrave të furnizuara nga subjekti P.Q. janë dorëzuar me procesverbal në zbatim të aktmarrëveshjes nr. 1122, datë 25.03.2013, të cilat janë bërë hyrje me fletë hyrjen nr. 4, datë 25.03.2013, ndërsa bërë dalje me fletë daljen nr. 147, datë 10.06.2013 nga kontrata shtesë, bashkëlidhur gjithë dokumentacioni justifikues i këtyre litrave, nga blerja me negocim paraprak pa botim.

Për vitin **2014**.

Karburanti	Gjendje 01.01.2014	Hyrje gjatë vitit	Dalje gjatë vitit	Gjendje 31.12.2014
Naftë	4520	29270	18390	15400
Benzinë	867	100	857	110

Institucioni ka pasur në administrim 18 mjete, nga të cilat 4 mjete në administrim të administratës së Prefektit (2 prej te cilave nuk kane punuar rrjedhimisht nuk janë furnizuar me karburant) dhe 14 mjete në administrim të PMNZSH-së. Nga 18 mjete në administrim të institucionit, janë furnizuar me karburant 14 mjete të PMNZSH së dhe 2 mjete në administrim të aparatit të Prefektit. Karburanti është justifikuar sipas fletë udhëtimeve të lëvizjeve dhe normës së konsumit /100 km. Norma e konsumit është përllogaritur sipas procesverbaleve të komisionit të ngritur për verifikimin e normës për çdo mjet, (i miratuar me urdhër të prefektit nr.37, datë 04.03.2014). Për çdo muaj janë përgatitur pasqyrat mujore të punës së mjeteve (furnizimit dhe konsumit) të cilat janë të konfirmuara nga komandantët e stacioneve dhe shefi sektorit të PMNZSH-së. Konsumi i karburantit të mjetit është llogaritur sipas normës së konsumit për km në lëvizje, minuta në punë, minuta në ndezje dhe për minuta në gadishmëri. Për të gjitha rastet e rënies së zjarreve është bërë regjistrimi dhe përputhet fleta e udhëtimit me librin e rënies së zjarreve. Lëvizjet e mjeteve janë të rakorduara edhe me fletë njoftimin dhe raportin e rënies së zjarreve sipas pasqyrës së shpenzimit të karburantit që ndodhet në rubrikën "anekse" të Raportit Përfundimtar.

Për vitin **2015**.

Karburanti	**Gjendje 01.01.2015**	**Hyrje gjatë vitit**	**Dalje gjatë vitit**	**Gjendje 31.12.2015**
Naftë	15400	28860	30785	13475
Benzinë	110	0	110	0

Institucioni ka pasur në administrim 19 mjete, nga të cilat 4 mjete në administrim të administratës së Prefektit dhe 15 mjete në administrim të PMNZSH-së. Nga 19 mjete në administrim të institucionit, janë furnizuar me karburant 15 mjete të PMNZSH së dhe 2 mjete në administrim të aparatit të Prefektit. Karburanti është justifikuar sipas fletë udhëtimeve të lëvizjeve dhe normës së konsumit /100 km. Norma e konsumit është përllogaritur sipas procesverbaleve të komisionit të ngritur për verifikimin e normës për çdo mjet, (i miratuar me urdhër të prefektit nr.151, datë 31.12.2014). Për çdo muaj janë përgatitur pasqyrat mujore të punës së mjeteve (furnizimit dhe konsumit) të cilat janë të konfirmuara nga komandantët e stacioneve dhe shefi sektorit të PMNZSH-së. Konsumi i karburantit të mjetit është llogaritur sipas normës së konsumit për km në lëvizje, minuta në punë, minuta në ndezje dhe për minuta në gadishmëri. Për të gjitha rastet e rënies së zjarreve është bërë regjistrimi dhe përputhet fleta e udhëtimit me librin e rënies së zjarreve. Lëvizjet e mjeteve janë të rakorduara edhe me fletë njoftimin dhe raportin e rënies së zjarreve, për harxhimin e karburantit sipas listës që kanë marrë makinat ndodhur në rubrikën "Anekse" në fund të Raportit Përfundimtar.

Nga totali i shpenzimeve të karburantit del se janë shpenzuar për emergjenca civile nga reshjet e dëborës 1008 litra për Komunën Qendër dhe 200 litra për Komunën Shushicë sipas dokumentacionit si më poshtë:

Urdhër i Prefektit të Qarkut Elbasan nr. 4, datë 14.01.2015 "Për marrjen e masave mbi situatën emergjente të krijuar nga reshjet e dëborës të rëna në zonat malore dhe reshjet e shiut të rëna në zonat fushore në qarkun e Elbasanit.

Për komunën Shushicë Elbasan në bazë të urdhrit të mësipërm është lidhur akt-marrëveshja me nr. 94/2, datë 30.01.2015 për vënien në dispozicion të sasisë së karburantit të harxhuar dhe për komunën Qendër Librazhd në bazë të urdhrit të mësipërm është lidhur akt-marrëveshja me nr. 94/3, datë 30.01.2015 për vënien në dispozicion të sasisë së karburantit të harxhuar në lidhje me situatat e rënduara emergjente.

Për vitin **2016.**

Karburanti	Gjendje 01.01.2016	Hyrje gjatë vitit	Dalje gjatë vitit	Gjendje 31.12.2016
Naftë	13475	6270	11855	7890

Institucioni ka pasur në administrim 4 mjete të administratës së Prefektit, nga të cilat janë furnizuar me karburant vetëm 2 mjete të aparatit të Prefektit. Karburanti është justifikuar sipas fletë udhëtimeve të lëvizjeve dhe normës së konsumit/100 km. Norma e konsumit është përllogaritur sipas procesverbaleve të komisionit të ngritur për verifikimin e normës për çdo mjet, (i miratuar me urdhër të prefektit nr. 83, datë 31.12.2015). Për çdo muaj janë përgatitur pasqyrat mujore të punës së mjeteve (furnizimit dhe konsumit) të cilat janë të konfirmuara nga personat që tërhequr karburantin.

Në lidhje me këtë shpenzim listohen makinat që kanë marrë karburant për vitin 2016.

	Mjeti	**Targa**	**Drejues i mjetit**	**Normativa litra/100 km**	**Km/orë sipas fletë udhëtimit**	**Konsum karburant**
1	Mjeti Volswagen Passat	EL 6000 B	Taulant Dedja	12	26000	3120
2	Mjeti Mitsubishi Pajero	EL 0452 B	Taulant Dedja	14	17890	2501.7

Për vitin **2017**.

Karburanti	Gjendje 01.01.2017	Hyrje gjatë vitit	Dalje gjatë vitit	Gjendje 30.09.2017
Naftë	7890	0	3850.48	4039.52

Edhe për periudhën 9 mujore të vitit 2017, Institucioni ka në administrim 4 mjete, nga të janë furnizuar me karburant vetëm 2 prej tyre në administrim të aparatit të Prefektit. Karburanti është justifikuar sipas fletë udhëtimeve të lëvizjeve dhe normës së konsumit /100 km. Norma e konsumit është përllogaritur sipas procesverbaleve të komisionit të ngritur për verifikimin e normës për çdo mjet, (i miratuar me urdhër të prefektit nr. 67, datë 30.12.2016). Për çdo muaj janë përgatitur pasqyrat mujore të punës së mjeteve (furnizimit dhe konsumit) të cilat janë të konfirmuara nga personat që tërhequr karburantin.

Në lidhje me këtë listohen makinat që kanë marrë karburant për 9 mujorin e vitit 2017

	Mjeti	**Targa**	**Drejues i mjetit**	**Norm l/100 km**	**Km/orë sipas fletë udhëtimit**	**Konsum karburant**
1	Mjeti Volswagen Passat	EL 6000 B	Taulant Dedja	12	20735	2488.2
2	Mjeti Mitsubishi Pajero	EL 0452 B	Taulant Dedja	14	9697	1357.8

Edhe për 9/mujorin e vitit 2017 Institucioni i Prefektit ka patur në administrim (në punë) 2 mjetet tipi Volswagen Passat dhe tip Mitsubishi Pajero të cilat janë furnizuar në sasinë 3850 litra naftë Volsvagen dhe targa El 6000 B, në sainë 2488.8 litra dhe tipi Mitsubishi Pajero targa El 0452 B, në sainë 1361.7 litra), sasi e cila është konsumuar 100% sipas km të përshkruara dhe normës së konsumit.

Dokumentacioni i justifikimit të konsumit është i firmosur rregullisht sipas kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010,*"Për menaxhimn financiar dhe kontrollin"* dhe *pikat 85,106 të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011,"Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësite e Sektorit Publik".*

Auditimi i të ardhurave

- *Auditimi i realizimit të të ardhurave, sipas llojit të tyre, funksionimi i kontrollit të brendshëm në vjeljen e të ardhurave.*

Për periudhën e audituar 01.01.2013 deri 30.09.2017, evidentimi dhe realizimi i të ardhurave që krijon Institucioni, *(të ardhura nga shërbimet e PMNZSH-së për miratim leje e sheshe ndërtimi, aktet teknike, ekspertizat dhe gjobat, nga zyrat e Gjendjeve Civile për shitjen e pullave),* janë të ardhura nga veprimtari dytësore dhe të klasifikuara si të ardhura jo tatimore jashtë planit limit të buxhetit në zbatim të kapitullit IV pikës 189 të Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" në të cilin është përcaktuar se: "*Të ardhura jashtë limitit janë të ardhura të paplanifikuara në buxhetin vjetor që sigurojnë njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe*

që përdoren prej tyre sipas masës dhe kritereve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse".

Baza ligjore e krijimit dhe përdorimit të të ardhurave në këtë Institucion, është VKM nr. 432, datë 26.06.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë Institucionet buxhetore" dhe Udhëzimi i përbashkët i MF dhe MB nr. 219, datë 21.11.2006 "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë Institucionet e MB" dhe VKM-së nr. 285, datë 27.06.2002 "Për tarifat e shërbimeve që kryen PMNZSH ndaj shtetasve dhe personave juridikë e fizikë, vendas e të huaj".

Të ardhurat që kjo njësi ka realizuar gjatë periudhës së audituar 01.01.2015 deri 30.09.2017, janë të regjistruara në llogari dhe të rakorduara me degën e thesarit Elbasan sipas llojit të të ardhurës dhe kodit përkatës të thesarit. Administrimi, ndjekja dhe arkëtimi i të ardhurave është realizuar nga specialistja V. G., sipas pasqyrës së mëposhtme.

Pasqyra e realizimit të ardhurave për vitet 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 9 mujorin e vitit 2017:

në 000/lekë

nr	Lloji i të ardhurave	V I T E T									
		2013		2014		2015		2016		9/m2017	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Leje ndërtimi	1678	1678	145	140	273	266	0	0	0	0
2	Gjoba	0	0	100	80	110	50	0	0	0	0
3	Kamatvonesa	0	0	0	0	0	10	0	5	0	8
4	Akte teknike	0	0	1110	1109	550	543	0	0	0	0
5	Akt-ekspertiza	0	0	175	0	750	0	0	0	0	0
6	Debitorë (buxheti)	0	104	0	302	0	0	0	0	0	0
7	qira objekti	392	392	268	264	119	119	137	191	119	80
8	Taksa e aktivit të pullës	0	0	0	0	0	65	65	68	68	46
9	Depozitime të tjera	0	0	0	0	0	1232	1232	1292	1292	883
10	arkive	16	17	7	12	14	8	10	6	6	2
	TOTALI:	2087	2190	1805	1907	1816	2293	1444	1562	1485	1019

Për periudhën Janar-Dhjetor 2013, janë arkëtuar në total 2,190,296 lekë, për periudhën Janar-Dhjetor 2014, ishte arkëtuar vlera 1,907,316 lekë, për periudhën Janar-Dhjetor 2015, vlera 2,293,458 lekë, për periudhën Janar-Dhjetor 2016, vlera 1,562,569 lekë dhe për periudhën Janar-Shtator 2017, vlera e arkëtuar është 1,019,646 lekë. Këto vlera rezultojnë të rakorduara dhe të konfirmuara me aktet e rakordimit për çdo vit me degën e thesarit të rrethit Elbasan dhe konkretisht:

Për vitin 2013, periudha Janar-Dhjetor (*sipas akt- rakordimit datë 06.01.2014 me nr. prot 19/2);*
Për vitin 2014, periudha Janar-Dhjetor (*sipas aktrakordimit datë 19.01.2015 me nr. prot 130/2);*
Për vitin 2015, periudha Janar-Dhjetor *(sipas akt-rakordimit datë 12.01.2016 me nr. prot 33/3);*
Për vitin 2016, periudha Janar-Dhjetor *(sipas akt-rakordimit datë 05.01.2017 me nr. prot 06/2) dhe*
Për periudhën Janar-Shtator 2017, *(sipas akt-rakordimit datë datë 02.10.2017 me nr.prot 1759/2).*

-Në lidhje me akt ekspertizat e përpiluara nga sektori PMNZSH-së për llogari të OPGJ pranë Prokurorisë rezulton se, në zbatim të pikës 5 të VKM nr. 285, datë 27.06.2002, janë përpiluar për periudhën 01.01.2015-31.12.2015 gjithsej 275 aktet e ekspertimit në vlerën 6,875,000 lekë. Akt ekspertizat janë të regjistruara në regjistrin përkatës i cili është plotësuar me të gjitha kërkesat e formatit. Për të 275 akt ekspertiza me vlerën 6,875,000 lekë është bërë arkëtim i vlerës nga Prokuroritë e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Peqin në emër të bashkive respektive.

Për vitin 2016 dhe 9 mujorin e vitit 2017 janë lidhur 5 kontrata qiraje në ambientet e katit parë të godinës së nënprefekturës Librazhd duke u arkëtuar 270,622 lekë për qira objekti dhe kamat vonesa për vlerën 13,793 lekë për mos pagesë në afatin e përcaktuar në kontrata respektive me nr. 1977, datë 01.06.2015 me subjektin privat "G. A.", përfaqësuar nga I. K., me sipërfaqe 19.4 m^2; nr. 1977/1, datë 01.06.2015 me subjektin privat "G. A.", përfaqësuar nga I. K., për sipërfaqen 19.4

m^2, nr. 1977/2, datë 01.06.2015 me subjektin privat "G. A.", përfaqësuar nga I. K., për sipërfaqen 28.7 m^2, nr. 3428/4, datë 14.10.2016 me subjektin privat E. B., për sipërfaqen 24.5 m^2 dhe kontrata nr. 3753/1, datë 16.11.2015 me subjektin privat A. B., për sipërfaqen 40 m^2, sipas genplaneve të çdo ambienti dhe vlerat për secilën kontratë janë konform Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"

Për vitin 2016 janë realizuar të ardhura nga shitja e pullave nga gjendja civile në një vlerë prej 1,292,475 lekë. Edhe për periudhën e 9 mujorit janë realizuar 46,475 lekë të ardhura nga 4 zyrat e gjendjeve civile Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Peqin.

Këto zyra të gjendjeve civile, për vleftën e pullave janë furnizuar nga dega e Tatim Taksave sipas akt-rakordimit me degën e thesarit dhe vlefta e pullave të shitura është kaluar në llogari të saj sipas aktit të rakordimit dhe inventarit fizik të kryer në çdo fund periudhe.

- *Rakordimi me degën e thesarit mbi krijimin dhe ndarjen e pjesmarrjes ndërmjet Institucionit dhe buxhetit.* Nga auditimi i kryer në drejtim të rakordimit me degën e thesarit të rrethit, për të ardhurat që krijon Institucioni dhe përdorimin e tyre, rezultoi se akti i rakordimit të të ardhurave, është i përpiluar nga Institucioni çdo muaj dhe progresiv dhe është konfirmuar nga punonjësi i degës së thesarit të rrethit Elbasan.

- *Respektimi i limiti dhe destinacionit të përdorimit të të ardhurave sipas llojit të tyre*.

Për të gjithë periudhën e përfshirë në auditim, (nga 01.01.2015 deri me 30.12.2016), nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, nuk ka përdorim të ardhurash të krijuara me autorizim rritje buxhetore.

Në fund të çdo viti ushtrimor për pasqyrimin e gjendjes së çdo llogarie është mbajtur procesverbali përkatës dhe janë të pasqyruara në kontabilitet, sipas zërave dhe klasave konform kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin", me VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël" dhe udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 26, datë 27.12.2007 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj"

Konkluzion. Në lidhje me sistemin e mbajtjes së dokumentacionit në sektorin e financës, maturimit dhe arkëtimit të të ardhurave konkludojmë se, menaxhimi dhe stafi i Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan ka punuar për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore që lidhen me arkëtimin e të ardhurave. Edhe pse të ardhurat që realizohen nga ky institucion janë të kufizuara nga ana e stafit të Institucionit janë marrë masat dhe janë ndjekur rrugët ligjore për arkëtimin e tyre në buxhetin e shtetit.

Trajtuar më hollësisht në Projekt Raportin e Auditimit.

4. Auditimit mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës, hartimi, miratimi dhe respektimi i strukturave organike të miratuar.

Në përbërje të strukturës së Institucionit të Prefektit të qarkut Elbasan,është:

a)Administrata e Prefektit;

b)Drejtoria e komisioni vendor të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore (AMTP);

c) Policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit. Respektivisht strukturat e mësipërme për periudhën 2013-2017 janë miratuar: Me Urdhrin e Kryeministrit nr. 66 datë 10.04.2006 dhe nr. 3 datë 12.01.2016, "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Elbasan*", me Urdhrin e Kryeministrit nr. 139 datë 07.11.2008 "*Për miratimin e organikës së komisioneve vendore të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë Prefektëve të Qarqeve*", VKM Nr. 80, datë 21.01.2009 "*Për disa ndryshime në VKM nr. 646, datë 30.09.2004 dhe VKM nr. 237 datë 23.04.2014:Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Mbrojtjes nga zjarri dhe Shpëtimi*",

Në zbatim të strukturës së mësipërme për secilin vit janë nxjerrë urdhrat administrativ të Prefektit për emërimin e punonjësve.
Struktura për vitin 2013 dhe 2014: Administrata e Prefektit me 37 punonjës; Komisioni vendor i shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të AMTP me 5 punonjës; PMNZSH me 55 punonjës, nga të cilët 6 oficer dhe 49 policë zjarrfikës.
Struktura për vitin 2015: Administrata e Prefektit me 37 punonjës; Komisioni vendor i shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të AMTP me 5 punonjës; PMNZSH me 53 punonjës, nga këta 47 policë zjarrfikës dhe 6 oficerë.
Struktura për vitin 2016 dhe 2017: Administrata e Prefektit me 33 punonjës, nga këta 4 punonjës gjendja civile; Komisioni vendor i shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të AMTP me 5 punonjës.
Nga auditimi nuk u konstatua tejkalim i strukturës për asnjë vit të periudhës së audituar, por periudhën e 9 mujorit 2017, rezulton që të jenë 3 vende vakant si Nënprefekti i Rrethit Peqin, përgjegjësi i sektorit të zhvillimit urban dhe përgjegjësi i sektorit emergjencave civile.
Menaxherët kryesorë të kësaj organizate janë:
- Prefekti i Qarkut Elbasan, njëkohësisht dhe nëpunësi autorizues;
- N/Prefektët e Rretheve Librazhd dhe Gramsh;
- Sekretar i Përgjithshëm;
- Përgjegjësi i sektorit juridik;
- Përgjegjësi i sektorit të shërbimeve të brendshme.
- Përgjegjës i sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse;
- Drejtori i komisionit të titujve të pronësisë;
- Përgjegjësi për personelin;

Fondi i pagave dhe sigurimeve

Planifikimi dhe realizimi i fondit të pagave, të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për Prefekturën e Qarkut Elbasan paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

		Viti 2013			Viti 2014			Viti 2015			Viti 2016			9 Mujori i 2017		
Nr	**Emërtimi**	**Plan**	**Fakt**	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	**Plan**	**Fakt**	**%**	**Plan**	**Fakt**	**%**
I	**Total Fond paga (600)**	66164	65053	90	64335	63609	99	66229	61139	89	26643	25898	93	24976	19995	78
1	Administrat	27880	26974	97	27000	26506	98	28900	25051	87	24001	23564	98	22600	18184	80
2	PMNZSH	35220	35034	99	34822	34604	99	34500	33757	98	-	-	-	-	-	-
3	Gj.Civile	3064	3045	99	2513	2499	99	2829	2331	82	2642	2334	88	2376	1811	76
II	**Sig shoq (601)**	11218	10805	97	10781	10593	98	11277	10186	87	4446	4302	93	3871	3313	84
1	Administrata	4625	4471	97	4495	4399	98	4900	4164	85	4000	3912	98	3500	3011	86
2	PMNZSH	6080	5824	96	5863	5774	98	5900	5632	95	-	-	-	-	-	-
3	Gj.Civile	513	510	99	423	420	99	477	390	82	446	390	87	371	202	81

Për vitin 2013 fondi i pagave është planifikuar në vlerën 66,164 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 65,053 mijë lekë, ose në masën 98 %. Për vitin 2014 planifikimi 64,335 mijë lekë mijë lekë, realizimi 63,609 mijë lekë, ose në masën 99%. Për vitin 2015 planifikimi 66,229 mijë lekë, realizimi 61,139 mijë lekë, ose në masën 89 %. Për vitin 2016 planifikimi 26,643 mijë lekë, realizimi 25,898 mijë lekë, ose në masën 98 % dhe për 9-mujorin e parë të vitit 2017 planifikimi 24,976 mijë lekë dhe realizimi 19,995 mijë lekë, ose në masën 78 %.
Nuk ka tejkalim të fondit të pagave dhe sigurimeve për asnjë vit të periudhës së audituar.

* *Hartimi i listë pagesave dhe listë prezencave*

Për gjithë periudhën e përfshirë në auditim, u auditua dokumentacioni i trajtimit të punonjësve me paga, shtesa mbi pagë, përllogaritja e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimit mbi të ardhurat, sigurimi suplementar, etj. Nga auditimi rezultoi se listëpagesa përpilohej mbi bazën e

listëprezencave. Për aparatin e Prefektit, listëprezenca hartohej nga specialisti i burimeve njerëzore, për n/prefekturat listëprezencat hartohen nga nënprefektët.
Për sektorin e PMNZSH-së, listë prezencat janë hartuar nga komandantët e stacioneve, dhe janë konfirmuar nga shefi i sektorit të PMNZSH-së dhe nëpunësi i burimeve njerëzore në prefekturë. Për programin e gjendjes civile, listëprezenca e punonjësve përfshihet në aparatin e Prefektit. Për punonjësit që janë me leje të zakonshme, bashkangjitur listëprezencës janë urdhrat përkatës të titullarit për lejen e zakonshme, për emërimet e largimet nga puna bashkangjitur janë urdhrat përkatës, për punonjësit që janë me raporte mjekësore janë bashkangjitur fletët e raporteve.
Përpilimi i listëpagesave bëhet nga specialisti i financës dhe konfirmohej nga nëpunësi i burimeve njerëzore.
Nga auditimi i kryer për rakordimin e listë pagesave për çdo program me përmbledhësen e listë pagesave rezultoi se ato rakordojnë, dhe shuma neto e përmbledhëses së listëpagesës, është e barabartë me shumën e urdhërpagesës, përmbledhësja e listpagesës nënshkruhej nga nëpunësi zbatues dhe nëpunësi autorizues. Në listë pagesat e çdo muaji, për çdo punonjës janë evidentuar pagat bazë, shtesat për funksion, vjetërsinë, janë llogaritur dhe ndaluar detyrimet si tatimi mbi të ardhurat personale, përqindja e kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, kontributi suplementar dhe çdo ndalesë tjetër.
Nga auditimi me të zgjedhur për periudhën 2013 deri 2015 të listëpagesave për programin e PMNZSH-së janë hartuar nga specialisti i financës, në bazë të listëprezencave të hartuara nga sektori i PMNZSH-së, të konfirmuara nga komandantët e stacioneve. Listë prezencat janë të shoqëruara sipas rastit, edhe me shkresat për leje të zakonshme, raporte paaftësie të përkohshme në punë, orë nate etj, i dërgohej zyrës së administrimit financiar për të kryer veprimet. Në listëpagesat e çdo muaji për çdo punonjës, pagat bazë për gradë, shtesat për natyrë të veçantë pune e shërbimi, ndalesat, paga neto.
Listëpagesat që dërgohen në bankë konfirmohen e vulosen nga institucioni, dega e thesarit të rrethit dhe nëpunësit e bankave përkatëse.
Listëpagesat konfirmohen nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues, por vetëm nga hartuesi i tyre, specialist i financës, në zbatim me pikën 69 të UMF nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", ku thuhet

"Listëpagesat plotësohen nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (listëprezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Ato kontrollohen dhe nënshkruhen nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij".

Përcaktimi i pagave sipas klasifikimit të funksioneve dhe vendeve të punës në shërbimin civil dhe atyre me kod pune.
Nga auditimi i saktësisë së llogaritjes së pagave të punonjësve u konstatua se llogaritja e pagave për punonjësit e aparatit të Prefektit, është bërë në zbatim VKM-së Nr. 545, datë 11.08.2011 "*Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të nëpunësve civilë, zëvëndësministrit dhe nëpunësve të kabinetit në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura dhe administratën e prefektit*", i ndryshuar.
Në sektorin e shërbimeve mbështetëse të këtij institucioni, pagat janë llogaritur në zbatim të VKM-së nr. 717, datë 23.6.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", i ndryshuar.
Pagesat e punonjësve të sektorit të PMNZSH-së, janë kryer në zbatim të VKM nr. 619 datë 24.07.2013 "Për pagat e punonjësve të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit", i ndryshuar.

Nga auditimi i pagesave të orëve suplementare u konstatua se pagesa është bërë në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr.26 datë 16.05.2002 "Për pagesën e orëve suplementare të personelit të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi".
Fondet e likuiduara janë të planifikuara dhe të akorduara, vlerat e likuiduara janë të përputhura me orët suplementare të kryera dhe me tarifat e miratuara në Urdhrin nr. 26, datë 16.05.2002.
Bashkëngjitur listëpagesës është urdhri i titullarit të institucionit për pagesën e orëve të natës duke i bashkëlidhur listën e punonjësve që kanë kryer shërbimin për çdo stacion.
Nga auditimi i trajtimit të punonjësve me leje të zakonshme u konstatua se janë planifikuar dhe janë kryer lejet e zakonshme dhe nuk ka pasur kompensim me pagë për leje të pakryera me përjashtim të punonjësve të larguar.
Nga ana e sektorit të financës janë hapur librat e pagave, në zbatim të nenit 95 të Ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.
Nga auditimi u konstatua se janë respektuar dispozitat ligjore për kohëzgjatjen e kohës së punës.

Mbi vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë në zbatim të VKM nr. 109, datë 26.02.2014 "Për vlerësimin e rezultateve në punë të Nëpunësve Civilë", i ndryshuar. (Njësia e Burimeve Njerëzore të paraqes një listë të punonjësve në lidhje me trajnimin juridik të marrëdhënieve të punës të punonjësve civil dhe me kodin e punës).
Gjatë plotësimit të pyetësorit doli se ka **18 raste** të ndëshkimit me masa disiplinore të punonjësve me status të shërbimit civil si dhe janë ndjekur procedurat me ngritjen e komisionit disiplinor ne përputhje me ligjin për nëpunësin civil dhe vendimit të Këshillit të Ministrave, ku në përbërje të këtij komisioni ka qenë edhe një përfaqësues i DAP.
Sipas kontrolle të pa lajmëruara janë konstatuar mungesa për të cilët janë marrë masa sipas legjislacionit në Fuqi.
Për vitin 2014, për 14 raste.
1.Urdhër i brendshëm nr. 8, datë 16.01.2014 "Vërejtje me shkrim për paralajmërim, pushim nga puna" për Znj.V. V.
2. Urdhër i brendshëm nr. 25, datë 28.01.2014 "Vërejtje me shkrim për paralajmërim, pushim nga puna" për Z.Xh. H., J. Sh., A. G., A. T., A. K., R. T., A. G.
3. Urdhër i brendshëm nr. 29, datë 05.02.2014 "Vërejtje me shkrim" për Z. A. G.
4. Urdhër i brendshëm nr.30, datë 07.02.2014 "Vërejtje me shkrim për paralajmërim, pushim nga puna" për Z.Xh. H.
5. Urdhër i brendshëm nr. 34, datë 28.02.2014 "Vërejtje me shkrim për paralajmërim, pushim nga puna" për Znj.N. Sh. dhe A. H.
6. Urdhër i brendshëm nr. 46, datë 18.03.2014 "Vërejtje me shkrim për paralajmërim, pushim nga puna" për Z.E. Z.
7. Urdhër i brendshëm nr. 56, datë 10.04.2014 "Mosparaqitje në punë" për Z. Xh. H.
8. Urdhër i brendshëm nr.64, datë 20.05.2014 "Ulje page dhe detyre" për Z. I. Sh.
9. Urdhër i brendshëm nr. 72, datë 13.06.2014 "Vërejtje me shkrim për paralajmërim, pushim nga puna" për Znj. E. B., A. Sh., A. T., L. S.
10. Urdhër i brendshëm nr. 75, datë 26.06.2014 "Vërejtje me shkrim lirim dhe paralajmërim, nga struktura" për Z.E. Z.
11. Urdhër i brendshëm nr. 109, datë 06.10.2014 "Pushim nga puna dhe zgjidhje kontrate" për Z. I. Sh.
12. Urdhër i brendshëm nr. 117, datë 10.10.2014 "Vërejtje me shkrim për paralajmërim, pushim nga puna" për A. K., A. T., R.T. dhe A. Sh.
13. Urdhër i brendshëm nr. 131, datë 12.11.2014 "Vërejtje me shkrim" për V. L.
14. Urdhër i brendshëm nr. 141, datë 11.12.2014 "Vërejtje me shkrim për paralajmërim, pushim nga puna"për Z. D. M.
Per vitin 2015, për 3 raste.

1. Urdhër i brendshëm nr. 17, datë 11.02.2015 "Vërejtje me shkrim për paralajmërim, pushim nga puna" për N. Sh.
2. Urdhër i brendshëm nr. 56, datë 23.07.2015 "Vërejtje me shkrim për paralajmërim, pushim nga puna" për G. M., Y. H., H. P.
3. Urdhër i brendshëm nr. 70, datë 02.11.2015 "Vërejtje me shkrim për paralajmërim, pushim nga puna" për A. T.

Për vitin 2016, për 1 rast.
1. Vendim nr. 38, datë 10.06.2016 "Vërejtje më shkrim" për E. B.
2. Vendim nr. 55, datë 30.11.2016 "Vërejtje më shkrim" për E. B.

Pagesa e TAP dhe sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe suplementare të punonjësve.
U audituan ndalesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe rezultoi se ato kryhen në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, VKM nr. 77, datë 28.1.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor". Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat janë në bazë të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Tatimi është mbajtur në mënyrë të drejtë edhe në rastin e marrjes së shpërblimeve.
Në listëpagesa, për çdo punonjës, në seksionin e ndalesave, janë evidentuar ndalesat për tatimin mbi të ardhurat, për sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe me evidencë të veçantë duke përfshirë detyrimet që ka punëmarrësi ndaj institucionit të drejtorisë rajonale të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dega Elbasan dhe janë kryer xhirimet e këtyre detyrimeve në buxhetin e shtetit.

Respektimi i dispozitave ligjore për krimin dhe përdorimin e fondit të veçantë, dhënia e shpërblimeve për rezultate në punë, ndihma, fatkeqësi.
- Krijimi dhe përdorimi i fondit të veçantë për periudhën objekt auditimi, është kryer në zbatim të kërkesave të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë" i ndryshuar me VKM nr. 493, datë 06.07.2011 dhe VKM Nr. 826, datë 05.12.2011.
- Për vitin 2013 fondi i veçantë i planifikuar për vlerën 404 mijë lekë, është përdorur në shumën 396 mijë lekë ose 99 për qind e fondit të akorduar. Për dhënien e shpërblimeve është marrë miratimi nga Ministria e Financave me shkresë nr. 7213/1, datë 09.05.2013 dhe Ministria e Brendshme me shkresë nr. 1765/6, datë 17.05.2013, për vlerën 52,000 lekë, për Gj.K. (rast fatkeqësie) dhe nga Ministria e Financave me shkresë nr. 4292/4, datë 19.11.2013 dhe Ministria e Brendshme me shkresë nr. 16804/1, datë 12.12.2013, për vlerën 50,000 lekë, për Xh. K. dalje në pension.
- Për vitin 2014 fondi i veçantë planifikuar për vlerën 554 mijë lekë është përdorur në shumën 374 mijë lekë ose 71 për qind e fondit të akorduar. Për dhënien e shpërblimeve, 2 paga pagesa kalimtare A. A. për vlerën 130,420 lekë, për të cilën është marrë miratimi nga Ministria e Brendshme me shkresë nr. 2961/3, datë 24.07.2014 dhe për vlerën 130,000 lekë për M. B. & P. B. (dalje në pension) nga Ministria e Brendshme me shkresë nr. 6831/4, datë 16.09.2014 dhe Ministria e Financave me shkresë nr. 11472/1, datë 29.08.2014.
- Për vitin 2015 fondi i veçantë planifikuar për vlerën 211 mijë lekë është përdorur në shumën 211 mijë lekë ose 100 për qind e fondit të akorduar. Për dhënien e shpërblimeve është marrë miratimi nga Ministria e Financave me shkresë nr. 12859/1, datë 15.09.2015 dhe Ministria e Brendshme me shkresë nr. 6696/3, datë 21.09.2015, për vlerën 88,500 lekë për G. Ll. & M. A. për dalje në pension; nga Ministria e Financave me shkresë nr. 13947/1, datë 07.10.2015 dhe Ministria e Brendshme me shkresë nr. 7307/3, datë 12.12.2015, për vlerën 30,000 lekë, për PMNZ A. B. (rast fatkeqësie); Ministria e Financave me shkresë nr. 3981/1, datë 20.03.2015 dhe Ministria e Brendshme me shkresë nr. 1916/3, datë 26.03.2015, për vlerën 62,000 lekë, për F. R. dhe

Ministria e Financave me shkresë nr. 11262/1, datë 03.08.2015 dhe Ministria e Brendshme me shkresë nr. 3652/3, datë 13.08.2015, për vlerën 30,000 lekë, për G. T. (rast fatkeqësie);;
- Për vitin 2016 fondi i veçantë planifikuar për vlerën 184 mijë lekë është përdorur në shumën 184 mijë lekë ose 100 për qind e fondit të akorduar. Për dhënien e shpërblimeve është marrë miratimi nga Ministria e Financave me shkresë nr. 7689/1, datë 03.06.2016 dhe Ministria e Brendshme me shkresë nr. 3606/3, datë 14.06.2016, për vlerën 145,500 lekë për A. F., lirim nga detyra si rrjedhojë e shkurtimit të pozicionit të punës dhe nga Ministria e Financave me shkresë nr. 9615/1, datë 12.07.2016 dhe Ministria e Brendshme me shkresë nr. 4335/3, datë 14.07.2016, për vlerën 38,000 lekë, për R. T., për dalje në pension.
- Edhe për 9-mujorin e vitit 2017 fondi i veçantë planifikuar për vlerën 237 mijë lekë është përdorur në shumën 237 mijë lekë ose 100 për qind e fondit të akorduar. Për dhënien e shpërblimeve është marrë miratimi nga Ministria e Financave me shkresë nr. 8178/4, datë 20.0.2017 dhe Ministria e Brendshme me shkresë nr. 3222/3, datë 28.06.2017, për vlerën 236,600 lekë, dy pagat e kryera për ish-prefektin e Qarkut Elbasasn z. A. K., në zbatim të ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe punonjësve të shtetit", i ndryshuar.
Për të gjitha rastet e dhënies së shpërblimeve është marrë miratimi nga Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme për çdo rast.

Auditimi mbi dorëzimin e detyrës nga punonjësit e larguar nga puna
Në 3 largime të punonjësve nga puna për periudhën 2013-2017 konstatohet se nuk është bërë dorëzimi i detyrës me procesverbal, dokumentacionit shkresor, elektronik, gjithçka e krijuar gjatë punës në institucion nga punonjësi. Pranë grupit të auditimit nuk u paraqit një dokument i tillë, duke mos u zbatuar kërkesat ligjore si nga institucioni edhe nga punonjësit e larguar. Konkretisht nuk janë zbatuar këto rregulla në largimet e punonjësve: z. V. B., ndërprerë marrëdhëniet e punës më 17.12.2013, me detyrë specialiste shërbimesh në nën/prefekturën Librazhd, z. I. Sh. me detyrë ish-drejtor i KV dhe më pas antarë komisioni, ndërprerë marrëdhëniet e punës më 28.10.2014, z. A. K. me detyrë ish-Sekretar i Përgjithshëm, ndërprerë marrëdhëniet e punës më 18.10.2013, si dhe të gjitha rastet e tjera të ish-punonjësve të sektorëve të PMNZSH-së Qarku Elbasan, , ndërprerë marrëdhëniet e punës trajtuar në vendimet e gjykatave respektive.
Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat ligjore si më poshtë:
Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 13 ku thuhet**:**

"*Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit te përcaktuar nga Nëpunësi Autorizues i njësisë respektive sipas specifikave të aktiveve".*

-VKM nr. 360, datë 14.07.2000 "Për lirimin nga shërbimi civil", pikat 19, 20 dhe 21 "Dorëzimi i detyrës", ku thuhet:

"*Nëpunësi duhet të bëjë tek eprori direkt dorëzimi e plotë të dokumentacionit që ka për shkak të detyrës, si dhe te njësia përgjegjëse për mbajtjen e inventarit fizik, dorëzimin e pajisjeve dhe të mjeteve të punës në inventar".*

-VKM nr. 171, datë 26.03.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil", *pika 50 ku thuhet:*
-Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, nenin 25 " Detyrimi i dhënies llogari dhe i kthimit" pika 3 ku thuhet:

"*Punëmarrësi i kthen punëdhënësit menjëherë edhe gjithçka të prodhuar nga veprimtaria e tij*

Për sa më sipër është mbajtur akt-verifikimi nr. 9, datë 17.11.2017 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, përfaqësuar nga znj. A. Ç. me detyrë përgjegjës e sektorit të financës dhe z. J. Sh. me

detyrë specialist në këtë sektor për burimet njerëzore, me shkresë nr. 1299/27, datë 24.11.2017 kanë bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:
- Në 3 largimet e punonjësve nga puna për periudhën 2013-2017 konstatohet se nuk është bërë dorëzimi i detyrës me proces-verbal, dokumentacion shkresor, elektronik, gjithçka e krijuar gjatë punës në institucion nga punonjësi. Pranë grupit të auditimit nuk u paraqit një dokument i tillë, duke mos u zbatuar kërkesat ligjore si nga institucioni edhe nga punonjësit e larguar.
Konkretisht nuk janë zbatuar këto rregulla në largimet e punonjësve:
1. Znj.V. B. ndërprerë marrëdhëniet e punës më datë 17.12.2013, me detyrë specialiste shërbimesh në N/Prefekturën Librazhd.
2. Z. I. Sh., me detyrë ish-drejtor i KVVTP-së, ndërprerë marrëdhëniet e punës më datë 28.10.2014.
3. Z. A. K., me detyrë ish Sekretar i Përgjithshëm, ndërprerë marrëdhëniet e punës më datë 18.10.2013.
Veprimet e mësipërme bien ndesh në kundërshtim me kërkesat ligjore të pikës 13 të udhëzimit nr. 30, datë 27.02.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikës 19,20 dhe 21 të VKM-së nr.360, datë 14.07.2000 "Për lirimin nga shërbimi civil", të pikës 50 të VKM-së nr. 171, datë 26.03.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil" dhe të pikës nr. 3, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës i Republikës së Shqipërisë".
Përsa i përket kësaj pike ne paraqesim kundërshtimin tonë pasi për personat e liruar si më lartë në zbatim të strukturës së Institucionit kanë qenë përgjegjës personat si më poshtë:
1. Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 62, datë 10.04.2006 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Elbasan" për burimet njerëzore për periudhën 10.04.2006 deri më datë 24.02.2014, ka qenë ngarkuar Znj. I. M. me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore .
2. Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 87, datë 21.02.2014 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Elbasan", nga data 25.02.2017 për burimet njerëzore kanë qenë përgjegjës Z. A. G. me detyrë përgjegjës i sektorit Juridik dhe funksioneve të deleguara dhe Znj. I. M. specialiste për burimet njerëzore.
Qëndrimet e audituesve.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se nga ana e grupit të auditimit merret në konsideratë, duke u bërë reflektimi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, pra duke ngarkuar me përgjegjësi znj. I. M. me detyrë ish-specialiste e burimeve njerëzore.

Auditim mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore për largimin nga puna.
Nga auditimi rezultoi se për vitet 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 9 mujorin e 2017 nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan janë kryer pagesa ndaj ish punëmarrësve, të cilat rrjedhin nga vendime gjyqësore të dhëna nga Gjykatat e Shkallës së Parë Elbasan apo Gjykata Apelit Durrës dëmshpërblim pagë për zgjidhjen e kontratave të punës, shpërblim për vjetërsi në punë për **29 raste**, në **vlerën 20,806,409 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë vijon:
Paditësi: N. M., ish punonjës i PMNZSH të Qarkut Elbasan, me gradë kapter II-të dhe detyrë shofer, personel zjarrfikës, shpëtues, luftues, Stacioni Elbasan, i cili është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit z. Q. S. me nr. 167, datë 24.12.2004 me motivacionin i sëmurë, sipas propozimit të shefit të sektorit të PMNZSH Qarku Elbasan.
I Padituri: Institucioni i Prefektit Qarkut Elbasan, vendimi është marrë në mungesë nuk ka pasur përfaqësues të Institucionit të Prefektit Qarkut.
Objekti: Trajtim me pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së vazhdimit karrierës dhe dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna.
Me vendimin nr. 1672, date 27.10.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është vendosur detyrimi i të padituritë dëmshpërblim për pagën e një viti dhe trajtimin me pagesë kalimtare për 2

vjet me 50% të pagesës mesatare neto të vitit të fundit të shërbimit. Vendimi është marrë në mungesë të Institucionit të Prefekturës duke mos pasur dijeni si e tillë nuk është apeluar. Çështja është ndjekur në rrugë përmbarimore nga paditësi.
Përsa më lart N. M. është paguar për shumën 345,225 lekë, likuiduar me urdhër shpenzimin nr. 93, datë 22.04.2013 dhe urdhër shpenzim nr. 161, datë 12.06.2014, nuk ka vendim të Gjykatës së Apelit dhe rekurs në Gjykatën e Lartë.
Paditësi: R. Z., ish punonjës i PMNZSH, me gradë Kapter IV, me detyrë personel zjarrfikës, shpëtues, luftues, Stacioni Librazhd dhe është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit zj. M. H. nr. 12, datë 31.01.2007 me motivacionin për mos përsëritje të kontratës së punës.
I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, vendimi është marrë në mungesë të përfaqësuesit të Institucionit të Prefektit Qarkut Elbasan, s'ka pas njoftim.
Objekti: Trajtim me pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së vazhdimit karrierës dhe dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna në masën e dy pagave.
Me vendimin nr. 1478, date 01.08.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është vendosur detyrimi i të paditurit dëmshpërblim me 2 paga dhe trajtimin me pagesë kalimtare për 3 vjet. Vendimi është marrë në mungesë të Institucionit të Prefekturës duke mos pasur dijeni si e tillë nuk është apeluar. Çështja [ër pagesën është ndjekur në rrugë përmbarimore nga paditësi R. Z., për shumën 122,664 lekë të likuiduara me urdhër shpenzimet nr. 93, datë 22.04.2013 dhe nr. 161, datë 12.06.2014, nuk ka vendim të Gjykatës së Apelit dhe rekurs në Gjykatë të Lartë.
Paditësi: S. D., ish punonjës i PMNZSH, me gradë Kapter II, me detyrë personel zjarrfikës, shpëtues, luftues, Stacioni Librazhd, është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit z. R. K. nr. 57/4, datë 17.07.2007, sipas propozimit te shefit te sektorit, me motivacionin për ristrukturim të organikës PMNZSH-së së Qarkut Elbasan.
I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, vendimi është marrë në mungesë të përfaqësuesit të Institucionit të Prefektit Qarkut Elbasan, s'ka pas njoftim.
Objekti: Trajtim me pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së vazhdimit karrierës dhe dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna në masën e dy pagave.
Me vendimin nr. 1753, datë 05.10.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është vendosur detyrimi i të paditurit dëmshpërblim me 2 paga dhe trajtimin me pagesë kalimtare në masën e 18 pagave mujore. Vendimi është marrë në mungesë të Institucionit të Prefekturës duke mos pasur dijeni si e tillë nuk është apeluar. Çështja është ndjekur në rrugë përmbarimore nga paditësi S. D., është paguar për shumën 649,522 lekë, likuiduar me urdhër shpenzim nr. 93, datë 22.04.2013 dhe urdhër shpenzim nr. 161, datë 12.06.2014, nuk ka vendim të Gjykatës së Apelit dhe rekurs në Gjykatën e Lartë.
Paditësi: Y. L., me gradë Kapter I, me detyrë personel zjarrfikës, shpëtues, luftues të Sektorit të PMNZSH-se se Qarkut Elbasan, Stacioni Elbasan dhe është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit z. R. K. nr. 57/1, datë 17.07.2007, sipas propozimit te shefit te sektorit, me motivacionin për ristrukturim të organikës PMNZSH-se se Qarkut Elbasan.
I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, vendimi është marrë në mungesë të përfaqësuesit të Institucionit të Prefektit Qarkut Elbasan, s'ka pas njoftim.
Objekti: Trajtim me pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së vazhdimit karrierës, dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna në masën e dy pagave, dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna për 1 vit, dhe njohje vjetërsi pune për pension.
Sipas vendimit nr. 2566, datë 26.12.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është vendosur detyrimi i të paditurit dëmshpërblim me 2 paga, trajtimin me pagesë kalimtare për 3 vjet dhe njohje vjetërsi pune. Çështja është ndjekur në rrugë përmbarimore nga paditësi.
Y. L., është paguar, për shumën 127,214 lekë, sipas urdhër shpenzimeve nr. 93, datë 22.04.2013 dhe nr. 161, datë 12.06.2014, nuk ka vendim të Gjykatës së Apelit dhe rekurs në Gjykatën e Lartë.

Paditësi: K. H., ish punonjës i PMNZSH, me gradë Kapter II, ka qenë me detyrë personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë) te Sektorit te PMNZSH-se se Qarkut Elbasan, Stacioni Elbasan, dhe është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit z. R. K. nr. 57/2, datë 17.07.2007, sipas propozimit te shefit te sektorit, me motivacionin për ristrukturim te organikës PMNZSH-se së Qarkut Elbasan, vendimi është marrë në mungesë të përfaqësuesit të Institucionit të Prefektit Qarkut Elbasan, s'ka pas njoftim.
K. H., është paguar, në zbatim të Vendimit të Gjykatës Elbasan nr. 1672, datë 27.10.2005, për shumën 127,214 lekë, sipas urdhër shpenzim nr. 93, datë 22.04.2013 dhe urdhër shpenzim nr. 161, datë 12.06.2014, nuk ka vendim të Gjykatës së Apelit dhe rekurs në Gjykatën e Lartë.
Paditësi: M. Gj., ish punonjës i PMNZSH, me grade Kapter II, ka qenë me detyrë personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë) të Sektorit të PMNZSH-së së Qarkut Elbasan, Stacioni Elbasan, dhe është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit z. R. K. nr. 57/3, datë 17.07.2007, sipas propozimit te shefit te sektorit, me motivacionin për ristrukturim të organikës PMNZSH-së së Qarkut Elbasan, vendimi është marrë në mungesë të përfaqësuesit të Institucionit të Prefektit Qarkut Elbasan, s'ka pas dijeni.
M. Gj., është paguar, në zbatim të Vendimit të Gjykatës Elbasan nr. 1672, datë 27.10.2005, për shumën 128,136 lekë, sipas urdhër shpenzim nr. 93, datë 22.04.2013 dhe urdhër shpenzim nr. 161, datë 12.06.2014, nuk ka vendim të Gjykatës së Apelit dhe rekurs në Gjykatën e Lartë.
Paditësi: A. B., ish punonjës i PMNZSH-së së Qarkut Elbasan, Stacioni Librazhd, me gradë agjent dhe detyrë personel zjarrfikës, shpëtues, luftues, është liruar nga detyra me urdhër të ish-Prefektit zj. M. H. nr. 13, datë 31.01.2007 me motivacionin për mos përsëritje të kontratës së punës, sipas propozimit të shefit të sektorit të PMNZSH Qarku Elbasan.
I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, përfaqësuar në gjykim nga z. A. G. dhe A. K., me detyrë jurist.
Objekti: Trajtim me pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së vazhdimit karrierës, dëmshpërblim për largim të padrejtë në masën e 2 pagave.
Me vendimin nr. 613, datë 28.03.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është vendosur detyrimi i të paditurit dëmshpërblim me 2 paga dhe trajtimin me pagesë kalimtare për 3 vjet në masën 50% të pagës. Ky vendim është apeluar me shkresë nr. 1173, date 17.04.2007, ankimim i cili nuk është pranuar nga gjykata e Apelit me vendimin nr. 336, datë 16.02.2009. Çështja është ndjekur në rrugë përmbarimore nga paditësi.
Artan Balla, është paguar për shumën 598,247 lekë të likuiduara me urdhër shpenzim nr. 93, datë 22.04.2013 dhe urdhër shpenzim nr. 161, datë 12.06.2014, në zbatim të Vendimit të Gjykatës Elbasan dhe vendim të Gjykatës së Apelit, nuk ka rekurs në Gjykatën e Lartë.
Paditësi: M. B., ish punonjës i PMNZSH-së, të Qarkut Elbasan, me detyrë Komandant Stacioni Librazhd, është liruar nga detyra me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 2997, datë 24.11.2006 me motivacionin ne kuadër të ristrukturimit të institucionit të Ministrisë së Brendshme, Tiranë, sipas propozimit te shefit te sektorit te PMNZSH Qarku Elbasan.
I Padituri: Ministria e Brendshme dhe
Person i trete: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, përfaqësuar nga z. A. G.
Objekti: Trajtim me pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së vazhdimit karrierës, për 2 vjet.
Me vendimin nr. 3331, datë 24.04.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Vendimit te Gjykatës së Apelit Tiranë me nr. 908, datë 19.05.2010 është vendosur detyrimi i të paditurit trajtim me pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së vazhdimit karrierës, për 2 vjet. Vendimi është Apeluar duke u ankimuar në Gjykatën e Lartë nga Ministria e Brendshme. Çështja është ndjekur në rrugë përmbarimore nga paditësi.
M. B., është paguar për shumën 49,107 lekë me urdhër shpenzim nr. 91, datë 22.04.2013, nr. 343, datë 26.12.2013 dhe nr. 315, datë 09.12.2013, nuk ka rekurs në Gjykatën e Lartë.
Paditësit: A. B., Sh. G. dhe R. H., ish punonjës i PMNZSH, të Qarkut Elbasan, Stacioni Elbasan, me grada agjentë dhe detyrë personel zjarrfikës, shpëtues, luftues, janë liruar nga detyra me

urdhrin e ish-Prefektit z. Sh. D. nr. 28, date 30.03.2009, sipas propozimit te shefit te sektorit te PMNZSH Qarku Elbasan, me motivacionin shkurtim strukture sipas VKM nr. 80, date 21.01.2009.

I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, përfaqësuar nga juristi A. K.

Objekti: Trajtim me pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së vazhdimit karrierës për 3 vjet.

Ky proces ka përfunduar me vendimin nr. 1854, datë 17.07.2009 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe është vendosur detyrimi i të paditurve trajtimin me pagesë kalimtare për 3 vjet. Për këtë vendimi është bërë apelim, por nuk është pranuar ankimimi nga gjykata. Çështja është ndjekur në rrugë përmbarimore nga paditësi.

A. B., Sh. G. dhe R. H. janë paguar për shumën 2,355,980 lekë, likuiduar me urdhër shpenzim nr. 92, datë 22.04.2013, nr. 105, datë 02.05.2013, nr. 341, datë 16.12.2013, nr. 344, datë 26.12.2013 dhe nr. 159, datë 12.06.2014, nuk ka vendim të Gjykatës së Apelit dhe rekurs në Gjykatë të Lartë.

Paditësi: G. S., ish punonjës të PMNZSH, qarku Elbasan, me gradë agjent dhe detyrë personel zjarrfikës, shpëtues, luftues, është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit z. Sh. D. nr. 19, datë 23.02.2009, sipas propozimit të shefit të sektorit të PMNZSH-së së Qarkut Elbasan.

I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, përfaqësuar nga z. A. G.

Objekti: Trajtim me pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së karrierës me tre vjet, dëmshpërblim me dy paga mujore referuar pagës së muajit të fundit për ndërprerje të menjëhershme të karrierës, dëmshpërblim në masën një vit, sipas vendimit nr. 1413, date 05.06.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Nga ana e Prefekturës ky vendim është apeluar me shkresë nr. 2398, datë 10.06.2009, por nuk është pranuar ankimimi nga gjykata.

G. S. duke qenë në kushte shumë të vështira ekonomike ka bërë kërkesë tek Prefektura për likuidim të shumës së përcaktuar në vendimin e gjykatës sipas urdhrit të ministrisë së brendshme dhe është paguar për shumën 560,000 lekë të likuiduara me urdhër shpenzim nr. 346, datë 26.12.2013 dhe urdhër shpenzim nr. 148, datë 09.06.2014, sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nr. 10-2012-871 (442), datë 29.05.2013, nuk ka rekurs në Gjykatën e Lartë.

Paditësi: M. A., ish punonjës i PMNZSH-së së Qarkut Elbasan, Stacioni Librazhd, me gradë agjent dhe detyrë shofer, personel zjarrfikës, shpëtues, luftues, është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit z. R. K. nr. 23, datë 28.02.2008 me motivacionin sipas propozimit te shefit te sektorit te PMNZSH-së mos zotërim të aftësive të mjaftueshme fizike për kryerjen e detyrës, sipas propozimit te shefit te sektorit te PMNZSH Qarku Elbasan.

I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, nuk është përfaqësuar nga ky Institucion.

Objekti: Trajtim me pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së vazhdimit karrierës, dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna në masën e dy pagave, dëmshpërblim për largim të padrejtë nga puna për 1 vit, dhe njohje vjetërsi pune për pension.

Me vendimin nr. 826, date 01.04.2009 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur detyrimin e të paditurit për dëmshpërblim me 2 paga dhe trajtimin me pagesë kalimtare për 3 vjet. Çështja është ndjekur në rrugë përmbarimore nga paditësi.

M. A., është paguar për shumën 889,517 lekë, likuiduar me urdhër shpenzim nr. 168, datë 12.06.2014, pa vendim të Gjykatës së Apelit dhe rekurs në Gjykatën e Lartë.

Paditësit: A. P., ish punonjës i PMNZSH-së së Qarkut Elbasan, Stacioni Elbasan, me grade agjent dhe detyrë personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë) te Sektorit të PMNZSH është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit z. R. K. nr. 57, datë 17.07.2007, sipas propozimit te shefit te sektorit te PMNZSH Qarku Elbasan, me motivacionin për ristrukturim të organikës së PMNZSH-së së Qarkut Elbasan.

I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan përfaqësuar në shkallë të parë nga z. A. G., ndërsa në Apel nga z. A. K.

Objekti: Trajtim me pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së karrierës me tre vjet, dëmshpërblim me dy paga mujore referuar pagës së muajit të fundit për ndërprerje të

menjëhershme të karrierës, sipas vendimit nr. 2294, datë 08.10.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan që ka vendosur pranimin e kërkesë padisë. Ky vendim është apeluar nga ana e Prefekturës me shkresën nr. 3931, date 29.10.2009 dhe nuk është pranuar ankimimi nga gjykata.
A.P., është paguar për shumën 568,705 lekë, likuiduar me urdhër shpenzim nr. 160, datë 12.03.2014, nuk ka vendim të Gjykatës së Apelit dhe rekurs në Gjykatën e Lartë.
Paditëse: E. D., ish-komandante e Stacioni Gramsh të PMNZSH-së së Qarkut Elbasan, me gradë Inspektore dhe detyrë Komandante, është liruar nga detyra me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 724, datë 28.05.2007, sipas propozimit te shefit te sektorit te PMNZSH Qarku Elbasan, me motivacionin në kuadër të ristrukturimit të institucionit të Ministrisë së Brendshme, Tiranë.
I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, përfaqësuar nga juristi A. K.
Objekti: Trajtim me pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së karrierës për tre vjet, dëmshpërblim me dy paga mujore referuar pagës së muajit të fundit për ndërprerje të menjëhershme të karrierës, dëmshpërblim në masën një vit.
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. 1576, (3489) datë 14.07.2011 ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.
Nga ana e Prefekturës është depozituar kërkesë ankimore me nr. 2399, datë 03.08.2011 në Gjykatën e Apelit Durrës dhe nuk është marrë parasysh nga kjo gjykatë.
E. D., është paguar për shumën 985,800 lekë sipas urdhër shpenzim nr. 156, datë 09.06.2014, nuk ka vendim të Gjykatës së Apelit dhe rekurs në Gjykatën e Lartë.
Paditësit: Q. Sh., ish punonjës të PMNZSH-së së Qarkut Elbasan, Stacioni Elbasan, me gradë agjent dhe detyrë personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë) te Sektorit te PMNZSH dhe është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit z. Sh. D. nr. 21, datë 23.02.2009 me motivacionin sipas propozimit të shefit të sektorit të PMNZSH-se së Qarkut Elbasan.
I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, përfaqësuar nga juristi z. A.G.
Objekti: Trajtim me pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së karrierës me tre vjet, dëmshpërblim me dy paga mujore referuar pagës së muajit të fundit për ndërprerje të menjëhershme të karrierës, dëmshpërblim në masën një vit e vendosur sipas vendimit nr. 1413, date 05.06.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
Ky vendim është apeluar nga ana e Prefekturës me shkresë nr. 2398, datë 10.06.2009, por nuk është pranuar ankimimi nga gjykata e Apelit Durrës, sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nr. 10-2013-1230 (536), datë 10.09.2013.
Q. Sh., është paguar për shumën 1,408,000 lekë, likuiduar me urdhër shpenzim nr. 149, datë 09.06.2014, nuk ka rekurs në Gjykatën e Lartë.
Paditësit: S. B., ish punonjës i PMNZSH-së së Qarkut Elbasan, Stacioni Librazhd, me gradë agjent dhe detyrë shofer, personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë), është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit z. Sh. D. nr. 69, datë 05.07.2010, sipas propozimit te shefit te sektorit te PMNZSH Qarku Elbasan, me motivacionin nuk është i aftë për punë pasi nuk ka fituar testimin teoriko-praktik të zhvilluar me datë 24.12.2009.
I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, përfaqësuar nga juristi z. A. G.
Objekti: Trajtim me pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së karrierës me dy vjet, dëmshpërblim me dy paga mujore referuar pagës së muajit të fundit për ndërprerje të menjëhershme të karrierës, dëmshpërblim në masën një vit, me vendim nr. 2670, datë 30.12.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan është vendosur pranim pjesërisht të padisë.
Nga ana e Prefekturës është depozituar kërkese ankimore me nr. 30, datë 06.01.2011 në Gjykatën e Apelit Durrës e cila me vendimin nr. 563, date 10.09.2013 ka vendosur pjesërisht për dëmshpërblimin që ka kërkuar dhe vendosur Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan.
Sipas këtyre vendimeve S. B., është paguar për shumën 799,000 lekë të likuiduara me urdhër shpenzim nr. 153, datë 09.06.2014, në zbatim të Vendimit të Gjykatës Elbasan nr. 2670, datë 30.12.2010 dhe Vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nr. 536, datë 10.09.2013, nuk ka rekurs në Gjykatën e Lartë.

Paditësit: K. S., ish punonjës i PMNZSH-së së Qarkut Elbasan, Stacioni Elbasan, me gradë agjent dhe detyre personel zjarrfikës, shpëtues, luftues, është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit z. Sh. D. nr. 88, datë 13.10.2010 me motivacionin nuk është i aftë për punë pasi dhe nuk ka fituar testimin teoriko-praktik të zhvilluar me datë 24.12.2009.
I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, përfaqësuar nga juristi z. A. G.
Objekti: Trajtim me pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së karrierës me dy vjet, dëmshpërblim me dy paga mujore referuar pagës së muajit të fundit për ndërprerje të menjëhershme të karrierës, dëmshpërblim në masën një vit. Kjo kërkesë sipas vendimit nr. 556, datë 15.03.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesë padisë, trajtim me pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së karrierës me dy vjet, dëmshpërblim me dy paga mujore referuar pagës së muajit të fundit për ndërprerje të menjëhershme të karrierës, dëmshpërblim në masën e 5 muajve. Ky vendim është Apeluar nga ana e Prefekturës me shkresë nr. 1186, date 25.03.2011 dhe nuk është pranuar ankimimi nga gjykata. Çështja është ndjekur në rrugë përmbarimore nga paditësi.
K. S., është paguar për shumën 1,001,784 lekë sipas urdhër shpenzimeve nr. 345, datë 26.12.2013 dhe nr. 160, datë 12.06.2014, në zbatim të Vendimit të Gjykatës Elbasan nr. 556, datë 15.03.2011 dhe Vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nr. 10-2013-572 (301), datë 15.03.2011, nuk ka rekurs në Gjykatën e Lartë.
Paditës: L. N. , ish punonjës i PMNZSH-se se Qarkut Elbasan, Stacioni Librazhd, me grade kapter IV dhe detyrë shofer, personel zjarrfikës, shpëtues, luftues të Sektorit dhe është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit z. Sh. D. nr. 68, date 05.07.2010, sipas propozimit te shefit te sektorit te PMNZSH Qarku Elbasan, me motivacionin nuk është i aftë për punë pasi nuk ka fituar testimin teoriko-praktik të zhvilluar me datë 24.12.2009..
I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, përfaqësuar nga juristi A. K.
Objekti: Trajtim me pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së karrierës për tre vjet, dëmshpërblim me dy paga mujore referuar pagës së muajit të fundit për ndërprerje të menjëhershme të karrierës, dëmshpërblim në masën një vit.
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. 1004, datë 03.05.2011 ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesë padisë dhe konkretisht i ka dhënë vetëm 5 paga mujore.
Ky vendim është Apeluar nga pala paditëse dhe është ndryshuar duke i dhënë paditësve dëmshpërblim me 19 paga mujore, për ndërprerje të menjëhershme të karrierës. Çështja është ndjekur në rrugë përmbarimore nga paditësi.
L. N., është paguar për 881,073 lekë me urdhër shpenzimin nr. 160, datë 12.06.2014, në zbatim të Vendimit të Gjykatës Elbasan nr. 1004, datë 03.05.2011 dhe Vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës nr. 10-2013-376 (758), datë 09.05.2013, nuk ka rekurs në Gjykatën e Lartë.
Paditës: Xh. L., ish punonjës i PMNZSH-së qarku Elbasan me gradë K/Inspektor dhe detyrë Shef i Zyrës së Parandalimit të PMNZSH-se dhe është liruar nga detyra me urdhërin e Ministrit të Brendshëm nr. 1197/1, datë 27.11.2006, sipas propozimit të shefit të sektorit të PMNZSH Qarku Elbasan, me motivacionin në kuadër të ristrukturimit te institucionit të Ministrisë së Brendshme.
I Padituri: Ministria e Brendshme, Tirane.
Personi i Trete: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, i përfaqësuar nga juristi A. G.
Objekti: Trajtim me pagesë kalimtare për shkak të ndërprerjes së karrierës.
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 2458, datë 15.03.2012 ka vendosur pranimin të kërkesë padisë. Ky vendim është Apeluar nga pala paditëse dhe me vendimin nr. 2832, datë 03.12.2012 të Gjykatës se Apelit Tiranë është lënë në fuqi vendimi i Shkallës Parë.
Për efekt kryerje veprimeve për likuidim është përcjell nga Ministria e Punëve të Brendshme, Tiranë shkresa për pagesë dhe Xhezmi Latifi, është paguar për shumën 1,080,000 lekë, likuiduar me urdhër shpenzim nr. 314, datë 09.12.2013 dhe urdhër shpenzim nr. 144, datë 09.06.2014, në zbatim të Vendimeve të Gjykatës Elbasan nr. 2458, datë 15.03.2012 dhe Gjykatës së Apelit

Durrës nr. 2832, datë 03.12.2012, është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë nga Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e palës paditur dhe Institucioni i Prefektit nuk ka shkresë për këtë qëllim.
Paditës: A. K., ish-Sekretar i Përgjithshëm i Institucionit të Prefektit Qarkut Elbasan, i cili është liruar nga detyra me urdhëron e ish-Prefektit z. A. K. nr. 47, datë 18.10.2013 me motivacionin për mosparaqitje në punë.
I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, përfaqësuar nga juristi z. A. K.
Objekti: Kundërshtim urdhri lirimi nr. 47, datë 18.10.2013 dhe kërkim dëmshpërblimesh.
Nga Gjykata Administrative Shkallës së Parë Durrës me vendimin nr. 252, datë 19.03.2014 është vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe detyrimin e Institucionit te Prefektit që të dëmshpërblejë paditësin për një total 10 paga mujore bruto, 7 paga neto pesëmbëdhjete ditore si shpërblim për vjetërsi dhe shpenzimet gjyqësore 3,200 lekë.
Ndaj vendimit të sipërcituar është bërë ankim nga Institucioni i Prefektit me shkresën nr. 1036/1, datë 26.03.2014, në Gjykatën Apelit Administrativ Tiranë dhe me vendimin nr. 2801, datë 04.07.2017 është vendosur lenia në fuqi e vendimit nr. 252, datë 19.03.2014 dhe detyrimin e Institucionit te Prefektit që të dëmshpërblejë paditësin për një total 10 paga mujore bruto, 7 paga neto pesëmbëdhjete ditore si shpërblim për vjetërsi, dhe shpenzimet gjyqësore 3,200 lekë.
Bazuar në këtë vendim z. A. K., është paguar për shumën 1,253,487 lekë, likuiduar me urdhër shpenzim nr. 372, datë 24.10.2014, nr. 463, datë 23.12.2014 dhe nr. 467, datë 30.12.2014, përsa më lart nuk është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.
Paditës: V. B., ish punonjëse, Specialiste Shërbimesh, nën/Prefektura Librazhd, për Institucionin e Prefektit Qarkut Elbasan, është liruar nga detyra me urdhëron e ish-Prefektit z. A. K. nr. 84, datë 16.12.2013 me motivacionin shkelje e rëndë në kryerjen e detyrës funksionale si protokoll/arkiviste për Institucionin e nën/prefektit të rrethit Librazhd.
I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, përfaqësuar në gjykim nga A. G.
Objekti: Konstatim si të paligjshëm urdhëron e lirimit nr. 84, datë 16.12.2013 dhe kërkim dëmshpërblimesh sipas kodit të punës. Gjykata Administrative e Shkallës Parë Durrës me vendimin nr. 356, datë 07.04.2014 ka rrëzuar padisë se të pambështetur në ligj dhe prova.
Ndaj këtij vendimi është bërë ankim nga paditesja në Gjykatën Apelit Administrativ Tiranë.
Kjo Gjykatë me vendimin nr. 3993, datë 30.10.2014 ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 356, datë 07.04.2014 dhe detyrimin e Institucionit te Prefektit që të dëmshpërblejë paditësen me dy paga mujore për mosrespektim procedure të zgjidhjes së kontratës së punës.
Nga ana e Institucionit te Prefektit në lidhje me këtë vendim është depozituar rekurs ne Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë Tiranë me shkresën nr. 3866/1, datë 09.12.2014 dhe çështja nuk është gjykuar ende nga kjo gjykate.
V. B., është paguar për shumën 79,200 lekë, likuiduar me urdhër shpenzim nr. 468, datë 30.12.2014.
Paditës: A. L., ish-punonjës i Institucioni i Prefektit Qarkut Elbasan, me detyrë shofer i nën/Prefekturës Peqin, është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit z. A. K. nr. 3, datë 13.01.2014 me motivacionin mosrespektim të kohës dhe orarit të punës në mënyrë të përsëritur.
I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, përfaqësuar në gjykim nga A. K.
Objekti: Kundërshtim urdhri lirimit nr. 3, datë 13.01.2014 dhe kërkim dëmshpërblimesh.
Gjykata Administrative Shkallës së Parë Durrës me vendimin nr. 393, datë 11.04.2014 ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë dhe detyrimin e Institucionit te Prefektit që të dëmshpërblejë paditësin për një total 15 paga mujore, 1/2 paga mbi çdo vit pune nga data 09.01.2006 deri 09.01.2014 si shpërblim për vjetërsi dhe shpenzimet gjyqësore 43,000 lekë.
Ndaj vendimit të sipërcituar është bërë ankim nga Institucioni i Prefektit me shkresën nr. 1012/3, datë 23.04.2014, në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë për vendimin e Gjykatës Administrative Durrës nr. 393, datë 11.04.2014, e cila me vendimin nr. 3956, datë 28.10.2014 ka vendosur ndryshimin pjesërisht të vendimit nr. 393, datë 11.04.2014 dhe detyrimin e Institucionit të Prefektit që të dëmshpërblejë paditësin dhe shpenzimet gjyqësore 43,000 lekë.

A. L., është paguar për shumën 466,856 lekë, likuiduar me urdhër shpenzim nr. 469, datë 30.12. 2014, pa u bërë vendimi i rekursit nga Gjykata e Lartë.

Paditës: F. S., ish-punonjësit te PMNZSH-se, qarku Elbasan, Stacioni Elbasan, me gradë agjent dhe detyrë personel zjarrfikës, shpëtues, luftues, është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit z. A. K. nr. 88, datë 21.07.2014, sipas propozimit te shefit te sektorit te PMNZSH Qarku Elbasan, me motivacionin shkurtim të funksionit organik të vendit të punës.

I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, përfaqësuar në gjykim nga A. G.

Objekti: Kundërshtim urdhër lirimi nr. 88, datë 21.07.2014 për lirim nga detyra te ish-punonjësit te PMNZSH-se, qarku Elbasan dhe kërkim dëmshpërblimi.

Gjykata Administrative Shkallës së Parë Durrës me vendimin nr. 1437, datë 27.10.2014 ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, për vendosjen e detyrimit të institucionit të Prefektit për shpërblim me 12 paga mujore si pasojë e largimit nga puna dhe leja vjetore 2014.

Ndaj vendimit te sipërcituar është bërë ankim nga Institucioni i Prefektit në Gjykatën Apelit Administrativ Tiranë me shkresë nr. 3254/3 prot, datë 07.11.2014.

Kjo Gjykatë me vendimin nr. 2525, datë 14.09.2016 ka vendosur detyrimin e Institucionit te Prefektit pagesën sipas dispozitivit të vendimit.

F. S., është paguar për shumën 430,113 lekë, likuiduar me urdhër shpenzim nr. 280, datë 16.12.2016 dhe nr. 288, datë 29.12.2016, nuk ka kërkesë për rekurs në Gjykatën e Lartë.

Paditës: N. B., ish punonjës në detyrën e Inspektorit të Parandalimit, pranë Sektorit të PMNZSH-së Qarku Elbasan, me gradë Asistent I-rë dhe detyre inspektor parandalimi është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit z. Sh. D. nr. 37, datë 31.07.2013, sipas propozimit të shefit të sektorit të PMNZSH Qarku Elbasan, me motivacionin sipas kërkesës së tij me te cilën kërkon te largohet vetë nga puna për arsye shëndetësore.

I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, përfaqësuar nga juristi A. G.

Objekti: Trajtim me pagesë kalimtare me afat 2 vjet.

Gjykata Administrative Shkallës se Parë Durrës me vendimin nr. 139, datë 18.02.2014 ka vendosur rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj dhe prova.

Ndaj vendimit të sipërcituar është bërë ankim nga paditësi në Gjykatën Apelit Administrativ Tiranë për vendimin e Gjykatës Administrative Durrës nr. 139, datë 18.02.2014.

Gjykata Apelit Administrativ Tiranë me vendimin nr. 1823, datë 23.06.2016 ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 139, datë 18.02.2014 dhe ka vendosur detyrimin e Institucionit te Prefektit per trajtimin me pagesën kalimtare.

N. B., është paguar për shumën 470,721 lekë, likujduar me urdhër shpenzim nr. 281, datë 16.12.2016, nuk ka kërkesë për rekurs në Gjykatën e Lartë.

Paditës: E. G., ish-punonjësit te PMNZSH-se, qarku Elbasan, me gradë agjent dhe me detyrë personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë) të sektorit te PMNZSH-se se Qarkut Elbasan, Stacioni Elbasan dhe është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit z. A. K. nr. 69, datë 02.06.2014, sipas propozimit te shefit te sektorit te PMNZSH Qarku Elbasan, me motivacionin mosparaqitje në punë pa shkaqe të arsyetuara mbi 7 ditë.

I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, përfaqësuar nga juristi A. G.

Objekti: Kundërshtim urdhri lirimi nr. 69 datë 02.06.2014 për lirim nga detyra te ish-punonjësit te PMNZSH-se, qarku Elbasan dhe kërkim dëmshpërblimesh.

Gjykata Administrative Shkallës së Parë Durrës me vendimin nr. 1390, datë 17.10.2014 ka vendosur rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj e prova.

Ndaj vendimit të sipërcituar është bërë ankim nga paditësi në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë për vendimin e Gjykatës Administrative Durrës nr. 1390, datë 17.10.2014 e cila me vendimin nr. 3105, datë 06.10.2016 ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1390, datë 17.10.2014 dhe ka vendosur detyrimin e Institucionit te Prefektit që të dëmshpërblejë paditësin për 12 paga mujore, trajtimin me pagesë kalimtare.

E. G., është paguar për shumën 802,005 lekë, likuiduar me urdhër shpenzim nr. 285, datë 220.12.2016 dhe nr. 289, datë 29.12.2016dhe për shumën 205,673 lekë, likuiduar me urdhër shpenzim nr.18, datë 20.01.2017, në zbatim të Vendimit të Gjykatës Elbasan nr.1390, datë 17.10.2014 dhe Gjykatës së Apelit Durrës nr. 3105, datë 06.10.2016, nuk ka kërkesë për rekurs në Gjykatën e Lartë.

Paditës: Q. Xh., ish-punonjësit te PMNZSH-se, qarku Elbasan, me gradë asistent I-rë detyrë personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë) të sektorit të PMNZSH-se së Qarkut Elbasan, Stacioni Elbasan dhe është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit z. A. K. nr. 87, datë 21.07.2014, sipas propozimit te shefit te sektorit te PMNZSH Qarku Elbasan, me motivacionin shkurtim të funksionit organik të vendit të punës.

I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, përfaqësuar nga juristi A. G.

Objekti: Kundërshtim urdhri lirimi nr. 87, datë 21.07.2014 për lirim nga detyra te ish-punonjësit te PMNZSH-se, qarku Elbasan dhe kërkim dëmshpërblimi.

Gjykata Administrative Shkallës se Parë Durrës me vendimin nr. 1434, datë 27.10.2014 ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, për vendosjen e detyrimit të institucionit të Prefektit për shpërblim si pasojë e largimit nga puna ne total me 14 paga mujore dhe shpenzimet gjyqësore ne vlerën prej 43,500 lekë.

Ndaj vendimit të sipërcituar është bërë ankim nga Institucioni i Prefektit me shkresën nr. 3256/4, datë 07.11.2014 në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë për vendimin e Gjykatës Administrative Durrës nr. 1434, datë 27.10.2014.

Gjykata Apelit Administrativ Tirane me vendimin nr. 3237, datë 13.10.2016 ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1434, datë 27.10.2014, për kryerjen vetëm të pagesës kalimtare.

Sipas vendimit të gjykatës, Q. Xh. është likuiduar për shumën 433,631 lekë, me urdhër shpenzimit nr. 43, datë 22.02.2017, në zbatim të Vendimit të Gjykatës Elbasan nr. 1434, datë 27.10.2014 dhe Gjykatës së Apelit Durrës nr. 3237, datë 13.10.2016, nuk ka kërkesë për rekurs.

Paditës: I. Sh., me detyrë ish-anëtar i Komisionit Vendor të Verifikimit Titujve te Pronësisë për Institucionin e Prefektit Qarkut Elbasan, me urdhrin e ish-Prefektit z. A. K. nr. 126, datë 28.10.2014 është liruar nga detyra me motivacionin shkelje e rëndë në kryerjen e detyrës funksionale në mënyrë të përsëritur.

I Padituri: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan, përfaqësuar nga juristi z. A. G.

Objekti: Kundërshtim urdhri i lirimit nr. 126, datë 28.10.2014 për lirim nga detyra dhe kërkim dëmshpërblimesh.

Gjykata Administrative Shkallës së Parë Durrës me vendimin nr. 1777, datë 22.12.2014 ka vendosur rrëzimin e padisë, si të pambështetur në ligj e prova.

Ndaj këtij vendimi është bërë ankim nga paditësi në Gjykatën Apelit Administrativ Tiranë për vendimin e Gjykatës Administrative Durrës nr. 1777, datë 22.12.2014.

Gjykata Apelit Administrativ Tiranë me vendimin nr. 296, datë 01.02.2017 ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1777, datë 22.12.2014 dhe ka vendosur detyrimin e Institucionit të Prefektit që të dëmshpërblejë paditësin për një total 20 paga mujore bruto.

Nga ana e Institucionit te Prefektit është depozituar rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë Tiranë, me shkresë nr. 3599/4, datë 06.03.2017, çështje e cila ende nuk është shqyrtuar.

Sipas vendimit të gjykatës I. Sh. është likuiduar për vlerën prej 1,524,400 lekë, sipas urdhër shpenzimit nr. 81, datë 12.04.2017 për 50,000 lekë; me urdhër shpenzimin nr. 95, datë 27.04.2017, për vlerën 300,000 lekë; me urdhër shpenzimin nr. 137, datë 20.06.2017 për 636,374 lekë dhe me urdhër shpenzimin nr. 208, datë 11.09.2017 për vlerën 538,026 leke, pagesë e kryer pa përfunduar gjykimi nga Gjykata e Lartë sipas rekursit të bërë.

Paditës: E. Z., ish-punonjësit te PMNZSH-së, qarku Elbasan, me gradë Agjent dhe detyrë shofer, personel zjarrfikës, shpëtues, luftues (niveli bazë) te sektorit te PMNZSH-së, Stacioni Gramsh, i cili është liruar nga detyra me urdhrin e ish-Prefektit z. A. K. nr. 77, datë 02.07.2014, sipas

propozimit te shefit te sektorit te PMNZSH Qarku Elbasan, me motivacionin kryerje në mënyrë të përsëritur thyerje të rënda të disiplinës.

I Paditurë: Institucioni i Prefektit qarkut Elbasan i përfaqësuar nga juristi A. G.

Objekti: Kundërshtim urdhër lirimi nr. 77, datë 02.07.2014 për lirim nga detyra te ish-punonjësit te PMNZSH-se, qarku Elbasan dhe kërkim dëmshpërblimi.

Gjykata Administrative Shkallës së Parë Durrës me vendimin nr. 101, datë 02.02.2015 ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, për vendosjen e detyrimit të Institucionit të Prefektit, me 9 paga mujore shpërblim si pasojë e largimit nga puna.

Ndaj këtij vendimi është bërë ankimim në Gjykatën e Apelit Administrativ Tirane nga Institucioni i Prefektit me shkresë nr. 4353/2, date 11.02.2015 për vendimin e Gjykatës Administrative Durrës nr. 101, datë 02.02.2015.

Gjykata Apelit Administrativ Tiranë, ka shqyrtuar këtë vendim dhe me vendimin nr. 1306, datë 30.03.2017 duke vendosur detyrimin e Institucionit te Prefektit për likuidim të 9 paga mujore.

Sipas vendimit të gjykatës, E. Z. është likuiduar për shumën 408,200 lekë, me urdhër shpenzimin nr. 210, datë 12.09.2017, është kryer pagesa pa u bërë Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

Për periudhën nga viti 2013 deri 9/mujori i vitit 2017 u audituan rast pas rasti largimet nga puna të ish-punonjësve dhe rezultoi se ndërprerje te marrëdhënieve te punës nga punëmarrësit është kundërshtuar në gjykatë të Shkalllës Parë dhe të Apelit, duke kërkuar kundërshtimin e urdhrave të lërimit, mos lidhjes së kontratës, etj dhe kërkimin e dëmshpërblimeve dhe për **29 raste**, është paguar **vlera me efekt financiar prej 20,806,409 lekë,** sipas Pasqyrës së pagesave të ish-punonjësve të larguar, përfituar me vendime të Gjykatave për periudhën janar 2013 - shtator 2017, **"ANEKSI nr. 1".**

Mos zbatimi i procedurave për largimin e punonjësve nga puna ka shkaktuar efekt negativ në buxhetin e shtetit për vlerën e mësipërme prej 20,806,409 lekë, vlera të cilat duhet të shpenzoheshin për destinacione të tjera të dobishme nga institucioni. Këto shpenzime gjyqësore nuk sigurojnë mirë menaxhim të fondeve publike.

Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur, arrihet në konkluzionin se në zbatimin e 29 vendimeve gjyqësore nga titullarët e institucionit, nuk janë analizuar këto vendime dhe nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative. Nuk ka akt nga titullari për përcaktimin e përgjegjësive. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 62 ku thuhet:

"Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa aktin e titullarit që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi".

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. R. K. me detyrë, ish-Prefekt i Prefekturës së Qarkut Elbasan në cilësinë e nëpunësit autorizues, për periudhën 08.05.2007 deri 08.05.2008; për 6 raste;
- Znj. M. H. me detyrë, ish-Prefekte e Prefekturës së Qarkut Elbasan në cilësinë e nënpunësit autorizues, për periudhën 01.11.2005 deri 07.05.2007, për 2 raste;
- Z. Sh. D. me detyrë, ish-Prefekt i Prefekturës së Qarkut Elbasan në cilësinë e nënpunësit autorizues, për periudhën 09.05.2008 deri 08.10.2013, për 8 raste;
- Z. A. K. me detyrë, ish-Prefekt i Prefekturës së Qarkut Elbasan në cilësinë e nëpunësit autorizues, për periudhën 10.10.2013 deri 05.05.2017, për 8 raste;
- Z. A. G. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik Prefekturës, në cilësinë e nënpunësit zbatues;
- Z. A. K. me detyrë jurist në Sektorin Juridik Prefektura Elbasan në cilësinë e nënpunësit zbatues;

• Znj. A. Ç. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse Prefektura Elbasan në cilësinë e nëpunësit zbatues.
Për sa më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr. 2, datë 14.11.2017 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, përfaqësuar nga z. A. G. përgjegjësi i sektorit juridik në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan, me shkresë nr. 1299/19, datë 24.11.2017, për sa trajtuar në **faqen 10,** ku është evidentuar se "Mos zbatimi i procedurave për largimin e punonjësve nga puna ka shkaktuar efekt negative në buxhetin e shtetit" si dhe për Projekt Raportin e Auditimit me shkresë nr. 1299/30, datë 11.12.2017, protokolluar në KLSH me nr. 880/4, datë 12.12.2017, ka paraqitur kundërshtitë duke bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:
a) Politikat e punësimit për punonjësit e ish-sektorit të PMNZSH Qarku Elbasan në respekt të ligjit nr. 8766, datë 05.04.2001, ndryshuar me ligjin nr. 10 137, datë 11.05.2009, nr. 11/2013, datë 14.2.2013, "Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe për Shpëtimin", neni 12 "Emërimi dhe lirimi nga detyra", pika 3. Emërimi dhe lirimi nga detyra e personelit oficer, në përbërje të strukturës së PMNZSH-së bëhet nga Ministri përgjegjës, pika 4. Emërimi dhe lirimi nga detyra i personelit të shërbimit në strukturat e prefektit bëhen nga Prefekti me propozim të shefit të sektorit të PMNZSH-së. Pra lidhur me motivin dhe procedurën e ndjekur në respekt të ligjeve të sipërcituara përgjegjësia nuk është e sektorit juridik por e përgjegjësit te sektorit të PMNZSH-së Qarku Elbasan i cili ka detyrimin ligjor ti propozojë prefektit për çdo lirim dhe emërim në detyrë të kësaj kategorie punonjësish dhe prefekti sipas propozimit të paraqitur bën miratimin për çdo lirim dhe emërim dhe konkretisht për rastet:
- **N. M.**, ish-punonjës i PMNZSH,
- **R. Z.**, ish-punonjës i PMNZSH,
- **S. D.**, ish-punonjës i PMNZSH,
- **Y. L., K. H., M. Gj.**, ish-punonjës i PMNZSH,
- **A.B.**, ish-punonjës i PMNZSH,
- **M. B.**, ish-punonjës i PMNZSH,
- **A. B., Sh. G., R. H.**, ish-punonjës i PMNZSH,
- **G. S., Q. Sh.**, ish-punonjës të rrethit Elbasan PMNZSH,
- **M. A.**, ish-punonjës i PMNZSH,
- **A. P.**, ish-punonjës i rrethit Elbasan PMNZSH,
- **E. D.**, ish-komandante e stacionit zjarrfikës Gramsh,
- **S. B.**, ish-punonjës i rrethit Elbasan PMNZSH,
- **K. S.**, ish-punonjës i rrethit Elbasan PMNZSH,
- **L. N.**, ish-punonjës i stacionit zjarrfikës Librazhd,
- **Xh. L.**, ish-punonjës i sektorit te PMNZSH-se qarku Elbasan,
- **A. L.**, ish-punonjës Shofer i Nen/Prefektit Peqin, Institucioni i Prefektit Qarkut Elbasan,
- **F. S.**, ish-punonjës i PMNZSH-se, qarku Elbasan,
- **N. B.**, ish-punonjës i PMNZSH-së Qarku Elbasan,
- **E. G.**, ish-punonjës i PMNZSH-se, qarku Elbasa,
- **Q. Xh.**, ish-punonjës i PMNZSH-se, qarku Elbasan,
- **E. Z.**, ish-punonjës i PMNZSH-se, qarku Elbasan,
- **B. B.**, ish-punonjës i PMNZSH-së,

Pra përsa i përket motivit të lirimit dhe procedurës së ndjekur nuk është në përgjegjësinë e sektorit juridik.
Lidhur me faktin se për vendimet gjyqësore të trajtuara në akt-konstatim dhe Projekt Raport Auditimi, se nuk janë ndjekur procedurat gjyqësore dhe shkallët e ankimimit gjyqësor sektori juridik në respekt të rregullores së brendshme për Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan, çdo kërkesë padi e paraqitur apo njoftim nga gjykata protokollohet në zyrën e protokoll arkivës së institucionit të prefektit dhe mbasi siglohet nga prefekti ose sekretari i përgjithshëm i jepet kundrejt firmës sektorit juridik i cili ka për detyrë pastaj të ndjekë të gjitha hapat e duhura ligjore

për këtë procedurë gjyqësore, ndërsa për këtë procedurë sektori juridik në 5 raste nuk ka pasur asnjë dijeni dhe asnjë njoftim zyrtar të marrë kundrejt firmës nga zyra e protokoll arkivës dhe për këto arsye vendimi është marrë në mungesë nga gjykata si dhe nuk ka pasur përfaqësues të Institucionit të Prefektit Qarkut Elbasan si dhe nuk është apeluar nga ana jonë dhe konkretisht:
- **N. M.**, ish-punonjës i PMNZSH,
- **R. Z.**, ish-punonjës i PMNZSH,
- **S. D.**, ish-punonjës i PMNZSH,
- **Y. L., K. H., M. Gj.**, ish-punonjës i PMNZSH,
- **M. A.**, ish-punonjës i PMNZSH,

Ndërsa për rastet e tjera janë apeluar sipas vendimeve të Gjykatës së Apelit Durrës, nga këto në 3 raste, sqarohet se institucioni i prefektit në këtë proces ka qenë person i tretë dhe jo palë e paditur dhe përgjegjësia e drejtpërdrejtë është e Ministrisë së Brendshme Tiranë për rastet.
- **M. B.**, ish-punonjës i PMNZSH,
- **E. D.**, ish-komandante e stacionit zjarrfikës Gramsh,
- **Xh. L.**, ish-punonjës i sektorit te PMNZSH-se qarku Elbasan,

b) Politikat e punësimit për punonjësit e administratës së Prefektit në respekt të ligjit "Për Prefektin e Qarkut", Urdhrit të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Elbasan", si dhe rregullores së brendshme për funksionimin e administratës së Prefektit të Qarkut Elbasan, bëhen nga Prefekti me propozim të përgjegjëses së sektorit të shërbimeve të brendshme znj. I. M. që mbulonte edhe detyrën e përgjegjëses së administratës. Pra lidhur me motivin dhe procedurën e ndjekur në respekt të ligjeve të sipërcituara përgjegjësia nuk është e sektorit juridik por e znj. Irena Mero që mbulonte edhe detyrën e përgjegjëses së administratës e cila ka detyrimin ligjor ti propozojë prefektit për çdo lirim dhe emërim në detyrë dhe konkretisht për rastet.
- **A. K.**, ish-Sekretar i Përgjithshëm i Institucionit të Prefektit Qarkut Elbasan,
- **V. B.**, ish-punonjëse, Specialiste Sherbimesh, Nën/Prefektura Librazhd,
- **I. Sh.**, ish-Drejtor dhe anëtar i KVVTP pranë Prefekturës së Qarkut Elbasan.

Pra për sa i përket motivit të lirimit dhe procedurës së ndjekur nuk është në përgjegjësinë e sektorit juridik.
Nga ana e sektorit juridik për vendimet gjyqësore të cituara në akt-konstatimin dhe Projekt Raportin e Auditimit nuk janë ndjekur procedurat gjyqësore për sa i përket rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, Tiranë, pasi shprehen se kemi qenë në kushtet që parashikon ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me ligjet nr. 8431, datë 14.12.1998; nr. 8491, datë 27.5.1999; nr. 8535, datë 18.10.1999; nr. 8812, datë 17.5.2001; nr. 9062, datë 08.05.2003; nr. 9953, datë 14.07.2008, nr. 10 052, datë 29.12.2008, nr. 49/2012, datë 19.4.2012; nr. 122/2013, datë 18.04.2013; nr. 160/2013, datë 17.10.2013; nr. 114/2016, datë 03.11.2016; nr. 38/2017, 30.03.2017, neni 472, është përcaktuar se "Vendime ndaj të cilave mund të ushtrohet rekurs (Ndryshuar me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001; shfuqizuar shkronja "c" me ligjin nr. 122/2013, datë 18.4.2013). Vendimet e shpallura nga gjykata e Apelit dhe ato të gjykatës së shkallës së parë, në rastet që përcaktohen nga ky Kod, mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë vetëm kur: a) nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji; b) ka shkelje të rënda të normave procedurale (neni 467 i këtij Kodi); c) shfuqizuar", pra këto vendime të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë nuk ka qenë në asnjë nga kushtet që ka parashikuar ligji i sipërcituar dhe si i tillë nga ana e sektorit juridik nuk është paraqitur rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, Tiranë.
Lidhur me faktin se këto vendime gjyqësore nuk janë analizuar dhe nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative si dhe vendimet gjyqësore nuk mund likuidohej pa aktin e titullarit që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi këto detyra i takojnë titullarit të institucionit, Prefektit të

Qarkut Elbasan dhe znj. I. M. që mbulonte edhe detyrën e përgjegjëses së administratës dhe jo të sektorit juridik.
Nga ana e Institucionit të Prefektit Qarkut Elbasan janë zbatuar të gjitha procedurat mbi largimin e punonjësve nga puna, **por është evidente që gjyqësori sot mbron dhe favorizon gjithmonë punonjësit dhe jo institucionet, prandaj vendimet kanë qenë të njëanshme në dëm të institucioneve.** Nga ana jonë jemi munduar në respekt të kodit të punës dhe ligjit nr. 8766, datë 05.04.2001, ndryshuar me ligjin nr. 10 137, datë 11.05.2009, nr. 11/2013, datë 14.2.2013, "Për Mbrojtjen nga Zjarri dhe për Shpëtimin" të kryejmë të gjitha procedurat e duhura ligjore mbi respektimin e marrëdhënieve Punëdhënës dhe Punëmarrës.
Efekti negativ që është shkaktuar në buxhetin e shtetit ka ardhur për rrjedhojë të vendimeve gjyqësore që siç ju kemi përmendur më lart kanë qenë të njëanshme si dhe nga ana jonë janë ndjekur hapat e duhura ligjore lidhur me ankimimet në shkallët e gjyqësorit.

c) Lidhur me pagesën e vlerës prej 1,379,235 lekë në favor të **Operatorëve ekonomik "B", Elbasan, "Ç", Librazhd, "H" Librazhd, "S-G", Librazhd, "B", Peqin, "R", Gramsh,** sipas vendimit gjyqësor të shkallës parë Elbasan nr. 2101, datë 16.09.2009 dhe gjykatës së Apelit nr. 1783, datë 20.11.2013, për mos ndjekje të tre shkallët e gjyqësorit sqarojmë si më poshtë vijon:
Referuar Ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar. Vendimet e shpallura nga gjykata e apelit dhe ato të gjykatës së shkallës së parë, në rastet që përcaktohen nga ky Kod, mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë vetëm kur: a) nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji; b) ka shkelje të rënda të normave procedurale (neni 467 i këtij Kodi); c) shfuqizuar", pra vendimi sipërcituar i Gjykatës se Apelit Durrës nuk ka qenë në asnjë nga kushtet qe ka parashikuar ligji i sipërcituar dhe si i tille nga ana e sektorit juridik nuk është paraqitur rekurs ne Gjykatën e Lartë.
Në këtë proces gjyqësor përfaqësues në gjyq për Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan kanë qenë z. A. H., përgjegjës i sektorit të PMNZSH qarku Elbasan, z. T. A., komandant stacioni Elbasan te PMNZSH qarku Elbasan, zj. O. Sh., ekonomiste e PMNZSH qarku Elbasan të cilët kishin detyrimin ligjor të mbronin interesat e vetë sektorit të PMNZSH qarku Elbasan edhe për faktin se detyrimet financiare që kërkoheshin nga subjektet private "B", Elbasan, "Ç", Librazhd, "H" Librazhd, "S-G", Librazhd, "B", Peqin, "R", Gramsh, ishin për sasitë e karburantit që janë konsumuar nga vetë ky sektor në situate emergjente zjarri e fatkeqësish natyrore.
Lidhur me faktin se ky vendim gjyqësor nuk është analizuar dhe nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative si dhe vendimi gjyqësor nuk mund likuidohej pa aktin e titullarit që provon gjysmën e auditimit te këtij procesi këto detyra i takojnë titullarit te institucionit, Prefektit te Qarkut Elbasan dhe përgjegjësit të sektorit te PMNZSH-së Qarku Elbasan dhe jo të sektorit juridik.
Qëndrimet e auditusve Shtetëror të KLSH-së.
Në lidhje me komentet e bëra nga përgjegjësi i sektorit juridik z. A. G. se kundërshtitë e paraqitura prej tij i cili ka përshkruar në mënyrë të detajuar procedurat e ndjekura në lidhje me vendimet gjyqësore, nga ana e grupit të auditimit nuk merret në konsideratë, pasi këto veprime grupi i auditimit nuk i ka trajtuar shkelje por është trajtuar shkelje,
- së pari: mos zbatimi i procedurave për largimin e punonjësve nga puna dhe
- së dyti: nuk janë ndjekur të tre shkallët e gjyqësorit, në zbatim të neneve 112 dhe 472 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

2. A. K., me detyrë jurist në sektorin juridik në Institucionin e Prefektit të Qarkut, për akt-konstatimin nr. 2, datë 14.11.2017 me shkresë nr. 1299/20, datë 24.11.2017 si dhe për Projekt Raportin e Auditimit, me shkresë nr. 1299/31, datë 11.12.2017, protokolluar në KLSH me nr. 880/4, datë 12.12.2017, ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Ndër të tjera jam ngarkuar me përgjegjësi, për sa më sipër sqaroj se në të gjitha proceset gjyqësore ku jam autorizuar nga titullari i institucionit kam marrë pjesë rregullisht dhe konkretisht për rastet:
- **A. B.**, ish-punonjës i PMNZSH,
- **A. B., Sh. G., R. H.**, ish-punonjës të PMNZSH,
- **A. P.**, ish-punonjës i PMNZSH,
- **Ë. D.**, ish-komandante e stacionit zjarrfikës Gramsh,
- **L. N.**, ish-punonjës i stacionit zjarrfikës Librazhd,
- **A. K.**, ish-Sekretar i Përgjithshëm i Institucionit të Prefektit Qarkut Elbasan,
- **A. L.**, ish-punonjës Shofer i Nen/Prefektit Peqin, Institucioni i Prefektit Qarkut Elbasan,

Për të gjitha rastet e mësipërme kamë ndjekur procedurat ligjore duke marrë pjesë, duke paraqitur kundërshtime dhe në çdo rast ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë janë bërë apelimet në gjykatën e apelit, ku më pas vendimet kanë marrë formë të prerë.
Përsa i përket rekurseve nuk janë bërë për arsye se dhe vetë ligji **nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 472,** përcakton se për cilat shkaqe mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë.
Vendimet e shpallura nga gjykata e apelit dhe ato të shkallës së parë në rastet që parashikohen në këtë Kod mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë:
a) për zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, të një rëndësie themelore për njehsimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;
b) kur vendimi i ankimuar është i ndryshëm nga praktika gjyqësore e Kolegjit Civil ose praktika e njehsuar e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
c) ka shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurës së gjykimit, sipas nenit 467 të këtij Kodi.
Duke gjykuar se nuk plotësohej asnjë nga kushtet ligjore të përmendura në nenin më lart për rekurs, nuk kemi proceduar më tej me këtë hallkë të gjyqësorit.
Qëndrimet e auditusve Shtetëror të KLSH-së.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se kundërshtitë e paraqitura prej personave të atakuar të cilët kanë përshkruan në mënyrë të detajuar procedurat e ndjekura në lidhje me vendimet gjyqësore, nga ana e grupit të auditimit nuk merret në konsideratë, pasi këto veprime grupi i auditimit nuk i ka trajtuar shkelje por është trajtuar shkelje,
- së pari: mos zbatimi i procedurave për largimin e punonjësve nga puna dhe
- së dyti: nuk janë ndjekur të tre shkallët e gjyqësorit, në zbatim të neneve 112 dhe 472 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

3. A. Ç. me detyrë përgjegjëse e sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse, për akt-konstatimin nr. 2, datë 14.11.2017, me shkresë nr. 1299/24, datë 24.11.2017 si dhe për Projekt Raportin e Auditimit, me shkresë nr. 1299/33, datë 11.12.2017, protokolluar në KLSH me nr. 880/4, datë 12.12.2017, ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:
-Mos zbatimi i procedurave për largimin e punonjësve nga puna ka shkaktuar efekt negativ në buxhetin e shtetit për vlerën e mësipërme prej 20,806,409 lekë, vlera të cilat duhet të shpenzoheshin për destinacione të tjera të dobishme nga institucioni. Këto shpenzime gjyqësore nuk sigurojnë mirë menaxhimin të fondeve publike
Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e paraqitur, arrihet në konkluzionin se në zbatimin e 29 vendimeve gjyqësore nga titullarët e institucionit, nuk janë analizuar këto vendime dhe nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative. Nuk ka akt nga titullari për përcaktimin e përgjegjësive, veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" pika 62.
Përsa i përket kësaj pike paraqesim kundërshtimin tonë pasi për personat e likuiduar nga përgjegjësja e sektorit financiar dhe shërbimeve mbështetëse për detyrimet e vendimeve gjyqësore

të lindura në periudhën e Prefektit Z. A. K. janë bërë gjurmët e auditimit sipas materialeve bashkangjitur kësaj shkrese si më poshtë:
1. për vendimin e gjykatës Durrës nr. 2525, datë 14.09.2016, përfituesi Z. F. S. gjurma e auditit protokoll nr. 2065/2, datë 14.12.2016.
2. për vendimin e gjykatës Durrës nr. 1823, datë 23.06.2016, përfituesi Z. N. B. gjurma e auditit protokoll nr. 2064/2, datë 14.12.2016.
3. për vendimin e gjykatës Durrës nr. 3105, datë 06.10.2016, përfituesi Z. E. G. gjurma e auditit protokoll nr. 3012/2, datë 22.12.2016.
4. për vendimin e gjykatës Durrës nr. 3237, datë 13.10.2016, përfituesi Z. Q. Xh. gjurma e auditit protokoll nr. 311/1, datë 21.02.2017.
5. për vendimin e gjykatës Durrës nr. 296, datë 01.02.2017, përfituesi Z. I. Sh. gjurma e auditit protokoll nr. 707/3, datë 10.04.2017.
6. për vendimin e gjykatës Durrës nr. 1306, datë 30.03.2017, përfituesi Z. E. Z. gjurma e auditit protokoll nr. 1610/2, datë 11.09.2017

Ndërsa referuar vendimeve gjyqësore të tjera të likuiduara, që i përkasin vendimeve gjyqësore prej periudhës 2005, mendojmë që i takon personave të tjerë në pozicioni e nëpunësit zbatues, si administrues të fondeve buxhetore për institucionin e prefektit të qarkut Elbasan. Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan rezulton që në momentin e marrjes në dorëzim të detyrës më 31.03.2012 si përgjegjëse e sektorit financiar Znj. A. Ç, rezultonin detyrime në vlerën 13,452,894 lekë detyrime për vendime gjyqësore, vlerë kjo e trashëguar prej vitit 2005 që i përkasin periudhës:
-V. Z., ish përgjegjëse e sektorit financiar për periudhën 01.09.2006 deri 31.03.2008;
-F. R., ish përgjegjëse e sektorit financiar periudha 01.04.2008 deri 24.07.2008;
-A. D., ish përgjegjëse e sektorit financiar periudha 25.07.2008 deri 29.02.2012.

Së pari, nga momenti i marrjes në dorëzim të detyrës janë bërë tentativa si në rrugë shkresore dhe në kontakte telefonike me nëpunësit e Drejtorisë së Financës pranë Ministrisë së Brendshme për njohjen e këtyre detyrimeve si dhe kërkesat për shtesë fondi dhe konkretisht.

Në vitin 2012 rezulton që prej buxhetit të shtetit të akorduar në fillim të vitit janë likujduar 450,000 lekë për shpenzime për vendime gjyqësore dhe nuk është akorduar as një shtesë fondi për likujdim detyrimesh vendimesh gjyqësore.

Bashkangjitur observacionit po ju dërgojmë një kopje të kërkesave për shtesë fondi drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme Tiranë, shkresa nr. 937, datë 06.03.2012, shkresa nr. nr. 937/1, datë 19.04.2012, shkresa nr. nr. 937/2, datë 11.06.2012, shkresa nr. 3066/1, datë 12.10.2012, shkresa nr. nr. 937/3, datë 31.10.2012, shkresa nr. 3066/2, datë 12.12.2012.

Në vitin 2013 rezulton që nga buxheti i shtetit janë bërë pagesa në vlerën 2,630,750 lekë.

Prej kësaj shume rezulton që nga Ministria e Punëve të Brendshme është bërë një shtesë në buxhetit vjetor në vlerën 200,000 lekë fond ky me destinacioni mbi personat përfitues.

Nëpërmjet shkresës së Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. prot. 7606/3, datë 15.11.2013 është çelur fondi për likuidim te pjesshëm të dy personave Xh. L. dhe M. B.

Duhet theksuar që likuidimet e bëra gjate vitit 2013 janë bërë duke marrë konfirmim nga Ministria e Brendshme në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 214, datë 20.05.2013 "Për procedurat e trajtimit dhe shlyerjes së detyrimeve ndaj vendimeve gjyqësore në ngarkim të Ministrisë së Brendshme" si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 18.08.2011 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit".

Bashkangjitur do të gjeni një kopje të korrespondencës:

Shkresa Prefekturës së Qarkut Elbasan nr. 2984/1, datë 05.12.2013 konfirmuar me shkresë të MB nr. 5159/1, datë 24.12.2013, gjithashtu çdo likuidim i bërë për vendimet gjyqësore është bërë me urdhër të brendshme të titullarit të institucionit.

Në vitin 2014 rezulton që të gjitha detyrimet e vendimeve gjyqësore u likuiduan në zbatim të VKM nr. 50, datë 05.02.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e

detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit", të urdhrit të MB nr. 103, datë 11.04.2014 "Për marrjen e masave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, detyrimet ndaj KESH-it si dhe realizimin e investimeve të miratuara për vitin 2014", të Urdhrit të Ministrit të Punëve të Brendshme nr. 214, datë 20.05.2013 "Për procedurat e trajtimit dhe shlyerjes së detyrimeve ndaj vendimeve gjyqësore në ngarkim të Ministrisë së Brendshme", të Udhëzimit nr. 2, datë 18.08.2011 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit" si dhe të Udhëzimin nr. 1, datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".
Detyrimet për vendimet gjyqësore u njohën nga detyrime të prapambetura, pasi u konfirmuan si detyrime dhe nga dega e Thesarit Elbasan, në zbatim të bazës ligjore të sipërpërmendur dhe u çel fondi në të gjithë shumën e kërkuar për likuidim.
Gjithsesi kërkesat tona për shtesa fondi kanë vazhduar pasi institucioni ynë për arsyet të detyrimeve për vendimet gjyqësore ka qene i bllokuar në thesar për likuidim të shpenzimeve të llojeve të ndryshme .
Bashkangjitur po ju dërgojmë shkresën tonë me nr. 1373, datë 28.03.2014, nr. 789, datë 17.02.2014, nr. 789/1, datë 28.03.2014, si dhe shkresën nr. 5116, datë 13.06.2014 "Akordim fondi" të Ministrisë së Punëve të Brendshme në shumën 12,922,468 lekë prej të cilave nuk është likuiduar vetëm shuma 127,010 lekë shumë kjo e likuiduar në vitin 2015 për arsye sepse subjekti përfitues kishte ndërruar administrator dhe me kërkesën tonë, debitori nëpërmjet një vendimi gjyqësor vërtetoi që përfituesi në rastin konkret kishte ndërruar administrimin për arsye të pozicionit publik që mbante, për arsye të shmangies së konfliktit të interesit. Ky detyrim u shlye nga fondet buxhetore të akorduara për tu përdorur në vitin 2015.
Gjithashtu dhe vendimet gjyqësore të lindura brenda vitit 2014 për personat e liruar si Admirim Kongoli, Valbona Balla dhe Arjan Lumi janë mbyllur me fondet buxhetore të vitit 2014 dhe jo me fonde shtesë.
<u>Në vitin 2016</u> rezulton që janë paguar shpenzime gjyqësore jemi përpjekur ti likuidojmë brenda vitit buxetor në zbatim të Udhëzimin nr. 1, datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit" pika 5 dhe 7 duke minimizuar detyrimet e prapambetura për vitin pasardhës megjithëse janë fituar në fund të tetorit periudhë kjo që korrespondon me mbylljen e vitit buxhetor.
<u>Së dyti</u>, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", të Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimin nr. 1, datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit", të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", të Udhëzimit nr. 21, datë 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjithave niveleve" si dhe të ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara dhe detyrimet kontraktuale", përgjegjësia e nëpunësit zbatues është të mos krijojë detyrime të prapambetura, përkundrazi me përjashtim të shpenzimeve për energji dhe ujë sipas pikës 139 të Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
Qëndrimet e audituesve Shtetëror të KLSH-së.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se kundërshtitë e paraqitura prej personave të atakuar të cilët kanë përshkruan në mënyrë të detajuar procedurat e ndjekura në lidhje me pagesat e vendimeve gjyqësore, nga ana e grupit të auditimit nuk merret në konsideratë, pasi këto veprime grupi i auditimit nuk i ka trajtuar shkelje por është trajtuar shkelje, mos zbatimi i procedurave për largimin e punonjësve nga puna, të fituara e drejta e pagesës me vendime gjyqësore, ku pagesa ka shkaktuar efekt negativ në buxhetin e shtetit për vlerën prej 20,806,409 lekë, vlera të cilat duhet të shpenzoheshin për destinacione të tjera të dobishme nga institucioni dhe se këto shpenzime gjyqësore nuk sigurojnë mirë menaxhimin të fondeve publike.

5. Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit.

Nga audtimi i dokumentacionit mbi organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit sipas planit unik kontabël për institucionet (azhurnimi i tij në librat përkatës, ditar, partitar, libri i madh ose centralizatori, ditari i veprimeve të ndryshme etj), për periudhën janar 2013 deri me datë 30.09.2017, rezulton se llogaritë mbaheshin sipas planit unik kontabël për institucionet, kontabiliteti mbahet duke aplikuar programin në IT dhe atë të shkruar. Nga auditim mbi aplikimin e programit të IT rezulton se sistemi kompjuterik nuk është i certifikuar nga kompani të licencuar për ruajtjen e të dhënave, sistemi kompjuterik nuk mbron asetet dhe nuk ruan integritetin e të dhënave, pasi dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 10273, datë 29.4.2010 "Për dokumentin elektronik".

- Analiza mbi regjistrimet në Ditari të veprimeve për vitin 2013, 2014, 2015. Nga auditimi i dokumentacionit mbi regjistrimet e veprimeve të kryera në ditari n e bankës, arkës, magazinës, veprimeve të ndryshme etj, në librat kontabilitetit rezulton se në të gjitha rastet veprimet kontabël janë regjistruar në Ditarët përkatës duke kryer veprimet kontabël në debi dhe kredi të llogarive përkatëse, veprim në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Nga verifikimi i bilancit të viti 2016 rezultoi që: *"Nxjerrja e bilancit kontabël me afat , plotësimi i pasqyrave financiare në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qëndrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar.*

Bilanci i vitit 2016 për Prefekturën e Qarkut Elbasan është hartuar brenda afatit ligjor datë 14.02.2017 dhe është miratuar në degën e thesarit Elbasan. Dërgimi i pasqyrave financiare pranë Ministrisë së Brendshme është bërë me shkresë përcjellëse nr. 271, datë 14.02.2017 "Dërgim i pasqyrave financiare vjetore të vitit 2016"

Bilanci ka të plotësuar aktiv-pasivin, pasqyrën e shpenzimeve, të ardhurave si dhe pasqyrat e tjera shoqëruese, pra u konstatua se nga ana e sektorit të financës dhe shërbimeve mbështetëse ishte hapur dhe mbajtur regjistri i aktiveve në zbatim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, pika 26 që shpreh:

> *"Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar".*

Aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe patrupëzuara pasqyrohen në bilanc ku shtesat dhe pakësimet janë pasqyruar tek pasqyra nr. 6 e bilancit "*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve te qëndrueshme*" e cila kuadron me aktivin e bilancit dhe konkretisht:

A. Aktive të Qëndrueshme. Zërat e Aktiveve të qëndrueshme paraqiten për vlerën 28,360,299 lekë janë zbërthyer analitikisht me inventar kontabël dhe kuadrojnë, konkretisht: llog: 212 "*ndërtime e konstruksione* " në vlerën 27,962,747 lekë, vlerë e cila pasqyron vlerën e objekteve të Prefekturës Elbasan dhe të nënprefekturave, Librazhd, Gramsh dhe Peqin; llog: 214 "*instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune* " prej 2,333,141 lekë, Llog: 215 "*Mjete transporti* " për 4 automjete me vlerë 7,950,655 lekë, Llog: 218 "*inventar ekonomik* " me vlerë 9,467,922 lekë, etj.

Aktivet e qëndrueshme janë pasqyruar në regjistër.

Amortizimi vjetor pasqyrohet në llogarinë 219 "Amortizimi" me një vlerë prej 19,354,166 lekë dhe është llogaritur sipas normave dhe tarifave ligjore në zbatim të VKM nr. 401, datë 23.10.1989 "Për miratimin e normave të reja të amortizimit të makineri e paisjeve dhe të mjeteve të transportit si dhe Udhëzimit nr. 14 të Ministrisë së Financave datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të

huaj", i ndryshuar, ndërsa amortizimi i mbartur është pasqyruar në bilanc dhe kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit.
B. Aktive Qarkulluese. Zërat e aktiveve Qarkulluese paraqiten për vlerën 6,514,057 lekë dhe përbëhet nga materiale me vlerë 1,997,121 lekë, objekte inventari 643,780 lekë, të tjera operacione me shtetin 3,165,489 lekë (financim i pritshëm nga buxheti), debitorët në fund të vitit 2016 paraqiten me vlerën 694,917 lekë, të cilët në fillim të vitit ishin me vlerën 7,584,512 lekë, ku për vlerën 6,890,000 lekë përbëhej nga akt-ekspertiza të pa paguara nga ana e prokurorive të rretheve Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Peqin, të cilat sipas procesverbaleve datë 24 dhe 25 maj 2016 janë transferuar bashkive respektive si detyrime të pa likuiduara për akt-ekspertiza dhe miratim objekti. Për ecurinë e tyre për periudhën nën auditim është përpiluar pasqyra e ecurisë së debitorëve llogaria 468 "Aneksi nr. 5", bashkangjitur këtij akt-verifikimit, ndërsa për vlerën 694,917 lekë përbëhet për detyrimet që kanë 12 persona Institucionit të Prefektit të krijuar prej vitesh, megjithëse janë bërë përpjekjet për arkëtimin e tyre, duke kërkuar në rrugë gjyqësore dhe së fundmi duke i dërguar në zyrën përmbarimore.
Edhe llogaria 532 "vlera të tjera" paraqitet me një vlerë prej 12,750 lekë që pasqyron vlerën e pullave gjendje e cila është e njëjtë sipas procesverbalit datë 30.12.2016.
Pra në mbyllje të vitit të ushtrimit totali i aktivit paraqitet me vlerën 34, 874,356 lekë i barabartë me totalin e pasivit për 34,874,356 lekë, ku pasqyra e shpenzimeve ka të pasqyruara shpenzimet sipas zërave analitik si shpenzime personeli, shpenzime për sigurimet shoqërore, shpenzime operative e tjera. Shpenzimet e personelit dhe të sigurimeve shoqërore kuadrojnë me pasqyrën nr. 9 të bilancit "*Numri punonjësve dhe fondi i pagave".*
Ditarët e kontabilitetit për vitin 2016 janë mbajtur dhe azhurnuar në përputhje me Planin Unik Kontabël për institucionet buxhetore.
Llogaritë e debi-kredive janë të analizuara dhe të kuadruara me analizat përkatëse. Tepricat e llogarive të pasqyruara në bilancin e vitit 2015, janë mbartur si çelje për llogaritë e vitit 2016, u bë krahasimi i çeljes së tyre dhe doli se janë përshkruar të njëjta, pa gabime.
Mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e bilancit për vitin 2016, përputhet me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin", me VKM nr. 248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël" dhe udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 26, datë 27.12.2007 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore , organet e pushtetit vendorë dhe njësite që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj" etj.

Auditimi i administrimit të aktiveve:
Auditimi mbi regjistrimin e ndërtesave në hipotekë, administrimi i tyre, dhe marrja në evidencë kontabile e ndërtimeve apo rikonstruksioneve. Mbajtja e regjistrit të aktiveve. Inventarizimi i pasurisë dhe nxjerrjet nga përdorimi.
U auditua mbajtja e të dhënave lidhur me aktivet dhe u konstatua se nga ana e Sektorit të financës ishte hapur regjistri i aktiveve për asetet por për objektet ndërtimore nuk jepen të gjitha të dhënat e kërkuara sipas Kapitullit III, pikës 30, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011. Sipas pikës 26 të këtij udhëzimi thuhet:*"Çdo njësi publike duhet te krijojë dhe të përditesojë një regjistër kontabel të të gjitha aktiveve që zoteron apo ka në administrim, përfshirë dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura.* Rregjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar. Është përgjegjësi e nëpunësit autorizuesë sipas periudhave përkatëse për ndarjen e detyrave në mbajtjen e regjistrit të aktiveve. Sipas pikës 27 të udhëzimit thuhet: "*Nëpunësi Autorizues i njësisë, brenda strukturës së institucionit, cakton nëpunësin për krijimin dhe mbajtjen e rregjistrit"*, duke ngarkuar me përgjegjësi nëpunësit autorizues dhe zbatues të këtij Institucioni sipas periudhave.
Nga auditimi i regjistrimit të ndërtesave në ZVRPP Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Peqin rezultoi se, sipas VKM nr. 1691 datë 10.10.2007 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të

paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për Prefektët dhe administratën e tyre, Nënprefektët dhe administratën e tyre dhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencës civile (Drejtorisë së PMNZSH)" Institucioni i Prefektit Elbasan ka patur 8 objekte ndërtimore në përgjegjësi administrimi, dhe konkretisht:

1. Zyra e Prefekturës të Qarkut Elbasan ndodhur në lagjen "Brigada e 17 S" Elbasan, janë marrë dokumentet për regjistrimin e kryer në ZVRPP Elbasan dhe konkretisht:

- vërtetim hipotekar nr. 8522-566, datë 28.07.2017, ndërtesë kati përdhe me nr. pasurisë 3/5-Z.2, në ZK 8522, me sipërfaqe 332 m^2, me përgjegjësi administrimi Ministria e Brendshme, Prefektura e Qarkut Elbasan, sipas VKM nr. 1691, datë 10.10.2007;
- vërtetim hipotekar nr. 8522-567, datë 28.07.2017, ndërtesë kati parë me nr. pasurisë 3/5-Z.3, në ZK 8522, me sipërfaqe 678.8 m^2, me përgjegjësi administrimi Ministria e Brendshme, Prefektura e Qarkut Elbasan, sipas VKM nr. 1691, datë 10.10.2007;
- vërtetim hipotekar nr. 8522-568, datë 28.07.2017, ndërtesë kati dytë me nr. pasurisë 3/5-Z.4, në ZK 8522, me sipërfaqe 432.5 m^2, me përgjegjësi administrimi Ministria e Brendshme, Prefektura e Qarkut Elbasan, sipas VKM nr. 1691, datë 10.10.2007;
- Ndërsa objekti dhe trualli që janë për policinë e PMNZSH-së që ndodhen në lagjen "Shkumbini" Elbasan kanë kaluar në favor të bashkisë Elbasan sipas procesverbalit datë 25.05.2016, në bazë të VKM nr. 366 datë 18.05.2016.

2. Zyra e Nënprefekturës Librazhd, me përgjegjësi administrative (ndërtesa 3 katëshe), nuk ka dokument hipotekar, pasi është në proces procedura e marrjes së certifikatës së pronësisë, sipas aplikimit nr. 2943-2945, datë 13.9.2017, të ZVRPP Librazhd, për regjistrim objektesh.

Për zyrën e Nënprefekturës Librazhd nuk janë evidentuar garazhet dhe nuk ka asnjë procedura për marrjen e certifikatës së pronësisë, për truall dhe garazhe lagja nr. 1, Librazhd me sipërfaqe 216 m^2, 3 ambiente të dhëna me qira, zyra ndodhet në katin e parë të ndërtesës së ish-Këshillit të rrethit me sipërfaqe të përgjithshme 549 m^2, zyra e rekrutimit, që ndodhet në katin e III-të të ndërtesës së ish-Këshillit të Rrethit pasuria është e gjitha ndërtesë.

- Ndërsa objekti dhe trualli që janë për repartin e PMNZSH-së që ndodhen në Librazhd kanë kaluar në favor të bashkisë Librazhd sipas procesverbalit datë 25.05.2016, në bazë të VKM nr. 366 datë 18.05.2016.

3. Zyra e Nënprefekturës Gramsh, me përgjegjësi administrative Nënprefektura Gramsh, nuk ka dokument hipotekar pasi ishte në proces procedura e marrjes së certifikatës së pronësisë, sipas aplikimit nr. 1294, datë 19.09.2017, për regjistrim objektesh në ZVRPP Gramsh.

Për zyrën e Nënprefekturës Gramsh akoma nuk ishte kryer marria e certifikatës së pronësisë dhe pse është aplikuar për godinën me një sipërfaqe prej 487.8 m^2, duke mos kërkuar regjistrimin për 15 objekte me sipërfaqe 281 m^2, të cilat janë në përgjegjësi administrimi nga Prefektura Elbasan (nënprefektura Gramsh) por që në fakt administrohen nga Institucione te tjera, pra nuk është bërë shkresë Ministrisë së Brendshme për heqje nga lista e inventarit të objekteve që janë në administrim të Prefekturës dhe që janë regjistruara në emër të Institucioneve të tjera sipas pasqyrës në vijim, që kalon në rubrikën "Anekse", të Raportit Përfundimtar.

- Ndërsa objekti dhe trualli që janë për policinë e PMNZSH-së që ndodhen në lagjen "Xhile Liçi" Gramsh kanë kaluar në favor të bashkisë Gramsh sipas procesverbalit datë 24.05.2016, në bazë të VKM nr. 366 datë 18.05.2016.

4. Zyra e Nënprefekturës Peqin, me përgjegjësi administrative Nënprefektura Peqin, nuk ka dokument hipotekar si dhe nuk janë bërë asnjë procedura për marrjes së certifikatës së pronësisë, për truall 452.5 m^2 dhe ndërtesë 372.5 m^2, zyrat dhe ambiente ndihmëse të nënprefektura Peqin, përfituar sipas VKM nr. 1691 datë 10.10.2007.

Për pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të PMNZSH-së ka dalë VKM nr. 366 datë 18.05.2016 "*Për transferimin në pronësi të bashkive të pronave të paluajtshme dhe të luajtshme shtetërore të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit dhe për disa ndryshime në vendimin nr. 1691, datë 10.10.2007, të Këshillit të Ministrave, "për miratimin e listës së inventarit të pronave të*

paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi ministrisë së brendshme, për prefektët në qarqe dhe nënprefektët, administratën e tyre, për drejtorinë e përgjithshme të emergjencave civile, (drejtorinë e PMNZSH-së)", sipas të cilit objektet ndërtimore të PMNZSH-së i transferohen bashkive respektive dhe konkretisht:

- Nga auditimi doli se për bashkinë Elbasan sipas vendimit të sipërcituar janë bërë dorëzimet me procesverbal datë 25.05.2016, në bazë të Urdhrit të Prefektit të Qarkut nr. 31, datë 24.05.2016 "Për ngritjen e komisionit për transferimin në pronësi të bashkive të pronave të paluajtshme dhe të luajtshme shtetërore të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit dhe për disa ndryshime në VKM nr. 1691, datë 10.10.2007, të ndryshuar, ndërsa nga ana e bashkisë Elbasan bashkangjitur praktikës ndodhet Urdhri nr. 1234, datë 30.12.2016 "Për ngritje komisioni për marrje në dorëzim të dokumentacionit teknik dhe inventarit fizik përkatës, për pronat e transferuara sipas shkronjave a, b të pikës 1 të VKM nr. 366, datë 18.05.2016, pra rreth 6 muaj më vonë, ndërkohë që nga ana e bashkisë me shkresë nr. 1864/1, datë 25.05.2016 është bërë konfirmimi i marrjes në dorëzim të inventarit fizik të pronave në administrim të SHMZSH-së.

Sipas procesverbalit të mbajtur nga ana e komisioneve të prefekturës (dorëzues) dhe bashkisë (marrës në dorëzim), pasqyrohet dorëzimi i llogarive inventariale si më poshtë:

1) Llogaria 212, fletë 3 copë vetëm në vlerë pa u shënuar sipërfaqet si të truallit apo ndërtesës sipas VKM nr. 1691, datë 10.10.2007, por vetëm në vlerë, veprim në kundërshtim me kërkesat e këtij akti, që përmbajnë regjistrin e aktiveve të llogarisë 212 dhe amortizimin përkatës.
2) Llogaria 214 (Pajisje elektrike + pajisje pune), që përbëhet nga 16 fletë;
3) Llogaria 215 (automjetet), që përbëhet nga 8 fletë, inventarin e tyre dhe amortizimin përkatës;
4) Llogaria 218 (pajisje zyrash), që përbëhet nga 12 fletë, inventarin e tyre dhe amortizimin përkatës;
5) Llogaria 327 (inventar i imët), që përbëhet nga 5 fletë, inventarin e tyre dhe amortizimin përkatës;
6) Llogaria 468 (akte ekspertize nga prokuroria e rrethit gjyqësor) për vitet 2010 deri 2015 në vlerë 4,850,000 lekë për 164 akte të pa arkëtuara.

- Për bashkinë Librazhd doli se janë bërë dorëzimet sipas procesverbalit datë 25.05.2016, në bazë të Urdhrit të Prefektit të Qarkut nr. 31, datë 24.05.2016 "Për ngritjen e komisionit për transferimin në pronësi të bashkive të pronave të paluajtshme dhe të luajtshme shtetërore të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit dhe për disa ndryshime në VKM nr. 1691, datë 10.10.2007, të ndryshuar, ndërsa nga ana e bashkisë Librazhd bashkangjitur praktikës ndodhet Urdhri nr. 319, datë 25.05.2016 "Për ngritje komisioni për marrje në dorëzim të dokumentacionit teknik dhe inventarit fizik përkatës, për pronat e transferuara sipas shkronjave a, b të pikës 1 të VKM nr. 366, datë 18.05.2016.

Sipas procesverbalit të mbajtur nga ana e komisioneve të prefekturës (dorëzues) dhe bashkisë (marrës në dorëzim), pasqyrohet dorëzimi i llogarive inventariale si më poshtë:

1) Llogaria 212, fletë 3 copë vetëm në vlerë pa u shënuar sipërfaqet si të truallit apo ndërtesës sipas VKM nr. 1691, datë 10.10.2007, veprim në kundërshtim me kërkesat e këtij akti, që përmbajnë regjistrin e aktiveve të llogarisë 212 dhe amortizimin përkatës.
2) Llogaria 214 (Pajisje elektrike + pajisje pune), që përbëhet nga 7 fletë;
3) Llogaria 215 (automjetet), që përbëhet nga 5 fletë, inventarin e tyre dhe amortizimin përkatës;
4) Llogaria 218 (pajisje zyrash), që përbëhet nga 3 fletë, inventarin e tyre dhe amortizimin përkatës;
5) Llogaria 327 (inventar i imët), që përbëhet nga 2 fletë, inventarin e tyre dhe amortizimin përkatës;
6) Llogaria 468 (akte ekspertize nga prokuroria e rrethit gjyqësor) për vitet 2010 deri 2015 në vlerë 750,000 lekë për 30 akte të pa arkëtuara.

- Për bashkinë Gramsh doli se janë bërë dorëzimet sipas procesverbalit datë 24.05.2016, në bazë të Urdhrit të Prefektit të Qarkut nr. 31, datë 24.05.2016 "Për ngritjen e komisionit për transferimin në

pronësi të bashkive të pronave të paluajtshme dhe të luajtshme shtetërore të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit dhe për disa ndryshime në VKM nr. 1691, datë 10.10.2007, të ndryshuar, ndërsa nga ana e bashkisë Elbasan bashkangjitur praktikës ndodhet Urdhri nr. 114, datë 30.12.2015 "Për ngritje komisioni për marrje në dorëzim të dokumentacionit teknik dhe inventarit fizik përkatës, për pronat e transferuara sipas shkronjave a, b të pikës 1 të VKM nr. 366, datë 18.05.2016, pra rreth 6 muaj më parë se dalja e vendimit.
Sipas procesverbalit të mbajtur nga ana e komisioneve të prefekturës (dorëzues) dhe bashkisë (marrës në dorëzim), pasqyrohet dorëzimi i llogarive inventariale si më poshtë:
1) Llogaria 212, fletë 3 copë vetëm në vlerë pa u shënuar sipërfaqet si të truallit apo ndërtesës sipas VKM nr. 1691, datë 10.10.2007, veprim në kundërshtim me kërkesat e këtij akti, që përmbajnë regjistrin e aktiveve të llogarisë 212 dhe amortizimin përkatës.
2) Llogaria 214 (Pajisje elektrike + pajisje pune), që përbëhet nga 4 fletë;
3) Llogaria 215 (automjetet), që përbëhet nga 8 fletë, inventarin e tyre dhe amortizimin përkatës;
4) Llogaria 218 (pajisje zyrash), që përbëhet nga 5 fletë, inventarin e tyre dhe amortizimin përkatës;
5) Llogaria 327 (inventar i imët), që përbëhet nga 2 fletë, inventarin e tyre dhe amortizimin përkatës;
6) Llogaria 468 (akte ekspertize nga prokuroria e rrethit gjyqësor) për vitet 2010 deri 2015 në vlerë 825,000 lekë për 33 akte të pa arkëtuara.
- Për bashkinë Peqin doli se janë bërë dorëzimet sipas procesverbalit datë 24.05.2016, në bazë të Urdhrit të Prefektit të Qarkut nr. 31, datë 24.05.2016 "Për ngritjen e komisionit për transferimin në pronësi të bashkive të pronave të paluajtshme dhe të luajtshme shtetërore të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit dhe për disa ndryshime në VKM nr. 1691, datë 10.10.2007, të ndryshuar, ndërsa nga ana e bashkisë Elbasan bashkangjitur praktikës ndodhet Urdhri nr. 110, datë 25.05.2016 "Për ngritje komisioni për marrje në dorëzim të dokumentacionit teknik dhe inventarit fizik përkatës, për pronat e transferuara sipas shkronjave a, b të pikës 1 të VKM nr. 366, datë 18.05.2016.
Sipas procesverbalit të mbajtur nga ana e komisioneve të prefekturës (dorëzues) dhe bashkisë (marrës në dorëzim), pasqyrohet dorëzimi i llogarive inventariale si më poshtë:
1) Llogaria 214 (Pajisje elektrike + pajisje pune), që përbëhet nga 8 fletë;
2) Llogaria 215 (automjetet), që përbëhet nga 3 fletë, inventarin e tyre dhe amortizimin përkatës;
3) Llogaria 218 (pajisje zyrash), që përbëhet nga 4 fletë, inventarin e tyre dhe amortizimin përkatës;
4) Llogaria 327 (inventar i imët), që përbëhet nga 2 fletë, inventarin e tyre dhe amortizimin përkatës;
5) Llogaria 468 (akte ekspertize nga prokuroria e rrethit gjyqësor) për vitet 2010 deri 2015 në vlerë 450,000 lekë për 18 akte të pa arkëtuara.
Sipas procesverbalit del se nuk është dorëzuar pranë bashkisë Peqin trualli prej 300 m^2 dhe ndërtesë prej 110 m^2, truall dhe ndërtesë zyrat e PMNZSH-së Lagja "Teqe" Peqin të përfituara sipas VKM nr. 1691 datë 10.10.2007 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për Prefektët dhe administratën e tyre, Nënprefektët dhe administratën e tyre dhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencës civile (Drejtorisë së PMNZSH)", veprim në kundërshtim me shkronjat a, b të pikës 1 të VKM nr. 366, datë 18.05.2016 dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"pika 34 që shpreh:

"Veprimet ekonomike që kryhen në njësite publike si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi.".

Gjetje: Nga auditimi i regjistrimit të ndërtesave në hipotekë dhe administrimi i tyre rezultoi se për zyrat e Prefektit të Qarkut Elbasan ishin marrë 3 vërtetime pronësie nga ZVRPP Elbasan, janë kryer aplikimet dhe pagesat për regjistrim në ZVRPP Librazhd, Gramsh dhe Peqin, por nuk kanë dalë certifikata e pronësisë. Në lidhje mbi sa më lart ka ndryshime midis të dhënave të VKM nr. 1691, datë 10.10.2007, të ndryshuar dhe të dhënave dokumentare që janë kërkuar për hipotekim.
Për zyrën e Nënprefekturës Librazhd nuk janë evidentuar garazhet dhe nuk ka asnjë procedura për marrjen e certifikatës së pronësisë, për truall dhe garazhe lagja nr. 1, Librazhd me sipërfaqe 216 m^2, 3 ambiente të dhëna me qira, zyra ndodhet në katin e parë të ndërtesës së ish-Këshillit të rrethit me sipërfaqe të përgjithshme 549 m^2, zyra e rekrutimit, që ndodhet në katin e III-të të ndërtesës së ish-Këshillit të Rrethit pasuria është e gjitha ndërtesë.
Për zyrën e Nënprefekturës Gramsh akoma nuk ishte kryer marria e certifikatës së pronësisë dhe pse është aplikuar për godinën me një sipërfaqe prej 487.8 m^2, duke mos kërkuar regjistrimin për 15 objekte me sipërfaqe 281m^2, të cilat janë në përgjegjësi administrimi nga Prefektura Elbasan (nënprefektura Gramsh) por që në fakt administrohen nga Institucione te tjera, pra nuk është bërë shkresë Ministrisë së Brendshme për heqje nga lista e inventarit të objekteve që janë në administrim të Prefekturës dhe që janë regjistruara në emër të Institucioneve të tjera sipas pasqyrës në vijim:

Formulari për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore në përgjegjësi administrimi nga Prefektura Elbasan, nënprefektura Gramsh.

Zona Kad	Pas nr.	Lloji i pronës	Sip m^2		Adresa Bash Gramsh	Funksioni që kryen	Institucioni përgj admi	Institucioni përdorues
			trull	ndër				
1842	6/53	Tru+ nd	580	56	L "Xhile Liçi"	Zyra e nënprefekturës	Prefek Elbasan	Prefekt Elbasan
1842	6/53	Tru+ nd	580	10	L "Xhile Liçi"	Zyra e shoqatës së oficerave	Prefek Elbasan	Bashkia Gramsh
1844	6/53	Tru+ nd	580	32	L "Xhile Liçi"	Zyra e gjendjes civile	Prefek Elbasan	Bashkia Gramsh
1845	6/53	Tru+ nd	580	20	L "Xhile Liçi"	Zyra e ruajtjes së mjedisit	Prefek Elbasan	Ministria e Mjed
1845	6/53	Tru+ nd	580	10	L "Xhile Liçi"	Zyra e statistikës së rrethit	Prefek Elbasan	INSTAT
1845	6/53	Tru+ nd	580	12	L "Xhile Liçi"	Zyra e punëve të bashkisë	Prefek Elbasan	Bashkia Gramsh
1845	6/53	Tru+ nd	580	12	L "Xhile Liçi"	Zyra e shoqatës së invalid	Prefek Elbasan	Shoq Inval Shqip
1845	6/53	Tru+ nd	580	9.5	L "Xhile Liçi"	Zyra e tregëtisë	Prefek Elbasan	Dhom Treg Shqip
1845	6/53	Tru+ nd	580	11	L "Xhile Liçi"	Zyra e shoq të verbërve	Prefek Elbasan	Shoq Verb Shqip
1845	6/53	Tru+ nd	580	25.7	L "Xhile Liçi"	Zyra e buxhetit	Prefek Elbasan	Ministia e Financ
1845	6/53	Tru+ nd	580	25	L "Xhile Liçi"	Zyra e Konf së Sind të Pav	Prefek Elbasan	Konf Sind Pavar
1845	6/53	Tru+ nd	580	12	L "Xhile Liçi"	Zyra e kadastrës së qarkut	Prefek Elbasan	Kësh Qarkut El
1845	6/53	Tru+ nd	580	13	L "Xhile Liçi"	Zyra e inspekt i shërbimeve	Prefek Elbasan	Prefek Elbasan
1845	6/53	Tru+ nd	580	15	L "Xhile Liçi"	Zyra e emergjencave civile	Prefek Elbasan	Prefek Elbasan
1845	6/53	Tru+ nd	580	6	L "Xhile Liçi"	Zyra e PMNZSH	Prefek Elbasan	Prefek Elbasan
1845	6/53	Tru+ nd	580	75	L "Xhile Liçi"	Sallë mbledhjesh	Prefek Elbasan	Prefek Elbasan
1845	6/53	Tru+ nd	580	22.5	L "Xhile Liçi"	Zyra e punëve të bashkisë	Prefek Elbasan	Prefek Elbasan
1845	6/53	Tru+ nd	580	64	L "Xhile Liçi"	Zyra e thesarit	Prefek Elbasan	Prefek Elbasan

1845	6/53	Tru+ nd	580	9.1	L "Xhile Liçi"	Zyra e deputetit të rrethit	Prefek Elbasan	Prefek Elbasan
1845	6/53	Tru+ nd	580	12	L "Xhile Liçi"	Zyra e kadastrës së Qarkut	Prefek Elbasan	Prefek Elbasan
1845	6/53	Tru+ nd	580	12	L "Xhile Liçi"	Magazina e Prefekturës	Prefek Elbasan	Prefek Elbasan
1845	6/53	Tru+ nd	580	28	L "Xhile Liçi"	Zyra Salla e pritjes	Prefek Elbasan	Prefek Elbasan
1845	6/53	Tru+ nd	580	22.5	L "Xhile Liçi"	Zyra e nënprefektit	Prefek Elbasan	Prefek Elbasan
1845	6/53	Tru+ nd	580	15	L "Xhile Liçi"	Zyra paradhoma e nënpref	Prefek Elbasan	Prefek Elbasan
1845	6/53	Tru+ nd	580	9	L "Xhile Liçi"	Zyra e punëve të bashkisë	Prefek Elbasan	Prefek Elbasan
1845	6/53	Tru+ nd	580	8	L "Xhile Liçi"	Zyra e ËC të të nën/pref	Prefek Elbasan	Prefek Elbasan
1845	6/53	Tru+ nd	580	30.2	L "Xhile Liçi"	Zyra e ish-këshill të rrethit	Prefek Elbasan	Prefek Elbasan
				587				

Për të gjitha ndërtesat mungon përgjegjësi material. Mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe pikën 26, kreu III-të Regjistri i aktiveve të njësive të sektorit publik të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", përgjegjësi e nëpunësve autorizues e zbatues sipas periudhave, duke ngarkuar me përgjegjësi nëpunësit autorizues e zbatues sipas viteve, që shpreh:

Lidhur me inventarizimin e aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese dhe nxjerrjet jashtë përdorimit, rezulton se:

Për vitin 2016. Me urdhrin nr. 64, datë 28.12.2016 të Prefektit të Qarkut Elbasan (urdhër administrativ i titullarit të institucionit, për ngritjen e komisionit të vlerësimit të pasurisë të përberë prej 5 persona, znj. E. B., kryetare komisioni, M. A., M. V., S. B. dhe G. T. antarë, nga ana e komisionit të inventarizimit janë zbatuar kërkesat e pikës 81 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, nga ana e komisionit janë fiksuar numrat e fundit të fletë hyrjeve dhe fletë daljeve, aspekte këto të fiksuara në procesverbalin e mbajtur me përgjegjësin material. Gjithashtu komisioni ka konstatuar 8 artikuj për nxjerrje jashtë përdorimit me një vlerë prej 11,308 lekë. Ndërsa për nxjerrejn jashtë përdorimit dhe asgjësimin e tyre është ngritur një komision tjetër me Urdhërin nr. 69, datë 30.12.2016 me kryetare V. G., dhe antarë I. K., V. V., F. Sh., Q. B., H. K. dhe A. D. Vlera e nxjerrjes jashtë përdorimit është mbajtur procesverbal nga ana e komisionit dhe kjo vlerë është pasqyruar në mbylljen e llogarive të bilancit të viti ushtrimor.

Nga titullari i Institucionit për verifikimin e sasisë dhe cilësisë së mallrave është ngritur komisioni me urdhrin e brendshëm nr. 101, datë 21.01.2016 dhe për pritjen e mallrave dhe shërbimeve për blerje me vlera të vogla, për zbatimin e kontratave, me Urdhrin nr. 98, datë 21.01.2016 duke përcaktuar një komision prej 3 antarë, në zbatim me pikën 42 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për manaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" që shpreh:

pika 42."Titullari i njësisë miraton urdhrin per ngritjen e komisionit per marrjen ne dorëzim të aktiveve te furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe te dokumentacionit shoqërues.
pika 43. Komisioni përbëhet nga specialistë te fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi materiale".

Në auditmin e dokumentacionit të lëvizjes së mallrave e materialeve.

Për periudhën janar-shtator 2017 në auditimin e dokumentacionit të lëvizjes së mallrave e materialeve, rezultoi se, mallrat e materialet e hyra e të dala në këtë institucion janë përpiluar

nëpërmjet magazinës së institucionit. Hyrja dhe dalja e vlerave materiale nëpërmjet magazinës është i dokumentuar për çdo rast me flete hyrje-daljen përkatëse, të cilat janë të shoqëruara me dokumentacionin justifikues e autorizues. Çdo hyrje dalje e vlerave materiale është kontabilizuar në ditarin e llogarisë në vlerë dhe në sasi sipas emërtesës dhe çmimit për çdo artikull. Librat e llogarisë materiale janë të mbajtur në sistem kompjuterik dhe në fund të çdo periudhe mujore janë të printuara e nënshkruara nga përdoruesi (specialisti financës dhe magazinieri). Përpilimi i dokumentacionit të lëvizjes së mallrave e materialeve nëpërmjet magazinës është me numër rendor kronologjik (rritës) dhe është i kontabilizuar i plotë.
Më hollësisht për periudhën e parashikuar për auditim, janar 2013 deri 30.09.2017 del se janë analizuar nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme Tiranë, në zbatim të planeve vjetore janë kryer tre auditime, duke u mbuluar me auditim deri më 31.12.2016, pra periudhë e pa audituar është vetëm periudha e 9 mujorit 2017 dhe konkretisht:
* Në vitin 2014, sipas shkresë nr. 151, datë 24.01.2014, "Për auditimin e brendshëm në strukturat e MPB për vitin 2014", është ushtruar auditim në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan, miratuar me shkresën nr. 4011/1, datë 07.05.2014 "Program për auditimin në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan", periudha e përfshirë në auditim është nga data 01.11.2012 deri më 31.04.2014.
* Në vitin 2016, me shkresë nr. 7130/3, datë 15.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në strukturat e MPB për vitin 2016", është ushtruar auditim në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan, miratuar me shkresë nr. 4232/2, datë 11.07.2016 "Program auditimi për auditimin në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan". Periudha e përfshirë për auditim është nga data 01.05.2014 deri më 31.12.2015
* Edhe për vitin 2017, në zbatim të planit të vitit 2017, miratuar nga Ministri i Punëve të brendshme me urdhrin nr. 578, datë 20.10.2016 "Për miratimin e planit vjetor të veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2017", është audituar periudha e përfshirë në auditim nga data 01.01.2016 deri më 31.12.2016, sipas shkresës nr. 4227, datë 23.05.2017.
- Për auditimet e ushtruara në vitin 2014, me shkresë nr. 4011/8, datë 12.09.2014, në vitin 2016, me shkresë nr. 4232/7, datë 19.09.2016 dhe për vitin 2017, me shkresë nr. 4227/5 datë 28.07.2017, në të cilat, në zbatim të pikës d, të nenit 12, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditin e brendshëm në sektorin publik", të Manualit të Auditit të Brendshëm dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 12, datë 05.06.2012 "Për procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditit në sektorin publik", pika 3.3, janë dërguar Raportet Finale të Auditimit dhe ndjekja e rekomandimeve.
Qëllimi i këtyre auditimeve ka qenë shqyrtimi dhe vlerësimi i veprimtarisë së këtij Institucioni, dhënia e rekomandimeve për rreziqet e brendshme dhe përmirësimin e sistemit të drejtimit të institucionit, për pajtueshmërinë e veprimtarisë së këtij subjekti me legjislacionin në fuqi, ndërgjegjësimin për përdorimin e sistemeve të kontrollit, për një përdorim sa më efektiv dhe transparent të fondeve të akorduara si dhe të burimeve në përdorim të këtij institucioni.
Në këto auditime është përdor metoda mbi vlerësimin e riskut duke kryer auditim me bazë sistemi për periudhën nën auditim. Gjatë zhvillimit të auditimit është përdor metodologjia e auditimit hap pas hapi duke arritur në një opinion mbi funksionimin e sistemit të kontrollit dhe kontrollet e munguara. Për realizimin e këtyre auditimeve nga grupi i audituesve te Ministrisë së Brendshme është përdorur teknika e sondazheve me përzgjedhje sipas gjykimit profesional duke ekzaminuar mbi veprimtarinë e këtij institucioni për periudhën nën auditim.
Për çdo raport është bërë përmbledhja ekzekutive në të cilën janë shpjeguar qartë të gjitha pikat e programit të auditimit, detyrat dhe rekomandimet dhe janë zbatuar kërkesat Manualit të Auditit.
Për sa më sipër është mbajtur akt-verifikimi nr. 5, datë 15.11.2017 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, përfaqësuar nga znj. A. Ç. me detyrë përgjegjës e sektorit të financës, me shkresë nr. 1299/26, datë 24.11.2017 kanë bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

-Kontabiliteti mbahet duke aplikuar programin në IT si dhe në atë të shkruar ku çdo ditar si ai i të ardhurave, shpenzimeve, bankës, magazinës, debitorëve dhe i pagave mbahet dhe në atë të shkruar ku çdo fund viti në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar të mbështetur në komponentin e kontrollit "Mjedisi i kontrollit", si dhe të udhëzimit nr. 30, datë 27.02.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar bëhet sekretimi dhe protokollimi i këtyre ditarëve pranë zyrës së arshivë protokollit në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan.
Bashkangjitur po ju dërgojmë materiale të fotokopjuara nga zyra e arshiv protokollit mbi ditarët e mbajtur në atë të shkruar si ai i të ardhurave, shpenzimeve, bankës,magazinës, debitorëve dhe i pagave për periudhën 2014- 9 mujori i vitit 2017.
Qëndrimet e auditusve.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se nga ana e grupit të auditimit merret në konsideratë, duke u bërë reflektimi në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

6. Auditim mbi prokurimin e fondeve publike për mallra, ndërtime dhe shërbime.

- Për periudhën e parashikuar për auditim, janar 2013 deri 30.09.2017 del se nga viti 2013 deri në fund të vitit 2016, në zbatim të planeve vjetore të miratuara janë kryer tre auditime, nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme Tiranë, për rrjedhojë mbetet pa audituar vetëm periudha e 9 mujorit 2017, pasi për periudhën tjetër do krijohej dublime auditimesh bashkëlidhur pasqyrën "**Lista e objekteve te prokuruara për periudhën 5 vjeçare nga data 01.01.2013 deri me datën 31.12.2016" Aneksi nr. 5** dhe konkretisht:
Për periudhën e 9 mujorit të vitit 2017, janë realizuar 14 procedura prokurimi për blerje me vlera të vogla, 568 mijë lekë dhe një procedurë prokurimi "kërkesë për propozim me objekt: "Ruajtja Fizike e objektit Prefektura Elbasan", me vlerë 162,362 lekë dhe 1,198,800 lekë pa tvsh si më poshtë:
** Hartimi i një tabele në lidhje me procedurat e prokurimit publik, objekti i prokuruar, lloji i procedurës, fondi limit, data dhe vlera e kontratës lidhur, shtesat e kontratës, diferenca nga fondi limit, operatori ekonomik fitues dhe cila procedurë prokurimi dhe audituar nga grupi/audituesi i KLSH në vlerë dhe në përqindje. (Të paraqitet në formë tabelore ne Projektraport dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit).*

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Ruajtja Fizike e objektit Prefektura Elbasan" (Negocim pa botim paraprak) periudha janar-shkurt 2017 kontratë shtesë		
1.Urdhër Prokurimi nr. 3048, datë 28.12.2016	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr. 3048, datë 28.12.2016	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 3048, datë 28.12.2016
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Negocim pa botim paraprak"	Z. A. K. me detyrë jurist; Znj. A. Ç. p/Sek Finan; Znj. G. T. specialiste sek Urb	znj.E. B. Sekretare e Përgjithshme; z. I. K. Përgj/sek Kop Vendore; z. A. G. P/sek Juridik
5.Fondi Limit (pa tvsh) 163,362 lekë	**6. Oferta fituese "K.-1" (pa tvsh)** 163,362 lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh)** - lekë
8. Data e hapjes së tenderit 30.12.2016	**9.Burimi Financimit** Buxheti i shtetit.	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tender **1 OE:** b)S'kualifikuar - OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime: AK; **APP** dhe **KPP**-s'ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK s'ka	**13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP s'ka
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 3048/4, datë 30.12.2016; Afati nga 01.01.2017-02.03.2017	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 196,034 lekë	**16.Likuiduar deri datë 10.03.2017 Lekë 196,034** **24**. Urdhër shpenzimi nr. 38 dhe nr. 56, datë 10.03.2017 për 196,034 lekë

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Ruajtja Fizike e objektit Prefektura Elbasan" (Negocim pa botim paraprak) periudha janar-shkurt 2017 kontratë shtesë është zhvilluar, pasi procedura e prokurimit publik del se nuk është hapur fondi buxhetor.
Ruajtja fizike me fond limit 162,362 lekë pa tvsh, për nevoja emergjente në muajt janar – shkurt, është filluar me zhvillimin e procedurës me Urdhër Prokurimi nr. 3048, datë 28.12.2016, duke përdorur argumentin se procedura normale ka afat deri dy muaj në lidhjen e kontratës shtesë për ruajtjen e objektit, janë zbatuar kërkesat sipas tabelës së plotësuar duke u zbatuar procedurat përkatëse dhe është lidhur kontrata shtesë nr. 3048/4, datë 30.12.2016; me afat 01.01.2017-02.03.2017, me vlerë 162.362 lekë pa tvsh dhe 196,034 lekë me tvsh të likuiduara me urdhër shpenzimet nr. 38 dhe 56, datë 10.03.2017

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : "Ruajtja Fizike e objektit Prefektura Elbasan" (Kërkesë për propozim) viti 2017		
1.Urdhër Prokurimi Nr. 16, datë 7.02.2017 **2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Kërkesë për propozim"**	**3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit** Urdhër Nr. 3048, datë 28.12.2016 Z. A. K. me detyrë jurist; Znj. A. Ç. p/Sek Finan; Znj. G. T. specialiste sek Urb	**4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave** Urdhër Nr. 3048, datë 28.12.2016 znj.E. B. Sekretare e Përgjithshme; z. I. K. Përgj/sek Kop Vendore; z. A. G. P/sek Juridik
5.Fondi Limit (pa tvsh) 1,198,800 lekë	**6. Oferta fituese "Kumria-1" (pa tvsh)** 1,194,516 lekë	**7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 4,284** lekë
8. Data e hapjes së tenderit 17.02.2017	**9.Burimi Financimit** Buxheti i shtetit.	**10.Operatoret Ekonomike** **a)**Pjesëmarrës në tender **3 OE: "Kumria-1", "Bahiti-6" dhe "Nazeri".** b)S'kualifikuar 1 OE **"Nazeri".** c) Kualifikuar **"Kumria-1", "Bahiti-G"**
11.Ankimime: AK; **APP** dhe **KPP**-s'ka	**12. Përgjigje Ankesës** nga AK s'ka	**13.Përgjigje** Ankesës nga APP apo AKKP s'ka
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 222/16, datë 06.03.2017; Afati nga 06.03.2017-31.12.2017	**15.Vlera e kontratës (me tvsh)** 1,420,556 lekë	**16.Likuiduar deri datë 30.09.2017 lekë 846,562, pa likujduar 573,944 lekë** **24**. Urdhër shpenzimi nr. 94 , datë 24.04.2017, nr. 118, datë 02.06.2017, nr. 135, datë 16.06.2017, nr. 155, datë 14.07.2017, nr. 180, datë 14.08.2017 dhe nr. 206, datë 11.09.2017, për 846,562 lekë

Me Urdhër nr. **16, datë 7.02.2017** është urdhëruar fillimi i procedurës së prokurimit publik me objekt "Shërbimi i rojeve dhe sigurisë fizike" me fond limit **1,198,800** lekë pa tvsh vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit. Procedura e përcaktuar për prokurimin publik është përcaktuar "kërkesë për propozim". NJP ka hartuar, dokumentuar, argumentimin e vendosjes së kritereve specifike për kualifikim, në zbatim me pikën 2, në nenin 57 të VKM nr. 914, 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". NJP ka përllogaritur dhe arsyetuar fondin limit për procedurën e prokurimit që kanë çelur, parashikimet e përcaktuara në nenin 59 të VKM nr. 914, 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" sipas të cilit në llogaritjen e fondit limit të kontratës AK duhet të ketë parasysh çmimet e botuara nga INSTAT, çmimet e tregut, kontratat e mëparshme, dhe çmimet ndërkombëtare. Në urdhër përveç Njësisë së Prokurimit i përbërë nga A. K., G. T. dhe E. B. janë përcaktuar edhe anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, i përbërë nga E. B.a Kryetare, A. G. dhe I. K., veprim ky në kundërshtim me pikën përcaktuar në nenin 57, 60 të VKM nr. 914, 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" pasi janë përcaktuar dhe anëtarët e KVO-së në urdhrin e prokurimit. NjP ka dërguar në APP me datë 07.02.2017 formularin e njoftimit të kontratës për të botuar në sistemin e prokurimit publik me datë 08.02.2017. NjP hartoi dhe miraton paketën e dokumentacionit në përputhje me modelet e dokumentacionit standarte dhe me datë 08.02.2017 në mënyrë elektronike janë ftuar 5

OE (M., K. 1, S., D.-E-S. dhe Sh.. Me datë 17.02.2017 nga KVO është mbajtur procesverbali i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, ku KVO fillon nga puna, me mbylljen e fazës së dorëzimit të dokumentacionit anëtarët e KVO futën në sistem për të vazhduar më tej me verifikimet dhe vlerësimet përkatëse të ofertuesve pjesëmarrës 3 OE dhe konkretisht: 1. OE "K. 1" Elbasan, 2. OE "B.-G" Elbasan, dhe 3. OE "N.-2000". Më pas KVO vendos fillimin e procedurave për hapjen dhe vlerësimin e ofertave.
Me datë 23.02.2017 nga KVO është mbajtur procesverbali i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, ku ka rezultuar se kanë paraqitur ofertë 3 OE, me dokumentacionin ligjor të fiksuar ne tabelën përkatëse dhe konkretisht: 1. OE "K. 1" Elbasan me ofertë ekonomike 1,194,516.38 lekë pa tvsh, 2. OE "B.-G" Elbasan, me ofertë ekonomike 1,194,516.38 lekë pa tvsh dhe 3. OE "N.-2000" mbas verifikimit dhe shyrtimit të dokumentacionit ligjore, teknik dhe ekonomik konstatohet se nuk është i plotë dhe si e tillë s'kualifikohet për mos përmbushje të kritereve. Mbi 3 ofertat e paraqitura KVO ka vlerësuar: S'kualifikimin e 1. OE "N.-2000" me arsyetimin se dokumentacioni nuk është i plotë.
Kualifikimin: - OE "K. 1" me ofertë ekonomike 1,194,516.38 lekë pa tvsh dhe OE "B.-G" me ofertë ekonomike 1,194,516.38 lekë pa tvsh. Më datë 28.02.2016 është hartuar Raporti përmbledhës dhe i vlerësimit të ofertave referuar procesverbaleve datë 17 dhe 23 shkurt 2017. Përsa më sipër ka 2 OE me të njëjtën ofertë me vlerë ekonomike të njëjtë, në respekt të VKM nr. 914, datë 19.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 66, pika 8, autoriteti kontraktor në pamundësi për të shpallur fituesin , njoftoi nëpërmjet mesazheve elektronike në datë 27.02.2017 të dy operatorët ekonomikë të paraqesin me datë 28.02.2017 ora 11.00 për hedhjen e shortit. Të dy OE paraqiten dy fletë shënimesh me ngjyrë të verdhë në formë dhe madhësi të njëjtë ku njëra kishte shënuar "fitues" dhe tjetra ishte bosh. Këto dy letra u hodhën në kuti dhe u vunë në dispozicion OE të tërhiqnin në mënyrë të lirë. Përsa më sipër OE me vullnet të lirë vendosën të tërhiqet subjekti "B.-G" dhe fitues shpallet "K. 1" Elbasan të cilët kanë nënshkruar dhe në procesverbal.
Në lidhje mbi sa më lart nuk ka ankimime në AKP dhe KKP si e tillë me shkresë nr. 3/4 i është propozuar Titullarit të AK lidhja e kontratës me OE "K. 1" me ofertë ekonomike 1,624,000 lekë pa tvsh. Me Vendim nr. 3/5, datë 19.02.2016 është bërë miratimi i procedurës dhe shpall fitues OE "K.1" nga Titullari i AK. Më datë 19.02.2016 është bërë njoftimi i fituesit në APP dhe më datë 01.03.2016 është nënshkruar kontrata midis Titullarit të AK dhe OE të shpallur fitues. Nga auditimi rezulton se procedurave e vlerësimit është në pajtueshmëri me kërkesat e ligjit dhe konstatohen të meta, të sipërpërmendura, nga NJP në procedurën e prokurimit në tërësi.

Pika 6.2 Përcaktimi i nivelit të shpenzimeve të prokuruara në referencë të totalit të shpenzimeve si dhe vlerësimi i zonave me risk për auditim.
Në lidhje me këtë pikë me urdhrin nr. 7, datë 30.01.2017 është ngritur komisioni për këtë qëllim i përbërë V. G. kryetare, A. D. dhe G. T. anëtare, nga verifikimi del se janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit të APP nr. 3, datë 27.01.2015 "Për procedurat e prokurimeve me vlera të vogla".

Pika 6.3 Dhënia e opinionit për rregullshmërinë e realizimit të proçesit të prokurimit në sigurimin e mallrave dhe shërbimeve.
Për verifikimin e sasisë dhe cilësisë së mallrave është ngritur komisioni me urdhrin nr. 10, datë 31.01.2017 i përbërë V. L. kryetare, B. A. dhe Xh. H. antarë dhe për pritjen e mallrave dhe shërbimeve për blerje me vlera të vogla, për zbatimin e kontratave, është ngritur komisioni me Urdhrin nr. 9 , datë 30.01.2017 i përbërë J. Sh. kryetar, A. D. dhe A. K. antarë.

Pika 6.4 Parashikimi i fondit limit për çdo objekt të prokuruar, bazuar në çmimet e publikuara sipas VKM, përvojën e mëparshme ose testimin e tregut. Zbatimi procedurave të prokurimit, nga nxjerrja e urdhrit prokurimit deri shpalljen fituesit.

Pas miratimit të kërkesës për blerjen e mallrave e materjaleve, apo shërbimeve me vlera të vogla nën 400 mijë lekë, ku është përcaktuar sasia dhe natyra e mallit sipas regjistrave të parashikimit në fillim të vitit 2017, procedurat janë zbatuar sipas formatit "tip" në zbatim të Udhëzimit nr. 2, datë 27.01.2016 "Për hartimin e regjistrit të parashikimit të prokurimit publik dhe regjistri i realizimit të prokurimit publik", "**Lista e objekteve te prokuruara për periudhën 9 mujore nga data 01.01.2017 deri me datën 30.09.2017", Aneksi nr. 5,** ku në vijim po i trajtojmë rast pas rasti.

*** Urdhër Prokurimi** nr. 1, datë 18.01.2017, me objekt "shpenzime për mirëmbajtjen e rrjeteve elektrike", data e zhvillimit të tenderit 18.01.2017, për procedurë prokurimi blerje me vlerë te vogël, janë paraqitur 3 operatorë ofertues.

1. L. C., me vlerë 11,083 lekë (pa tvsh)
2. V. R., me vlerë 12,166 lekë (pa tvsh)
3. E. A., me vlerë 11,875 lekë (pa tvsh), nga këto pjesëmarrës shpallet fitues subjekti **"**E. A.", me vlerë 11,875 lekë (pa tvsh), i cili i ka bërë dalje sipas me flete dalje nr.3, datë 18.01.17, për 6,845 lekë, nr.4, datë 18.01.17, për 3,935 lekë, nr.5, datë 18.01.17, për vlerën 3,470 lekë.

Ndërsa nga ana e Institucionit të Prefekturës janë bërë hyrje me nr. 1, datë 18.01.17, për vlerën 14,250 lekë, likujduar kjo me urdhër shpenzimi nr. 40, datë 20.02.2017, për 14,250 lekë.

*** Urdhër Prokurimi** nr.2, datë 20.02.2017, me objekt "Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve te zyre", me datë zhvillimi të tenderit 20.02.2017, për procedurë prokurimi blerje me vlera të vogël. Në këtë konkurrim u paraqitën 4 ofertues:

1. ABCOM me vlerë 120,000 lekë (pa tvsh)
2. 4ALB me vlerë 99,000 lekë (pa tvsh)
3. ASC me vlerë 125,000 lekë (pa tvsh)
4. Selcom me vlerë 110,000 lekë (pa tvsh)

Për këtë konkurrim u shpall fitues "4ALB", me 99,000 lekë (pa tvsh), vlera më e ulët.

Vlera e fituar është likuiduar me Urdhër shpenzimet nr. 66, datë 21.03.2017, në shumën 709 lekë, nr. 90, datë 19.04.2017, në shumën 11,809 lekë, nr. 117, datë 02.06.2017, në shumën 11,809 lekë, nr. 134, datë 16.06.2017, në shumën 11,809 lekë, nr. 154, datë 14.07.2017, në shumën11,809 lekë, nr. 186, datë 14.08.2017, në shumën 11,809 lekë dhe nr. 207, datë 11.09.2017, për 11,809 lekë.

*** Urdhër Prokurimi** nr. 3, datë 23.02.2017, për objekt procedure "Shërbim interneti", datë ë zhvillimit të tenderit 23.02.2017, për llojin e procedurës, për procedurën e prokurimit blerje me vlerë të vogël, me datë zhvillimit të tenderit 23.02.2017, në llojin e procedurës prokurimit blerje me vlerë të vogël, me 3 operator ofertues:

1. Selcom me vlerë 3,000 lekë (Pa TVSH)
2. ICS me vlerë 2,500 lekë (Pa TVSH)
3. BNT electroniks me vlerë 3,500 lekë (pa tvsh) dhe subjekti fitues "ICS" me vlerë 2,500 lekë.

Likuiduar me urdhër Shpenzimi nr. 57, datë 10.03.2017, në shumën 2,500 lekë.

*** Urdhër Prokurimi** nr. 4, datë 03.03.2017, me objekt të procedurës Taksa Vendore, me datë e zhvillimit të tenderit 03.03.2017, ne llojin e procedurës Blerje me vlere te vogël me

Operator ofertues: 1. Bashkia Elbasan, me vlerë 40,220 lekë (pa tvsh)

Likuiduar me Urdhër Shpenzimi nr. 55, datë 06.03.2017, në shumën 40,220 lekë.

*** Urdhër Prokurimi** nr. 5, datë 07.03.2017, me objekt të procedurës Taksa Vendore, me datë e zhvillimit të tenderit 03.03.2017, ne llojin e procedurës Blerje me vlere te vogël me

Operator ofertues: 1. Bashkia Peqin, me vlerë 70,000 lekë (pa tvsh)

Likuiduar me Urdhër Shpenzimi nr. 67, datë 21.03.2017, në shumën 70,000 lekë.

*** Urdhër Prokurimi** nr. 6, datë 30.03.2017, me objekt të procedurës "Pjese këmbimi", me datë e zhvillimit tenderit 30.03.2017 dhe lloji i procedurës prokurimit Blerje me vlere të vogël

Paraqiten 3 operator ofertues:

1. G. M. me vlerë 64,000 lekë(pa tvsh)
2. Rr. C. me vlerë 67,000 lekë (pa tvsh)

3. N. T. me vlerë 66,000 lekë (Pa TVSH), me Subjekt Fitues "G. M.", me vlerë 64,000 lekë (pa tvsh) të bëra dalje me Fletë daljen nr. 40, datë 31.03.2017, me vlerë 64,000 lekë dhe të bëra hyrje me fletë hyrjen nr. 3, datë 31.03.2017,me vlerë 64,000 lekë.
Likuiduar me urdhër shpenzimi nr. 78, datë 05.04.2017, në shumën 64,000 lekë
*** Urdhër Prokurimi** nr. 7, datë 04.04.2017, me objekt të procedurës "Shpenzime te tj transporti/Takse Qarkullimi", data e zhvillimit tenderit 04.04.2017, në llojin e procedurës prokurimit Blerje me vlere te vogël, merr pjesë 1 operator ofertues:
1. DRSHTRR me vlerë 25,871 lekë (pa tvsh) dhe shpallet fitues DRSHTRR me vlerë 25,871 lekë.
Likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 79, datë 05.04.2017, në shumën 25,871 lekë.
*** Urdhër Prokurimi** nr. 8, datë 01.06.2017, me objekt të procedurës "shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyrës", me datë e zhvillimit tenderit 01.06.2017, në llojin e procedurës prokurimit, Blerje me vlerë të vogël, marrin pjesë 3 operatorë ofertues.
1. S. CO me vlerë 24,583 lekë (Pa TVSH)
2. IT P. me vlerë 26,796 lekë (Pa TVSH)
3. T. B. C. me vlerë 26,058 lekë (pa tvsh)
Subjekti Fitues: S. CO, me vlerë 24,583 lekë (pa tvsh)
Nga subjekti është fletë dalje nr. 75, datë 01.06.17, me vlerë 24,500 lekë, ndërsa nga Institucioni është bërë hyrje me fletë hyrjen nr. 4, datë 01.06.17 me vlerë 24,500 lekë, likuiduar me Urdhër Shpenzimi nr. 141, datë 29.06.2017, në shumën 29,500 lekë
*** Urdhër Prokurimi** nr. 9, datë 18.07.2017, me objekt të procedurës "Shërbime të tjera" me datë zhvillimit tenderit 18.07.2017 dhe llojin e procedurës prokurimit, Blerje me vlerë të vogël
Operatorët ofertues pjesëmarrës:
1. BNT elektronike, me vlerë 120,200 lekë (Pa TVSH)
2. ICS, me vlerë 100,000 lekë (Pa TVSH)
3. S., me vlerë 129,300 lekë (Pa TVSH)
Subjekti Fitues shpallet "ICS", me vlerë 100,000 lekë (Pa TVSH)
Likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 185, datë 14.08.2017, në shumën 120,000 lekë
*** Urdhër Prokurimi** nr. 10, datë 18.07.2017, me objekt të procedurës "Materiale special (Pulla)", me datë zhvillimi të tenderit 18.07.2017 dhe llojin e procedurës prokurimit, Blerje me vlere te vogël, marrin pjesë 1 operator.
1. Filiali i Postës Shqiptare Elbasan, me vlerë 3,200 lekë (pa tvsh) dhe shpallet ofertues, Subjekti Filiali i Postës Shqiptare Elbasan me vlerë 3,200 (pa tvsh) të cilat janë bërë hyrje me fletë hyrjen nr. 7, datë 18.07.2017, me vlerë 3,200 lekë
Likuiduar m Urdhër shpenzimi nr. 166, datë 20.07.2017, në shumën 3,200 lekë.
*** Urdhër Prokurimi** nr. 11, datë 18.07.2017, me objekt të procedurës "Shpenzime për mirëmbajtjen e pajisjeve të zyre", me datë të zhvillimit të tenderit 18.07.2017, në llojin e procedurës prokurimit Blerje me vlerë te vogël, marrin pjesë 3 operator.
1. S. CO, me vlerë 12,333 lekë (Pa TVSH)
2. IT P., me vlerë 13,443 lekë (Pa TVSH)
3. T. B. C., me vlerë 13,073 lekë(Pa TVSH) ku është shpallur fitues Subjekti "S.CO", me vlerë 12,333 lekë (pa TVSH) i cili i ka bërë dalje me fletë daljen nr. 90, datë 01.06.17, me vlerë 11,300 lekë, ndërsa Institucioni i Prefektit i ka bëra hyrje me fletë hyrjen nr. 6, datë 18.07.17, me vlerë 11,300 lekë
Likuiduar me urdhër shpenzimi nr. 167, datë 20.07.2017, në shumën 14,800 lekë
*** Urdhër Prokurimi** nr. 12, datë 27.07.2017, me objekt të procedurës "Siguracion automjeti", me datë të zhvillimit të tenderit 27.07.2017, në llojin e procedurës prokurimit Blerje me vlere te vogël, marrin pjesë 3 operator:
1. S. i., me vlerë 48,624 lekë (Pa TVSH)
2. S. U.G. A., me vlerë 48,480 lekë (Pa TVSH)
3. E., me vlerë 48,576 lekë (Pa TVSH)

Subjekti Fitues: "S. U.G. A.", me vlerë 48,480 lekë (Pa TVSH)
Likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 181, datë 14.08.2017, në shumën 48 480 lekë.
*** Urdhër Prokurimi** nr. 13, datë 03.08.2017, me objekt të procedurës "materiale zyre te përgjithshme", me datë të zhvillimit të tenderit 03.08.2017, në llojin e procedurës prokurimit, Blerje me vlerë te vogël, marrin pjesë 3 operator.
1. V. S., me vlerë 31,750 lekë (Pa TVSH)
2. M. P., me vlerë 32,350 lekë (Pa TVSH)
3. H. Gj., me vlerë 32,795 lekë (Pa TVSH). Nga këto shpallet fitues subjekti "V. S." me vlerë 31,750 lekë (Pa TVSH), nga i cili janë bërë dalje me, - fletë daljet nr. 95, datë 03.08.17, me vlerë 6,409.09 lekë, nr. 96, datë 03.08.17, me vlerë 6,409.09 lekë, nr. 97, datë 03.08.17, me vlerë 6,409.09 lekë, nr. 98, datë 03.08.17, me vlerë 6,409.09 lekë, nr. 99, datë 03.08.17, me vlerë 2,018.18 lekë, nr. 100, datë 03.08.17, me vlerë 2,018.18 lekë dhe nr. 121, datë 31.08.17, me vlerë 6,409.09 lekë;
Sasitë e mësipërme janë bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen nr. 9, datë 03.08.2017, me vlerë 38,100 lekë. Likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 184, datë 14.08.2017, në shumën 38,100 lekë.
*** Urdhër Prokurimi** nr. 14, datë 08.09.2017, me objekt të procedurës "Shpenzime të tij transporti/ Takse Kolaudimi", me datë të zhvillimit tenderit 08.09.2017, në llojin e procedurës prokurimit: Blerje me vlere të vogël, merr pjesë vetëm:
1. SGS A. A., me vlerë 3,908 lekë(Pa TVSH) dhe shpallet fitues me vlerën 3,908 lekë (pa tvsh), likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 209, datë 11.09.2017, në shumën 4,690 lekë.
Për të gjitha rastet e blerjeve me vlera të vogla titullari i Institucionit ka ngritur komisionin e prokurimeve me vlera të vogla, sipas Urdhrit nr. 6, datë 30.01.2017, i përbërë nga A. G. kryetar, A. K. dhe A. Ç. anëtarë, ku ky komision për ftesat për oferta ka kërkuar dokumentacionin si dhe vendosjen e kritereve sipas llojit të mëllit apo shërbimit, për llogaritjen e fondit limit është ngritur komisioni me urdhrin nr. 7, datë 30.01.2017 i përbërë V. G. kryetare, A. D. dhe G. T. anëtare, nga verifikimi del se janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit të APP nr. 3, datë 27.01.2015 "Për procedurat e prokurimeve me vlera të vogla". Anëtarët e komisionit kanë marrë oferta në mënyrë elektronike apo me dokumente dhe kanë përzgjedhur gjithmonë ofertën me çmimin më të ulët. Për blerjet me vlera të vogla janë hapur dosje të veçanta të cilat përmbajnë dokumentacionin e duhur konform kërkesave ligjore.
Për verifikimin e sasisë dhe cilësisë së mallrave është ngritur komisioni me urdhrëin nr. 10, datë 31.01.2017 i përbërë V. L. kryetare, B. A. dhe Xh. H. antarë dhe për pritjen e mallrave dhe shërbimeve për blerje me vlera të vogla, për zbatimin e kontratave, me Urdhrin nr. 9 , datë 30.01.2017 i përbërë J. Sh. kryetar, A. D. dhe A. K. anëtarë, në zbatim me pikën 42 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për manaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" që shpreh:

pika 42. "Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen ne dorëzim te aktiveve te furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe te dokumentacionit shoqërues.

Pika 6.5 Lidhja dhe zbatimi i kontratave, zbatimi i kërkesave ligjore e nënligjore për marrjen në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit.
Në lidhje me këtë pikë të programit nuk del që të ketë investime në ndërtim.

Pika 6.6 Auditim procedurën e marrjes në dorëzim të objekteve dhe pasqyrimi i vlerës së investimit në aktivet e qëndrueshme.
Në lidhje me këtë pikë të programit nuk del që të ketë investime në ndërtim.
Për sa më sipër është mbajtur akt-verifikimi nr. 8, datë 17.11.2017 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, përfaqësuar nga z. A. K. me detyrë jurist në sektorin juridik, me shkresë nr. 1299/21, datë 24.11.2017 kanë bërë komente dhe shpjegime në lidhje me daljen e urdhrit për krijimin e KVO për

këtë procedurë nuk është përcaktuar në urdhrin e prokurimit nr. 16, datë 07.02.2017. Në këtë urdhër janë përcaktuar vetëm anëtarët e Njësisë Prokurimit, ndërsa anëtarët e KVO janë përcaktuar me urdhër të veçantë, në urdhrin nr. 16/1, datë 07.02.2017, gjë e pasqyruar edhe në tabelën përkatëse për këtë prokurim në akt-verifikimin nr. 8 të mbajtur nga ju.
Qëndrimet e auditusve.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se nga ana e grupit të auditimit merret në konsideratë, pasi ky fakt është pasqyruar edhe në tabelën përkatëse për këtë prokurim.

Aditim mbi zbatimin e vendimeve gjyqësore për pagesën e 6 operatorëve ekonomikë për likuidim të vlerës së karburantit.
Nga auditimi rezultoi se për vitet 2014 dhe 2015 nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan është kryer pagesa prej 1,379,235 lekë ndaj 6 operatorëve ekonomikë për likuidim të vlerës së karburantit, bazuar në vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. 2101, datë 16.09.2009 dhe gjykatës së Apelit Durrës nr. 10-2013-1784, datë 20.11.2013 dhe konkretisht sipas tabelës si më poshtë:

Pasqyra e vendimeve gjyqësore për pagesën e 6 operatorëve ekonomikë për likuidim të vlerës së karburantit										
Nr	Emër mbiemër	Vlefta	Urdhër shpenzimi		Vendime gjykate					
					Elbasan		Durrës		Rekurs	
			nr	datë	Nr.	datë	Nr.	datë	Nr	datë
18	"B" SHPK "H" SHPK "S- G" "B" SHPK "R" SHPK	1,252,225	162 165 215 216 220	12.06.2014 12.06.2014 04.07.2014 04.07.2014 08.07.2014	2101	16.09.09	10-2013 -1784	20.11. 13	ska	s'ka
01	"Ç" SHPK	170,710	348	29.10.2015						
	Shuma 2017	**1,379,935**								

Nga auditimi rezultoi që nga 6 operatorë ekonomikë subjektet "B" shpk Elbasan, "B" shpk Peqin, "R" shpk Gramsh dhe "H" shpk, "S G", dhe "Ç" shpk, Librazhd, gjatë fund-vitit 2007 dhe fillim-vitit 2008 kanë furnizuar më karburant (gazoil) PMNZSH-në Qarku Elbasan, në vartësi të Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, me një vlerë prej 1,379,235 lekë, pa kontratë dhe pa kryer procedurat e tenderimit, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar. Kjo sasi karburanti është marrë gjatë një situate emergjente për shkak të përmbytjeve në juridiksionin e kësaj Prefekture dhe nga marrësit (përfaqësuesit të PMNZSH-së) janë lëshuar vërtetime, për sasinë e furnizimit me gazoil nga këto karburante dhe konkretisht për periudhën 01.10.2007 deri 31.03.2008 palët kanë furnizuar stacionet përkatëse, të administruara sipas dosjes së gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, kopje e së cilës u morr gjatë periudhës së auditimit me shkresë të Prefektit nr. 1922, datë 30.10.2017, si më poshtë:
- Shoqëria "B" shpk Elbasan në sasinë prej 3545 litra me një vlerë prej 461,390 lekë;
- Shoqëria "Ç" shpk Librazhd në sasinë prej 1014 litra me një vlerë prej 127,010 lekë;
- Shoqëria "H" shpk Librazhd në sasinë prej 1650 litra me një vlerë prej 226,655 lekë;
- Shoqëria "S G" shpk Krujë në sasinë prej 200 litra me një vlerë prej 26,400 lekë;
- Shoqëria "B" shpk Peqin në sasinë prej 1260 litra me një vlerë prej 138,600 lekë;
- Shoqëria "R" shpk Gramsh në sasinë prej 2650 litra me një vlerë prej 399,180 lekë;

Meqenëse këto vlera nuk janë likujduar në mënyrë vullnetare nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan, këto shoqëri kanë kërkuar likuidimin nëpërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Operatorët ekonomik subjektet "B" shpk Elbasan, "B" shpk Peqin, "R" shpk Gramsh dhe "H" shpk, "S-G", dhe "Ç" shpk, Librazhd.
Kanë paditur Sektorin e PMNZSH-së, pranë Institucionit tëi Prefektit të Qarkut Elbasan, përfaqësuar nga z. A. H., Përgjegjës i Sektorit të PMNZSH, z. T. A., Komandant Stacioni të

PMNZSH-së Elbasan dhe zj.O. Sh., ekonomiste e PMNZSH-së Qarku Elbasan, me objekt: Detyrimin e të paditurit të paguajë shumën 1,379,235 lekë, për karburant të marrë prej tyre pa kontratë apo tender të kryer.
Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan kjo çështje është gjykuar dhe me vendimin nr. 2101, datë 16.09.2009 ka vendosur pranimin e kërkesë padisë dhe detyrimin e palës së paditur Policia e Mbrojtjes, Ndërhyrjes kundër zjarrit dhe shpëtimit (PMNZSH), pranë Prefektit të Qarkut Elbasan që të paguajë vlerën e karburantit gazoil ndaj palëve paditëse.
Ky vendim nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut me shkresë nr. 3567, datë 28.09.2009, është apeluar në Gjykatën e Apelit Durrës e cila ka vendosur sipas vendimit nr. 1783, datë 20.11.2013, lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan me nr. 2101, datë 16.09.2009, në këtë mënyrë:.
- Për Shoqërinë "B" shpk Elbasan vlerën prej 461,390 lekë;
- Për Shoqërinë "Ç" shpk Librazhd vlerën prej 127,010 lekë;
- Për Shoqërinë "H" shpk Librazhd vlerën prej 226,655 lekë;
- Për Shoqërinë "S-G" shpk Krujë vlerën prej 26,400 lekë;
- Për Shoqërinë "B" shpk Peqin vlerën prej 138,600 lekë; dhe
- Për Shoqërinë "R" shpk Gramsh vlerën prej 399,180 lekë;

Bazuar në vendimet e mësipërme del se është likuiduar shuma prej 1,252,225 lekë subjektet "B" shpk Elbasan, "B" shpk Peqin, "R" shpk Gramsh, "H" shpk Librazhd dhe "S-G" Librazhd, me urdhër shpenzim nr. 162, datë 12.06.2014, nr. 165, datë 12.06.2014, nr. 220, datë 08.07.2014, nr. 215, datë 04.07.2014, nr. 216, datë 04.07.2014 dhe në vitin 2015, vlefta prej 170,710 lekë subjektit "Ç" shpk me urdhër shpenzimi nr. 348, datë 29.10.2015, pa u bërë hyrje karburanti, pasi nuk janë kryer procedurat e tenderimit si dhe ky vendim nuk është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
Vlera prej 1,379,235 lekë, e cila përfaqëson sasinë e 10.329 litra karburant gazoil të pa bërë hyrje e dalje do të konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit.
* Nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra për celjen e fondit për blerje karburanti, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, veprim ky me ligjin e sipërcituar.
bërjen hyrje të sasisë së furnizuar, bërjen dalje shpenzimin e karburantit dhe plotësimin e dokumentacionit përsa i përket vlerës së paguar.
Referuar nenit 1 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, ***Objekti dhe qëllimi*** dhe Udhëzimit nr. 2, datë 28.03.2013 "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla", i ndryshuar në të përcaktohet që:

"1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.
2. Qëllimi i këtij ligji është:
a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."

* Nuk janë bërë hyrje e dalje sasia prej 10.329 litra gazoil, ndërsa nga personat e atakuar në këtë akt-konstatimi pasi u thirrën dhe ju bë present këto shkelje, paraqitën pasqyrimin e harxhimit të këtyre sasive, sipas sektorëve të PMNZSH të Qarkut Elbasan dhe konkretisht:
- Për sektorin e PMNZSH-së Elbasan sipas fletëve të udhëtimit janë harxhuar 4320 litra;
- Për sektorin e PMNZSH-së Librazhd sipas fletëve të udhëtimit janë harxhuar 2982 litra;
- Për sektorin e PMNZSH-së Gramsh sipas fletëve të udhëtimit janë harxhuar 3558 litra;
- Për sektorin e PMNZSH-së Peqin sipas fletëve të udhëtimit janë harxhuar 1011 litra;

Në lidhje me mos dokumentimin e hyrje dalje të sasisë së trajtuar më lart konstatohet, veprim në kundërshtim me nenet 13 dhe14 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin i ndryshuar me ligjin nr. 110, datë 15.10.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa", pika 44 e nenit 3 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe pika 37 dhe 38 të dokumentimit e lëvizjes së aktiveve të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar në të cilën përcaktohet që:

Pika 37"Hyrja e aktiveve në magazinë dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre. Fletëhyrjet lëshohen nga magazinieri, pasi të jetë bërë më parë verifikimi fizik i sasisë, i cilësisë dhe i çmimit (Procesi i marrjes ne dorëzim te aktiveve, referuar kushteve te përcaktuara ne kontrate. "

Pika 38"Dalja e aktiveve nga magazina bëhet mbi bazën e urdhërdorëzimit, fletëkërkesës, planit të shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohet me fletëdaljen ose me dokument tjetër të njehsuar me të sipas specifikave te aktiveve. "

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
- Z. R. K. me detyrë, ish-Prefekt në cilësinë e nëpunësit autorizues;
- Z. Sh. D. me detyrë, ish-Prefekt në cilësinë e nëpunësit autorizues;
- Z. A. H. me detyrë, ish-përgjegjësi i PMNZSH-së Qarku Elbasan në cilësinë e nënpunësit zbatues;
- Z. T. A. me detyrë, ish-komandant i stacionit të PMNZSH-së Qarku Elbasan në cilësinë e nëpunësit zbatues;
- Znj. O. Sh. me detyrë, ekonomiste e PMNZSH-së Qarku Elbasan, në cilësinë e nëpunësit zbatues;

Për sa më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr. 3, datë 15.11.2017 dhe për këtë çështje subjekti i audituar, me shkresë nr. 1299/23, datë 24.11.2017, si dhe për Projekt Raportin e Auditimit me shkresë nr. 1299/29, datë 11.12.2017, protokolluar në KLSH me nr. 880/4, datë 12.12.2017, ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

1. z. A. H. ish-shef Sektori Ndërhyrjes për Shuarjen e Zjarreve PMNZSH Elbasan.

Duke u nisur nga pozicioni im drejtues për periudhën 2007-2008, detyra jonë si shërbim zjarrfikës ka qenë ajo e ndërhyrjes në çdo situatë zjarri apo përmbytje, evakuim, shpëtim etj. Për periudhën në fjalë mund të themi se ka qenë një periudhë e cila ka patur mbi 20 dalje në ditë dhe detyrimisht ne kemi vepruar në kohë duke ndërhyrë në zjarre dhe besoj se kemi kryer detyrën tonë funksionale dhe parësore të shërbimit zjarrfikës. Mjetet zjarrfikëse nuk mund të punojnë pa ujë dhe pa naftë. Nafta e tenderuar për vitin 2007 u konsumua që në fillim të muajve të verës dhe si rrjedhojë kemi patur nevojë për shtesë nafte. Kjo naftë e cila ishte jetike për punën tonë dhe situatën në të cilën ne ndodheshim, nuk u mundësua asnjëherë që të blihej nga ana e Institucionit të Prefektit, pasi nuk u zhvillua asnjë lloj procedure prokurimi. Kështu dhe me miratimin dhe urdhrin e drejtuesve duke nisur që nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e PMNZSH-së, Prefektit të Qarkut dhe drejtorit juridik të Institucionit të Prefektit, na u komunikua që ju bëni detyrën tuaj se problem i naftës do të zgjidhet. Në këtë mënyrë ndodhur para këtij fakti 4 stacionet zjarrfikëse

furnizoheshin me karburant në 6 operatorët ekonomikë. Gjej rastin të falënderoj subjektin "Besmiri" sh.p.k. i cili na është përgjigjur orar pa orar dhe siç ndodh shpesh në marrëdhëniet me shtetin ky subjekt është likuiduar për këtë karburant në vitin 2014. Ky ishte shpërblimi që kjo firmë mori mbrapsht duke i marë lekët me vendim gjyqi.
Çdo komandant stacioni ka tërhequr dhe konsumuar naftë pranë pikave të karburantit më të afërta të qytetit të tyre, pasi dhe për stacionet e tjera zjarrfikëse Librazhd, Gramsh, Peqin ka qenë e njëjta situatë emergjente zjarresh, ashtu si në të gjithë republikën. Karburantin që kanë tërhequr komandantët e stacioneve nga operatorët ekonomikë e kanë justifikuar konsumin e tyre nëpërmjet fletë udhëtimeve.
Ju lutem duke lexuar me vëmendje Akt Konstatimet tuaja e shoh veten si person që i paskam sjellë shtetit dëm ekonomik, por a ka qenë në gjendje njeri të vlerësojë dëmin që kanë sjellë personat për të gjitha zjarret e vëna, që ne kemi ndërhyrë për ti fikur dhe çuditem me faktin që ndëshkohet ai që punon.
Fatmirësisht viti 2017 ishte pak a shumë vit i ngjashëm si viti 2007 dhe angazhimet për të vepruar për të fikur këto zjarre të vëna kanë qenë të mëdha. Zjarrvënësit nuk morën parasysh çfarë ishin vreshta apo kullota, ullishte apo pyje apo pika turistike, të cilat mund të themi që ishin pasuri të këtij vendi dhe me plotë gojën mund të them se ishin zjarrfikësit ata që ndërhynë për fikjen e këtyre zjarreve, me ditë të tëra duke luftuar. Angazhimi i shtetit ishte i madhe duke ndërhyrë edhe nga ajri me aeroplan dhe helikopter të marrë me qira nga shtete të tjera, prandaj e kam moralin dhe kurajon të them që për zjarrfikësit ka vetëm shpërblim dhe jo ndëshkim.
2. z. T. A. ish-Komandant i Stacionit Zjarrfikës Elbasan, nga viti 1993 e vazhdim.
Në fund vitin 2007 dhe fillim vitin 2008 kam qenë i punësuar në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan me detyrë Komandant Stacioni dhe magazinier, në stacionin zjarrfikës Elbasan, si detyrë funksionale dhe parësore kam patur:
- Përgatitjen tekniko-profesionale të efektivit zjarrfikës Elbasan,
- Mbajtjen në gatishmëri të mjeteve zjarrfikëse që kishim në stacionin e Elbasanit, pjesë e së cilës ishte jo vetëm gatishmëria dhe gjendja teknike, por dhe furnizimi i mjeteve me karburant. Karburanti për furnizimin e mjeteve bëhej nga Prefektura dhe tenderimi e menaxhimi i tij bëhej nga i njëjti institucion.
Gjatë vitit 2007 jemi furnizuar me karburant në bazë të kontratës së lidhur nga Institucioni i Prefektit, me subjektin "Besmiri" sh.p.k.
Për shkak të emergjencave jo normale në zjarret e shumta, sasia e planifikuar e këtij karburanti u mbarua në fund të stinës së verës. Për muajt e mbetur të vitit 2007 si dhe 3 mujorin e parë 2008 Institucioni i Prefektit nuk kishte më kontratë për furnizim me karburant me subjektin e lartpërmendur. Për vijimin e gatishmërisë, pra për sigurimin e sasisë së nevojshme të karburantit, për t'ju përgjigjur çdo situate që mund të paraqitej i kemi kërkuar institucionit të Prefektit, nga i cili kishim varësi, që të mundësonte vijimin me furnizim me karburant. Por kjo gjë nuk u bë e mundur për shkak të mos zhvillimit të procedurave të tenderimit nga ana e tyre.
Me urdhër të drejtuesve të Institucionit të Prefektit vazhdoja të furnizohesha në të njëjtin subjekt "Besmiri" sh.p.k. i cili kishte kontratë të mëparshme në vazhdimësi me institucionin e Prefektit.
Për 5 muaj rresht kam marrë 3545 litra naftë për automjetet zjarrfikëse, duke i shërbyer të gjithë rrethit Elbasan. Për çdo furnizim kam marrë faturat përkatëse nga subjekti, duke furnizuar mjetet me sasinë e nevojshme të karburantit sipas volumit të punës dhe urdhrave në fuqi, përpilimin e dokumentacionit me fletë udhëtimet përkatëse për çdo mjet. Fletë udhëtimet ndodhen në prefekturë kurse faturat e furnizimit janë dorëzuar në gjykatë.
Pra ju informoj se çdo veprim i kryer nga ana ime është bërë konform rregullave për përmbushjen e detyrës për të cilat isha ngarkuar "Për t'ju përgjigjur çdo situate zjarri, apo çdo fatkeqësie natyrore, si dhe zbatimin e urdhrave të ngarkuar".
Kjo mënyrë funksionimi për mua si Komandant Stacioni ishte më e lehtë, sesa të mbaja përgjegjësi dhe riskun e pasojave që mund të vinin nga mosveprimet në situata të ndryshme si

zjarre, përmbytje dhe fatkeqësi të tjera natyrore, të cilat mund të shkaktonin pasoja dhe në jetë njerëzish. Gjykata mbasi bëri vlerësimin e gjithë arsyetimet e paraqitura nga ana jonë, e pa të arsyeshme dhe vendosi likuidimin e operatorëve ekonomikë nga ana e Institucionit të Prefektit.
3. znj. O. Sh. me detyrë ekonomiste e PMNZSH Qarku Elbasan.
Karburanti i tërhequr nga stacionet zjarrfikëse të Qarkut Elbasan për periudhën 2007-2008 në 6 operatorët ekonomikë erdhi si rrjedhojë e konsumimit të plotë të karburantit të prokuruar për vitin 2007. Ndodhur para këtij fakti Institucioni i Prefektit me njësinë e tij të prokurimit nuk mund të kryente asnjë lloj procedure tenderimi pasi Ministria e linjës nuk dha miratimin për këtë gjë. Kështu njësia e prokurimit nuk zhvilloi asnjë proçedurë në mënyrë që puna në 4 stacionet zjarrfikëse të vijonte për të përballuar të gjitha situatat ekstreme gjatë asaj periudhe emergjencash me zjarre masivë. Theksoj faktin se nuk kam qenë pjesë e njësisë së prokurimit dhe person përgjegjës për procedurat e tenderimit.
Me buxhetin që kishim në dispozicion institucioni nuk mund të kryente asnjë lloj procedure blerjeje pasi nuk kishim fonde disponibël të lira.
Sasia e karburantit e tërhequr dhe e konsumuar nga 4 Komandantët e stacioneve zjarrfikëse, përkatësisht Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Peqin, në 6 operatorët ekonomikë nuk është bërë hyrje në institucion pasi nuk kishte asnjë lloj procedure që të justifikonte hyrjen e aktiveve në magazinë. Kështu nuk kishte 1 komision për marrjen në dorëzim të mallit, verifikimin fizik të tij të sasisë, cilësisë dhe çmimit.
Gjithashtu bërja hyrje e këtij malli, pa patur fonde disponibël dhe paraqitja si detyrim në bilancin e fund vitit, është në shkelje të plotë të Ligjit për Buxhetin, si dhe është i papranueshëm të reflektohet në bilanc nga Dega e Thesarit, (10319 litra në vlerë 1,379,235 lekë).
Pozicioni im në këtë situatë është ai i ekonomistes së Sektorit të PMNZSH-së dhe jo ai i nëpunësit zbatues.
Gjithashtu pjesa ime takuese në vërtetimet e lëshuara për efekt gjyqi, vërteton vetëm faktin që këto sasi karburanti (të marra dhe konsumuara nga komandantët e stacioneve zjarrfikëse) ishin të pa likuiduara nga ana e institucionit.
Qëndrimet e auditusve Shtetëror të KLSH-së.
Në lidhje me komentet e bëra nga personat e lartpërmendur sqarojmë se kundërshtitë e paraqitura prej personave të atakuar të cilët kanë përshkruan në mënyrë të detajuar procedurat e ndjekura në lidhje me pagesat e vendimeve gjyqësore, nga ana e grupit të auditimit nuk merret në konsideratë, pasi siç është trajtuar rezulton:
- së pari: kjo sasi karburanti nuk është bërë hyrje e dalje në magazinë në kundërshtim me pika 37 dhe 38 të dokumentimit e lëvizjes së aktiveve të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar dhe
- së dyti: për këtë furnizim nuk janë kryer procedurat e tenderimit, në papajtueshmëri me nenin 1 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 2, datë 28.03.2013 "Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla", i ndryshuar.

7. Auditim mbi funksionimin e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, marrëdhëniet me Seksionin e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut (SAMT), me Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Elbasan, Librazhd, Gramsh dhe Peqin, si dhe me Njësitë e Qeverisjes Vendore.

Auditim mbi rregullshmërinë e ngritjes, funksionimin dhe eficencën e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Elbasan.
Për periudhën e auditimit 2013 deri 30.09.2017, KVVTP përbëhet prej 5 veta nga të cilët 1 drejtor dhe 4 specialistë me specialitete 2 juristë, 1 topograf dhe 1 agronom, pra përbërja është në zbatim të kërkesave të VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 "Për Përbërjen, Mënyrën e Funksionimit dhe Detyrat e Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë

Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", Kreun III, germa "A", Pika 2 "Përbërja dhe mënyra e funksionimit", ku shprehet se: ".... Ata (anëtarët e komisionit), duhet të jenë juristë agronom apo inxhinier gjeodetë, ose në pamundësi, teknik topografë të licencuar..."
Lidhur me funksionimin për periudhën e auditimit u konstatuan mangësi e shkelje në drejtimet si më poshtë:
Para vitit 2009 deri në vitin 2012 evidentohen gjithsej 1007 kërkesa për të cilat nuk raportohet sa janë trajtuar përfundimisht, sa janë në proces trajtimi dhe cilat janë stadet e trajtimit të tyre.
Për periudhën nën auditim janar 2013 deri korrik 2017 janë shtuar dhe 521 kërkesa të reja dhe gjithsej 1528 kërkesa për të cilat janë marrë 235 vendime ose 15.4 % të tyre, ndërsa për kërkesat e prapambetura, gjendje të trashëguara para vitit 2013, nuk evidentohen si numër dhe nuk janë planifikuar e përfshirë në programet vjetore shqyrtimi i tyre vit pas viti deri në përfundimin e tyre dhe konkretisht.

<u>Për vitin 2013</u>

Programi Vjetor i Kontrollit dhe Verifikimit, të Titujve të Pronësisë, për vitin 2013, i përgatitur nga KVVTP-së Elbasan, është dërguar KQT (Sekretariatit Teknik) me shkresë nr. 49/1, datë 14.02.2013, jashtë afatit ligjor të parashikuar, por nuk është shqyrtuar e i miratuar nga KQT, pasi nuk ka shkresë për këtë qëllim, mosveprim në kundërshtim me Kreun e I, germa "B", pika 1 të VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 "Për Përbërjen, Mënyrën e Funksionimit dhe Detyrat e Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" dhe me nenin 18, pika 1 të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP, miratuar me vendimin nr. 1, datë 27.03.2009, të Komisionit Qeveritar të Tokës, ku shprehet se: *"KV-të dërgojnë programet vjetore të kontrollit dhe verifikimit, pranë Sekretariatit Teknik të KQT-së brenda datës 30 janar, i cili ia paraqet KQT-së në mbledhjen e parë të vitit së bashku me vërejtjet dhe komentet dhe propozimet e tij".*
Për vitin 2013 evidentohen ***149 kërkesa*** të cilat mbahen në një libër protokolli (korespodence), por mungojnë dhe nuk u paraqitën evidentimi dhe raportimi i kërkesave mujore e progresive sipas stadeve të trajtimit, për muajt e vitit 2013. Pra mungon sistemi i evidencave dhe i raportimeve të gjendjes të sëcilës kërkesë sipas stadit dhe gjendjes në fillim të çdo viti, muaji, etj.

Për vitin 2014

Programi Vjetor 2014 i Kontrollit dhe Verifikimit, të Titujve të Pronësisë, i përgatitur nga KVVTP-së Elbasan, është dërguar KQT (Sekretariatit Teknik) me shkresë nr. 3544/1, datë 13.01.2013, brenda afatit të parashikuar, por nuk është shqyrtuar e i miratuar nga KQT, pasi nuk ka shkresë për këtë qëllim, mosveprim në kundërshtim me Kreun e I, germa "B", pika 1 të VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 "Për Përbërjen, Mënyrën e Funksionimit dhe Detyrat e Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" dhe me nenin 18, pika 1 të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP, miratuar me vendimin nr. 1, datë 27.03.2009, të Komisionit Qeveritar të Tokës, ku shprehet se: *"KV-të dërgojnë programet vjetore të kontrollit dhe verifikimit, pranë Sekretariatit Teknik të KQT-së brenda datës 30 janar, i cili ia paraqet KQT-së në mbledhjen e parë të vitit së bashku me vërejtjet dhe komentet dhe propozimet e tij".*
Për vitin 2014 evidentohen ***139 kërkesa*** të cilat mbahen në një libër protokolli (korespodence), por mungojnë dhe nuk u paraqitën evidentimi dhe raportimi i kërkesave mujore e progresive sipas stadeve të trajtimit, për muajt e vitit 2014. Pra mungon sistemi i evidencave dhe i raportimeve të gjendjes të sëcilës kërkesë sipas stadit dhe gjendjes në fillim të çdo viti, muaji, etj.

Për vitin 2015

Programi Vjetor 2015 i Kontrollit dhe Verifikimit, të Titujve të Pronësisë, i përgatitur nga KVVTP-së Elbasan, është dërguar KQT (Sekretariatit Teknik) me shkresë nr. 1074, datë 18.03.2015, jashtë afatit ligjor i përcaktuar, por nuk është shqyrtuar e i miratuar nga KQT, pasi nuk ka shkresë për këtë qëllim, mosveprim në kundërshtim me Kreun e I, germa "B", pika 1 të VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 "Për Përbërjen, Mënyrën e Funksionimit dhe Detyrat e

Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" dhe me nenin 18, pika 1 të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP, miratuar me vendimin nr. 1, datë 27.03.2009, të Komisionit Qeveritar të Tokës, ku shprehet se: *"KV-të dërgojnë programet vjetore të kontrollit dhe verifikimit, pranë Sekretariatit Teknik të KQT-së brenda datës 30 janar, i cili ia paraqet KQT-së në mbledhjen e parë të vitit së bashku me vërejtjet dhe komentet dhe propozimet e tij".*
Për vitin 2013 evidentohen ***122 kërkesa*** të cilat mbahen në një libër protokolli (korespodence), por mungojnë dhe nuk u paraqitën evidentimi dhe raportimi i kërkesave mujore e progresive sipas stadeve të trajtimit, për muajt e vitit 2015. Pra mungon sistemi i evidencave dhe i raportimeve të gjendjes të sëcilës kërkesë sipas stadit dhe gjendjes në fillim të çdo viti, muaji, etj.

Për vitin 2016

Programi Vjetor 2016 i Kontrollit dhe Verifikimit, të Titujve të Pronësisë, i përgatitur nga KVVTP-së Elbasan, është dërguar KQT (Sekretariatit Teknik) me shkresë nr. 9672/2, datë 08.01.2016, brenda afatit të parashikuar, por nuk është shqyrtuar e i miratuar nga KQT, pasi nuk ka shkresë për këtë qëllim, mosveprim në kundërshtim me Kreun e I, germa "B", pika 1 të VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 "Për Përbërjen, Mënyrën e Funksionimit dhe Detyrat e Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" dhe me nenin 18, pika 1 të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP, miratuar me vendimin nr. 1, datë 27.03.2009, të Komisionit Qeveritar të Tokës, ku shprehet se: *"KV-të dërgojnë programet vjetore të kontrollit dhe verifikimit, pranë Sekretariatit Teknik të KQT-së brenda datës 30 janar, i cili ia paraqet KQT-së në mbledhjen e parë të vitit së bashku me vërejtjet dhe komentet dhe propozimet e tij".*
Për vitin 2016 evidentohen ***59 kërkesa*** të cilat mbahen në një libër protokolli (korespodence), por mungojnë dhe nuk u paraqitën evidentimi dhe raportimi i kërkesave mujore e progresive sipas stadeve të trajtimit, për muajt e vitit 2016. Pra mungon sistemi i evidencave dhe i raportimeve të gjendjes të sëcilës kërkesë sipas stadit dhe gjendjes në fillim të çdo viti, muaji, etj.

Edhe për 9 muorin e vitit 2017

Programi Vjetor 2017 i Kontrollit dhe Verifikimit, të Titujve të Pronësisë, i përgatitur nga KVVTP-së Elbasan, është dërguar KQT (Sekretariatit Teknik) me shkresë nr. 288, datë 17.02.2017, jashtë afatit të parashikuar, por nuk është shqyrtuar e i miratuar nga KQT, pasi nuk ka shkresë për këtë qëllim, mosveprim në kundërshtim me Kreun e I, germa "B", pika 1 të VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 "Për Përbërjen, Mënyrën e Funksionimit dhe Detyrat e Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" dhe me nenin 18, pika 1 të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP, miratuar me vendimin nr. 1, datë 27.03.2009, të Komisionit Qeveritar të Tokës, ku shprehet se: *"KV-të dërgojnë programet vjetore të kontrollit dhe verifikimit, pranë Sekretariatit Teknik të KQT-së brenda datës 30 janar, i cili ia paraqet KQT-së në mbledhjen e parë të vitit së bashku me vërejtjet dhe komentet dhe propozimet e tij".*
Për vitin 2017 evidentohen ***52 kërkesa*** të cilat mbahen në një libër protokolli (korespodence), por mungojnë dhe nuk u paraqitën evidentimi dhe raportimi i kërkesave mujore e progresive sipas stadeve të trajtimit, për muajt e vitit 2016. Pra mungon sistemi i evidencave dhe i raportimeve të gjendjes të sëcilës kërkesë sipas stadit dhe gjendjes në fillim të çdo viti, muaji, etj.
Kështu nga auditimi rezulton se deri në vendimin nr. 92, datë 31.12,2012 është ruajtur e ndjekur numri progresiv për vitet 2009-2012, nga nr. 1, datë 17.09.2009, deri nr. 92, datë 31.12,2012 janë marrë 92 vendime + 2 vendime me fraksion me nr. (79/1 dhe nr. 80/1), pasi janë rishqyrtuar pas vendimit tq KQT, **gjithsej 94 vendime.**

Në vitin 2013, fillon nga nr. 93, date 27.02.2013 deri 107, datë 04.12.2013, pra 15 vendime + 1 vendim me nr. fraksion (83/1), gjithsej 16 vendime dhe nuk ka kalim apo mungesë numurash.

Në vitin 2014, nga nr. 108, date 18.02.2014 deri 136, datë 27.11.2014, pra 29 vendime + 1 vendim me nr. fraksion (71/1), gjithsej 16 vendime dhe nuk ka kalim apo mungesë numurash.

Në vitin 2015, nga nr. 137, date 24.02.2015 deri 196, datë 14.12.2015, pra 60 vendime + 5 vendime me nr. fraksion (108/1, 117/1, 128/1, 112/1 dhe 119/1), gjithsej 65 vendime dhe nuk ka kalim apo mungesë numurash.
Në vitin 2016, fillon nga nr. 197, date 29.01.2016 deri 215, datë 30.12.2016, pra 19 vendime + 3 vendim me nr. fraksion (116/1, 135/1 dhe 180/1), gjithsej 22 vendime dhe nuk ka kalim apo mungesë numurash.
Edhe për periudhën e 9 mujorit 2017 nga nr. 216, datë 28.02.2017 deri nr. 223, datë 31.07.2017, gjithsej 8 vendime dhe nuk ka numura me fraksion apo kapërxim të tij.
Më hollësisht vendimet e marra pasqyrohen ne tabelën
"Inventarizimi dhe Rregullshmëria e numrave të Vendimeve të KVVTP Elbasan 2009 deri 9/mujori i vitit 2017".

Inventarizimi dhe Rregullshmëria e numrave të vendimeve të KVVTP Elbasan 2009-9/mujori 2017

VITET	Vendime Gjithsej	Nga këto:		
		Vendimet e marra	numra me fraksion	kapërcim nr.
Deri 2012	94	92 (Nga nr. 1 deri 92)	2 (79/1 dhe 80/1)	-
Viti 2013	16	15 (Nga nr. 93 datë 27.02.2013 deri në nr. 107, datë 4.12.2013)	1 (83/1)	-
Viti 2014	30	29 (Nga nr. 108, datë 18.02.2014 deri në nr. 136 datë 27.11.2014)	1 (71/1)	-
Viti 2015	65	60 (Nga nr. 137, datë 24.02.2015 deri 196, datë 14.12.2015)	5 (108/1, 117/1, 128/1, 112/1 dhe 119/1)	-
Viti 2016	22	19 (Nga nr. 197, datë 29.01.2016 deri nr. 215, datë 30.12.2016)	3 (116/1, 135/1 dhe 180/1)	-
9 mujori 2017	8	8 (Nga nr. 216 datë 28.02.2017 deri nr. 223, datë 31.07.2017)	-	-
	235	223	12	-

Shënim: *1. Burimi i të dhënave nga evidencat e paraqitura "Regjistri Vendimeve", Në këtë regjistër mungon përshkrimi i kolonave nr. dhe data e AMTP-së, fshati, Komuna, Zona Kadastrale dhe data e përcjelljes në ZVRPP, veprim në kundërshtim me nenin 14, pika 3, paragrafi i katërt të Rregullores "Për Organizimin dhe Funksionimin e KVVTP", miratuar me Vendimin nr. 1, datë 27.3.2009, me të dhënat jashtë formës së një standardit –formatit ligjor të miratuar (Formati tip).*
2. Nga nr.1 datë 17.09.2009, deri në vendimin nr. 92 datë 31.12.2010 është ruajtur numri progresiv i vendimeve.
3. Për vitin 2013 dhe deri në datë 31.07.2017 janë marrë 143 vendime nga KVVTP-ja.
*Për periudhën e auditimit dhe prej vitit 2009, gjenden të dhënat sipas "**Regjistrit të Vendimeve"**, por ky dokument nuk mbahet në zbatim të nenit 14, pika 3, paragrafi i katërt të Rregullores "Për Organizimin dhe Funksionimin e KVVTP", miratuar me Vendimin nr. 1, datë 27.3.2009 të KQT, kështu mungon përshkrimi në këtë libër të kolonave nr. i AMTP-së, data, fshati, Komuna, Zona Kadastrale dhe data e përcjelljes në ZVRPP, veprim në kundërshtim me nenin 14, pika 3, paragrafi i katërt të Rregullores "Për Organizimin dhe Funksionimin e KVVTP", miratuar me Vendimin nr. 1, datë 27.3.200, me të dhënat jashtë formës së një standardit – tip të miratuar.*
Nga auditimi doli se mungojnë dhe nuk u paraqitën evidentimi dhe raportimi i kërkesave mujore e progresive sipas stadeve të trajtimit, për muajt e viteve 2013 deri 9/mujori i 2017.
Pra mungon sistemi i evidencave dhe i Raportimeve të gjendjes së secilës kërkesë sipas stadit dhe gjendjes në fillim të çdo viti muaji etj, mangësi që tregon se :
a. Sistemi statistikor i evidentimit dhe i Raportimit nuk është real në pasqyrim të gjendjes që ka sjellë si pasojë mungesën e ndjekjes së ecurisë së procesit të vlerësimit të titujve të pronësisë dhe

fenomenit në tërësi në rajonin juridiksional të Prefekturës në funksion të kohës dhe kapaciteteve ,dhe mungesën e punës studimore sipas njësive territoriale,
b. Nuk krijon mundësinë e ndjekjes e trajtimit në kronologji të zgjidhjes e trajtimit të kërkesave, progresivisht sipas procedurave dhe afateve kohore,
c. Uljen ose mungësën e transparencës për cilësinë e shërbimit ndaj Publikut nga gjithë institucionet dhe NJQVp-të që kanë detyrimin ligjor të verifikim vlerësimit të titujve të pronësisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga ana e KVVTP pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të Rregullores "Për Organizimin dhe Funksionimin e KVVTP", miratuar me Vendimin nr. 1, datë 27.3.2009 të KQT, kështu mungon përshkrimi në këtë libër të kolonave nr. i AMTP-së, data, fshati, Komuna, Zona Kadastrale dhe data e përcjelljes në ZVRPP, Referuar nenit 14, pika 3, paragrafi i katërt të Rregullores "Për Organizimin dhe Funksionimin e KVVTP", miratuar me Vendimin nr. 1, datë 27.3.2009, me të dhënat jashtë formës së një standardit – tip të miratuar që shpreh:.

"Vendimet e KV-së janë akte administrative dhe përgatiten në përputhje me ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga ana e KVVTP pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 "Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar.
Referuar Kreun e I, germa "B", pika 1 të VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 "Për Përbërjen, Mënyrën e Funksionimit dhe Detyrat e Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" dhe me nenin 18, pika 1 të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP, miratuar me vendimin nr. 1, datë 27.03.2009, të Komisionit Qeveritar të Tokës, në të përcaktohet që:

"KV-të dërgojnë programet vjetore të kontrollit dhe verifikimit, pranë Sekretariatit Teknik të KQT-së brenda datës 30 janar, i cili ia paraqet KQT-së në mbledhjen e parë të vitit së bashku me vërejtjet dhe komentet dhe propozimet e tij".

Mbi marrëdhëniet e KVVTP me Komisionin Qeveritar të Tokës (KQT) me Sekretariatin Teknik të KQT,

Nga Sekretariatin Teknik i KQT nuk përcaktohet një formë standarde apo Formular-tip i "Regjistrit të Kërkesave", kështu që forma e këtij regjistri është mbajtur si regjistër korrespondence, gjë që nuk i shërben pasqyrimit të ndjekjes së ecurisë së trajtimit të kërkesës sipas stadeve, procedurave të ndjekura, që do të sillte pasqyrimin e qartë të afateve, dokumentacionit, rritjen e transparencës, llogaritjen e kapaciteteve dhe pasqyrimin e punës së KVVTP sipas periudhave, në plotësim të detyrimit të nenit 7, pika 1 të Rregullores "Për Organizimin dhe Funksionimin e KVVTP", miratuar me Vendim nr. 1, datë 27.3.2009 të KQT,

Ka qenë detyrim i hershëm i KQT, përcaktimi paraqitja dhe miratimi e formatit-tip të Regjistrit të Kërkesave, si dokument bazë i evidentimit, ndjekjes së ecurisë së kërkesave sipas stadeve, në funksion të respektimit të procedurave të afateve ligjore dhe të rritjes së transparencës ndaj publikut , në zbatim të KPA, ligjit nr. 9948 dhe të rregullores.

-Për periudhën e auditimit dhe prej vitit 2009, kanë munguar, kontrollet në KVVTP Elbasan, nga Sekretariati Teknik i KQT, pasi nuk u paraqit asnjë dokumentacion mosveprim ky në mosplotësim të detyrimit sipas Kreut V-të , neni 23, pikat 1,2,3,4,5 të Rregullores "Për Organizimin dhe Funksionimin e KVVTP", miratuar me Vendimin nr. 1, datë 27.3.2009 të KQT.

-Gjithashtu për periudhën objekt auditimi, kanë munguar trajnimet nga Sekretariati Teknik i KQT me stafin e KVVTP Elbasan, apo dhe forma të tjera të shkëmbimit të eksperiencës me qarkore të ndryshme, apo kontaktet me KVVTP me eksperiencë.
Për veprimet dhe mosveprimet lidhur me rregullshmërinë e ngritjes, funksionimin dhe eficencën e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) Elbasan, marrëdhëniet me Komisionin Qeveritar të Ndarjes së Tokës, ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e Vendimeve të marra për tituj pronësie, evidentimin dhe raportimin e procesit, krahas strukturave të tjera, sipas legjislacionit përkatës mbajnë përgjegjësi:
• *Z. I. Sh. me detyrë ish-drejtor i KVVTP, Prefektura Elbasan dhe në cilësinë e antarit KV;*
• *Znj. A. K. me detyrë ish-drejtore e KVVTP dhe në cilësinë e juristes së këtij komisioni;*
• *Z. E. S. me detyrë Drejtor i KVVTP Prefektura e Qarkut Elbasan;*
• *Znj. A. D. me detyrë juriste e KVVTP Prefektura Elbasan;*
• *Z. P. S. me detyrë topograf në KVVTP Prefektura Elbasan;*
• *Z. A. T. me detyrë agronom në KVVTP Prefektura Elbasan.*

Auditimi i procesverbalit të mbledhjeve, firmosja nga pjesëmarrësit, problematikat dhe diskutimet për periudhën janar 2013 deri më 30.09.2017.
Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së komisionit vendor të vlerësimit ligjor të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Elbasan (KV), rezulton se komisioni ka funksionuar si organ kolegjial, ndërsa mbledhjet janë thirrur dhe drejtuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan. Për periudhën 01.01.2013 deri 30.09.2017, komisioni vendor ka zhvilluar 35 mbledhje dhe janë marrë 141 vendime në lidhje me rikonfirmimin e AMTP-ve, korrigjim dhe rrëzim të AMTP-ve, shfuqizim të plotë dhe të pjesshëm të AMTP-ve, mos shqyrtim të kërkesave dhe Përfundim të Procedurave Administrative, sipas pasqyrës më poshtë:

Pasqyra e mbledhjeve të zhvilluara janar 2013 deri me 30.09.2017.

Nr	Vitet	Mbledhje të zhvilluara	Shqyrtuar Kërkesa gjithsej	Nga këto				
				Kërkesa individë	Kërkesa ZVRPP	Kërkesa Komunat	Kërkesa DAMT	Kërkesa të tjera
1	2013	9	16	4	11			1
2	2014	8	30	11	17	1		1
3	2015	8	65	33	26		1	5
4	2016	7	22	7	7		5	3
5	9/muj 2017	3	8	1	2		5	
	TOTALI	35	141	56	63	1	11	10

Sipas pasqyrës rezulton se për vitin 2013 nga komisioni vendor janë zhvilluar 9 mbledhje duke marrë 16 vendime, për vitin 2014 janë zhvilluar 8 mbledhje duke marrë 30 vendime, për vitin 2015 janë zhvilluar 8 mbledhje dhe janë marrë 65 vendime, për vitin 2016 janë zhvilluar 7 mbledhje duke marrë 22 vendime dhe për periudhën janar - shtator 2017 janë zhvilluar 3 mbledhje dhe janë marrë 8 vendime, ndërsa për periudhën e auditimit vendimmarrja e komisionit ka qenë e plotë.
Nga auditimi për periudhën 01.01.2013 deri 30.09.2017 rezulton se, procesverbali i mbledhjes nuk është mbajtur në një libër të sekretuar, me numër fletësh, të vulosur e firmosur nga punonjësi i Arkivës së Prefektit të Qarkut Elbasan, por me fleta format të thjeshta të pa sekretuara të cilat në fund të çdo mbledhje ishin të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e komisionit të pranishëm dhe prefekti, gjithashtu nuk janë të nënshkruara nga mbajtësi i protokollit, veprim në zbatim të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".
Duke i shqyrtuar këto procesverbale del se për periudhën nën auditim janë marrë 141 vendime, nga të cilët për periudhën Janar 2013 deri Shtator 2014 nuk ndodhen procesverbale të mbledhjeve

për 37 vendime nga të cilët 16 vendime për vitin 2013 dhe 21 vendime për vitin 2014, sipas pasqyrës "**Vendimet e KVVTP pranë Prefekturës së Qarkut Elbasan për vitet 2013-2017**", **Aneksi nr. 4** me numër rendor 1 deri 37, ndërsa për periudhën në vazhdim vazhdohet të mos mbahet libër i sekretuar me numër fletësh, të vulosura dhe të mbajtura nga punonjësi i arkivës së Prefektit të Qarkut Elbasan, nuk janë të shënuar diskutimet e të gjitha anëtarëve të komisionit, veprim në papajtueshmëri me kërkesat e ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar. Në procesverbalin e mbledhjes së komisionit vendor në asnjë rast nuk janë regjistruar diskutimet e Prefektit si në hapjen dhe mbylljen e mbledhjeve, ku Prefekti, ka detyrimin ligjore që të bëjë hapjen dhe mbylljen e mbledhjes veprim në papajtueshmëri me pikën 6 kreu III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 "Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër ngarkohen me përgjegjësi z. Irfan Shurdha me detyrë ish-drejtor për periudhën 01.01.2009 deri 19.05.2014, znj. A.K. me detyrë ish-drejtore për periudhën 20.05.2014 deri 28.10.2014 dhe z. E. S. me detyrë Drejtor i komisionit vendor për periudhën 29.10.2014 e në vazhdim.

Për periudhën Shtator 2014 e në vazhdim sipas dokumentacionit që i bashkëngjitet procesverbalit të mbledhjeve gjendet shkresa e drejtorit të komisionit për thirrjen në mbledhje të Prefektit të Qarkut dhe anasjelltas si dhe përgjigjet që u janë kthyer kërkesave sipas vendimmarrjes. Në asnjë rast nuk rezulton të ketë thirrur në mbledhjen e komisionit drejtues të institucioneve shtetërore, që ushtrojnë veprimtari në juridiksionin e qarkut, drejtues të qeverisjes vendore, të cilët kanë lidhje dhe informacion me çështjet konkrete, që shqyrtohen, veprim në papajtueshmëri me pikën 6 kreu III, të VKM nr. 1269, date 17.09.2008 "Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar.

Në të gjitha rastet, në procesverbalin e mbledhjes nuk janë regjistruar problemat e trajtuara nga relatori i çështjes si dhe nuk janë regjistruar diskutimet e anëtarëve të komisionit, të cilët janë të detyruar të shprehin mendimet e tyre në lidhje me çështjen që relatohen në komisioni, detyrë e përcaktuar edhe në nenin 14, të Rregullores nr. 1, datë 27.03.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë", miratuar me vendim të Komisionit Qeveritar të Tokës, ku në paragrafin e dytë të pikës 3, përcaktohet: "Përveç relatorit përkatës që ka verifikuar çështjen çdo pjesëtar i KV-së është i detyruar të shpreh mendimin e vet i cili do të shënohet në procesverbalin e mbledhjes…".

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga ana e KVVTP pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 "Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar.

Referuar Kreu III, pika 6 të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008, në të përcaktohet që:

"*Mbledhjet e këtij komisioni thirren dhe drejtohen nga prefekti. Në mbledhje, prefekti mund të thërrasë edhe drejtues të institucioneve shtetërore, që ushtrojnë veprimtari në juridiksionin e qarkut, drejtues të qeverisjes vendore, të cilët kanë lidhje dhe informacion me çështjet konkrete, që shqyrtohen".*

Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër ngarkohen me përgjegjësi z. I. Sh. me detyrë ish-drejtor për periudhën 01.01.2009 deri 19.05.2014, znj. A. K. me detyrë ish-drejtore për periudhën 20.05.2014 deri 28.10.2014 dhe z. E. S. me detyrë Drejtor i komisionit vendor për periudhën 29.10.2014 e në vazhdim.

Në procesverbalin e mbledhjeve forma dhe rezultati i votimit nuk është shprehur në "Pro", "Kundër" dhe "Abstenim", veprim në papajtueshmëri me pikën 4 neni 16, të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", neni 253, të ligjit nr. 8116, datë 23.09.1996 "Kodi i Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe germën a pika 6, të VKM nr. 1269, date 17.09.2008 "Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar dhe Rregulloren e miratuar me vendim nr. 1, date 27.03.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë".
Nga relatorët e çështjes, në procesverbalin e mbledhjes nuk janë paraqitur në mënyrë kronologjike të gjitha dokumentet që kanë ardhur nga shtetasit dhe strukturat shtetërore dhe nuk janë përcaktuar arsyet të cilat e bëjnë aktin të pa vlefshëm ose absolutisht të pavlefshëm, si dhe nuk janë përcaktuar organet që i kanë lëshuar këto Akte Administrative, veprim në papajtueshmëri me nenin 2, 3, 4, 13 dhe 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar.
Për veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër ngarkohen me përgjegjësi z. I. Sh. me detyrë ish-drejtor për periudhën 01.01.2009 deri 19.05.2014 dhe në vazhdim me detyrë specialist në komisionin vendor, znj. A. K. me detyrë ish-drejtore për periudhën 20.05.2014 deri 28.10.2014 dhe në vazhdim me detyrë juriste në komisionin vendor dhe z. E. S. me detyrë Drejtor i komisionit vendor për periudhën 29.10.2014 e në vazhdim, znj. A. D. me detyrë juriste në komisionin vendor, z. P. S. me detyrë topograf dhe z. A. T. me detyrë agronom në komisionin vendor.
Për sa më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr. 1, datë 13.11.2017, si dhe Projekt Raporti i Auditimit, për këtë çështje subjekti i audituar, përfaqësuar nga z. E. S. me detyrë Drejtor, znj. A. K., znj. A. D., z. A. T. dhe z. P. S. me detyrë anëtarë të KVVTP pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, me shkresë nr. 1299/22, datë 24.11.2017 dhe shkresë nr. 1299/34, datë 11.12.2017, protokolluar në KLSH me nr. 880/4, datë 12.12.2017, kanë bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:
Shënim 1: Burimi i të dhënave nga evidencat e paraqitura "Regjistri i Vendimeve", Në këtë regjistër mungon përshkrimi i kolonave nr. dhe data e AMTP-së, fshati, komuna, zona kadastrale dhe data e përcjelljes në ZVRPP, veprim në kundërshtim me nenin 14, pika 3, paragrafi i katërt të Rregullores miratuar me vendimin nr.1, datë 27.03.2009.
Neni 14, pika 3 paragrafi i katërt i Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP" parashikon se: Vendimet nënshkruhen nga Prefekti dhe Drejtori i KV-së dhe vulosen me vulën e institucionit të Prefektit. **Vendimet regjistrohen në regjistrin e vendimeve.** Pra në nenin 14, pika 3, paragrafi i katërt i Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP" nuk ka ndonjë përcaktim për mënyrën e mbajtjes së regjistrit të vendimeve të KV-së. Në këtë nen parashikohet vetëm që vendimet e KV regjistrohen në regjistrin e vendimeve.
Qëndrimet e auditusve.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se këto mangësi janë përcaktuar sipas formatit tip të evidencës përkatëse emërtuar "evidenca e vendimeve të komisionit vendor për pavlefshmëri të titujve të pronësisë dhe vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë".
Shënim faqja nr. 5: Mungon sistemi i evidencave dhe i raportimeve të gjendjes së secilës kërkesë dhe gjendjes në fillim të çdo viti muaji etj.
Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë në zbatim të nenit 21 të Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP" dhe të nenit 6 pika 4 e ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", informon dhe raporton në Sekretariatin Teknik pranë KQT-së në mënyrë periodike çdo fillim muaji për përmbushjen e detyrimeve, ecurinë dhe problematikën e kërkesave të paraqitura nga institucionet e ndryshme apo nga shtetasit dhe vendimet e marra nga ana e saj. Pra evidentimi i

kërkesave dhe i vendimeve si dhe ecuria e tyre është një detyrë që është realizuar nga Komisioni Vendor çdo fillim muaji.
Qëndrimet e audituesve.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se ecuria e kërkesave prej fillimit, pasi gjendja e rritur e tyre është në shkelje të afateve, sipas pikës 8, neni 8 i ligjit nr. 9948.
Shënim faqja nr. 5: Mbi marrëdhëniet e KVVTP me Komisionin Qeveritar të Tokës (KQT) me Sekretariatin Teknik të KQT. Nga Sekretariati Teknik nuk përcaktohet një formë standarde e "Regjistrit të kërkesave" gjë që nuk i shërben pasqyrimit të ndjekjes së ecurisë së trajtimit të kërkesës dhe forma e këtij regjistri është mbajtur si regjistër korrespondence.
Sipas pikës 6/ç, të paragrafit A, kapitulli III i VKM nr.1269, datë 17.09.2008 "Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", përcaktohet se korrespondenca e KV mbahet sipas rregullave në bazë të të cilës funksionon administrata e Prefektit. Prandaj dhe regjistri i kërkesave protokollohen dhe mbahen sipas rregullave të administratës së Prefektit.
Qëndrimet e audituesve.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se nuk mbështetet në ligjin për Prefektin, por në ligjin e veçantë nr. 9948 "Për KVVTP".

Procesverbali i mbledhjes nuk është mbajtur në një libër të sekretuar dhe nuk janë shënuar diskutimet e të gjithë anëtarëve të Komisionit.
Në lidhje me mbajtjen e procesverbalit të mbledhjeve në një libër të sekretuar, me numër fletësh, të vulosur e firmosur nga punonjësi i Arkivës së Prefektit të Qarkut, Komisioni Vendor do të marrë masa për përmbushjen e këtij rekomandimi për vendimet që do te merren në vazhdim.
Qëndrimet e audituesve.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se nuk ka patur kundërshti, pra del se kanë karakter pohues.

Ndërsa në lidhje me faktin se në procesverbalin e mbledhjes nuk janë regjistruar diskutimet e anëtarëve të komisionit të cilët janë të detyruar të shprehin mendimet e tyre në lidhje me çështjet që relatohen dhe se nuk janë paraqitur në mënyrë kronologjike dokumentet dhe arsyet që e bëjnë aktin të pavlefshëm, **kjo është realizuar** nga anëtarët e Komisionit me hartimin e projekt vendimeve. Përgatitja e projekt vendimit ka për qëllim që anëtarët e KV të shprehin mendimin dhe qëndrimin e tyre lidhur me zgjidhjen e kërkesave dhe të paraqisin propozimin përkatës. Gjithashtu në projekt vendim janë të paraqitura të gjitha dokumentat dhe korrespondencat që kanë ardhur nga shtetasit apo të krijuara me institucionet shtetërore si dhe janë të analizuara të gjitha shkaqet që e bëjnë të pavlefshëm pjesërisht apo plotësisht AMTP.
Qëndrimet e audituesve.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se jo në të gjitha rastet ndodheshin projekt-vendimet e hartuara.

Aditim mbi pavleshmërinë e AMTP-ve, të ankimuara, për periudhën janar 2013-30.09.2017.
Në 11 vendime për shfuqizim të AMTP-ve në sipërfaqen prej 62.900 m^2 të nxjerra nga KVVTP Elbasan, pas shqyrtimit gjyqësor nga gjykata administrative janë shfuqizuar 3 vendime me një sipërfaqe 42.700 m^2 me shkakun e provimit faktik të çështjes, duke mos marrë parasysh përcaktimet e shprehura në vendimet e KVVTP të bazuara në aktet ligjore të fitimit të titujve të pronësisë siç janë ligji nr. nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", të ndryshuar, trajtuar në pasqyrën emërtuar vendime për pavlefshmëri të AMTP-ve, në proces ankimi të shfuqizuara në shkallën e parë dhe ankimuar në apel.

Vendime për pavlefshmëri të AMTP të ankimuara

Nr.	Emri i perfituesit	Vendimi i KV		Ankuesi	Shkaku
		Nr.	Date		
1	R. K.	151	30.03.2015	I Padituri	Nuk është dakord me gjykatën, shkaqet do ti paraqesi në apel
2	S. P.	164	30.06.2015	Komisioni	Gjykata ka marë parasysh vendbanim faktik dhe jo atë me gjendje civile
3	B. S.	178	30.10.2015	I Padituri	Gjykata duhet të marrë parasysh vendbanimin faktik dhe që nuk ka marrë tokë në vend tjetër
4	A. H.	192	14.12.2015	Komisioni	Gjykata nuk i la kohe te mjaftueshme KV per te plotesuar te metat (adresa)
5	I.T.	198	29.01.2016	Komisioni	Vendimi i pabazuar ne ligj e prova, Gjykata nuk ka marre parasysh njoftimet e paleve
6	R. E.	203	31.03.2016	Komisioni	Vendimi i pabazuar ne ligj e prova
7	H. Q.	209	23.09.2016	Komisioni	Gjykata nuk pranoi plotesimin e te metave (adresa)
8	Kisha "Sh. Th."	211	31.10.2010	Komisioni	Vendimi i pabazuar ne ligj e prova, Gj.Adm interpreton gabim afatin e ngritjes se padise
9	A. B.	212	31.10.2010	Komisioni	Vendimi i pabazuar ne ligj e prova, i padituri ka sjelle prova qe nuk i ka paraqitur ne KV
10	A. B.	214	30.12.2016	Komisioni	Vendimi i pabazuar ne ligj e prova, Gjykata nuk ka marre parasysh njoftimet e paleve
11	Xh. H.	221	19.04.2017	Komisioni	Vendimi i pabazuar ne ligj e prova, Gjykata nuk ka marre parasysh njoftimet e paleve

Nga auditimi me zgjedhje i 3 dosje-vendime ka rezultuar që sipërfaqja e gjetur në kundërshtim me pikën 2, nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", për tokën e përfituar sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", të ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore është zbritur nga KVVTP-ja, por nga auditimi me të zgjedhur i këtyre praktikave del se ka mos konfirmime të sakta të gjendjes juridike nga ZVRPP dhe për faktorët AMTP-LN.

Rekomandim: Të merret në analizë nga KQT-ja Sekretariati Teknik, duke ja prezantuar problemin KVVTP-ja Elbasan

Përsa më lart u krye auditimi me të zgjedhur i 3 dosjeve-praktikave dhe konkretisht:

-Dosja e vendimit nr. 151, datë 30.03.2015, për shqyrtimin e kërkesës së z. R. E., Bashkia Elbasan, me kërkesën nr. 1209, date 24.03.2009, i cili kërkon nga komisioni vendor i verifikimit të titujve të pronësisë, verifikimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP-së nr. 107, datë ska, për tokën e përfituar sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", të ndryshuar.

Komisioni vendor ka analizuar dokumentet shkresore bashkëlidhur ankimit nr. 1209, datë 24.03.2009 si dhe materialet shkresore të krijuara nga korrespodenca me institucionet, në mbështetje të nenit 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" dhe VKM nr. 1269, datë 17.09.2008, ka hartuar projektvendimin dhe vendimin nr. 151, datë 30.03.2015 ku ka vendosur shfuqizimin e plotë të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 107, datë s'ka, në emër të R. B. K., përkatësisht shfuqizimin e plotë të sipërfaqes totale prej 2000 m^2 tokë bujqësore në sektorin fidanishte, Bashkia Elbasan dhënë në parcelën me nr. ngastre 430 e cila korrespondon me parcelën me numër pasurie 430/2 sipas hartës së ZVRPP Elbasan dhe kalimin e kësaj –parcele në pronësi të shtetit, pasi ky akt është dhënë në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan përfaqësuar nga KVVTP, me shkresën nr. 1209/36, datë 07.04.2015 ka kërkuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës deklarimin e pavlefshmërisë absolute dhe shfuqizimin plotësisht të ASMTP-së nr. 107, datë s'ka, në emër të R. B. K. të sipërfaqes prej 2000 m^2, në sektorin fidanishte të ish-NB Elbasan dhëne në parcelën me

nr. ngastre 430 e cila korrespondon me parcelën me numër pasurie 430/2 dhe kalimin e kësaj pasurie në pronësi të shtetit.
Kjo kërkesë padi është marrë në gjykim nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës e regjistruar me nr. 982, datë 7.04.2015 dhe sipas vendimit nr. 894, datë 14.07.2015, ka vendosur:
- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute dhe shfuqizimin plotësisht të aktit të marrjes së tokës në pronësi me nr. 107, datë s'ka, në emër të R. B. K., shfuqizimin e plotë të sipërfaqes prej 2000 m^2 dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 151, datë 30.03.2015 të KVVTP, pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, pasi bazuar në përgjigjet shkresore të organeve kompetente përbërja familjare e R. B. K. me datë 01.08.1991 deri 01.10.1992 nuk është subjekt përfitues pasi në bazë të certifikatës në kohën e ndarjes së tokës ka qenë në moshë pensioni dhe si i tillë nuk duhet të përfitonte, pra të trajtohej me tokë nga komisioni i ndarjes së tokës, pranë bashkisë Elbasan.
Në lidhje me këtë vendim i padituri nuk është dakord me gjykatën të cilët me datë 05.10.2015 kanë bërë ankimim mbi prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës parë të rrethit gjyqësor Durrës dhe rrëzimin e padisë si të pa bazuar, shkaqet do ti paraqesin në Apel.
Kjo padi është në proces pranë Gjykatës së Apelit Administrativ.
Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se komisioni vendor me personat fizik dhe juridik të cilët e kanë përfituar padrejtësisht tokën dhe e përdorin në mënyrë ta paligjshme, nuk ka mbajtur një procesverbal, ku të përcaktoj se këto persona tokën e kanë lënë të lirë në pronësi të shtetit, pasi toka vazhdon të përdoret nga këto persona, veprim në papajtueshmëri me pikën 2 nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar dhe pikën 4, Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 "Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, por me shkresë nr. 1209/37, datë 07.04.2015 i është dërguar vendimi i KVVTP, për ndjekje ZVRPP Elbasan.
Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën 'dh" nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat". Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuara më sipër ngarkohet me përgjegjësi specialistët në komisionin vendor për vlerësimin e titujve të pronësisë e përpunimit të çdo dosje.
-Dosja e vendimit nr. 164, datë 30.06.2015, për shqyrtimin e kërkesës së z. A. G., Bashkia Peqin, me kërkesën nr. 964, date 11.03.2013, i cili kërkon nga komisioni vendor i verifikimit të titujve të pronësisë, verifikimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP-së nr. 24, datë 25.06.1992, për tokën e përfituar sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", të ndryshuar.
Komisioni vendor ka analizuar dokumentet shkresore bashkëlidhur ankimit nr. 964, datë 11.03.2013 si dhe materialet shkresoren të krijuara nga korrespodenca me institucionet, në mbështetje të nenit 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" dhe VKM nr. 1269, datë 17.09.2008, ka hartuar projektvendimin dhe vendimin nr. 164, datë 30.06.2015 ku ka vendosur ç'fuqizimin e plotë të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 24, datë 25.06.1992, në emër të S. Xh. P., përkatësisht shfuqizimin e plotë të sipërfaqes totale prej 6600 m^2 tokë në parcelat me nr. Kadastral 291 me sipërfaqe 6000 m^2 dhe nr. 391 me sipërfaqe 600 m^2.
Ç'regjistrimin e pasurive të regjistruara sipas AMTP-së nr. 24, datë 25.06.1992, të cilat korrespondojnë përkatësisht:
a) pasuria nr. 44 sipas hartës së ZVRPP Peqin, me sipërfaqe 3289 m^2;
b) pasuria nr. 89/10 sipas hartës së ZVRPP Peqin, me sipërfaqe 6500 m^2 dhe
c) pasuria nr. 89/11 sipas hartës së ZVRPP Peqin dhe kalimin e këtyre pasurive në pronësi të shtetit, pasi ky akt është dhënë në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi.

Këto pasuri sipas printim III të listës emërore të pronarëve ndodhet në ZK nr. 2908 qyteti Peqin, pasuria 89/10 me sipërfaqe 6500 m^2 e regjistruar në volum 3, faqe 179, me indeks të HTR K-34-100-(217-C) PE.
Gjithashtu për këtë konfirmim ndodhet shkresa nr. 120/2, datë 08.05.2013 e ZVRPP Peqin, kthim përgjigje në zbatim të shkresës nr. 964/5, datë 06.05.2013, ku ZVRPP Peqin konfirmon se disponon dosjen e fshatit Progër AMTP nr. 24, datë 25.06.1992 të dorëzuar në ZVRPP Peqin për shtetasin S. P., akt i cili i referohet edhe pasurisë nr. 89/10 e ndodhur ne qytetin Peqin.
Kundër këtij vendimi është bërë ankimim në gjykatën Administrative të Shkallës Parë Durrës mbi deklarimin e pavlefshmërisë absolute dhe shfuqizimin e plotë të AMTP-së nr. 24, datë 25.06.1992, çregjistrimin e pasurive të regjistruara në bazë të këtij akti sipas pasurive të sipërcituara.
Gjykata e Administrative e Shkallës Parë Durrës me vendimin nr. 82/2015, datë 28.10.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë së ngritur nga pala paditëse Prefekti i Qarkut si i pa bazuar në ligj.
Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore dhe analiza e fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen rezulton e provuar se titulli i pronësisë AMTP nr. 24, datë 25.06.1992 për dhënien në pronësi të familjes bujqësore të S. P., të sipërfaqes së tokës prej 6600 m^2 në parcelën nr. 291 dhe 391 në vendin e quajtur blloku i portokalleve dhe ullishteve në fshatin Progër nuk është absolutisht i pavlefshëm pasi nuk rezultojnë asnjë nga rrethanat e parashikuara në nenin 116 të KPr. Administrative dhe nenin 9/1, germa "a" ligjit nr. 9948, për këtë formë pavlefshmërie.
KVVTP pranë Institucionit të Prefekit të Qarkut Elbasan me shkresë nr. 964/42, datë 09.11.2015 kërkesë apelimi, duke kërkuar se përfituesi i tokës bujqësore me AMTP nr. 24, datë 25.06.1992 nuk ka qenë banor në fshatin Progër dhe as në qytetin Peqin por banor në qytetin Elbasan sipas certifikatë të gjendjes civile, datë 15.05.2014 e Zyrës së Gjendjes Civile Elbasan dhe shkresës nr. 50, datë 24.04.2014 që sqaron lëvizjet e kësaj familje dhe vendosjen përfundimisht në qytetin Elbasan më 30.01.1986, në regjistrin themeltar nr. 13/35.
Kjo padi është në proces pranë Gjykatës së Apelit Administrativ.
Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se komisioni vendor me personat fizik dhe juridik të cilët e kanë përfituar padrejtësisht tokën dhe e përdorin në mënyrë ta paligjshme, nuk ka mbajtur një procesverbal, ku të përcaktoj se këto persona tokën e kanë lënë të lirë në pronësi të shtetit, pasi toka vazhdon të përdoret nga këto persona, veprim në papajtueshmëri me pikën 2 nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar dhe pikën 4, Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 "Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, por me shkresë nr. 964/35, datë 06.07.2015 i është dërguar vendimi i KVVTP, për ndjekje ZVRPP Peqin.
Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën dh nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat". Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuara më sipër ngarkohet me përgjegjësi specialistët në komisionin vendor për vlerësimin e titujve të pronësisë e përpunimit të çdo dosje.
-Dosja e vendimit nr. 221, datë 19.04.2017, për shqyrtimin e kërkesës së ZVRPP Elbasan e cila kërkon nga komisioni vendor i verifikimit të titujve të pronësisë, verifikimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP-së nr. 162, datë s'ka, në emër të Xh. H., me të cilin i është dhënë në pronësi sipërfaqja totale 54.300 m^2, për tokën e përfituar sipas ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", të ndryshuar, me arsyetimin se është në zërin kadastral tokë truall.
Komisioni vendor ka analizuar dokumentet shkresore bashkëlidhur ankimit nr. 561/21, datë 13.10.2017 si dhe materialet shkresore të krijuara nga korrespodenca me institucionet, në mbështetje të nenit 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" dhe VKM nr. 1269, datë 17.09.2008, ka

hartuar projektvendimin dhe vendimin nr. 221, datë 19.04.2017 ku ka vendosur shfuqizimin e pjesshëm të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 162 datë s'ka, në emër të Xh.H., përkatësisht shfuqizimin e pjesshëm të sipërfaqes totale prej 34.100 m^2 tokë e pa frutshme dhe truall, në parcelat me nr. Kadastral 417 me sipërfaqe 5.300 m^2, 418 me sipërfaqe 27.600 m^2 dhe 419 me sipërfaqe 1.200 m^2 sipas AMTP-së nr. 162, datë ska.
Në lidhje me këtë kërkesë të ZVRPP Elbasan KVVTP pranë Institucionit të Prefektit Elbasan ka krijuar korrespodencën kryesisht me DAMT pranë Këshillit të Qarkut Elbasan sipas shkresë nr. 651/3, datë 28.04.2016 ku kërkohet informacion për zërat kadastral për zërat e tokës të ndarë me AMTP nr. 162. Nga DAMT me shkresë nr. 521/1, datë 23.05.2016 konfirmon se ngastrat me nr. 417, 418 dhe 419 janë në zërin kadastral gjendje 01.08.1991 tokë e pa frytshme dhe truall.
Nisur nga kjo e dhënë KVVTP ka marrë vendimin nr. 221, datë 19.04.2017, pra shfuqizimin e pjesshëm të AMTP-së nr. 162, datë ska duke argumentuar se komisioni i ndarjes së tokës ka dhënë tokë jo bujqësore kjo në kundërshtim me nenin 3 të ligjit 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën" si dhe pika 1 e Udhëzimit nr. 5, datë 25.05.1993 "Për zbatimin e VKM nr. 161, datë 08.04.1993.
Ky vendim nga KVVTP është dërguar në Gjykatën Administrative të Shkallës Parë Durrës me shkresë nr. 561/14, datë 25.04.2017 për shqyrtim gjyqësor, në bazë të nenit 10 të ligjit nr. 9948.
Gjykata e Administrative e Shkallës Parë Durrës me vendimin, datë 03.10.2017, ka vendosur rrëzimin e padisë së ngritur nga pala paditëse Prefekti i Qarkut Elbasan si i pa bazuar në ligj.
Gjykata Administrative e ka rrëzuar me shkakun se KVVTP nuk ka respektuar procedurën administrative në marrjen e vendimit nr. 221, datë 19.04.2017, psi nuk ka njoftuar palët e prekura.
Në lidhje me këtë arsyetim del se nuk qëndron, pasi palët janë njoftuar për paraqitje pranë KVVTP-së, sipas shkresave nr. 561/9, nr. 561/10, nr. 561/11 dhe nr. 561/12, datë 01.12.2016, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm për trajtimin e AMTP-së nr. 162, datë s'ka, por ato nuk janë paraqitur. Gjithashtu KVVTP-ja ka vazhduar procedurën dhe ka nxjerrë vendimin nr. 221, datë 19.04.2017 dhe me shkresën nr. 561/15, datë 25.04.2017 ka njoftuar këtë vendim trashëgimtarëve të familjes H.
Përveç kësaj në kërkesën ankimore është trajtuar se respektimi i procedurave administrative nga ana e komisionit vendor nuk përbën shkak për rrëzimin e padisë, pasi nuk ka qenë objekt i padisë.
Gjykata Administrative e Shkallës Parë Durrës nuk i ka mbajtur parasysh këto fakte, për këtë shkak KVVTP pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan ka paraqitur kërkesë ankimore nr. 561/21, datë 13.10.2017, në Gjykatës së Apelit Administrativ, duke kundërshtuar vendimin e gjykatës Administrative të Shkalës Parë Durrës .
Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se komisioni vendor me personat fizik dhe juridik të cilët e kanë përfituar padrejtësisht tokën dhe e përdorin në mënyrë ta paligjshme, nuk ka mbajtur një procesverbal, ku të përcaktoj se këto persona tokën e kanë lënë të lirë në pronësi të shtetit, pasi toka vazhdon të përdoret nga këto persona, veprim në papajtueshmëri me pikën 2 nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar dhe pikën 4, Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 "Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, por ka mjaftuar vetëm njoftimin me shkresë nr. 561/19, datë 25.04.2017 i është dërguar vendimi i KVVTP, për ndjekje ZVRPP Elbasan.
Nga auditimi rezulton se dosja është pa inventarizuar, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhe në dosje, si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën dh nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat". Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuara më sipër ngarkohet me përgjegjësi specialistët në komisionin vendor për vlerësimin e titujve të pronësisë e përpunimit të çdo dosje.

* Për veprimet dhe mos veprimet e konstatuara më sipër ngarkohet me përgjegjësi A. K., me detyrë juriste, A. D., me detyrë juriste, P. S. me detyrë topograf, A. T. me detyrë agronom dhe E. S. me detyrë Drejtor i komisionit vendor.

Gjetje: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me vendim nr. 221, datë 19.04.2017, ka vendosur shfuqizimin e pjesshëm të AMTP-së nr. 162, datë ska duke argumentuar se komisioni i ndarjes së tokës ka dhënë tokë jo bujqësore kjo në kundërshtim me nenin 3 të ligjit 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën" si dhe pika 1 e Udhëzimit nr. 5, datë 25.05.1993 "Për zbatimin e VKM nr. 161, datë 08.04.1993, pasi sipas konfirmimi nga ana e DAMT, këto sipërfaqe ndodhen në zërin kadastral tokë të pa frytshme dhe truall, të përfituar në kundërshtim me ligjin nuk e ka kaluar në pronësi shtet, veprim në papajtueshmëri me germën a neni 1, të ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", të ndryshuar me nenin 2, 3, 4, dhe pikën 1 nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar dhe VKM nr. 255, datë 02.08.1991 "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore".
Rekomandim: KVVTP të vazhdojë procedurat gjyqësore në Gjykatën Administrative te Apelit për lënien në fuqi të vendimit nr. 221, datë 19.04.2017, për shfuqizimin e pjesshëm të AMTP-së nr. 162, datë s'ka në emër të Xh. H. (trashëgimtarët e tij), përkatësisht për sipërfaqen 34100 m^2 tokë e pa frytshme dhe trual në parcelat me nr. Kadastral 417, 418 dhe 419, me vendndodhje sektori Manas, NB Elbasan ZK nr. 8527 dhe kalimin e parcelave në pronësi të shtetit.
Për sa më sipër është mbajtur akt-verifikimi nr. 4, datë 14.11.2017, si dhe Projekt Raporti i Auditimit, për këtë çështje subjekti i audituar, përfaqësuar nga z. E. S. me detyrë Drejtor, znj. A.K., znj. A. D., z. A. T. dhe z. P. S. me detyrë anëtarë të KVVTP pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, me shkresë nr. 1299/22, datë 24.11.2017 dhe shkresë nr. 1299/34, datë 11.12.2017, protokolluar në KLSH me nr. 880/4, datë 12.12.2017, kanë bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:
Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i 3 dosjeve, konkretisht vendimeve të KV-së nr. 151, 164 dhe 221 ka rezultuar se dosjet janë të pa inventarizuara, dokumentacioni është pa numëruar për çdo fletë, nuk përcaktohet sasia e fletëve që ndodhen në dosje si dhe nuk përmban personin dorëzues dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9154, datë.6.11.2003 "Për arkivat".
Për sa i takon rekomandimeve të lëna Komisioni Vendor do të marrë masat e nevojshme për zbatimin e tyre menjëherë e në vazhdimësi.
Qëndrimet e auditusve..
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se kanë karakter pohues, pra janë të pranuara prej tyre, duke marrë masat e nevojshme për zbatimin menjëherë dhe në vazhdimësi.

Auditim mbi Vendimet e marra nga Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) për shfuqizimin e pjesshëm të AMTP-ve
7.5 a 1. KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan për periudhën 2013-30.92017 ka marrë 10 vendime për shfuqizim të AMTP-ve, në sipërfaqen prej 23387,.82 m^2 të cilët kanë ***marrë formë të prerë*** pasqyruar ne tabelën emërtuar "Vendime për Pavlefshmëri/shfuqizim të AMTP-ve marrë formë të prerë nga Gjykata për periudhën 01.01.2013 deri më 30.09.2017"
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me Vendimet e KVVTP dhe vendimet përkatëse të Gjykatës të lidhura me to rezulton sa më poshtë
Tabela Vendime për Pavlefshmëri/shfuqizim të AMTP-ve marrë formë të prerë nga Gjykata *për periudhën 01.01.2013 deri më 30.09.2017*

nr.	Përfituesi	Vendndodhja, Fshati, ish-Komuna, Qyteti, Bashkia	Vendimi KVVTP		Vendim gjykate		Sipër m^2
			Nr	datë	Nr	datë	
1	K. L.	Copanaj, K.Perparim, Peqin	96	29.03.2013	2309	20.11.2013	900

2	H. K.	F.Gryksh i vogel, K. Sheze	99	31.05.2013	1889	11.09.2013	339
3	M. Sh.	F.Caushaj, Perparim, Peqin	100	31.05.2013	1533	10.11.2014	3500
4	D. P.j	F.Liçaj, K.Shales Elbasan	103	24.07.2013	1395	20.10.2014	794.[02] **+2611**
5	N. H.	F.Hyse, Belsh, Elb	104	17.09.2013	1360	14.10.2014	4000
6	R. K.	Gryksh i Vogel, Sheze Peqin	130	30.09.2014	115	03.02.2015	708 **+Konf**
7	Sh. K.	F.Gjocaj, K.Gjocaj Peqin	131	30.09.2014	1794	23.12.2014	273.[80] **+ 563**
8	Xh. D.	F.Copanaj, K.Perparim Peqin	134	27.11.2014	442	09.04.2015	3900
9	H. K.	Elbasan	204	31.03.2016	691	12.07.2016	2768 **+1572**
10	F. G.	Mamël Gracen Elbasan	194	14.12.2015	230	11.3.2016	6155
	Totali i Zbritur sipas Vendimeve KVVTP Zbritje me pak T OTALI QË DUHEJ ZBRITUR						23387,.[82] **+ 4746** **28103**

Shënim: *Shifrat pasqyruar në tabelë me bold (**përkatësisht +2611,+ 563 dhe +1572**) përfaqësojnë sipërfaqe pavlefshmërie të zbritura më pak nga konfirmimet e parregullta dhe mosmbajtja parasysh e gjendjes fizike AMTP-LN-PIII*

Nga pasqyra më sipër janë audituar 10 dosjet, mbi ligjshmërinë e vendimeve të marra nga komisioni vendor i verifikimit të vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë dhe kryesisht auditimi u shtri në çështjet: a) lidhur me nëse ka shmangie nga krahasimi i sipërfaqeve të shfuqizuara nga vendimi i KVVTP krahasuar me sipërfaqet sipas Vendimit të Gjykatës,
b) njoftimi i institucioneve përkatëse si NJQV për marrjen nën administrim dhe i ZVRPP –ve për marrjen e masave përkatëse vendosjen e kufizimit dhe regjistrimit "shtet" të sipërfaqeve mbi të cilat është vendosur pavlefshmëria e mbajtësit të titullit të pronësisë se tokës bujqësore.

I. Nga auditimi i dokumentacionit-dosjeve të periudhës viti 2013-2017, në lidhje me 10 vendime për shfuqizim të AMTP-ve, në sipërfaqen prej 23387,82 m^2,(ose 23388 m^2) vendime të cilët kanë ***marrë formë të prerë*** rezulton se ***6 vendime*** u gjetën të rregullta (përkatësisht Vendimi nr. 96, datë 29.03.2013, nr. 99, datë 31.05.2013, nr. 100, datë 31.05.2013, nr. 104, datë 17.03.2013, nr. 134, datë 27.11.2014, nr. 194, datë 14.12.2015 për sa i takon saktësisë së sipërfaqeve të zbritura).
-7 vendime me sipërfaqen e zbritur 16201 m^2 dhe kthyer "shtet" nuk janë dërguar për njoftim (që do të krijonte mundësi ekzekutimi edhe nga NJQV), pra për marrje në dorëzim e vënien nën administrim të sipërfaqes kthyer "shtet", përkatësisht vendimet nr. 96, nr. 100, nr. 134 për ish-Komuna Përparim dhe vendimi nr. 99 për ish- Komuna Shezë me sipërfaqe 8639 m^2 (aktualisht NJQV të Bashkisë Peqin) dhe vendimet nr. 103, për ish- Komuna Shalës, vendimi nr. 204 për Bashkinë Elbasan për sipërfaqen 3562 m^2 si dhe vendimi nr. 104 për sipërfaqen 4000 m^2 për Bashkinë Belsh, gjendje në kundërshtim me nenin 9 pika 1 të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", i ndryshuar edhe sepse Mungon dorëzimi i këtyre sipërfaqeve Komunave ose Bashkive, sipas germës a, dorëzimi në Zyrën Rajonale të AKKP, sipas germës b, sipas VKM nr. 567, datë 5.9.2007 "Për miratimin e kritereve dhe procedurave, përcaktimin e pronarëve fond pasurie të paluajtshme, për kompensim fizik" dhe sipas VKM nr. 868, datë 18.6.2008"Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi i tokës bujqësore" , mosveprim në kundërshtim me kreun III, germa "B", pika 4, germat a,b të VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 "Për Përbërjen, Mënyrën e Funksionimit dhe Detyrat e Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore". Ka qenë e nevojshme që KVVTP Prefekti Qarkut ti dergonte ne institucionet perkatese.
Gjetje nga auditimi: Në 7 vendime me sipërfaqen e zbritur 16201 m^2 dhe kthyer "shtet" nuk janë dërguar për njoftim, dhe nuk janë marrë në dorëzim me proces verbal, për vënien nën nën administrim të sipërfaqes kthyer "shtet", përkatësisht vendimet nr. 96, nr. 100, nr. 134 për ish-Komuna Përparim dhe vendimi nr. 99 për ish- Komuna Shezë me sipërfaqe 8639 m^2 (aktualisht

NJQV të Bashkisë Peqin) dhe vendimet nr. 103, për ish- Komuna Shalës, vendimi nr. 204 për Bashkinë Elbasan për sipërfaqen 3562 m^2 si dhe vendimi nr. 104 për sipërfaqen 4000 m^2 për Bashkinë Belsh, gjendje kjo në kundërshtim me nenin 9 pika 1 të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", i ndryshuar dhe në kundërshtim me kreun III, germa "B", pika 4, germat a,b të VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 "Për Përbërjen, Mënyrën e Funksionimit dhe Detyrat e Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", pasqyruar në Tabelën "*Tabelën Vendime për Pavlefshmëri/shfuqizim të AMTP-ve marrë formë të prerë* nga Gjykata *për periudhën 01.01.2013 deri më 30.09.201"*

Rekomandim: KVVTP Prefekti i Qarkut Elbasan, të marrë masa për dorëzimin me proces verbal të sipërfaqes prej 16201 m^2 e kthyer "shtet" nga pavlefshëmria e pjesshme e Titujve të Pronësisë që i përket **7** Vendimeve përkatësisht nr. 96, nr. 100, nr. 134 për ish-Komuna Përparim dhe vendimi nr. 99 për ish- Komuna Shezë me sipërfaqe 8639 m^2 (aktualisht NJQV të Bashkisë Peqin) dhe vendimet nr. 103, për ish- Komuna Shalës, vendimi nr. 204 për Bashkinë Elbasan për sipërfaqen 3562 m^2 si dhe vendimi nr. 104 për sipërfaqen 4000 m^2 për Bashkinë Belsh

-Në 3 vendime (përkatësisht nr. 4,7,9, sipas tabelës*) *të KVVTP, të cilat kanë marrë forme të prerë nga Gjykata, shfuqizimi të titujve të pronësisë është llogaritur zbritje më pak për - 4746 m^2 (2611 m^2+563 m^2+1572 m^2) (janë zbritur 3836 m^2 kundrejt 8582 m^2 që duheshin zbritur), nga mos konfirmimet e sakta të ZVRPP-ve dhe mos marrja parasysh e gjendjes juridike AMTP-LN-PIII), kjo konkretisht në vendimet (në vendimin nr. 103, datë 24.07.2013,për të cilin janë zbritur 794 m^2 kundrejt 3405 m^2 pra janë zbritur më pak 2611 m^2; në vendimin nr 131, datë 30.09.2014,për të cilin janë zbritur 274 m^2 kundrejt 837 m^2 , pra janë zbritur më pak 563m^2 si dhe në vendimin nr. 204, datë 11.03.2016, për të cilin janë zbritur 2768 m^2 kundrejt 4340 m^2, pra janë zbritur më pak 1572 m^2, si dhe ***u gjetën me mangësi dhe parregullsi të tjera që së bashku lidhen me shkakun për konfirmime të parregullta të gjendjeve juridike- fizike të pasurive konfirmuar nga ZVRPP, Peqin dhe Elbasan ndërsa në 2 raste me mungesë rikërkimi te konfirmimit për persona të lidhur me K/Familjarin, pra*** mos konfirmime në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2"c", mos konfirmime dhe pasaktësi të shkaktuara nga ZVRPP Elbasan, Peqin**,** pasqyruar ne tabelën emërtuar "Vendime shfuqizimi të KVVTP në proces gjyqësor, sipas procedurës nenet 9, 10 të ligjit nr. 9948 periudhën 01.01.2013 deri më 30.09.2017", pasqyruar në tabelën " Sipërfaqet e pavlefshmërisë dhe zbritur më pak për Vendime e KVVTP Marre Forme të prerë nga Gjykata " dhe trajtuar ***përkatësisht:***

" Sipërfaqet e pavlefshmërisë dhe zbritur më pak për Vendime e KVVTP, marre forme të prerë nga Gjykata"

NR	Përfituesi	Vendndodhja, Fshati, ish-Komuna, Qyteti, Bashkia, ZVRPP	Vendimi KVVTP		Vendim gjykate		Sip m^2		Zeri Kadastral	
			nr	datë	nr	datë	sipas KVVTP	Zbrit me pak sipas AMTP-LN	Arë m^2	Ullishte m^2
4	D. P.	F.Liçaj, K.Shales Elbasan	103	24.07.2013	1395	20.10.2014	794	**+2611**	1705	906
6	Rr. K.	Gryksh i Vogel, Sheze Peqin	130	30.09.2014	115	03.02.2015	708	**+Konf**		
7	Sh. K.	F.Gjocaj, K.Gjocaj Peqin	131	30.09.2014	1794	23.12.2014	274	**+ 563**	563	-
9	H. K.	Elbasan	204	31.03.2016	691	12.07.2016	2768	**+1572**	-	1572
	Totali për të 10 vendimet						23388	**+ 4746**	**2268**	**2478**

Shënim: 1..VKVVTP nr. 130 për K/Familjarin Rr. K. lidhet me *rikërkimin e munguar te konfirmimit për persona të lidhur me K/Familjarin, prandaj në tabelë është përfshirë edhe vendimimi nr. 129, datë 30.9.2014*

Dosjet sipas tabelës me Sipërfaqet e pavlefshmërisë dhe zbritur më pak për Vendime e KVVTP , marre forme të prerë nga Gjykata trajtuar analitikisht si më poshtë:

-Per dosjen (nr.3, sipas tabelës) D. Y. P., fshat Licaj, Komuna Shalës, lidhur me AMTP nr..-, datë 17.10.1991, është marrë nga KVVTP Vendimi nr. 103,datë 24.07.2013, i cili ka marrë formë të prere me Vendimin e Gjykatës nr. 1395, datë 20.10.2014, sipas të cilit është kërkuar shfuqizimi në sipërfaqen tepër ***prej 794 m²,*** konstatojmë:
ZVRPP Elbasan me kërkesën nr. 1110, datë 20.7.2010 ka kërkuar verifikim vlerësim të pasurive të titullit të pronësisë për AMTP nr. s'ka, datë 17.10.1991, ndërsa në konfirmimet e gjendjeve juridike fizike të pasurive me shkresën nr. 1376/1, datë 17.09.2010 dhe konfirmimi me shkresën 1390/1, datë 15.7.2013 ZVRPP Elbasan nuk ka konfirmuar të plotë e saktë gjendjen juridike, dhe as transaksionet as ka konfirmuar certifikatat e lëshuara datë 25.08.1997 për 6 pasuri, regjistruar dëshmi trashëgimie e certifikata datë 20 12.2007 tashmë për 7 pasuri (shtuar nga ndarja e një pasurie në 2 pasuri të cilat njëra është dhuruar 20.10.97 dhe tjetra shitur 13.11.1997) si dhe 1 pasuri lëshuar certifikatë datë 20.12.2008. Gjithashtu ZVRPP nuk ka deklaruar të gjitha pasuritë në PIII (Printim III,pasqyrohen vetëm 3 nga 6 pasuri sipas AMTP) në emër të Dilaver Yzeir Prroj dhe pasardhësve trashëgimtar të tij, dhe konkretisht:
Sipas konfirmimeve të parregullta ZVRPP dhe sipas kartelave të çelura të pasurive rezultojnë pasuritë me transaksionet vijuese

	AMTP	PIII-LN	Dif	Në ZK.2449 Transaksione (Certif, Dtrash, ndarje shitje dhurim
Pas R1, nr.279/8, v.1, fq.173 ,	2100	2500	+ 400	c. 25.8.97, 20.12.07, 20.12.08
Pas R2, nr.417/1, v.1, fq.177 ,	2580	2550	- 30	c. 28.8.97, 20.12.07, -
Pas R3, nr.326/3, v.1, fq.174 ,	2400	2021	- 379	c. 28.8.97, 20.12.07, -
Pas R4, nr.354/7, v.1, fq.175,	3000	4950	+1950	c. 28.8.97, 20.12.07, -
Pas R5, nr.141/1, v.1, fq.172,	4200	5106	+ 906	c. 25.8.97, 20.12.07, -
Pas R6, nr.2821, v.1, fq.176,	2500	2178	- 322	c. 25.8.97, 20.12.07, -ndare:
-nr.282/1/1 v.9,fq.108		1278 arë		K.Dhurimi 30.10.97
-nr.282/1/2 v.9,fq.109		900 arë		K. Shitje 13.10.97
Total (R1 +R6)	16780	19305	+ 2525	

Llogaritjet për zbritjen prej 794 m² ne Vendim nga KVVTP janë të pasakta pasi janë nisur nga:
Në Vendim KVVTP ka marrë si bazë normën e përgjithshme llogaritur 6 frymë x 2664,32 m² = 15 985,92 m² afërsisht 15986 m²; e cila në vendim ka zbritur 794,2 m² , llogaritur :
Nga sasia prej 16780 m²sipas totalit AMT- zbritur 15 985,92 m² = -794,02 m²,
Ndërsa referuar shkresës nr.-, datë 20.5.2009 (prot. 1857, datë 25.5.2009 në Prefekturë) së Komunës Shalës ku përcakton normën prej 2600 m²/frymë, Sipërfaqja takuese ligjore e familjes është 6 frymë x 2600m² norma = 15600 m².
Pra sipas auditimit referuar identifikimit të pasurive dhe transaksioneve si më sipër rezulton se familja disponon tokë më tepër 3705 m², që duhej të zbritej nga Vendimi nr. 103 llogaritur si më poshtë:
19305 m² sipërfaqe faktike – 15600 m²zbresim sipërfaqen takuese sipas normës ligjore- 300 m² trualli i shtëpisë = 3405 m². Pra KVVTP ka zbritur-794 m² kundrejt 3405 m², pra më pak 2611 m².
Si konkluzion: Në Vendimin nr. 103, datë 24.07.2013,si rezultat i konfirmimeve të pasakta nga ZVRPP Elbasan për gjendjen juridike fizike të pasurive mos deklarimit të gjithë pasurive, mos konfirmimeve të transaksioneve si ndarje pasurish, lëshim certifikatash, dëshmi trashëgimie, kontrata shitje e kontrata dhurimi lidhur me vlerësimin e titujve të pronësisë AMTP nr. s'ka, datë 17.10.1991 me mbajtës D. Y. P., dhe trashëgimtarët fshati Licaj, Komuna Shalës***;*** mos konfirmime në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të

Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2"c", mos konfirmime dhe pasaktësi të shkaktuara nga ZVRPP Elbasan që kanë sjellë si pasojë që KVVTP Prefekti Qarkut në Vendimin nr. 103, datë 24.07.2013, marrë formë të prerë Vendimin e Gjykatës nr. 1395, datë 20.10.2014, sipas të cilit është kërkuar shfuqizimi në sipërfaqen tepër ***prej 794 m^2, por nuk ka përfshirë sipërfaqen tepër prej 2611 m^2(19305-15600 m^2 norma ligjore -300 m^{2}trualli shtëpisë- 794 m^2 tokë bujqësore) sipërfaqe tepër ligjit shpërndarë: pasuria nr. 141/1, v. 1, fq. 172 ullishtë 906 m^2 ZK. 2449, pasuria nr. 279/8, v.1, fq. 173 arë 400 m^2, pasuria nr. 354/7, v. 1, fq175 arë 1305 m^2*,** në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2"c. Për të cilat KVVTP do te duhet të rishqyrtojë Vendimin nr. 103, datë 24.07.2013**, për zbritjen edhe *2611* m^2. *Mangësi të tjera mungojnë relacionet, projekt vendimi e tjerë dokumente që provojnë zbatimin e procedurave ligjore në ketë vendim.***
Dosja është përpunuar nga z. I. Sh., ish-Drejtor, zj. A. K., z. R. T., z. A. T., znj. A. Sh.a anëtar dhe miratuar z. Sh. D., ish-Prefekt.

-Për dosjen (nr.6,sipas tabelës) Rr. S. K. fshat Gryksh i Vogël, Komuna Shezë, Peqin lidhur me AMTP nr. 40, datë 10.03.1992, është marrë nga KVVTP Vendimi nr. 130,datë 30.09.2014, i cili ka marrë formë të prere me Vendimin e Gjykatës nr. 115, datë 03.02.2015, sipas të cilit është kërkuar shfuqizimi në sipërfaqen tepër ***prej 708 m^2,*** konstatojmë:
ZVRPP Peqin me kërkesën nr. 539/1, datë 20.11.2013, bazuar në kërkesën e vetë qytetarit, ka kërkuar verifikim vlerësim të pasurive të titullit të pronësisë për AMTP nr. 40, datë 10.03.1992, ndërsa në konfirmimet e gjendjeve juridike fizike të pasurive me shkresën nr. 8, datë 10.01.2014 ZVRPP Peqin nuk ka konfirmuar të plotë e saktë gjendjen juridike, dhe as transaksionet as ka konfirmuar nëse ka lëshuar ose jo certifikata për 5 Pasuritë me sipërfaqe totale 16930 m^2 sipas AMTP dhe sipërfaqe 18175 m^2 të deklaruara për kryefamiljarin Rr. S. K. me nr. 35 sipas Printimit të III (PIII), kundrejt normës për 4 frymë me sipërfaqe takuese ligjore prej 14852 m^2, që rezulton nga llogaritja: 4 frymë x 3713 m^2/frymë norma = 14852 m^2.
Ky mos konfirmim nga ZVRPP Peqin është në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2"c", mos konfirmime dhe pasaktësi të shkaktuara nga ZVRPP Peqin që kanë sjellë si pasojë që KVVTP Prefekti Qarkut në Vendimin nr. 130, datë 30.09.2014, ka kërkuar shfuqizimin ***për sipërfaqen 708 m^2*** në pasurinë nr. 281/12-b zk. 1878, Grykësh i Vogël, Komuna Shezë.
Pra ky vendim nr. 130, datë 30.09.2014, rezulton i pa argumentuar, për 2 fakte që nuk janë shqyrtuar nga KVVTP , konkretisht:
a. Për mos konfirmim të saktë nga ZVRPP Peqin bërë sipas shkresës nr. 8, datë 10.01.2014 ku nuk ka konfirmuar të plotë e saktë gjendjen juridike, dhe as transaksionet as ka konfirmuar nëse ka lëshuar ose jo certifikata për 5 Pasuritë me sipërfaqe totale 16930 m^2 sipas AMTP dhe sipërfaqe 18175 m^2 të deklaruara për kryefamiljarin Rr. S. K. me nr. 35 sipas Printimit të III (PIII), kundrejt normës për 4 frymë me sipërfaqe takuese ligjore prej 14852 m^2,
b. Gjithashtu edhe për faktin se me z. Rr. S. K. është i lidhur edhe personi L. Rr. K., për të cilin janë shqyrtuar nga KVVTP titujt e pronësisë me Vendimin nr. 129, datë 30.9.2014 (për normën 3713 m^2 x 2 = 7426 m^2) ku edhe për këtë ***vendim mungon konfirmimi i Gjendjes juridike të pasurive dhe mungon Konfirmimi , Deklarimi nga ZVRPP Peqin "Nëse është pajisur ose jo me toke si kryefamiljar dhe a përfshihet në PIII të fshatit Grykësh i Vogël*** L. Rr. K.", fakt ky që vjen në kundërshtim edhe me certifikatën gjendje datë 01.08.1991, lëshuar datë 08.08.2014 nga

ZGJC Pajovë, Fshati Grykësh i Vogël; që tregon se ka qenë kryefamiljar i Fshatit Grykësh i Vogël, Komuna Pajovë, ndërsa ZVRPP Peqin nuk jep gjendjen e PIII ku të jetë përfshire L. Rr. K. Pra për këtë KVVTP duhet të rishqyrtojë dy vendimet Vendimi nr. 130,datë 30.09.2014, dhe nr. 129, datë 30.9.2014 dukë kërkuar Konfirmimin e gjendjes juridike të pasurive dhe PIII për K/Familjarët Rr. S. K. lidhur me faktin që me sipërfaqe totale 16930 m^2 sipas AMTP dhe sipërfaqe 18175 m^2 të deklaruara për kryefamiljarin Rr. S. K. me nr. 35 sipas Printimit të III (PIII), kundrejt normës për 4 frymë me sipërfaqe takuese ligjore prej 14852 m^2, si dhe për kryefamiljarin L. Rr. K. të rishqyrtojë vendimin lidhur me faktin e mungesës konfirmimit të gjendjes juridike e të PIII ndërsa ekziston dokumenti certifikatë gjendje datë 01.08.1991, lëshuar datë 08.08.2014 nga ZGJC Pajovë, Fshati Grykësh i Vogël; që tregon se L. Rr. K. ka qenë kryefamiljar i Fshatit Grykësh i Vogël, Komuna Pajovë, ndërsa ZVRPP Peqin nuk jep gjendjen e PIII ku të jetë përfshire L. Rr. K. Dosja është përpunuar nga zj. A. K., Ish- Drejtore, z. I. Sh., z. R. T., znj. A. Sh., z. A. T., anëtar dhe miratuar z. A. K., ish-Prefekt.

-Për dosjen (nr. 7, sipas tabelës) Sh. S. K., fshati Gjocaj, Komuna Gjocaj Peqin lidhur me AMTP nr. 20, datë 20.11.1991, është marrë nga KVVTP Vendimi nr. 131, datë 30.09.2014, i cili ka marrë formë të prere me Vendimin e Gjykatës nr. 1794, datë 20.12.2014, sipas të cilit është kërkuar shfuqizimi në sipërfaqen tepër ***prej 274 m^2, ullishte parcela nr.23/92 Rreshti R5*** sipas AMTP ose pasurisë nr. 102/106-b zk. 1748, konstatojmë:
ZVRPP Peqin me kërkesën nr. 95/1, datë 23.04.2010, bazuar në kërkesën e vetë qytetarit, ka kërkuar verifikim vlerësim të pasurive dhe titullit të pronësisë tokës bujqësore për AMTP nr. 20, datë 20.11.1991, ndërsa në konfirmimet e gjendjeve juridike fizike të pasurive me shkresën nr. 332/1, datë 03.09.2010 ZVRPP Peqin, nuk ka dërguar fotokopjen e PIII me Kryefamiljarë sipas Formatit Tip por dhe nuk ka konfirmuar të plotë e saktë gjendjen juridike,(pasi sipas konfirmimit në këtë shkresë jep shifrat 11600 m^2 sipas AMTP dhe 11337 m^2 sipas LN- dhe nuk ka konfirmuar shprehur as transaksionet as ka konfirmuar nëse ka lëshuar ose jo certifikata për 5 Pasuritë; në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2"c",
Llogaritjet për zbritjen prej 273,8 m^2 (274 m^2) ne Vendim nga KVVTP janë të pasakta pasi llogaritjet janë nisur nga:
Në Vendim KVVTP ka marrë si bazë normën e përgjithshme llogaritur 5 frymë x 2265, ^{24} m^2 = 11,336,^{2} m^2 afërsisht 11,336,m^2; e cila në vendim ka zbritur 273,^{8} m^2(274 m^2), llogaritur:
Nga Sasia prej 11600 m^2sipas totalit AMT- zbritur 11,336,2 m^2 = -<u>273,8 m^2 (274 m^2</u>),
Ndërsa referuar shkresës nr. 160, datë 23.9.2009 (ndodhur në dosje të këtij vendimi) të Komunës Gjocaj ku përcakton normën prej 2100 m^2/frymë, sipërfaqja takuese ligjore e familjes është 5 frymë x 2100 m^2 norma = 10500 m^2.
Kështu që zbritja e sipërfaqes tepër me normën prej 2100 m^2 rezulton:
11337 m^2 -10500 m^2= 837 m^2 dhe jo sa 274 m^2, pra është zbritur me pak 563 m^2 (274-837).
Për të cilat KVVTP do te duhet të rishqyrtoje vendimin nr. 131,datë 30.09.2014, duke kërkuar Konfirmimin e gjendjes juridike të pasurive dhe PIII për K/Familjarin Sh. S. K. fshat Gjocaj, Komuna Gjocaj Peqin lidhur me AMTP nr. 20, datë 20.11.1991, sipas të cilit është zbritur 273,8 m^2(274 m^2), si të paargumentuar për shkak të ekzistencës së dhe përdorimit të normës përgjithshme 2265,24 m^2 ndërsa ekziston dhe nuk është zbatuar në llogaritje norma 2100 m^2, si dhe të kërkohet konfirmimi i printim III- Tip dhe gjendja juridike e pasurive; pasi në këto kushte e fakte zbritja mbetet e paargumentuar.
Mangësi të tjera mungojnë relacionet, projekt vendimi e tjerë dokumente të tjera që provojnë zbatimin e procedurave ligjore në ketë vendim.

Dosja është përpunuar nga zj. A. K., Ish- Drejtore, z. I. Sh., z. R. T., znj. A. Sh. (Dylgjeri), z. A. T., anëtar dhe miratuar z. A. K., ish-Prefekt.

-Per dosjen (nr.9, sipas tabelës) H. K. & B. Z. (trashëgimtar të A. H. K.) ndodhur në Elbasan (Zaranike) ZK.8526, lidhur me AMTP nr. 130, datë -, trajtuar nga Ish-NB Elbasan si ish-Themelues është marrë nga KVVTP Vendimi nr. 204,datë 31.03.2016, i cili ka marrë formë të prere me Vendimin e Gjykatës nr. 691, datë 12.07.2016, sipas të cilit është kërkuar shfuqizimi në sipërfaqen tepër ***prej 8000 m^2,*** llojit toke (e pafrytshme PF, sheshe) (Truall),për shkakun ligjor se nuk është objekt i ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 neni 1, dhe 3 që ka si objekt vetëm tokën bujqësore; konstatojmë:
ZVRPP Elbasan me kërkesën nr. 2141, datë 04.06.2015 ka kërkuar verifikim vlerësim të pasurive të titullit të pronësisë për AMTP nr. 130, datë -, ndërsa në konfirmimet e gjendjeve juridike fizike të pasurive me shkresën nr. 2247/1, datë 25.06.2015 ZVRPP Elbasan ka dërguar PIII për KF Hysen Kopili me nr. 332, sipas AMTP me 5 pasuri në 4 rreshta me sipërfaqe 28000 m^2 ***ndarë:*** 4 pasuri Ullishtë me sipërfaqe 20000 m^2 dhe 1 pasuri me 8000 m^2 truall; ndërsa sipas kolonës PIII-LN konfirmon 8 pasuri me sipërfaqe totale 24340 m^2 ***ndarë:*** 7 pasuri me sipërfaqe 21572 m^2 ullishtë dhe 1 pasuri me 2768 m^2 truall.
Gjithashtu ka dërguar KPP e pasurive në të cilat janë shënuar lëshim certifikatash datë 17.4.2014 për 6 pasuri me sipërfaqe 14875 m^2 ullishtë si dhe ka vendosur kufizime datë 5.01.2013 mbi 1 pasuri me sipërfaqe 6697 m^2 ullishtë dhe 1 pasuri me sipërfaqe 2768 m^2 truall, të dy kufizimet për shkak të ndërtimeve pa leje.
* Nga auditimi bazuar në konfirmimet e ZVRPP Elbasan dhe sipas kartelave të çelura të pasurive dhe transaksioneve të regjistruara në to si lëshim certifikatash, dëshmi trashëgimie dhe kufizime për shkak të ndërtimeve pa leje, fakte të cilat përveç mangësive të ZVRPP, nuk janë mbajtur parasysh pra nuk është bërë llogaritja sipas PIII-LN dhe transaksioneve përkatëse që ka sjellë si pasojë që në ***Vendimin nr. 204, datë 31.03.2016 duhen të ishin zbritur edhe 1572 m^2 ullishtë*** përveç sa janë zbritur pasuria R4 me 8000 m^2 sipas AMTP dhe 2768 m^2 faktik sipas PIII-LN që rezulton nga bilanci pasurive, ku trajtohet e veçuar dhe grupuar toka ullishtë (20000 m^2 me 21572 m^2 pra +1572 m^2), si më poshtë:

	AMTP	PIII-LN	Dif	Kol		Në ZK.8526 Transaksione (Certif D trash, ndarje shitje dhurim
Pas R1, nr.1340/7, v.6, fq.23,	2000	2055 +	55	k1	U	c. 17.4.14
Pas R4, nr.1324/1, v.6, fq.21,	4000	6697 +	2697	k1	U	kuf 5.01.13, ndert palej
Pas R , nr.1346/1, v.6, fq.24,	-	1622 +	1622	k1	U	c. 17.4.14
Pas R, nr.1348/1, v.6, fq.25,	-	3030 +	3030	k1	U	c. 17.4.14
Pas R2, nr.1353/7, v.6, fq.26,	10000	2765 -	7235	k1	U	c. 17.4.14
Pas R, nr.1230/1, v.14, fq.78,	-	3096 +	3096	k1	U	c. 17.4.14
Pas R3, nr.1222/14, v.14, fq.65,	4000	2307 -	1693	k1	U	c. 17.4.14
Total (R1+R2+R3+R4)	20000	21572+1572			U	
Pas R4, nr. 1327/1, v. 6, fq.22,	8000	2768 -	5232	k2	TR	kuf 5.01.13, ndert pa leje

Shënim: Inicialet shprehin përkatësisht:"k" = kolona e AMTP-së, "R" =Reshti përkatës i AMTP, "U" = Ullishte.
Nisur nga faktet bazuar në konfirmimet e ZVRPP Elbasan në kartelat e çelura të pasurive dhe transaksioneve të regjistruara në to si lëshim certifikatash, dëshmi trashëgimie dhe kufizime për shkak të ndërtimeve pa leje, lidhur me AMTP nr. 130, datë - lidhur me mbajtës H. K. & B. Z. (trashëgimtar të A. H. K.) ndodhur në Elbasan (Zaranike) ZK.8526; fakte të cilat përveç mangësive të ZVRPP, nuk janë mbajtur parasysh nga KVVTP pra nuk është bërë llogaritja sipas PIII-LN dhe transaksioneve përkatëse që ka sjellë si pasojë që në ***Vendimin nr. 204, datë 31.03.2016 duhen zbritur edhe 1572 m^2 ullishtë*** përveç sa janë zbritur pasuria R4 me 8000 m^2

sipas AMTP dhe 2768 m^2 faktik sipas PIII-LN që rezulton nga bilanci pasurive, ku trajtohet e veçuar dhe grupuar toka ullishtë (20000 m^2 me 21572 m^2 pra +1572 m^2) mosveprime në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2"c.

Prandaj **KVVTP do te duhet të rishqyrtoje vendimin** ***nr. 204, datë 31.03.2016*** , (përveç sa janë zbritur pasuria R4 me 8000 m^2 sipas AMTP dhe 2768 m^2 faktik sipas PIII-LN), ***duke zbritur edhe 1572 m^2 ullishtë*** ndodhur në njërën nga pasuritë nr. 1230/1, v.14, fq.78, nr. 1222/14, v.14, fq.65, zk.8526 që i përkasin R3, të AMTP ose në pasurinë, nr.1324/1, v.6, fq.21 zk.8526 që i përket R4 të AMTP nr. 130, datë - lidhur me mbajtës H. K. & B. Z. (trashëgimtar të A. H. K.) të rezultuara nga bilanci pasurive, veçuar dhe grupuar toka ullishtë (20000 m^2 me 21572 m^2 pra +1572 m^2) duke shqyrtuar e marrë në konsideratë faktet si gjendjen juridike të Pasurive dhe transaksioneve sipas KPP-ve, bilancin e pasurive ullishtë sipas AMTP-PIII-LN, duke kërkuar informacion nga ALUIZNI, dega Elbasan për gjendjen e pasurive me ndërtime paleje si dhe duke kërkuar shfuqizimin e certifikatave lëshuar datë 17.4.2014.

Dosja është përpunuar nga z. E. S., me detyrë Drejtor, zj. A. K., z. R. T., znj. A. Sh. (Dylgjeri), z. A. T., anëtar dhe miratuar nga z. A. K., ish-Prefekt.

Gjetje nga auditimi: ***Në 3 vendime (përkatësisht nr. 4,7,9, sipas tabelës) të KVVTP, të cilat kanë marrë*** forme të prerë nga Gjykata, shfuqizimi të titujve të pronësisë është llogaritur zbritje më pak për - 4746 m^2 (2611 m^2+563 m^2+1572 m^2) (janë zbritur 3836 m^2 kundrejt 8582 m^2 që duheshin zbritur), nga moskonfirmimet e sakta të ZVRPP-ve dhe mos marrja parasysh e gjendjes juridike AMTP-LN-PIII), në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2"c", mos konfirmime dhe pasaktësi të shkaktuara nga ZVRPP Elbasan dhe Peqin**,** pasqyruar ne tabelën emërtuar "Vendime shfuqizimi të KVVTP në proces gjyqësor, sipas procedurës nenet 9, 10 të ligjit nr. 9948 periudhën 01.01.2013 deri më 30.09.2017", pasqyruar në tabelën "Sipërfaqet e pavlefshmërisë dhe zbritur më pak për Vendime e KVVTP Marre Forme të prerë nga Gjykata "

Rekomandim: KVVTP Prefekti i Qarkut Elbasan, të marrë masa për rishqyrtimin e 3 vendimeve ***marrë*** forme të prerë me vendime Gjykate, ku shfuqizimi të titujve të pronësisë është llogaritur zbritje më pak për - 4746 m^2 (2611 m^2+563 m^2+1572 m^2) si më poshtë :

1. Vendimin nr. 103, datë 24.07.2013 ku ***nuk ka përfshirë në zbritje për pavlefshmëri sipërfaqen tepër prej 2611 m^2(19305-15600 m^2 norma ligjore -300 m^2trualli shtëpisë- 794 m^2 tokë bujqësore) sipërfaqe tepër ligjit shpërndarë në pasuritë: pasuria nr. 141/1, v. 1, fq. 172 ullishtë 906 m^2 ZK. 2449, pasuria nr. 279/8, v.1, fq. 173 arë 400 m^2 , pasuria nr. 354/7, v. 1, fq175 arë 1305 m^2 ,***

2. **Vendimin** nr. 131,datë 30.09.2014, ku ***nuk ka përfshirë në zbritje për pavlefshmëri*** pra është zbritur me pak 563 m^2 (274-837) për shkak të përdorimit të normës përgjithshme në vend të normës fshatit si dhe të kërkojë Konfirmimin e gjendjes juridike të pasurive dhe PIII për K/Familjarin Sh. S. K. fshat Gjocaj, Komuna Gjocaj Peqin lidhur me AMTP nr. 20, datë 20.11.1999

3. **Vendimin** ***nr. 204, datë 31.03.2016*** , pasi nuk ka ***përfshirë në zbritje edhe 1572 m^2 ullishtë*** ndodhur në njërën nga pasuritë nr.1230/1, v.14, fq.78, nr.1222/14, v.14, fq.65, zk.8526 që i përkasin R3, të AMTP ose në pasurinë, nr.1324/1, v.6, fq.21 zk.8526 që i përket R4 të AMTP nr. 130, datë - në emër të H. K. & B. Z. (trashëgimtar të A. H. K.) duke shqyrtuar e marrë në konsideratë faktet si gjendjen juridike të Pasurive dhe transaksioneve sipas KPP-ve, bilancin e pasurive ullishtë sipas AMTP-PIII-LN, të kërkoj informacion nga ALUIZNI, dega Elbasan për

gjendjen e pasurive me ndërtime pa leje si dhe të kërkojë shfuqizimin e certifikatave lëshuar datë 17.4.2014, lëshuar nga ZVRPP Elbasan.

Për veprimet e mosveprimet si më sipër mbajnë përgjegjësi:
z. Sh. D., në cilësinë e nëpunësit autorizues, me detyre Ish-Prefekt i Qarkut, deri tetor 2013, në cilësinë e nëpunësve autorizues.
z. A. K., në cilësinë e nëpunësit autorizues, me detyre Ish-Prefekt i Qarkut, deri maj 2017, në cilësinë e nëpunësve autorizues.
z. I. Sh., me detyrë ish-Drejtor deri datë 19.5.2014 dhe ish-specialist deri 28.10.2014, në cilësinë e nëpunësve zbatues.
Zj. A. K., me detyrë anëtare deri 19.5.2014, ish-drejtore 20.5.2014-2810.2014, aktualisht anëtarë juriste, në cilësinë e nëpunësve zbatues.
z. E. S., me detyrë Drejtor prej 29.10.2014 e vazhdim, në cilësinë e nëpunësve zbatues.
znj.A. D. (Sh.) me detyrë anëtarë, jurist në cilësinë e nëpunësve zbatues.
z. R. T., me detyrë ish- anëtar, Topograf deri 15 Qershor 2016,aktualisht në pension, në cilësinë e nëpunësve zbatues.
z. A. T., me detyrë anëtar, agronom, në cilësinë e nëpunësve zbatues.
Për sa më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr. 4, datë 17.11.2017, si dhe Projekt Raporti për këtë çështje subjekti i audituar, përfaqësuar nga z. E. S. me detyrë Drejtor, znj. A. K., znj. A. D., z. A.T. dhe z. P. S. me detyrë anëtarë të KVVTP pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, me shkresë nr. 1299/22, datë 24.11.2017 dhe shkresë nr. 1299/34, datë 11.12.2017, të cilët kanë bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:
Gjetje nga auditimi: Në 7 vendime me sipërfaqen e zbritur 16201 dhe kthyer "shtet" nuk janë dërguar për njoftim dhe nuk janë marrë në dorëzim me proces verbal për vënien nën administrim të sipërfaqes kthyer "shtet" njësive të qeverisjes vendore.
Nuk jemi dakord me rekomandimin përkatës, sepse as në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" dhe as në VKM nr.1269, datë 17.09.2008 "Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" nuk parashikohet që Komisioni Vendor ka për detyrë që të dorëzojë me procesverbal njësive të qeverisjes vendore sipërfaqen e kthyer "shtet". Madje në VKM nr.1269, datë 17.09.2008 Kreu III, pika 4 parashikohet :
Për tokat e liruara, KV-ja harton procesverbalin përkatës i cili dorëzohet përgjegjësit të SAMT-së së qarkut përkatës.
Qëndrimet e auditusve.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se kanë karakter pohues dhe kundërshti, por që nuk pranohet pasi për tokat e liruara, KV-ja harton procesverbalin përkatës i cili dorëzohet përgjegjësit të SAMT-së së Qarkut përkatës..

Përgjegjësi i SAMT-së, pas marrjes së kopjes së procesverbalit kryen veprimet e dorëzimit të kësaj sipërfaqeje a) komunës dhe/ose bashkisë b) zyrës rajonale të AKKP.
Pra Komisioni Vendor ka për detyrë vetëm të përgatisë procesverbalin përkatës për tokat e kthyer shtet dhe tja përcjellë përgjegjësit të kadastrës. Më tej është detyrë e përgjegjësit të kadastrës që ta përcjellë këtë procesverbal pranë njësive të qeverisjes vendore dhe jo e KV-së.
Qëndrimet e auditusve.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se kanë karakter pohues, pra janë të pranuara prej tyre, duke marrë masat e nevojshme për zbatimin menjëherë dhe në vazhdimësi.

Gjetje nga auditimi: Në 3 vendime të KVVTP, të cilat kanë marrë formë të prerë nga Gjykata, shfuqizimi i titujve të pronësisë është llogaritur zbritje më pak -4746 nga mos konfirmimet e sakta

të ZRPP-ve dhe mos marrja parasysh e gjendjes juridike AMTP-LN-PIII) përkatësisht për vendimet nr. 103, nr. 131 dhe vendimi nr. 204 të KV-së.
Për sa i takon rekomandimit të lënë Komisioni Vendor do të marrë masat e nevojshme për zbatimin e tyre menjëherë e në vazhdimësi.
Qëndrimet e auditusve.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se kanë karakter pohues, pra janë të pranuara prej tyre, duke marrë masat e nevojshme për zbatimin menjëherë dhe në vazhdimësi.

Auditim mbi Vendimet për shfuqizim të pjesshëm të AMTP-ve, të marra nga KVVTP, dhe që janë në proces shqyrtimi (gjykimi nga Gjykatat dhe ecuria e procesit.
7.5 a2. KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan për periudhën 2013-30.92017 ka marrë ***18 vendime*** shfuqizimi të AMTP-ve të cilat ndodhen në proces shqyrtimi gjyqësor prej të cilave ***7 vendime*** shfuqizimi të titujve të pronësisë ***"truall", dhënë për zërin kadastral 'Tokë bujqësore",*** në sipërfaqen prej 14,782 m^2 me 12 pasuri të ndodhura 11 në fshatin Urakë, zonë jashtë Sistemi të regjistrimit fillestar dhe 1 pasuri tokë "PF" Elbasan, pra shfuqizime për veprime ne kundërshtim me nenin 2, 3, 4 të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" i ndryshuar. Gjithashtu ***4 vendime shfuqizimi, shfuqizuar për shkak të trajtimit me tokë bujqësore të ndodhur jashtë juridiksionit*** territorial të Komisionit të Ndarjes së Tokës, në sipërfaqen 8528 m^2 për 6 pasuri, prej tyre 5 pasuri ndodhur Fshati Urakë NJA Rrrajcë dhe 1 pasuri NJA Gjergjan, në kundërshtim me nenin 3,4 të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" i ndryshuar, për shfuqizim të AMTP-ve, pasqyruar ne tabelën emërtuar "Vendime shfuqizimi të KVVTP në proces gjyqësor, sipas procedurës nenet 9, 10 të ligjit nr. 9948 periudhën 01.01.2013 deri më 30.09.2017" , si vijon:
Vendime shfuqizimi të KVVTP në proces gjyqësor, sipas procedurës nenet 9, 10 ligjit nr. 9948 periudhën 01.01.2013 deri më 30.09.2017."

Nr.	Emri i përfituesit	Vendimi i KV		Faza	Data Kërkesë Padisë	Sip m^2	lekë
		Nr.	Date				
I	**Zk Truall për Tb**						
1	A. K.	133	27.11.2014	Rrezuar padia e KV nga Gjykata e Apelit Tiranë	27.11.14	6095	
2	I. T.	196	14.12.2015	Kthyer padia me te meta	21.12.15	1840	
3	A. T.	202	29.02.2016	Pranuar padia e KV, s'ka vendim	2.3.16	1720	
4	J. B.	216	28.02.2017	Ne proces	6.3.17	2180	
5	R. F.	220	19.04.2017	Ne proces,	25.4.17	792	
6	A. F.	222	31.07.2017	Ne proces, ska date te njoftuar	01.8.17	891	
7	H. H.	223	31.07.2017	Ne proces, ska date te njoftuar	01.8.17	1264	
II	**Jasht Komp Territ**	(+608)					
8	G. F.	210	31.10.2016	Ne proces	4.11.16	470	
9	R. B.	213	30.12.2016	Ne proces	30.12.16	1546	
10	B. T.	219	19.04.2017	Ne proces, ska date te njoftuar	25.4.17	4712	
11	H. Sh.	208	24.05.2016	Ne proces, ndrysh Gjyqtari	30.5.16	1800 +608	
III	**Për Normë/frymë**	(+1278+1428+ Juba fakte te reja)					
12	R. M.	71/1	18.02.2014	Rrezuar padia e KV nga Apeli Tr., ska vendim	21.2.14	2076	

13	S. R. J.	197	29.01.2016	Kthyer padia me te meta	5.2.16	6395	
14	S. L.	207	24.05.2016	Pranuar padia e KV, s'ka vendim	30.5.16	529 +1278	
15	Q. Q.	215	30.12.2016	Ne proces, ska date te njoftuar	30.12.16	1392 +1428	
IV.	**Themelues dhe ndrysh. z/kadastre**						
16	A. F.	157	04.05.2015	Kthyer padia me te meta 25.9.15 , KV pret DT	11.5.15	2490	6974837
17	Q. H.	119/1	30.10.2015	Kthyer padia me te meta, *KV pret DT nga datë 19.9.17*	3.11.15	8220	
18	P. E.	193	14.12.2015	Pranuar padia e KV, *Gjykata s'ka dërg. vendimin*	21.12.15	3037	253,731
	Shuma				-		7,228,568

I. Nga auditimi i dokumentacionit-dosjeve në lidhje me 18 Vendimet të KVVTP për shfuqizimi të AMTP-ve, të cilat ndodhen në proces shqyrtimi gjyqësor rezulton se ***11 vendime u gjetën të rregullta, përkatësisht:***

-7 vendime shfuqizimi të titujve të pronësisë (nr. 133, datë 27.11.14; nr. 196,datë 14.12.15 nr. 202, datë 29.02.16, nr. 216, datë 28.02.17, nr. 220, datë 19.4.17, nr. 223, datë 31.7.17, nr. 222, datë 31.7.17) janë marrë për shkakun ligjor se është dhënë titull pronësie ***"truall", jashtë objektit të Ligjit Nr. 7501 në vend të zërit kadastral 'Tokë bujqësore",*** në sipërfaqen prej ***14782 m²*** me 12 pasuri të ndodhura 11 në fshatin Urakë, zonë jashtë Sistemi të regjistrimit fillestar dhe 1 pasuri tokë "PF" Elbasan, pra shfuqizime të gjendura ne kundërshtim me nenin 2, 3, 4 të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" i ndryshuar, me pikën 1, VKM nr. 255, datë 2.8.1991 "Për Kriteret e Ndarjes së Tokës Bujqësore", me pikën 3, VKM nr. 230, datë 23.7.1991"Për Krijimin e Komisioneve të Tokave" dhe me UKM nr. 2, datë 2.8.1991 "Për Funksionimin e Komisioneve të Tokës në Rrethe e Fshatra".

-Gjithashtu 4 vendime shfuqizimi, (nr. 208, datë 24.5.2016, pjesërisht; nr. 210, datë 31.10.16, nr. 213, datë 30.12.16 dhe nr. 219, datë 19.4.17) janë marrë për shkak të trajtimit me tituj pronësie tokë bujqësore të ndodhur jashtë juridiksionit territorial të Komisionit të Ndarjes së Tokës, në sipërfaqen 8528 m² për 6 pasuri prej tyre 5 pasuri ndodhur Fshati Urakë NJA Rrajcë dhe 1 pasuri NJA Gjergjan, pra shfuqizime të AMTP-ve, të gjendura në kundërshtim me nenin 3, 4 të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" i ndryshuar, me pikën 1, VKM nr. 255, datë 2.8.1991 "Për Kriteret e Ndarjes së Tokës Bujqësore", me pikën 3, VKM nr. 230, datë 23.7.1991"Për Krijimin e Komisioneve të Tokave" dhe me UKM nr. 2, datë 2.8.1991 "Për Funksionimin e Komisioneve të Tokës në Rrethe e Fshatra", pasqyruar ne tabelën emërtuar" Vendime shfuqizimi të KVVTP në proces gjyqësor, sipas procedurës nenet 9, 10 të ligjit nr. 9948 periudhën 01.01.2013 deri më 30.09.2017".

II. Nga auditimi i dokumentacionit-dosjeve në lidhje me 18 dosje-Vendimet të KVVTP për shfuqizim të AMTP-ve, të cilat ndodhen në proces shqyrtimi gjyqësor në Gjykata, rezulton se ***7 vendime u gjetën me mangësi dhe parregullsi që lidhen me sipërfaqe të zbritura me pak në 3 raste për sipërfaqen 3314 m², me shkakun për konfirmime të parregullta të gjendjeve juridike fizike të pasurive konfirmuar nga ZVRPP, 1 rast me mosverifikim të plotë pas ndryshimit të emrit, 1 rast me konfirmime të pasakta të rrjedhura nga bashkëpronësia e paligjshme, si dhe 2 raste me mungesë përcaktimi për shlyerjen e detyrimit financiar,*** mos konfirmime në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet

Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2"c", mos konfirmime dhe pasaktësi të shkaktuara nga ZVRPP Elbasan, Peqin**,** pasqyruar ne tabelën emërtuar "Vendime shfuqizimi të KVVTP në proces gjyqësor, sipas procedurës nenet 9, 10 të ligjit nr. 9948 periudhën 01.01.2013 deri më 30.09.2017", ***përkatësisht:***
-Në 3 Vendime (përkatësisht nr. 11,14,15, sipas tabelës) shfuqizimi të titujve të pronësisë është llogaritur zbritje më pak për - 3314 m^2 (608 m^2+1278 m^2+1428 m^2) (janë zbritur 3721 m^2 kundrejt 7035 m^2 që duheshin zbritur), nga mos konfirmimet e sakta të ZVRPP-ve dhe mos marrja parasysh e gjendjes juridike AMTP-LN-PIII), kjo konkretisht në vendimet (nr. 208 datë 24.05.2016 për të cilin janë zbritur 1800 m^2 kundrejt 2408 m^2 pra më pak 608 m^2; në VKKP nr. 207, datë 24.5.2016 janë zbritur 529 m^2 kundrejt 1807 m^2 pra më pak 1278 m^2 dhe në VKKP nr. 215, datë 30.12.2016 ne proces janë zbritur 1392 m^2 kundrejt 2820 m^2 pra më pak 1428 m^2) ;
-Në 3 Vendime (përkatësisht nr. 12,13,17,sipas tabelës) ka pasaktësi të rrjedhura si pasojë e mos konfirmime të rregullta dhe të pasakta si VKKP nr. 197, datë 29.01.2016 të lidhura me konfirmime për Bashkëpronësi të paligjshme, VKKP nr. 119/1, datë 30.10.2015 lidhur me pasaktësi për mos konfirmim të plotë të pasurive pas ndryshimit të emrit të mbajtësit, si dhe VKKP nr. 71/1, datë 18.02.2014 për pasaktësi në konfirmim për ekzistencën ose jo të transaksioneve mbi gjendjen juridike te pasurive; për të dy grupet e vendimeve trajtuar analitikisht dosjet si më poshtë:
-Per dosjen (nr.11,sipas tabelës) H. Sh. Vendimi nr. 208 datë 24.05.2016 ne proces, ndryshuar Gjyqtari dërguar në Gjykatën Administrative Durrës me datë 30.5.16, sipas të cilit kërkuar shfuqizimi në sipërfaqen tepër ***prej 1800 m^2,*** konstatojmë:
ZVRPP Elbasan në kërkesën për verifikim të titullit të pronësisë me shkresën nr. 3587, datë 4.11.2015 dhe konfirmimi me shkresën 4560/1, datë 30,12.2015 nuk ka konfirmuar të plotë e saktë gjendjen juridike, dhe as transaksionet as pajisur ose jo me certifikatë për secilën prej 6 pasurive me sipërfaqe totale prej 11880 m^2 të AMTP nr. 192, datë 20.01.1992 në emër të H.Sh. dhe konkretisht:
-Nuk jep informacion për gjendjen juridike, ekzistencën dhe orientimin e përfshirjes dhe vendndodhjes, të pasurisë nr. kadastral 280 me emër "Rrahi..." e llojit arë me sipërfaqe 1800 m^2 ndodhur sipër rreshtit I-rë të AMTP nr.192, datë 20.01.1992,
-Nuk jep informacion (megjithëse ZVRPP është Kërkuesi), lidhur me gjendjen juridike, lëshim apo jo të certifikatave, apo transaksionet lidhur me 5 pasuritë me sipërfaqe prej 9480 m^2 sipas AMTP dhe 10088 m^2 sipas LN –PIII(shprehur në shkresën 4560/1, datë 30,12.2015, bashkëlidhur PIII)***, pra tepër +608 m^2;*** mos konfirmime në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2"c", mos konfirmime dhe pasaktësi të shkaktuara nga ZVRPP Elbasan që kanë sjellë si pasojë që KVVTP Prefekti Qarkut në Vendimin nr. 208, datë 24.05.2016, ka kërkuar shfuqizimin e pasurisë ***nr.kadastral 280 me emër "Rrahi..." e llojit arë me sipërfaqe 1800 m^2 ndodhur sipër rreshtit I-rë të AMTP nr.192, datë 20.01.1992*** por nuk ka identifikuar sipërfaqen sipas LN, dhe poseduesin e saj (përfshirjen ne cilën AMTP poseduesin); si dhe ***nuk ka përfshirë në Vendimin nr. 208, datë 24.05.2016, shfuqizimin e sipërfaqes tepër prej +608 m^2 që u përket 5 pasuritë me sipërfaqe prej 9480 m^2 sipas AMTP dhe 10088 m^2 sipas LN –PIII, ;*** *sipërfaqe kjo e ndodhur në pasurinë nr. 86/101, v.4, f.166 zk.1732 (550 m^2) dhe në pasurinë nr.37/9, v.4.f.165 zk.1732 (58 m^2).* **Për të cilat KVVTP do të duhet të rishqyrtojë vendimin nr. 208 datë 24.05.2016, për zbritjen të *608* m^2.**
Dosja është përpunuar nga z. E. S., me detyrë Drejtor, zj. A. K., z. R. T., znj. A. Sh.(D.), z. A.T., anëtar dhe miratuar nga z. A. K, ish-Prefekt; si dhe është ndjekur procesi gjyqësor nga znj. A. Sh.

Gjetje nga auditimi: KVVTP Prefekti Qarkut në Vendimin nr. 208, datë 24.05.2016, ka kërkuar shfuqizimin e pasurisë ***nr.kadastral 280 me emër "Rrahi..." e llojit arë me sipërfaqe 1800 m^2***

ndodhur sipër rreshtit I-rë të AMTP nr.192, datë 20.01.1992 në emër të H. Sh., por nuk ka identifikuar sipërfaqen sipas LN, dhe poseduesin e saj (përfshirjen ne cilën AMTP dhe emrin e poseduesit); si dhe ***nuk ka përfshire në këtë vendim shfuqizimin e sipërfaqes tepër prej +608 m^2 që u përket 5 pasurive me sipërfaqe prej 9480 m^2 sipas AMTP dhe 10088 m^2 sipas LN –PIII, ; sipërfaqe kjo e ndodhur në pasurinë nr.86/101, v.4, f.166 zk.1732 (550 m^2) dhe në pasurinë nr.37/9, v.4.f.165 zk.1732 (58 m^2),*** që kanë ardhur si pasojë e mos konfirmimit të saktë nga ZVRPP Elbasan, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2 "c"

Rekomandim: KVVTP Prefekti Qarkut **të marrë masa të rishqyrtojë Vendimin nr.** 208, datë 24.05.2016, i ndodhur në proces gjyqësorë, ku të ***përfshijë në zbritje për pavlefshmëri sipërfaqen tepër prej +608 m^2 që u përket 5 pasurive me sipërfaqe prej 9480 m^2 sipas AMTP dhe 10088 m^2 sipas LN –PIII, ; sipërfaqe kjo e ndodhur në pasurinë nr.86/101, v.4, f.166 zk.1732 (550 m^2) dhe në pasurinë nr.37/9, v.4.f.165 zk.1732 (58 m^2)***

-Per dosjen (nr.12,sipas tabelës) R. B. M., Vendimi nr. 71/1, datë 18.02.2014 ne proces, mbështetur dhe në shqyrtimin e Sekretariatit KQT me shkresën nr. 3238/5, datë 4.10.2011, sipas të cilit është kërkuar shfuqizim i pjesshëm ne sipërfaqen 2076 m^2 i AMTP nr.60, datë 30.8.1994, fshati Bradashesh, NJA Bradashesh, Bashkia Elbasan, rrëzuar padia datë 21.2.14 e KVVTP nga Gjykatën Administrative Durrës me vendim nr.497, datë 28.4.2014, ankimuar nga KVVTP me shkresën nr.33/79, datë 12.5.14 dhe rrëzuar nga Gjykata Administrative Apelit (GJAA) Tiranë (sipas publikimit në Fzyrtare, pasi zyrtarisht vendimi nuk është njoftuar në KVVTP), konstatojmë:

a. ZVRPP Elbasan në konfirmimin me shkresën nr. 640, datë 15.4.2011, nuk ka konfirmuar të plotë e saktë gjendjen juridike të pasurive pasi nuk ka informuar nëse ka lëshuar certifikata apo kryer transaksione mbi pasuritë objekt shqyrtimi të AMTP nr.60, datë 30.8.1994 për secilën prej 3 pasurive me sipërfaqe totale prej 9450 m^2 sipas AMTP-së dhe 9303 m^2 , sipas PIII-LN çelur KPP në emër të R. B. M., mos konfirmime në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2"c",

b. Mungesa e Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit (GJAA) Tiranë, i cili ka rrëzuar Vendimi nr. 71/1, datë 18.02.2014 (sipas publikimit në Faqen zyrtare, pasi zyrtarisht vendimi nuk është njoftuar në KVVTP), sjell pamundësinë për vlerësimin dhe dhënien e një opinioni në lidhje me këtë vendim nga auditimi i KLSH.

Dosja është përpunuar nga z. I. Sh., me detyrë ish-Drejtor, zj. A. K., z. R. T., znj. A. Sh., z. A. T., anëtar dhe miratuar nga z. A. K., ish-Prefekt; si dhe është ndjekur procesi gjyqësor nga I. Sh.,

Gjetje nga auditimi: KVVTP Prefekti i Qarkut Elbasan ka marrë Vendimi nr. 71/1, datë 18.02.2014 në proces akimimi në gjykatë lidhur me AMTP nr. 60, datë 30.8.1994 në mungesë të konfirmimit të saktë nga ZVRPP Elbasan të gjendjes juridike për secilën prej 3 pasurive me sipërfaqe totale prej 9450 m^2 sipas AMTP-së dhe 9303 m^2, sipas PIII-LN çelur KPP në emër të R. B. M., mos konfirmime në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2"c". Për këtë fakt si dhe për mungesën fizike në dosje të Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit (GJAA) Tiranë, i cili ka rrëzuar Vendimi nr. 71/1, datë 18.02.2014 nuk mund të shprehim opinion.

Rekomandim: KVVTP Prefekti i Qarkut Elbasan të marrë masa që në çdo rast të kërkojë me shkrim pranë gjykatave dhe pranë Ministrisë së Drejtësisë apo KLD-së dërgimin zyrtar të

vendimeve të gjykatave Administrative, Apelit, me synim shpejtimin e procesit të verifikimit të titujve të pronësisë dhe shmangien e pengesave të rrjedhura nga mos dërgimi i Vendimeve të gjykatave.

-Per dosjen (nr.13, sipas tabelës) S. R. J., fshati Rrozej, NjA Karinë Peqin, Vendimi nr. 197, datë 29.01.2016 ne proces, dërguar kërkesë padia në Gjykatën Administrative Durrës me datë 5.2.16, kthyer për të meta e plotësim, vendim i marrë pas shqyrtimit të kërkesës (datë 20.3.2015 së një Individi për verifikimin e AMTP nr. 16, datë 10.2.1992, sipas të cilit KVVTP ka kërkuar shfuqizim në sipërfaqen tepër prej 6395 m^2, konstatojmë:
ZVRPP Peqin me shkresën nr. 2777, datë 08.5.2015 ka konfirmuar në mënyrë të parregullt e të pasaktë lidhur me mos identifikimin e gjendjes juridike të pasurisë ullishtë rreshti 5 AMTP nr. 16, datë 10.2.1992 e cila ndodhet e regjistruar ***ne bashkëpronësi*** dhe nuk identifikon gjendjen fizike juridike e nuk është pasqyruar në PIII e nuk është çelur KPP e pasurisë Reshti I–rë për 7000 m^2 arë të AMTP nr.16, datë 10.2.1992, në emër të S. R. J., mos konfirmime në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2"c", mos konfirmime dhe pasaktësi të shkaktuara nga ZVRPP Peqin që kanë sjellë si pasojë pasaktësi në Vendimin nr. 197, datë 29.01.2016, KVVTP Prefekti Qarkut në të cilin ka kërkuar shfuqizimin e sipërfaqes 6395 m^2, dhe konkretisht:
a. Konfirmimi lidhur me gjendjen juridike fizike të pasurisë nr. 117, v.1, f.137, ZK 3238 fshati Rrozej Peqin e llojit Ullishtë, me sipërfaqe 2520 m^2 R_5 i AMTP –së sipas LN –PIII me 40138 m^2 është i pasaktë, pasi kjo pasuri përfshirë në PIII për K/Familjarin nr.30 S. R. J., nuk i përket vetëm këtij K/F,sepse rezulton e regjistruar në bashkëpronësi të jashtëligjshme, me 20 bashkëpronar, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", pasi për këto pasuri duhej të ishin çelur KPP të veçanta individuale, individualisht të përcaktuara dhe në përputhje me pjesët takuese të secilës prej 20 AMTP-ve përkatësisht: (AMTP nr.1, 2, 3, 5, 6, 7, 9, 10, 15, 16, 19, 20, 21, 25, 26, 27, 30, 31, 33, 34).Kjo gjendje evidentimi e identifikimi mbajtur nga ZVRPP Peqin ka sjellë ndër të tjera edhe pamundësinë e përcaktimit të sipërfaqes takuese në terren sipas LN- PIII të pasurisë sipas R 5 të AMTP nr. 16, datë 10.2.1992 e llojit ullishte (2520 m^2 sipas AMTP ndërsa LN-?), në kundërshtim me ligjin nr. 33, datë 21.3.2012 "Për Regjistrim in e PPL" dhe rregulloren nr. 184, datë 18.4.1998 "Për Punën ne Zyrat e Regjistrimit të PPL", kapitulli "Çelja dhe mbajtja e KPP-ve".
ZVRPP por edhe KVVTP duhej të kish kërkuar rishqyrtimin e Menaxhimit, ndarjen e çeljen e 20 KPP-ve individuale të përfshira dhe çelur në bashkëpronësi të jashtëligjshme në KPP nr. 117 v.1, f.137, ZK3238 Rrozej, Peqin me sipërfaqe 40138 m^2 e llojit Ullishtë, në kundërshtim me ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", me ligjin nr. 33, datë 21.3.2012 "Për Regjistrim in e PPL" dhe rregulloren nr.184, datë 18.4.1998 "Për Punën ne Zyrat e Regjistrimit të PPL", kapitulli "Çelja dhe mbajtja e KPP-ve".
b. ZVRPP Peqin nuk shprehet ne konfirmimin nr. 2777, datë 08.5.2015, dhe nuk e pasqyron as në PIII dhe as ka çelur KPP përkatëse, për identifikimin e gjendjes juridike –fizike të pasurisë Rreshti I-rë i AMTP nr. 16, datë 10.2.1992 e llojit arë me nr. Kadastral 153, me emer popullor "Lëmi i madh" me sipërfaqe 7000 m^2
Pra është i nevojshëm që KVVTP, përveç sipërfaqes zbritur, të rishqyrtojë nr. 197, datë 29.01.2016 duke marrë në konsideratë edhe 2 faktet përshkruar analitikisht sipër në pikat a,b, konkretisht bashkëpronësinë e jashtëligjshme me 20 BP në ***nr. 117 v.1, f. 137,ZK3238 Rrozej, Peqin me sipërfaqe 40138 m^2 e llojit Ullishtë, në kundërshtim me ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", me ligjin nr. 33, datë 21.3.2012 "Për Regjistrimin e PPL", me synim identifikimin e pjesës që i përket R5, të AMTP nr. 16, datë 10.2.1992, në emër të*** Sami Riza Juba, si dhe

identifikimin e gjendjes juridike–fizike të pasurisë Rreshti I-rë i AMTP nr. 16, datë 10.2.1992 e llojit arë me nr. kadastral 153, me emër popullor "Lëmi i madh", me sipërf 7000 m^2.
Dosja është përpunuar nga z. E. S., me detyrë Drejtor, zj. A. K., z. R. T., znj. A. Sh., z. A. T., anëtar dhe miratuar nga z. A. K., ish-Prefekt; si dhe është ndjekur procesi gjyqësor nga znj. A. Sh.
Gjetje nga auditimi: KVVTP Prefekti i Qarkut Elbasan ka marrë Vendimi nr. 197, datë 29.01.2016 në proces akimimi në gjykatë dhe kthyer nga gjykata administrative Durrës për të meta e plotësim lidhur me AMTP nr.16, datë 10.2.1992, sipas të cilit KVVTP ka kërkuar shfuqizim në sipërfaqen tepër prej 6395 m^2. Në kthimin për plotësim të këtij vendimi nga gjykata, auditimi konstaton konfirmime të pasakta nga ZVRPP Peqin që lidhen me bashkëpronësinë e jashtëligjshme me 20 BP në ***nr. 117 v.1, f. 137,ZK3238 Rrozej, Peqin me sipërfaqe 40138 m^2 e llojit Ullishtë, në kundërshtim me ligjin nr.7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", me ligjin nr. 33, datë 21.3.2012 "Për Regjistrimin e PPL", me synim identifikimin e pjesës që i përket R5, të AMTP nr. 16, datë 10.2.1992, në emër të*** Sami Riza Juba, si dhe identifikimin e gjendjes juridike–fizike të pasurisë Rreshti I-rë i AMTP nr. 16, datë 10.2.1992 e llojit arë me nr. Kadastral 153, me emër popullor "Lëmi i madh", me sipërfaqe 7000 m^2.
Rekomandim: KVVTP të marrë masa për rishqyrtimin e Vendimi nr. 197, datë 29.01.2016 ndodhur në proces akimimi në gjykatë, rishqyrtim i cili të mbështetet në marrjen në konsideratë dhe kërkimin nda ZVRPP Peqin duke i kërkuar rishqyrtimin dhe Menaxhimin, ndarjen e çeljen e 20 KPP-ve individuale të përfshira dhe çelur në bashkëpronësi të jashtëligjshme në KPP nr. 117 v.1, f.137, ZK3238 Rrozej, Peqin me sipërfaqe 40138 m^2 e llojit Ullishtë, si dhe të përcaktojë gjendjen juridike takuese të sipërfaqes ullishtë që i përket R5, të AMTP nr. 16, datë 10.2.1992, në emër të Sami Riza Juba.

Per dosjen (nr.14,sipas tabelës) S. S. L., fshati Gjergjan NJA Gjergjan Bashkia Elbasan Vendimi nr. 207, datë 24.5.2016 ne proces, dërguar në Gjykatën Administrative Durrës me datë 30.05.16, (për te cilën përfunduar gjykimi pritet vendimi), sipas të cilit kërkuar shfuqizimi në sipërfaqen ***tepër prej 529 m^2***, konstatojmë:
ZVRPP Elbasan në kërkesën për verifikim të titullit të pronësisë me shkresën nr. 3566, datë 04.11.2015 (ku kërkon verifikimin AMTP nr. 93, datë 20.01.92 për shkak të sipërfaqes mbi norme per frymë) dhe konfirmimi me shkresën 4263/1, datë 16.12.2015 nuk ka konfirmuar të plotë e saktë gjendjen juridike dhe as transaksionet as të dhëna pajisur ose jo me certifikatë për secilën prej 5 pasurive nga 6 gjithsejtë me sipërfaqe totale prej 14490 m^2 (14 790 -300 tr.) të AMTP nr. 93, datë 20.01.92 në emër të Selman Selman Lamçja dhe konkretisht:
-Nuk jep informacion (megjithëse ZVRPP Elbasan është Kërkuesi), lidhur me gjendjen juridike, lëshim apo jo të certifikatave, apo transaksionet lidhur me 6 pasuritë me sipërfaqe prej 14790 ***m^2 sipas AMTP dhe 16365 m^2 sipas LN –PIII (shprehur në*** shkresën 4263/1, datë 16.12.2015, bashkëlidhur PIII për k/F me nr. 207 dhe nr. 208)**,** mos konfirmime në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2"c", mos konfirmime dhe pasaktësi të shkaktuara nga ZVRPP Elbasan që kanë sjellë si pasojë që KVVTP Prefekti Qarkut në Vendimin nr. 207, datë 24.5.2016, ka kërkuar shfuqizimin e sipërfaqes prej 529 m^2, (nga 1807 m^2 në fakt, pra më pak 1278 m^2), bazuar ne normën për fryme llogaritur: 2023 m^2 x 7 fryme =14161 m^2.
Bazuar në Printim III, normën për frymë, duke zbritur dhe truallin 300 m^2, sipërfaqja tepër prej 1807 m^2 rezulton e llogaritur 16365 m^2 PIII- 97 m^2 "shtet" -300 trualli -14161 m^2 sipas normës = 1807 m^2 sipërfaqja tepër – 529 m^2 zbritja e KVVTP = -1278 m^2 sipërfaqe zbritur me pak me Vendimin nr. 207, datë 24.5.2016. si dhe e ndodhur ne pasurit nr. 115/1, v.2 ,f. 99, ZK. 1732 fshatin Gjergjan në pasurinë nr. 86/66,v. 2, f. 69 ZK. 1732 fshatin Gjergjan, nr. 54/56 v.3, f.82 ZK.1732 fshatin Gjergjan dhe ne nr.15/3, v.2, f.158 ZK. 1732 fshatin Gjergjan .**Për të cilat**

KVVTP do te duhet të rishqyrtoje Vendimin nr. 207, datë 24.5.2016 për zbritjen edhe të sipërfaqes prej 1278 m^2.
Dosja është përpunuar nga z. E. S., me detyrë Drejtor, zj. A. K., z. R. T., znj. A. Sh., z. A. T., anëtar dhe miratuar nga z. A. K., ish-Prefekt; si dhe është ndjekur procesi gjyqësor nga znj. A. Sh.

Gjetje nga auditimi: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan në Vendimin nr. 207, datë 24.5.2016 ne proces, dërguar në Gjykatën Administrative Durrës me datë 30.05.16, (për te cilën përfunduar gjykimi pritet vendimi), sipas të cilit kërkuar shfuqizimi në sipërfaqen ***tepër prej 529 m^2***, lidhur me AMTP nr. 93, datë 20.01.92 emër të S. S. L. për shkak të sipërfaqes mbi normë për frymë. Zbritja prej 529 m^2 nuk është e saktë pasi duhej të zbriste edhe 1278 m^2, kjo për shkak të mos konfirmimit të saktë nga ZVRPP Elbasan në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e kërkojnë individë apo institucione", i ndryshuar, pika 2"c"; llogaritur si më poshtë: (1807 m^2 në fakt, pra më pak 1278 m^2), bazuar ne normën për fryme llogaritur 2023 m^2 x 7 fryme =14161 m^2.
Rekomandim: KVVTP Prefekti Qarkut të marrë masa të rishqyrtojë Vendimin nr. 207, datë 24.5.2016, i ndodhur në proces gjyqësorë, ku të përfshijë në zbritje për pavlefshmëri edhe sipërfaqen tepër prej -1278 m^2 sipërfaqe zbritur me pak me Vendimin nr. 207, datë 24.5.2016 si dhe e ndodhur ne pasurit nr. 115/1, v.2 ,f. 99, ZK. 1732 fshatin Gjergjan në pasurinë nr. 86/66,v. 2, f. 69 ZK. 1732 fshatin Gjergjan, nr. 54/56 v.3, f.82 ZK.1732 fshatin Gjergjan dhe ne nr.15/3, v.2, f.158 ZK. 1732 fshatin Gjergjan.

Për dosjen (nr.15,sipas tabelës) Q. Q., fshati Rrenas, NJA Grekan Bashkia Belsh Vendimi nr. 215, datë 30.12.2016 ne proces, dërguar në Gjykatën Administrative Durrës me datë 30.12.16, sipas të cilit kërkuar shfuqizimi në sipërfaqen tepër prej 1392 m^2, konstatojmë:
ZVRPP Elbasan në kërkesën për verifikim të titullit të pronësisë me shkresën nr. 682, datë 10.3.2016 (ku kërkon verifikimin për shkak të ndryshimit të Zërit Kadastral) dhe konfirmimi me shkresën 760/1, datë 31.3.2016 nuk ka konfirmuar të plotë e saktë gjendjen juridike, dhe as transaksionet as të dhëna pajisur ose jo me certifikatë për secilën prej 6 pasurive me sipërfaqe totale prej 17 660 m^2 (17910-250 tr.) të AMTP nr. 40, datë 25.02.1992 në emër të Q. Q. dhe konkretisht:
- ZVRPP Elbasan nuk jep informacion (megjithëse është Kërkuesi), lidhur me gjendjen juridike, lëshim apo jo të certifikatave, apo transaksionet lidhur me 6 pasuritë me sipërfaqe prej 17 660 ***m^2 sipas AMTP dhe 19 398 m^2 sipas LN –PIII (shprehur në*** shkresën 760/1, datë 31.3.2016, bashkëlidhur PIII)**,** mos konfirmime në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2"c", mos konfirmime dhe pasaktësi të shkaktuara nga ZVRPP Elbasan që kanë sjellë si pasojë që KVVTP Prefekti Qarkut në Vendimin nr. 215, datë 30.12.2016, ka kërkuar shfuqizimin e sipërfaqes prej 1392 m^2, (nga 2820 m^2 në fakt, pra më pak 1428 m^2), bazuar ne normën për fryme llogaritur: 3615X4,5 frymë =16268 m^2 sipërfaqe takuese sipas normës e ligjit, ndërsa sipërfaqe tepër 17660-16268=1392 m^2.
Bazuar në Printim III, normën për frymë, duke zbritur dhe truallin 250 m^2, sipërfaqja tepër prej 1428 m^2 rezulton e llogaritur 19088 m^2 PIII- 16268 m^2 sipas normës = 2820 m^2 sipërfaqja tepër – 1392 m^2 zbritja e KVVTP = -1428 m^2 sipërfaqe zbritur me pak me Vendimin nr. 215, datë 30.12.2016. si dhe e ndodhur ne pasurit nr.114/4, v.1,f.232, ZK.3223 Grekan dhe në pasurinë nr.66/1,v.1,f.229 ZK.3223 Grekan. **Për të cilat KVVTP do te duhet të rishqyrtoje Vendimin nr. 215, datë 30.12.2016, për zbritjen edhe 1428 m^2.**
Dosja është përpunuar nga z. E. S., me detyrë Drejtor, zj. A. K., z. R. T., znj. A. Sh., z. A. T., anëtar dhe miratuar nga z. A. K., ish-Prefekt; si dhe është ndjekur procesi gjyqësor nga znj. A. Sh.

Gjetje nga auditimi: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan në Vendimin nr. 215, datë 30.12.2016 dërguar në Gjykatën Administrative Durrës me datë 30.12.16, sipas të cilit ka kërkuar shfuqizimi në sipërfaqen tepër prej 1392 m^2 lidhur me AMTP nr. 40, datë 25.02.1992 në emër të Q. Q. fshati Rrenas, NJA Grekan Bashkia Belsh. Zbritja prej 1392 m^2 nuk është e saktë pasi duhej të zbriste edhe 1428 m^2, kjo për shkak të përdorimit të normës së pasaktë për frymë si dhe për shkak të mos konfirmimit të saktë nga ZVRPP Elbasan në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2"c".
Rekomandim: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan të marrë masa të rishqyrtojë Vendimin nr. 215, datë 30.12.2016, duke u bazuar në Printim III, normën për frymë, duke zbritur dhe truallin 250 m^2, sipërfaqja tepër prej 1428 m^2 rezulton e llogaritur 19088 m^2 PIII- 16268 m^2 sipas normës = 2820 m^2 sipërfaqja tepër – 1392 m^2 zbritja e KVVTP = -1428 m^2 sipërfaqe zbritur me pak, ndodhur në pasuritë nr.114/4, v.1,f.232, ZK.3223 Grekan dhe në pasurinë nr.66/1,v.1,f.229 ZK.3223 Grekan.

-Per dosjen (nr.16, sipas tabelës) A. H. F., trajtuar me tokë si themelues ish NB Elbasan Sektori Dautbej (Tek Rrema), Bashkia Elbasan, Vendimi nr. 157, datë 04.05.2015 ne proces, dërguar kërkesë padia në Gjykatën Administrative Durrës me datë 11.5.15, kthyer për të meta e plotësim, vendim i marrë pas shqyrtimit të kërkesës (datë 13.01.2014 së një Individi për verifikimin e AMTP nr. 94, pa datë), sipas të cilit KVVTP ka kërkuar shfuqizim të plotë të AMTP nr. 94, në sipërfaqen tepër ***prej 4200 m^2, nga e cila 2491 m^2 kthim"Shtet" dhe për sipërfaqen prej 1709 m^2 të tjetërsuar detyrimin e pagesës së vlerës prej*** 6,974,837 ***lekë llogaritur me çmimin e hartës vlerës pronës të AKKP sipas VKM nr 187, datë 6.3.2013"Për miratimin e vlerës së pronës për secilin Qark të Republikës së Shqipërisë"; bazuar në nenin 9, pika 3 të*** ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" i ndryshuar, dhe ***pika 4*** ku shprehet: .." *Mënyra dhe afatet e shlyerjes së detyrimit për vlerën e tokës përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave*..", konstatojmë:
Megjithëse Vendimi nr. 157, datë 04.05.2015 i KVVTP është i drejte dhe i bazuar në ligj e prova, por për ekzekutimin e pikën 3 të këtij vendimi që lidhet me pjesën e pagesës së detyrimit financiar në ***vlerën prej*** 6,974,837 ***lekë për sipërfaqen prej 1709 m^2 të tjetërsuar nuk përcaktohet institucioni llogaria dhe mënyra e derdhjes, gjë që sjell pamundësinë e ekzekutimit të Vendimit dhe të derdhjes së detyrimit financiar të mësipërm.***

Në 2 Dosje-Vendime me detyrim financiar likuidim toke teper.
-Per dosjen (nr.17, sipas tabelës) Q. H. F., trajtuar me tokë si themelues ish NB Elbasan Sektori Belerbej, Bashkia Elbasan, Vendimi nr. 119/1, datë 30.10.2015 ne proces, dërguar kërkesë padia në Gjykatën Administrative Durrës me datë 3.11.15, kthyer për të meta e plotësim, vendim i marrë pas shqyrtimit të kërkesës (datë 24.2.2014 së një Individi për verifikimin e AMTP nr.54, pa datë), sipas të cilit KVVTP ka kërkuar shfuqizim në sipërfaqen tepër ***prej 8220 m^2,*** për shkak të mungesës dokumentit provë të qenit themelues, konstatojmë:
Mbështetur në konfirmimin e ZVRPP Elbasan me shkresën nr.285/1, datë 24.3.2015, e cila nuk jep informacion të plotë por dhe as sigurinë për, saktësi të informacionit; si dhe në faktin tjetër sipas të cilit me Vendim Gjykate nr. 323, datë 12.3.2002 z. **O. H. F.** (mbajtës i AMTP nr.54, pa date), ka ndryshuar emrin dhe mban emrin **Q. H. F.; pra mbështetur në këto dy fakte hetimi administrativ i KVVTP nuk është i plotë pasi:**
Nga KVVTP duhej kërkuar, përveç *informacionit të plotë dhe sigurisë për të, edhe konfirmimi nëse ka ndonjë AMTP tjetër në emrin (e ndryshuar) të* ***Q. H. F.;*** *kjo në ZVRPP Elbasan dhe në DAMT të K.Q.Elbasan (formulari nr. 6).*

Dosja është përpunuar nga z. E. S., me detyrë Drejtor, zj. A. K., z. R. T., znj. A. Sh., z. A. T., anëtar dhe miratuar nga z. A. K., ish-Prefekt; si dhe është ndjekur procesi gjyqësor nga znj. A. Sh.

Gjetje nga auditimi :KVVTP Prefekti Elbasan ka marrë Vendimi nr. 119/1, datë 30.10.2015 ne proces, dërguar kërkesë padia në Gjykatën Administrative Durrës me datë 3.11.15, kthyer për të meta e plotësim, vendim i marrë pas shqyrtimit të kërkesës (datë 24.2.2014 së një Individi për verifikimin e AMTP nr.54, pa datë), sipas të cilit KVVTP ka kërkuar shfuqizim në sipërfaqen tepër ***prej 8220 m^2,*** për shkak të mungesës dokumentit provë të qenit themelues. Ky vendim është marrë me mangësi të procesit të hetimit administrativ, së pari konfirmimi i ZVRPPP Elbasan është i pa plotë dhe së dyti mbështetur në faktin që me Vendim Gjykate nr. 323, datë 12.3.2002 z. **O. H. F.** (mbajtës i AMTP nr.54, pa date), ka ndryshuar emrin dhe mban emrin **Q. H. F.**, pra duke mos kërkuar *edhe konfirmimin nëse ka ndonjë AMTP tjetër në emrin (e ndryshuar) të **Q. H.F.;** kjo në ZVRPP Elbasan dhe në DAMT të K.Q.Elbasan (formulari nr. 6).*
Rekomandim: *KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan të marr masa të rishqyrtojë Vendimi nr. 119/1, datë 30.10.2015, duke plotësuar hetimin administrativ dhe **kërkuar, përveç** informacionit të plotë dhe sigurisë për të, edhe konfirmimi nëse ka ndonjë AMTP tjetër në emrin (e ndryshuar) të **Q. H. F.;** kjo në ZVRPP Elbasan dhe në DAMT të K.Q.Elbasan (formulari nr. 6).*
-Per dosjen (nr.18, sipas tabelës) P. S. E., trajtuar me tokë si ish anëtar i KB Shelcan NJA Shushicë, Bashkia Elbasan, Vendimi nr. 193, datë 14.12.2015 ne proces, dërguar kërkesë padia në Gjykatën Administrative Durrës me datë 21.12.15, përfunduar procesi fundor në gjykatë (vendimi i pazbardhur); vendim i marrë pas shqyrtimit të kërkesës nr. 3224, datë 12.9.14 të ZVRPP Elbasan për verifikimin e AMTP nr. 189,datë 30.4.1993 sipas të cilit KVVTP ka kërkuar pavlefshmëri të pjesshme të AMTP nr. 189,datë 30.4.1993, në sipërfaqen tepër ***prej 3037m^2, të tjetërsuar për të cilën detyrohet të paguaj vlerën prej*** 253,731 ***lekë llogaritur me çmimin e hartës vlerës pronës të AKKP sipas VKM nr. 514, date 30.7.2014 "Për miratimin e vlerës së pronës për secilin Qark të Republikës së Shqipërisë"; bazuar në nenin 9, pika 3 të*** ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" i ndryshuar dhe ***pika 4*** ku shprehet: .." *Mënyra dhe afatet e shlyerjes së detyrimit për vlerën e tokës përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave*..", konstatojmë:
Megjithëse Vendimi nr. 193, datë 14.12.2015 i KVVTP është i drejte dhe i bazuar në ligj e prova, por për ekzekutimin e pikën 2 të këtij vendimi që lidhet me pjesën e pagesës së detyrimit financiar në ***vlerën prej*** 253,731 ***lekë për sipërfaqen prej 3037 m^2 të tjetërsuar nuk përcaktohet institucioni llogaria dhe mënyra e derdhjes, gjë që sjell pamundësinë e ekzekutimit të Vendimit dhe të derdhjes së detyrimit financiar të mësipërm.***
Dosja është përpunuar nga z. E. S., me detyrë Drejtor, zj. A. K., z. R. T., znj. A. Sh., z. A. T., anëtar dhe miratuar nga z. A. K., ish-Prefekt; si dhe është ndjekur procesi gjyqësor nga znj. A. Sh.

Si konkluzion** për 2 Vendimet (*nr. 157, datë 04.05.2015 dhe Vendimi nr. 193, datë 14.12.2015 ***më sipër të KVVPP ekzekutimin e arkëtimit të detyrimit financiar në vlerën 7,228,568 lekë për sipërfaqen e tjetërsuar 4746 m^2 (1709 m^2 me vlerën 6,974,837 ***lekë që i përket Vendimit nr. 157, datë*** 04.05.2015; dhe ***3037 m^2 vlerën prej*** 253,731 ***lekë që i përket*** Vendimit nr. 193, datë 14.12.2015), pasi të përfundojë procesi në gjykatë i shprehur me vendimet përkatëse, KVVTP Elbasan të veprojë për arkëtimin e detyrimit financiar pra të VGJ dhe VKKP duke ndjekur procedurat e hartuar dokumentacionin në zbatim të shkresës së MBZHRAU nr. 1526/2, datë 11.4.2016 "Mbi çeljen e numrit të llogarisë për pagesën e tokës" dhe sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr. 3435/1, datë 18.3.2016 "Çelje llogarie, në zbatim të VKM nr. 605, datë 05.09.2012 "Për Procedurat e Njoftimit dhe Mënyrën e Pagesës së Detyrimit Financiar ne Rastet e Pavlefshmërisë së Pjesshme të AMTP-ve, si Rezultat i Mosrespektimit të Normës për Frymë të Tokës Bujqësore".

Gjetje nga auditimi: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan ka marrë 2 vendime (vendimet nr. 157, datë 04.05.2015 dhe Vendimi nr. 193, datë 14.12.2015 ***) për shlyerje detyrimi të në vlerën 7,228,568 lekë për sipërfaqen e tjetërsuar 4746 m^2 (1709 m^2 me vlerën*** 6,974,837 ***lekë që i përket Vendimit nr. 157, datë*** 04.05.2015; dhe ***3037 m^2 vlerën prej*** 253,731 ***lekë që i përket*** Vendimit nr. 193, datë 14.12.2015), ***bazuar në nenin 9, pika 3 të*** ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" i ndryshuar dhe ***pika 4*** ku shprehet: .." *Mënyra dhe afatet e shlyerjes së detyrimit për vlerën e tokës përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave*.."Në të dy këto Vendime ***nuk përcaktohet institucioni llogaria dhe mënyra e derdhjes, gjë që sjell pamundësinë e ekzekutimit të Vendimit dhe të derdhjes së detyrimit financiar të mësipërm tek Shteti..***

Rekomandim: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan të marrë masa ***për ekzekutimin e arkëtimit të detyrimit financiar në vlerën 7,228,568 lekë për sipërfaqen e tjetërsuar 4746 m^2 (1709 m^2 me vlerën*** 6,974,837 ***lekë që i përket Vendimit nr. 157, datë*** 04.05.2015; dhe ***3037 m^2 vlerën prej*** 253,731 ***lekë që i përket*** Vendimit nr. 193, datë 14.12.2015), pasi të përfundojë procesi në gjykatë i shprehur me vendimet përkatëse, duke ndjekur procedurat e duke hartuar dokumentacionin në zbatim të shkresës së MBZHRAU nr. 1526/2, datë 11.4.2016 "Mbi çeljen e numrit të llogarisë për pagesën e tokës" dhe sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr. 3435/1, datë 18.3.2016 "Çelje llogarie, në zbatim të VKM nr. 605, datë 05.09.2012 "Për Procedurat e Njoftimit dhe Mënyrën e Pagesës së Detyrimit Financiar ne Rastet e Pavlefshmërisë së Pjesshme të AMTP-ve, si Rezultat i Mosrespektimit të Normës për Frymë të Tokës Bujqësore".

Gjetje nga auditimi: Për të gjitha dosje-vendimet-Kërkesë paditë e KVVTP (gjithsej 26 të ndodhura në gjykata prej të cilave 15 proces shkalla e I-rë dhe 11 në shkallën e dytë të gjykimit) konstatohen vonesa e zgjatje procedurash me shtrirje mesatare kohore 2-3 vjet, gjë që ka sjellë edhe zgjatje kohore të trajtimit të kërkesave, por sidomos të ecurisë së marrjes së formës përfundimtare të Vendimeve të KVVTP si dhe të përfundimit të vetë procesit të vlerësimit të titujve të pronësisë së tokës bujqësore.

Për veprimet e mosveprimet si më sipër mbajnë përgjegjësi:
z. A. K., në cilësinë e nëpunësit autorizues, me detyre Ish-Prefekt i Qarkut, deri maj 2017, në cilësinë e nëpunësve autorizues.
z. I. Sh., me detyrë ish-Drejtor deri datë 19.5.2014 dhe ish-specialist deri 28.10.2014, në cilësinë e nëpunësve zbatues.
Zj. A. K., me detyrë anëtare deri 19.5.2014, ish-drejtore 20.5.2014-2810.2014, aktualisht anëtarë juriste, në cilësinë e nëpunësve zbatues.
z. E. S., me detyrë Drejtor prej 29.10.2014 e vazhdim, në cilësinë e nëpunësve zbatues.
znj.A. D. (Sh.) me detyrë anëtarë, jurist në cilësinë e nëpunësve zbatues.
z. R. T., me detyrë ish- anëtar, Topograf deri 15 Qershor 2016,aktualisht në pension, në cilësinë e nëpunësve zbatues.
z. A. T., me detyrë anëtar, agronom, në cilësinë e nëpunësve zbatues.
z. P. S. me detyrë anëtar, Topograf, në cilësinë e nëpunësve zbatues.
Për sa më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr. 5, datë 17.11.2017, si dhe Prejekt Raporti, për këtë çështje subjekti i audituar, përfaqësuar nga z. E. S. me detyrë Drejtor, znj. A. K., znj. A.D., z. A. T. dhe z. P. S. me detyrë anëtarë të KVVTP pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, me shkresë nr. 1299/22, datë 24.11.2017 dhe shkresë nr. 1299/34, datë 11.12.2017, të cilët kanë bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Gjetje nga auditimi: Në vendime u gjetën parregullsi që lidhen me sipërfaqe të zbrituara më pak në 3 raste, me shkakun për konfirmime të parregullta të gjendjeve juridike fizike të pasurive konfirmuar nga ZVRPP, 1 rast me mos verifikim të plotë pas ndryshimit të emrit, 1 rast me konfirmime të pasakta të rrjedhura nga bashkëpronësia e paligjshme si dhe 2 raste me mungesë përcaktimi për shlyerjen e detyrimit financiar.

Për sa i takon rekomandimeve të lëna Komisioni Vendor do të marrë masat e nevojshme për zbatimin e tyre menjëherë e në vazhdimësi.
Qëndrimet e auditusve.
Në lidhje me komentet e bërë nga subjekti i audituar sqarojmë se kanë karakter pohues, pra janë të pranuara prej tyre, duke marrë masat e nevojshme për zbatimin menjëherë dhe në vazhdimësi.

Auditim mbi Vendime të marra nga KVVTP por që janë në proces ankimimi në GJAA Tiranë (gjykimi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë dhe ecuria e procesit).
7.5 a 3. KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan për periudhën 2013-30.9.2017 ka marrë 11 vendime shfuqizimi të AMTP-ve të cilat ndodhen në proces shqyrtimi gjyqësor në ***GJAA Tiranë*** prej të cilave 2 vendime ankimuar nga i padituri (pala mbajtëse e AMTP) dhe 9 vendime shfuqizimi janë ankimuar nga KVVTP Elbasan për sipërfaqen 93 671 m^2 sipas kërkesave ankimore përkatëse bazuar në nenin 9, pika 1 e ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" i ndryshuar pasqyruar në tabelën emertuar: "***Vendime të marra nga KVVTP por që janë në proces ankimimi në GJAA Tiranë (gjykimi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë dhe ecuria e procesit).***"
Vendime të marra nga KVVTP por që janë në proces ankimimi në GJAA Tiranë (gjykimi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë dhe ecuria e procesit)

Nr.	Emri i përfituesit	Vendimi i KV, GJ		Ankuesi	Shkaku	Sip. pavl. m^2	Vend ndodhja
		Nr.	Date				
1	R. K.	151 894	30.03.2015 14.7.15	I Padituri 20.7.15 - 5.10.15	Nuk është dakord me gjykatën, shkaqet do ti paraqesë ne apel	2000 Pranuar	Fidanisht Ish-NB Elbasan
2	S. P.	164 82 964/42	30.06.2015 28.10.15 9.11.15	Komisioni	Gjykata ka marrë parasysh vendbanim faktik dhe jo atë me gjendje civile	6600	Proger Peqin
3	B. S.	178 93	30.10.2015 8.2.16	I Padituri - 7.3.16	Gjykata duhet të marrë parasysh vendbanimin faktik dhe faktin që nuk ka marrë tokë në vend tjetër	3500 Pranuar	
4	A. H.	192	14.12.2015	Komisioni	Gjykata nuk i la kohe te mjaftueshme KV për te plotësuar te metat (adresa)	14960	
5	I. T.	198	29.01.2016	Komisioni	Vendimi i pabazuar ne ligj e prova, Gjykata nuk ka marre parasysh njoftimet e palëve	4427	
6	R.(R.) M. E. (E. Sh., A. D., A. K.)	203 ? (1144) 1209/57/10	31.03.2016 28.12.16 4.1.17	Komisioni	Vendimi i pabazuar ne ligj e prova	8000	Fidanisht Ish-NB Elbasan
7	H. Q.	209 ?	23.09.2016 19.12.16	Komisioni 3761/103,dt 23.12.16	Gjykata nuk pranoi plotësimin e te metave (adresa)	7000 Rrezuar	
8	Kisha "Shen Thanasi"	211	31.10.2016	Komisioni	Vendimi i pabazuar ne ligj e prova, Gj.Adm interpreton gabim afatin e ngritjes se padisë	9800	
9	A.B.	212	31.10.2016	Komisioni	Vendimi i pabazuar ne ligj e prova, i padituri ka sjelle prova qe nuk i ka paraqitur ne KV	1263	

10	A.B.	214	30.12.2016	Komisioni	Vendimi i pabazuar ne ligj e prova, Gjykata nuk ka marre parasysh njoftimet e palëve	2021	
11	Xh. H.	221	19.04.2017	Komisioni	Vendimi i pabazuar ne ligj e prova, Gjykata nuk ka marre parasysh njoftimet e palëve	34,100	
Shuma 11 vendime						93 671	

Shënim: Rreshti I-rë në tabelë pasqyron vendimin e KVVTP-së, ndërsa rreshti i II-të pasqyron Vendimin e Gjykatës Administrative Shkalla I-rë Durrës, (GJA SH I Durrës) dhe rreshti III-të pasqyron Kërkesën ankimore të cilat janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë (GJAA Tiranë) nga individë apo nga KVVTP sipas rastit.

Gjetje nga auditimi: 1. Mungojnë vendimet e GJA SH1-rë Durrës për Vendimet e KVVTP nr. 203,datë 31.3.2016, nr. 209, datë 23.09.2016 ndërsa kërkesat ankimore nr. 1209/57/10, datë 04.01.2017 nr. 3761/103, datë 23.12.2016, drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë janë të pa plota pasi nuk përcaktojnë numrin përkatës të vendimet e GJA SH1 Durrës, gjendje kjo që tregon marrëdhënie të parregullta ndërmjet Institucionit të KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan dhe GJA SH1 Durrës, gjë për të cilën KVVTP do të duhet të kërkojë zyrtarisht Vendimin, qoftë edhe duke e prezantuar këtë parregullsi pranë KLD ose edhe pranë Ministrisë së Drejtësisë, parregullsi që ka sjellë zvarritje e zgjatje të procesit të vlerësimit të titujve të pronësisë së tokës bujqësore.
Rekomandim: KVVTP Prefekti i Qarkut Elbasan të marrë masa të plotësojë në mënyrë të rregullt kërkesat ankimore duke përcaktuar në to vendimin përkatës të GJA SH1 Durrës apo Gjykatës së Apelit që ankimohet, duke kërkuar dhe siguruar dorëzimin zyrtar të vendimit përkatës. Për këtë mungesë bashkëpunimi me gjykatat, KVVTP përvec se të kërkojë zyrtarisht Vendimin, duke e prezantuar këtë parregullsi pranë KLD ose edhe pranë Ministrisë së Drejtësisë, me synim shmangien e zvarritjes dhe zgjatjes së procesit të vlerësimit të titujve të pronësisë së tokës bujqësore.
Gjetje nga auditimi: 2. 1. KVVTP ne lidhje me (nr. 3sipas tabelës), Vendimin nr. 178, datë 30.10.2015, i ankimuar pranë GJAA Tiranë nga mbajtësi për AMTP nr. 623, datë 3.3.1998, në emër të B. S., me 3500 m^2 tokë arë, fshati Shtërmen Komuna Gostimë, ka mjaftuar vetëm me certifikatën gjendje datë 27.09.1991 lëshuar nga ZGJC Gostimë datë 10.10.14, pra që nuk ka qenë banor më datë 01.08.1991, dhe për pasojë nuk ka qenë subjekt i ligjit nr.7501, pra nuk ka bërë të plotë Hetimin administrativ sepse nuk e ka shtrirë hetimin në kërkimin e të dhënave lidhur me verifikimin e faktit nëse ka qenë trajtuar më parë me tokë bujqësore nga fshati Rrasë (mbështetur ne certifikatën ku shprehet: *"Familja B. S. është zhvendosur nga ZGJC Rrasë në ZGJC Gostimë "*, vendi nga ku është transferuar pra në vendin e origjinës, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9948, VKM nr. 1269 dhe me ligjin 7501 (pasi nuk ka qenë subjekt i 7501, për të cilin mungon hetimi i plotë. Edhe këto mangësi mungesë faktesh kanë sjellë që vendimi nr. 178, datë 30.10.2015, dhe vendimi i GJA SH1-rë Durrës nr. 93, datë 8.2.2016 të atakohet nga mbajtësi, duke sjellë që procesi të vazhdojë. Pra KVVTP ka mundësinë të plotësojë hetimin administrativ të kërkojë nga zyrat shtetërore fshati Rrasë Bashkia Belsh dhe nga ZVRPP Elbasan nëse qytetari ka qenë trajtuar me parë me tokë bujqësore dhe ti paraqesë ato para gjykatës,si dhe të marrë në dorëzim tokën "shtet" prej 3500 m^2, në lidhje me Vendimin nr. 178, datë 30.10.2015 pranuar me vendimin e GJA SH1 Durrës nr. 93, datë 8.2.2016
Rekomandim: KVVTP Prefekti i Qarkut Elbasan të marrë masa të plotësojë hetimin administrativ, të kërkojë nga zyrat shtetërore fshati Rrasë Bashkia Belsh dhe nga ZVRPP Elbasan nëse qytetari z. B. S. ka qenë trajtuar me parë me tokë bujqësore dhe ti paraqesë ato para gjykatës, si dhe të marrë në dorëzim tokën "shtet" prej 3500 m^2, në lidhje me Vendimin nr. 178, datë

30.10.2015 pranuar me vendimin e GJA SH1 Durrës nr. 93, datë 8.2.2016. Këto fakte KVVTP-ja t'i paraqesë zyrtarisht para Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.
Gjetje nga auditimi: KVVTP për vendimin nr. 178, datë 30.10.2015, me sipërfaqe 3500 m^2, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj anëtarëve të Komisionit të Ndarjes së tokës të fshatit Shërmen Komuna Gostimë pasi ka tejkaluar kompetencat ligjore me trajtimin me tokë bujqësore pa qenë subjekt i ligjit nr.7501, gjendje datë 1.8.1991, në papajtueshmëri me nenin 15 të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore".
Dosja është përpunuar nga z. E. S., me detyrë Drejtor, zj. A. K., z. R. T., znj. A. Sh., z. A. T., anëtar dhe miratuar nga z. A. K., ish-Prefekt; si dhe është ndjekur procesi gjyqësor nga znj. A. Sh.

Gjetje nga auditimi: 2. 2. KVVTP ne lidhje me (nr. 7 sipas tabelës),Vendimin nr. 209, datë 23.09.2016, i ankimuar pranë GJAA Tiranë nga KV për AMTP nr.274, datë -, në emër të A. & H. Q., me 16000 m^2 tokë Ullishtë Sektori Karroq ish-NB Elbasan si Themelues, shfuqizim i pjesshëm për 7000 m^2, mbi normë në pasuritë nr. 1145/1, v.4, f.32 zk. 8527 me sipërfaqe 11748 m^2 sipas LN dhe 16000 m^2 sipas AMTP, nr. 1169/11, v.4, f.33 zk.8527 me sipërfaqe 4232 m^2 sipas LN dhe –m^2 sipas AMTP konstatojmë:
Gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë për shkakun e mungesës së adresave për 3 prej trashëgimtarëve të K/Familjarit A. &H. Q..
Dosja është e pa inventarizuar nuk ka fletë inventari.
Mungon Vendimi i gjykatës, për mospranimin e padisë së KVVTP dhe lidhur me këtë, mungon dokumentacioni që të vërtetojë shkakun e mosplotësimit të metave (si adresa) të pretenduara nga gjykata.
Këto mangësi sjellin si pasojë mungesën e argumentimit (me nje relacion) të pjesës fundore fq.6-7 të kërkesës ankimore nr. 3761/103, datë 23.12.2016 drejtuar GJAA Tiranë dhe që zgjat procesin me pasojë që mbajtës i titullit vazhdon përdor në mënyrë të paligjshme sipërfaqen prej 7000 m^2 ullishtë, në kundërshtim me ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008.
Rekomandim: KVVTP Prefekti i Qarkut Elbasan të marrë masa për ndjekjene procesit gjyqësor në GJAA Tirane sipas kërkesës ankimore nr. 3761/103, datë 23.12.2016 drejtuar GJAA Tiranë, të plotësojë dokumentacionin për adresat e munguara të 3 trashëgimtarëve si dhe të plotësojë edhe me konfirmimet nga ZVRPP Elbasan dhe ti paraqesë ato para gjykatës. Gjithashtu të marrë në dorëzim tokën "shtet" prej 7000 m^2, tokë ullishtë sipas Vendimit nr. 209, datë 23.09.2016, rrëzuar me vendimin e GJA SH1 Durrës pa nr., datë 18.12.2016 dhe ankimuar me Kërkesën Ankimore nr. 3761/103,datë 23.12.16 në GJAA Tiranë.
Gjetje nga auditimi: Ecuria e procesit gjyqësor është mbajtur me shënime fletushka, nuk ka asnjë informacion për titullarin, megjithëse nga shënimet mbajtur në gjykatë datë 22.8.16, nga zj. Alba Kila, dhe shënimet pa datë, shënimet datë 6.12.2016 dhe datë 19.12.2016 të zj. Alma Dylgjeri; rezulton se janë zhvilluar 4 seanca gjyqësore pranë GJA Durrës dhe nuk kanë dhënë asnjë informacion tek Titullari, për ecurinë e procesit lidhur me kërkesë padinë nr. 3761/92, datë 29.9.2016, e cila lidhet me Vendimin nr. 209, datë 23.09.2016 të KVVTP për verifikim të AMTP nr. 274, pa datë, (në fakt ka dhe një tjetër AMTP me nr. 74, pa datë) me sipërfaqe 16000 m^2 Ullishtë në emër të A. e H. Q..
Rekomandim: KVVTP Prefekti i Qarkut Ebasan të marrë masa të evidentojë, dokumentojë me informacione në cdo rast për ecurinë e seancave të procesit gjyqësorë dhe mbi bazën e informacioneve të përgatisë dhe paraqesë titullarit relacionet përkatëse mbi bazën e të cilave të përgatitet kërkesa ankimore për vendimet e atakuara në GJAA e tjera sipas rastit.
Gjetje nga auditimi: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan Vendimin nr. 209, datë 23.09.2016, me 7000 m^2 ullishtë, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj anëtarëve të Komisionit të Ndarjes së tokës të Sektori Karroq ish-NB Elbasan, pasi ka tejkaluar kompetencat ligjore me trajtimin me tokë bujqësore mbi normë në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, në

papajtueshmëri me nenin 15 të ligjit nr.9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore".
Dosja është përpunuar nga z. E. S., me detyrë Drejtor, zj. A. K., z. R. T., znj. A. Sh., z. A. T., anëtar dhe miratuar nga z. A. K., ish-Prefekt; si dhe është ndjekur procesi gjyqësor nga znj. A. Sh.

Për veprimet e mosveprimet si më sipër mbajnë përgjegjësi:
z. A. K., në cilësinë e nëpunësit autorizues, me detyre Ish-Prefekt i Qarkut, deri maj 2017, në cilësinë e nëpunësve autorizues.
zj,A. K., me detyrë anëtare deri 19.5.2014, ish-drejtore 20.5.2014-2810.2014, aktualisht anëtarë juriste, në cilësinë e nëpunësve zbatues.
z. E. S., me detyrë Drejtor prej 29.10.2014 e vazhdim, në cilësinë e nëpunësve zbatues.
znj.A. D.(Sh.) me detyrë anëtarë, jurist në cilësinë e nëpunësve zbatues.
z. R. T., me detyrë ish- anëtar, Topograf deri 15 Qershor 2016,aktualisht në pension, në cilësinë e nëpunësve zbatues.
z. A. T., me detyrë anëtar, agronom, në cilësinë e nëpunësve zbatues.
z. P. S. me detyrë anëtar, Topograf, në cilësinë e nëpunësve zbatues.
Për sa më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr. 6, datë 17.11.2017, si dhe Projekt Raporti për këtë çështje subjekti i audituar, përfaqësuar nga z. E. S. me detyrë Drejtor, znj. A. K., znj. A. D., z. A. T. dhe z. P. S. me detyrë anëtarë të KVVTP pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, me shkresë nr. 1299/22, datë 24.11.2017 dhe shkresë nr. 1299/34, datë 11.12.2017, të cilët kanë bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:
Gjetje nga auditimi 1: Mungojnë vendimet e GJASH 1-rë Durrës për vendimet e KVVTP nr.203, datë 31.03.2016 dhe nr.209, datë 23.09.2016
Komisioni Vendor duke mbajtur parasysh rekomandimet e lëna do të marrë masa menjëherë e në vazhdim për sigurimin e vendimeve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës apo Gjykatës së Apelit që ankimohet.
Qëndrimet e auditusve.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se nuk ka patur kundërshti, pra del se kanë karakter pohues.

Gjetje nga auditimi 2: KVVTP në lidhje me vendimin me nr.178, datë 30.10.2015 ka mundësine të plotësojë hetimin administrativ të kërkojë nga zyrat shtetërore fshati Rrasë nëse është trajtuar z.B. S. me tokë në fshatin Rrasë.
KVVTP ka konkluduar me vendimin nr.178, datë 30.10.2015, pasi ka vërtetuar faktin se z.Bujar Sefa me datë 01.08.1991 nuk ka qenë banor i fshatit Shtërmen, Komuna Gostimë dhe në këtë mënyrë komisioni i ndarjes së tokës së fshatit Shtërmen ka tejkaluar kompetencat ligjore pasi nuk duhet ta pajiste me tokë në këtë fshat. Objekti i shqyrtimit nga ana e KV-së ka qenë AMTP-ja e lëshuar nga komisioni i ndarjes së tokës të fshatit Shtërmen qe z. B. S. ka marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore, dhe fakti nëse z. B. S. është trajtuar me tokë apo jo në fshatin Rrasë nuk e bën të ligjshëm AMTP e përfituar në fshatin Shtërmen. Duke qenë se më datë 01.08.1991 z.Sefa ka qenë banor i fshatit Rrasë, ai nuk duhet të kishtë përfituar tokë në fshatin Shtërmen prandaj dhe KV-ja ka marrë vendimin nr. 178 në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi.
Qëndrimet e auditusve.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se Gjykata ka rrëzuar vendimin nr. 178, pra ka qenë kjo mangësi e hetimit administrativ.

Gjetje nga auditimi 2.2: KVVTP në lidhje me vendimin nr. 209, datë 23.09.2016, mungon vendimi i gjykatës për mospranim të padisë së KVVTP, dosja është e pa inventarizuar, nuk ka relacion në lidhje me ecurinë e proçsit gjyqësore.

Për sa i takon rekomandimeve të lëna Komisioni Vendor do të marrë masat e nevojshme për zbatimin e tyre menjëherë e në vazhdimësi.
Qëndrimet e auditusve.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se kanë karakter pohues, pra janë të pranuara prej tyre, duke marrë masat e nevojshme për zbatimin menjëherë dhe në vazhdimësi.

Auditim mbi Vendimet e marra nga Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) për Mosshqyrtim të AMTP-ve janar 2013-30.9.2017.
7.5 a 4. KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan për periudhën 2013-30.92017 ka marrë 43 vendime për mosshqyrtim të AMTP-ve, pasqyruar ne tabelën emërtuar "Vendime për mos shqyrtim të Vlefshmërisë ligjore të AMTP v. 2013-30.9.2017" si më poshtë:
Tabela Vendime për mos shqyrtim të Vlefshmërisë ligjore të AMTP v. 2013-30.9.2017

Nr	Vendim		Subjekti	AMTP		Sipërf m^2	Individ institucione
	nr	datë		nr	datë		
1	112	30.04.2014	M. Xh.	67	S'ka	7200	Individ
2	114	13.05.2014	F. P.	422	S'ka	4476	Individ
3	115	13.05.2014	A. R.	273	S'ka	4230	Individ
4	116	13.05.2014	G. H.	87	26.12.1991	3600	Individ
5	119	24.06.2014	O. H.	54	S'ka	8220	Individ
6	122	17.07.2014	K. H.	43	S'ka	7295	ZVRPP Pe
7	123	17.07.2014	Sh. Gj.	18	01.04.1992	11230	ZVRPP Lb
8	124	17.07.2014	S. Xh.	122	02.04.1992	2180	ZVRPP Lb
9	125	17.07.2014	Q. B.	64	S'ka	9981	Individ
10	126	17.07.2014	A. L.	3	05.04.1992	7200	ZVRPP Lb
11	127	17.07.2014	Xh. Ç.	2309	06.04.1992	10100	ZVRPP Lb
12	132	30.09.2014	F. M.	S'ka	20.01.1992	2300	Komuna
13	136	27.11.2014	F. K.	139	05.12.1991	5880	ZVRPP El
14	138	24.02.2015	L. D.	43	11.05.1992	32490	ZVRPP El
15	139	24.02.2015	Xh. I.	249	08.12.1991	5700	ZVRPP El
16	140	24.02.2015	Q. Z.	14	04.03.1992	13909	Individ
17	141	24.02.2015	Rr. B.	63	20.07.1993	6300	ZVRPP Lb
18	142	24.02.2015	Z. Z.	S'ka	28.02.1992	20624	ZVRPP Lb
19	143	24.02.2015	Xh. H.	11	S'ka	9800	Individ
20	147	30.03.2015	S. B.	4914	S'ka	3000	ZVRPP Lb
21	148	30.03.2015	A. D.	S'ka	25.07.1995	3092	Individ
22	149	30.03.2015	S. D.	S'ka	25.07.1995	3487	Individ
23	154	04.05.2015	F. Ç.	153	09.04.1992	6488	ZVRPP Lb
24	155	04.05.2015	R. .P.	99	19.02.1992	7808	ZVRPP Lb
25	156	04.05.2015	J. M.	85	08.04.1992	8584	ZVRPP Lb
26	158	04.05.2015	R. H.	39	ska	4300	ZVRPP Lb
27	162	27.05.2015	Gj. Ç.	426	S'ka	9088	Individ
28	165	30.06.2015	I. P.	3	26.06.1992	14900	ZVRPP Pe
29	166	30.06.2015	H. K.	49	26.02.1992	3700	ZVRPP Pe
30	167	30.06.2015	M. Gj.	53	26.02.1992	6000	ZVRPP Pe
31	168	30.06.2015	A. H.	37	S'ka	12158	ZVRPP Pe
32	169	30.06.2015	H. I0	205	S'ka	5600	Individ
33	172	31.07.2015	J. T.	349	S'ka	9526	ZVRPP El
34	173	31.07.2015	I. M.	580	S'ka	17914	ZVRPP El
35	174	31.07.2015	J. V.	113	S'ka	5863	ZVRPP El
36	179	30.10.2015	I. L.	400	25.11.1991	2340	ZVRPP El
37	183	14.12.2015	I. M.	S'ka	24.02.1992	8980	ZVRPP Lb
38	184	14.12.2015	Xh. M.	S'ka	04.03.1992	10465	ZVRPP Lb
39	185	14.12.2015	N. M.	S'ka	24.02.1992	23674	ZVRPP Lb
40	186	14.12.2015	G. Ç.	S'ka	28.02.1992	15214	ZVRPP Lb

41	187	14.12.2015	N. L.	S'ka	24.02.1992	17432	ZVRPP Lb
42	188	14.12.2015	Sh. P.	41	S'ka	19500	ZVRPP El
43	189	14.12.2015	F. Q.	17	19.02.1992	4580	Individ
			Shuma				

Nga auditimi i dokumentacionit dhe dosjeve që i përket 43 vendimeve marrë për mos shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP-ve, nga Komisioni Vendor i Verifikimit Ligjor të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Elbasan, për periudhën janar 2013 deri me 30.09.2017, rezulton se për 39 vendime mosshqyrtimi lidhet me mosplotësim të kërkesave të UKM nr. 2, datë 13.01.2010, "Për Mënyrën e Verifikimit apo të Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore, nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë a Institucione", UKM nr.2, datë 13.06.2013 "Për mënyrën e procedimit të Organeve të Administratës publike për pasuritë e Paluajtshme të fituara me AMTP", ndërsa për 4 vendime (përkatësisht nr. 112,114,116,119 referuar tabelës) mosshqyrtimi për 112, 114 lidhet me moskompetencë të KVVTP dhe kanë vazhduar në proces gjyqësor, kurse për vendimet 116 dhe 119 mosshqyrtimi lidhet me pikën 7 të VKM nr. 224, datë 19.2.2009 "Për procedurat e krijimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve,të kryera nga Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë (KV) dhe me UMB nr. 106, datë 23.2.1996..

Sipas kësaj pasqyre nga auditimi i 43 dosjeve më konkretisht rezulton se Vendimmarrja për Mos shqyrtimin e 43 kërkesa-vendimeve është bazuar ne:

-UKM nr. 2, datë 13.01.2010, kapitulli i pikat 1.a ku shprehet:" … *Kur në AMTP mungon një a me shumë element të formës a përmbajtjes, të përcaktuar ne pikën 1 të këtij udhëzimi. Në këto kushte KV vendos;*

i) Mos shqyrtimin e kërkesës kur AMTP (origjinale, dokumenti i njësuar me origjinalin, dublikatë apo fotokopje e noterizuar), apo dhe në piken a),b) e ç të Udhëzimit nr.2, datë 08.04.2009

-Pika 1b e UKM nr. 2, datë 13.06.2013 "Për mënyrën e procedimit të Organeve të Administratës publike për pasuritë e Paluajtshme të fituara me AMTP", ku përcaktohet se: *"AMTP-të duhet të përmbajnë disa element të formës e përmbajtjes, ndër të cilat pika 1 b "identifikimin e organit që e ka lëshuar AMTP-në, duke përfshirë nënshkrimin e Kryetarit të Komisionit të Ndarjes së Tokës*", ndërsa pika 1ç) "*AMTP duhet të përmbajë disa element të formës e përmbajtjes ndër të cilat njërën nga vulat e mëposhtme:*

i. Vulën e komitetit ekzekutiv të fshatit, ii. Vulën e Kryeplakut, iii. Vulën e Komunës/Bashkisë, iii. vulën e ndërmarrjes bujqësore, iv. Vulën e Këshillit të Rrethit /të Qarkut."

Këto mangësi në dokumentacionin e AMTP-ve të evidentuara si shkaqe ligjore të mos shqyrtimit nga KVVTP të AMTP-ve për periudhën deri fundviti 2015, janë zgjidhur me delegimin e kompetencave dhe detyrimeve për trajtim nga bashkitë sipas VKM nr. 994, datë 09.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të AMTP-ve", *për pasojë KVVTP Prefektit të qarkut mund dhe duhet tua bëjë të ditura zyrtarisht NJQV-ve përkatësisht Bashkive Elbasan, Librazhd, Përrenjas, Peqin, Cërrik.*

Rekomandim: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan të marr masa të bëjë me dije dhe dërgojë zyrtarisht 41 vendimet e marra për mos shqyrtim të Vlefshmërisë ligjore të AMTP v.2013-30.9.2017 përkatësisht në Bashkitë Elbasan, Librazhd, Përrenjas, Peqin, Cërrik, për kompetencë e shqyrtim bazuar në VKM nr. 994, datë 09.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të AMTP-ve" sipas tabelës emërtuar: "Tabela Vendime për mos shqyrtim të Vlefshmërisë ligjore të AMTP v.2013-30.9.2017"

Nga auditimi i 43 dosjeve të vendimeve për Mos shqyrtim u konstatuan mangësitë si më poshtë:

-Në dosjet e 43 vendimeve për Mos shqyrtim ***mungonin relacionet***, në mos përmbushje të pikës 3, neni 14 "Afatet dhe dokumentimi i veprimeve" të Rregullores "Për Organizimin dhe Funksionimin

e KVVTP-ve", miratuar me Vendimin nr.1, datë 27.3.2009 të Komisionit Qeveritar të Tokës (KQT).

-Nga auditimi i kohëzgjatjes rezulton se ***janë shkelur afatet*** e zbatimit të procedurave të trajtimit të kërkesave deri në nxjerrjen e Vendimit nga KVVTP të mos shqyrtimit nisur dhe nga shpërndarja sipas viteve; 5 kërkesa nga v.2009, 5 nga v.2010, 5 nga v.2011, 9 nga v.2012, 5 nga v.2013, 4 nga v.2014, 4 nga v.2015,1 nga v.2016 dhe 1 nga v.2017 dhe konkretisht: vetëm 5 vendime –kërkesa janë trajtuar në afatin nga disa dite -2 muaj, ndërsa 38 kërkesa-vendime janë në afate të tejkaluara mbi 4 muaj-6vjet e 3 muaj, tregues që shpreh afate të tejskajshme, pra janë shkelur afatet në kundërshtim dhe në shkelje të afatit 1 mujor sipas KPA, me ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" i ndryshuar, apo dhe në shkelje të afatit 3mujor sipas pikës 1, neni 14 "Afatet dhe dokumentimi i veprimeve" të Rregullores Për Organizimin dhe Funksionimin e KVVTP-ve", miratuar me Vendimin nr.1, datë 27.3.2009 të Komisionit Qeveritar të Tokës (KQT).me rregulloren e "Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP-ve" të miratuar me vendimin nr.1, datë 27.03.2009 të KQT-së, pasqyruar në tabelën "Vendime për Mos shqyrtim të Vlefshmërisë ligjore të AMTP dhe afati I Trajtimit të Kërkesave viti 2013-30.09.2017".

Gjetje: Nga auditimi u konstatuan -Mangësi ***në inventarizimin e dokumentacionit*** të 43 dosjeve, i cili aktualisht pasqyrohet me listë dokumentesh, por nuk ka fletën e inventarit standard-tip e cila të përfshije emërtimin e dokumentacionit përbërës me numër progresiv fletësh, mbylljen e dosjes, dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim në arkiv, gjendje kjo në mosplotësim të kërkesave të germes "dh" neni 9,36,40,64, të ligjit nr. 9154, datë 06.01.1993 dhe akteve nën ligjore përkatës**.**

Rekomandim: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan të marr masa të bëjë inventarizimin e dokumentacionit në dosje me plotësimin e fletës inventarit standard-tip e cila të përfshije emërtimin e dokumentacionit përbërës me numër progresiv fletësh, mbylljen e dosjes, dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim në arkiv.

Për mangësitë në zbatimin e procedurave shoqëruar me mungesën e relacioneve, shkeljen e afateve të procedurave dhe mangësitë në inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të dosjeve dhe 43 vendimeve të Mos shqyrtimit, që vijnë në kundërshtim me ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" i ndryshuar, apo dhe në shkelje të afatit 3 mujor sipas pikës 1, pikës 3, neni 14 "Afatet dhe dokumentimi i veprimeve" të Rregullores Për Organizimin dhe Funksionimin e KVVTP-ve", miratuar me Vendimin nr. 1, datë 27.3.2009 të Komisionit Qeveritar të Tokës (KQT).me rregulloren e "Për organizimin dhe funksionimin e KVVTP-ve" të miratuar me vendimin nr. 1, datë 27.03.2009 të KQT-së, pasqyruar në tabelën "Vendime për Mos shqyrtim të Vlefshmërisë ligjore të AMTP dhe afati i Trajtimit të Kërkesave viti 2013-30.09.2017" dhe me ligjin nr. 9154, datë 06.01.1993 dhe akteve nën ligjore përkatës**,** emërtuar "Vendime për mos shqyrtim të Vlefshmërisë ligjore të AMTP v. 2013-30.9.2017", mbajnë përgjegjësi personat që kanë përpunuar dosjet.

Për veprimet e mos veprimet si më sipër mbajnë përgjegjësi z. A. K., në cilësinë e nëpunësit autorizues, me detyre Ish-Prefekt i Qarkut, deri maj 2017, personat që kanë përpunuar dosjet z. I. S., me detyrë ish-Drejtor deri datë 19.5.2014 dhe ish-specialist deri 28.10.2014, z. E. S., me detyrë Drejtor prej 29.10.2014 e vazhdim, zj. A. K., me detyrë anëtare deri 19.5.2014, ish-drejtore 20.5.2014-2810.2014, aktualisht anëtare juriste, z. R. T., me detyrë ish- anëtar, Topograf deri 15 Qershor 2016, aktualisht në pension, z. A. T., me detyrë anëtar, agronom, znj. A. D. (Sh.) me detyrë anëtarë, jurist në cilësinë e nëpunësve zbatues.

Për sa më sipër është mbajtur akt-verifikimi nr. 6, datë 17.11.2017, si dhe Projekt Raporti, për këtë çështje subjekti i audituar, përfaqësuar nga z. E. S. me detyrë Drejtor, znj. A. K., znj. A. D., z. A. T. dhe z. P. S. me detyrë anëtarë të KVVTP pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, me shkresë nr. 1299/22, datë 24.11.2017 dhe shkresë nr. 1299/34, datë 11.12.2017, të cilët kanë bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

Gjetje nga auditimi: KVVTP-ja tu dërgojë zyrtarisht 41 vendimet e marra për mos shqyrtim të vlefshmërisë ligjore të AMTP Njësive të Qeverisjes Vendore.
Komisioni Vendor në bazë të VKM-së nr. 994, datë 09.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi", nuk ka detyrim ligjor që vendimet për AMTP të cilëve i mungojnë elementë të formës e përmbajtjes t'ja përcjellë Njësive të qeverisjes vendore, por këtë detyrim ligji ja ka ngarkuar zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të cilat duhet ti përcjellin këto AMTP pranë Njësive të qeverisjes vendore.
Qëndrimet e auditusve.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se nuk pranohen pasi koha e humbur dhe bashkërendimi i punëve ndërmjet KVVTP, Bashki, ZVRPP, etj.

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan mangësi në inventarizimin e dokumentacionit të 43 dosjeve i cili aktualisht pasqyrohet me listë dokumentesh, por nu ka fletën e inventarit standard-tip, e cila të përfshijë emërtimin e dokumentacionit përbërës me numër progresiv fletësh, mbylljen e dosjes, dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim në arkiv.
Për sa i takon rekomandimeve të lëna Komisioni Vendor do të marrë masat e nevojshme për zbatimin e tyre menjëherë e në vazhdimësi.
Qëndrimet e auditusve.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se kanë karakter pohues, pra janë të pranuara prej tyre, duke marrë masat e nevojshme për zbatimin menjëherë dhe në vazhdimësi.

Auditimi mbi kontrollet e drejtpërdrejta, të ushtruar me nismën e vet, për periudhën janar 2013 deri më 30.09.2017.
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se komisioni vendor i vlerësimit ligjor të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Elbasan, në zbatimi të nenit 7, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar ka detyrimin që të filloj kontrollet e drejtpërdrejta, të ushtruara me nismën e vet, për tokat e ish-NB-ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi të turizmit.
Në zbatimi të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", të ndryshuar, në ish-Ndërmarrjet Bujqësore nuk ka të dhëna për numrin e AMTP-ve, ndërsa sipërfaqja e ndarë është 8315 ha.
Në këtë Qark nuk trajtohen zona me përparësi të zhvillimit të turizmit, pavarësisht se ekzistojnë zona të tilla si fshati Gjinar, etj por që kanë qenë trajtuar kooperativa bujqësore dhe jo NB siç i parashikon ligji.
- Për ish-kooperativat bujqësore janë ndarë 45.098 AMTP me një sipërfaqe toke prej 47.746.53 ha, sipas pasqyrës që ndodhet në rubrikën **"Aneks "e"** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar.
Përsa më sipër janë pasqyruar të dhënat për tokë bujqësore të ndarë për ish-NB-të dhe ish-kooperativat bujqësore.
Sipas kërkesave të institucioneve të ndryshme dhe individëve janë marrë 141 vendime nga KVVTP, sipas pasqyrës "**Vendimet e KVVTP pranë Prefekturës së Qarkut Elbasan për vitet 2013-2017**", **Aneksi nr. 4,** bashkëlidhur akt-konstatimit nr. 1, datë 13.11.2017.
Ndërsa për periudhën nën auditim nga Komisioni Vendor nuk është marrë asnjë vendim në lidhje me programet vjetore të punës të hartuara për kontrolle të drejtpërdrejta, të ushtruar me nismën e vet, për tokat e ndërmarrjeve bujqësore si më poshtë:
- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga komisioni vendor i verifikimit ligjor të titujve të pronësisë nga viti 2009 deri 30.09.2017 janë marrë gjithsej 235 vendime, në bazë të kërkesave të individëve dhe institucioneve shtetërore, ndërsa nga kontrollet e drejtpërdrejta, të ushtruar me nismën e vet, për ish-Ndërmarrjet Bujqësore nuk janë marrë vendime. Për këtë periudhë KV ka dhënë 767 përgjigje administrative për kërkesa të ndryshme të qytetarit, duke u shprehur që këto kërkesa nuk janë në kompetencë të KV apo nuk mund të zgjidhen në bazë të legjislacionit në fuqi.

Në zbatimi të nenit 7, të ligjit nr. 9948/2008, Komisioni Vendor i Verifikimit të titujve të pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Elbasan, nga viti 2008 deri me datë 30.09.2017, ka planifikuar për të ushtruar kontrolle të drejtpërdrejta, me nismën e vet, në tokat e ish-NB-ve, por në asnjë rast nuk ka të dokumentuar një kontroll të tillë dhe konkretisht:
- Për vitin 2013 Komisioni Vendor ka hartuar programin mbi kontrollet e drejtpërdrejta, të ushtruar me nismën e vet dhe ka planifikuar ushtrimin e kontrollit mbi këto ish-NB:
1. Ish-NB Elbasan, Sektori Vreshtas
2. Ish-NB Peqin
3. Ish-NB Qendër Librazhd, sektorët Hotolisht, Prrenjas, Karkavec, Qendër.
Komisioni Vendor për realizimin e kontrollit të planifikuar ka dalë urdhëri nr. 30, datë 15.03.2010 te miratuar nga Prefekti dhe ka nisur procedurat për ish NB Elbasan Sektori Vreshtas.
Në zbatim te këtij urdhri u është kërkuar informacion institucioneve të përcaktuara në udhëzimin e KM nr. 1, datë 13.01.2010 dhe konkretisht:
- me shkresë nr. 1042/1, datë 15.03.2010 ZVRPP Elbasan;
- me shkresë nr. 1042/2 " " SAMT në Qarkun Elbasan;
- me shkresë nr. 1042/3 " " Seksionit te urbanistikes ne Keshillin e Qarkut Elbasan;
- me shkresë nr. 1042/4, datë 15.03.2010 Komunës Shushicë;
- me shkresë nr. 1042/5 " " Bashkisë Elbasan
- me shkresë nr. 1042/6 " " Arkivit Shtetëror vendor Elbasan
Në zbatim kërkesave të Udhëzimit nr. 1, datë 13.01.2010, "Për mënyrën e verifikimit apo shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore te ish NB-ve" ka kthyer përgjigje vetëm Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
Nuk ka kthyer përgjigje të plotë sipas udhëzimit, SAMT Qarkut Elbasan;
Kanë kthyer përgjigje negative duke u shprehur se nuk disponon dokumentacion:
- Bashkia Elbasan dhe Arkivi Shtetëror Vendor, Elbasan.
Kanë kthyer përgjigje vetëm për një pikë Seksioni i urbanistikës në Këshillin e Qarkut.
I është kërkuar informacion Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Elbasan lidhur me qenien ose jo punonjës të ish NB-së Elbasan me datë 01.101992 të përfituesve me AMTP. Përgjigja e dërguar nuk ka qenë e plotë pasi nuk jepet informacion për të gjithë qytetarët sipas listës emërore të dërguar nga ZVRPP Elbasan, por vetëm për një pjesë të tyre.
Për personat përfitues nuk është arritur të identifikohet adresa e saktë e banimit për tu bërë i mundur njoftimi i tyre sipas ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 Kodi Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë për NB Vreshtas, që ndodhet në Zonën Kadastrale nr. 3827, e cila nuk është futur në sistemin e regjistrimit dhe për këtë arsye Komisioni Vendor nuk ka mundur të marrë informacion nga ZVRPP, rreth gjendjes juridike të pasurive të përfituara me AMTP.
Përsa më lart rezulton se komisionit vendor në lidhje me kontrollet e drejtpërdrejta të ushtruar me nismën e vet, nuk ka kontrolluar asnjë AMTP.
- Për vitin 2014 ka hartuar programin mbi kontrollet e drejtpërdrejta, të ushtruar me nismën e vet dhe ka planifikuar ushtrimin e kontrollit mbi këto ish NB:
1. Ish NB Elbasan, Sektori Vreshtas
2. Ish NB Peqin
3. Ish NB Qendër Librazhd, sektori Qendër
Edhe gjatë këtij viti Komisioni Vendor nuk ka përfunduar verifikimin administrative për asnjë AMTP në sektorin Vreshtas të ish-NB Elbasan.
- Për vitin 2015 ka hartuar programin mbi kontrollet e drejtpërdrejta, të ushtruar me nismën e vet dhe ka planifikuar ushtrimin e kontrollit mbi këto ish NB
1. NB Elbasan, Sektori Vreshtas;
2. NB Peqin;
3. NB Librazhd Sektori Qendër.

Duke pasur parasysh ankesat e shumta për procesin e ndarjes së tokës së ish-NB-së Cërrik, Sektori Lugaj, Prefekti i Qarkut Elbasan ka nxjerrë urdhrin nr. 39, datë 22.04.2015 për ushtrimin e kontrollit edhe në këtë NB.
- Për NB Vreshtas, ashtu si në vitet paraardhëse kontrolli nuk është realizuar pasi përveç mangësive të tjera në dokumentacion, kjo zonë ende nuk ka hyrë në sistemin e regjistrimit.
- Për NB Peqin dhe për NB Cërrik, Sektori Lugaj, ashtu siç parashikohet edhe në Udhëzimin nr. 1, datë 13.01.2010, Komisioni Vendor i ka kërkuar informacion institucioneve përkatëse si më poshtë:
- Për të dyja këto NB është përgjigjur DAMT pranë Këshillit të Qarkut, duke vënë në dispozicion hartat e shkallës 1:5000 dhe sipërfaqen e vënë në dispozicion për tu ndarë.
DAMT është përgjigjur gjithashtu se nuk ka të dhëna për normën për frymë dhe për listën e themeluesve të NB.
- Për NB Peqin, ZVRPP Peqin nuk ka kthyer përgjigje Brenda afateve dhe për këtë Komisioni Vendor e ka përsëritur edhe njëherë kërkesën e saj.
Ndërsa për NB Cërrik, Sektori Lugaj, ZVRPP Elbasan (megjithëse ka detyrimin ligjor) ka refuzuar të vejë në dispozicion informacionin e kërkuar nga Komisioni Vendor. Komisioni Vendor ka ripërsëritur kërkesat e tij me shkresën nr. 1513/9 prot., datë 02.06.2015 por në përgjigjen e saj ZVRPP Elbasan përsëri nuk është përgjigjur sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 1, datë 13.01.2010, duke mos vënë në dispozicion AMTP-të.
- Nga njësitë e qeverisjes vendore (NjQV) kanë dërguar informacion Komuna Gjocaj (ku bëjnë pjesë 2 fshatra të ish NB Peqin) dhe për NB Cërrik, Sek.Lugaj, komuna Papër.
- Për vijat kufizuese nga Seksioni i Urbanistikës është përgjigjur për sektorin Lugaj të NB Cërrik ndërsa për ish NB Peqin nuk disponon vijë kufizuese të ndërtimit.
- Arkivi Shtetëror Vendor në përgjigjen e tij ka informuar se nuk disponon dokumentacion rreth procesit të ndarjes së tokës bujqësore.
Duke qenë se ZVRPP nuk ka vënë në dispozicion Aktet e Marrjes së Tokës në Pronësi, Komisioni Vendor nuk ka mundur të kryejë të gjithë procedurat e mëtejshme për verifikimin e vlefshmërisë ligjore të këtyre akteve.
- Edhe për vitin 2016 është hartuar programi mbi kontrollet e drejtpërdrejta, që do të ushtronte KVVTP, me nismën e vet dhe ka planifikuar ushtrimin e kontrollit mbi këto ish-NB.
1- NB Cërrik, Sektori Lugaj;
2- NB Peqin;
3- NB Librazhd, Sektori Qendër
- Sipas kërkesave të nisura nga Komisionit Vendor del se për ish-NB Librazhd, Sektori Qendër ka kthyer përgjigje vetëm DAMT pranë Këshillit të Qarkut.
- Arkivi Shtetëror Vendor Elbasan ka kthyer përgjigje se nuk disponon asnjë dokumentacion që lidhet me procesin e ndarjes se tokës.
- Institucionet e tjera të përcaktuara në Udhëzimin nr. 1, datë 13.01.2010 nuk kanë kthyer asnjë përgjigje.
Në përfundim për 4 vite nga Komisioni Vendor, nuk ka mundur të kryejë të gjithë proçedurat e mëtejshme për verifikimin e vlefshmërisë ligjore të këtyre akteve, pasi nuk janë vënë në dispozicion AMTP si nga ZVRPP, ashtu dhe dokumentacioni tjetër nga institucione të tjera, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimin nr. 1, datë 13.01.2010 "Për mënyrën e verifikimit apo shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore te ish NB-ve" ka kthyer përgjigje vetëm Zyra Vendore e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:
• Nga ana e KVVTP pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" përsa i përket kontrolleve të drejtpërdrejta, të ushtruar

me nismën e vet, për ish-Ndërmarrjet Bujqësore, pasi nuk ka asnjë vendimmarrje për këtë qëllim, kjo për mungesë të dokumentacionit nga institucionet e tjera.
Referuar nenit 7, shkronja b, pika 2 të Ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", përcaktohet që:

"*kontrolleve të drejtpërdrejta, të ushtruara me nismën e vet, mbi veprimtarinë dhe veprimet e kryera nga ish-komisionet e tokës, të të gjitha niveleve, në procesin e ndarjes së tokës. Këto kontrolle kryhen të plota në sipërfaqen e tokave të ish-NB-ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi të turizmit, të përcaktuara sipas ligjit nr. 7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave, që kanë përparësi turizmin", të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij".*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
• Z. Sh. D. me detyrë, ish-Prefekt i Prefekturës së Qarkut Elbasan në cilësinë e nënpunësit autorizues, për periudhën 09.05.2008 deri 08.10.2013;
• Z. A. K. me detyrë, ish-Prefekt i Prefekturës së Qarkut Elbasan në cilësinë e nënpunësit autorizues, për periudhën 10.10.2013 deri 05.05.2017;
• Z. A. D. me detyrë, Prefekt i Prefekturës së Qarkut Elbasan në cilësinë e nënpunësit autorizues, për periudhën 25.05.2017 e në vazhdim;
• Z. I. Sh. me detyrë ish-drejtor i KVVTP Prefektura Elbasan dhe në cilësinë e antarit KV;
• Znj. A. K. me detyrë ish-drejtore e KVVTP dhe në cilësinë e juristes së këtij komisioni;
• Z. E. S. me detyrë Drejtor i KVVTP Prefektura e Qarkut Elbasan;
• Znj. A. D. me detyrë juriste e KVVTP Prefektura Elbasan;
• Z. P. S. me detyrë topograf në KVVTP Prefektura Elbasan;
• Z. A. T. me detyrë agronom në KVVTP Prefktura Elbasan.
• Trajtuar më hollësisht në Projekt Raportin e Auditimit.
Për sa më sipër është mbajtur akt-konstatimi nr. 1, datë 13.11.2017 dhe Projektin e Auditimit dhe për këtë çështje subjekti i audituar, përfaqësuar nga z. E. S. me detyrë Drejtor, znj. A. K., znj. A. D., z. A. T. dhe z. P. S. me detyrë anëtarë të KVVTP pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, me shkresë nr. 1299/22, datë 24.11.2017 kanë bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:
Ndërsa në lidhje me programin vjetor të konrollit dhe verifkimit të titujve të pronësisë, të përgatitur nga KVVTP, në zbatim të nenit 18, pika 1 të Rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e KV" dhe të konstatimit nga ana KLSH, Komisioni Vendor do të marrë masa që programet vjetore që do të përgatiten për periudhën në vazhdimësi të dërgohen pranë Sekretariatit Teknik të KQT-së brenda datës 30 janar të vitit që vjen, pra brenda afatit ligjor të përcaktuar edhe në rregulloren e sipërpërmendur.
Në lidhje me faktin se përsa i përket kontrolleve të drejtpërdrejta, të ushtruar me nismën e vet, për ish-NB, Komisioni Vendor nuk ka konkluduar me ndonjë vendimmarrje, sepse gjendej para pamundësisë, e cila ka ardhur si pasojë e mungesës së dokumentacionit nga institucionet e tjera.
Qëndrimet e auditusve.
Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se nuk ka patur kundërshti, pra del se kanë karakter pohues.

- Gjetjet dhe Rekomandimet e Auditimit

B. <u>MASA ORGANIZATIVE</u>

`1. Gjetje nga auditimi: Në 7 vendime me sipërfaqen e zbritur 16201 m^2 dhe kthyer "shtet" nuk janë dërguar për njoftim, dhe nuk janë marrë në dorëzim me proces verbal, për vënien nën administrim të sipërfaqes kthyer "shtet", përkatësisht vendimet nr. 96, nr. 100, nr. 134 për ish-

Komuna Përparim dhe vendimi nr. 99 për ish- Komuna Shezë me sipërfaqe 8639 m^2 (aktualisht NJQV të Bashkisë Peqin) dhe vendimet nr. 103, për ish- Komuna Shalës, vendimi nr. 204 për Bashkinë Elbasan për sipërfaqen 3562 m^2 si dhe vendimi nr. 104 për sipërfaqen 4000 m^2 për Bashkinë Belsh, gjendje kjo në kundërshtim me nenin 9 pika 1 të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", i ndryshuar dhe në kundërshtim me kreun III, germa "B", pika 4, germat a, b të VKM nr. 1269, datë 17.9.2008 "Për Përbërjen, Mënyrën e Funksionimit dhe Detyrat e Përgjegjësitë e Strukturave Shtetërore, të Ngarkuara për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore", pasqyruar në Tabelën "*Tabelën Vendime për Pavlefshmëri/shfuqizim të AMTP-ve marrë formë të prerë* nga Gjykata *për periudhën 01.01.2013 deri më 30.09.2017" (Më hollësisht trajtuar në pikën 7.5 A, faqe 77-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: KVVTP Prefekti i Qarkut Elbasan, të marrë masa për dorëzimin me proces verbal të sipërfaqes prej 16201 m^2 e kthyer "shtet" nga pavlefshmëria e pjesshme e Titujve të Pronësisë që i përket **7** Vendimeve përkatësisht nr. 96, nr. 100, nr. 134 për ish-Komuna Përparim dhe vendimi nr. 99 për ish- Komuna Shezë me sipërfaqe 8639 m^2 (aktualisht NJQV të Bashkisë Peqin) dhe vendimet nr. 103, për ish- Komuna Shalës, vendimi nr. 204 për Bashkinë Elbasan për sipërfaqen 3562 m^2 si dhe vendimi nr. 104 për sipërfaqen 4000 m^2 për Bashkinë Belsh

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në 3 vendime *(përkatësisht nr. 4, 7, 9, sipas tabelës*) *të KVVTP, të cilat kanë marrë* formë të prerë nga Gjykata, shfuqizimi të titujve të pronësisë është llogaritur zbritje më pak për - 4746 m^2 (2611 m^2 + 563 m^2 + 1572 m^2) (janë zbritur 3836 m^2 kundrejt 8582 m^2 që duheshin zbritur), nga mos konfirmimet e sakta të ZVRPP-ve dhe mos marrja parasysh e gjendjes juridike AMTP-LN-PIII), në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2 "c", mos konfirmime dhe pasaktësi të shkaktuara nga ZVRPP Elbasan dhe Peqin**,** pasqyruar ne tabelën emërtuar "Vendime shfuqizimi të KVVTP në proces gjyqësor, sipas procedurës nenet 9, 10 të ligjit nr. 9948 periudhën 01.01.2013 deri më 30.09.2017", pasqyruar në tabelën "Sipërfaqet e pavlefshmërisë dhe zbritur më pak për Vendime e KVVTP marrë formë të prerë nga Gjykata" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.5 A, faqe 78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandim: KVVTP Prefekti i Qarkut Elbasan, të marrë masa për rishqyrtimin e 3 vendimeve ***marrë*** formë të prerë me vendime Gjykate, ku shfuqizimi të titujve të pronësisë është llogaritur zbritje më pak për - 4746 m^2 (2611 m^2+563 m^2+1572 m^2).

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan për periudhën 2013-30.09.2017 ka marrë ***18 vendime*** shfuqizimi të AMTP-ve të cilat ndodhen në proces shqyrtimi gjyqësor prej të cilave ***7 vendime*** shfuqizimi të titujve të pronësisë ***"truall", dhënë për zërin kadastral "Tokë bujqësore",*** në sipërfaqen prej 14 782 m^2 me 12 pasuri të ndodhura 11 në fshatin Urakë, zonë jashtë Sistemit të regjistrimit fillestar dhe 1 pasuri tokë "PF" Elbasan, pra shfuqizime për veprime në kundërshtim me nenin 2, 3, 4 të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" i ndryshuar. Gjithashtu ***4 vendime shfuqizimi, shfuqizuar për shkak të trajtimit me tokë bujqësore të ndodhur jashtë juridiksionit*** territorial të Komisionit të Ndarjes së Tokës, në sipërfaqen 8528 m^2 për 6 pasuri, prej tyre 5 pasuri ndodhur Fshati Urakë NJA Rrrajcë dhe 1 pasuri NJA Gjergjan, në kundërshtim me nenet 3, 4 të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" i ndryshuar, për shfuqizim të AMTP-ve, pasqyruar ne tabelën emërtuar "Vendime shfuqizimi të KVVTP në proces gjyqësor,

sipas procedurës nenet 9, 10 të ligjit nr. 9948 periudhën 01.01.2013 deri më 30.09.2017" dhe konkretisht si më poshtë.
KVVTP Prefekti Qarkut në Vendimin nr. 208, datë 24.05.2016, ka kërkuar shfuqizimin e pasurisë ***nr. kadastral 280 me emër "Rrahi..." e llojit arë me sipërfaqe 1800 m^2 ndodhur sipër rreshtit I-rë të AMTP nr. 192, datë 20.01.1992*** në emër të H. Sh., por nuk ka identifikuar sipërfaqen sipas LN, dhe poseduesin e saj (përfshirjen në cilën AMTP dhe emrin e poseduesit); si dhe ***nuk ka përfshirë në këtë vendim shfuqizimin e sipërfaqes tepër prej + 608 m^2 që u përket 5 pasurive me sipërfaqe prej 9480 m^2 sipas AMTP dhe 10088 m^2 sipas LN –PIII, sipërfaqe kjo e ndodhur në pasurinë nr. 86/101, volum 4, faqe 166 ZK nr. 1732, për (550 m^2) dhe në pasurinë nr. 37/9, volum 4, faqe 165 ZK nr. 1732, për (58 m^2),*** që kanë ardhur si pasojë e mos konfirmimit të saktë nga ZVRPP Elbasan, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2"c" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.5 A.2, faqe 85-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1. Rekomandim: KVVTP Prefekti Qarkut të marrë masa të rishqyrtojë Vendimin nr. 208, datë 24.05.2016, i ndodhur në proces gjyqësorë, ku të përfshijë në zbritje për pavlefshmëri ***sipërfaqen tepër prej + 608 m^2 që u përket 5 pasurive me sipërfaqe prej 9480 m^2 sipas AMTP dhe 10088 m^2 sipas LN –PIII, ; sipërfaqe kjo e ndodhur në pasurinë nr. 86/101, volum 4, faqe 166 ZK nr. 1732, për (550 m^2) dhe në pasurinë nr. 37/9, volum 4, faqe 165 ZK nr. 1732, për (58 m^2)***

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: KVVTP Prefekti i Qarkut Elbasan ka marrë Vendimi nr. 71/1, datë 18.02.2014 në proces ankimimi në gjykatë lidhur me AMTP nr. 60, datë 30.8.1994 në mungesë të konfirmimit të saktë nga ZVRPP Elbasan të gjendjes juridike për secilën prej 3 pasurive me sipërfaqe totale prej 9450 m^2 sipas AMTP-së dhe 9303 m^2, sipas PIII-LN çelur KPP në emër të R. B. M., mos konfirmime në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2 "c". Për këtë fakt si dhe për mungesën fizike në dosje të Vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit (GJAA) Tiranë, i cili ka rrëzuar Vendimi nr. 71/1, datë 18.02.2014 nuk mund të shprehim opinion *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.5 A.2, faqe 88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1. Rekomandim: KVVTP Prefekti i Qarkut Elbasan të marrë masa që në çdo rast të kërkojë me shkrim pranë gjykatave dhe pranë Ministrisë së Drejtësisë apo KLD-së dërgimin zyrtar të vendimeve të gjykatave Administrative, Apelit, me synim shpejtimin e procesit të verifikimit të titujve të pronësisë dhe shmangien e pengesave të rrjedhura nga mos dërgimi i Vendimeve të gjykatave.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: KVVTP Prefekti i Qarkut Elbasan ka marrë Vendimi nr. 197, datë 29.01.2016 në proces ankimimi në gjykatë dhe kthyer nga gjykata administrative Durrës për të meta e plotësim lidhur me AMTP nr. 16, datë 10.2.1992, sipas të cilit KVVTP ka kërkuar shfuqizim në sipërfaqen tepër prej 6395 m^2. Në kthimin për plotësim të këtij vendimi nga gjykata, auditimi konstaton konfirmime të pasakta nga ZVRPP Peqin që lidhen me bashkëpronësinë e jashtëligjshme me 20 BP në ***nr. 117 volum 1, faqe 137, ZK nr. 3238 Rrozej, Peqin me sipërfaqe 40138 m^2 e llojit Ullishtë, në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", me ligjin nr. 33, datë 21.3.2012 "Për Regjistrimin e PPL", me synim identifikimin e pjesës që i përket R5, të AMTP nr. 16, datë 10.2.1992, në emër të*** S. R. J., si dhe identifikimin e gjendjes juridike–fizike të pasurisë Rreshti I-rë i AMTP nr. 16, datë 10.2.1992 e llojit arë me nr. Kadastral

153, me emër popullor "Lëmi i madh", me sipërfaqe 7000 m^2 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.5 A.2, faqe 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandim: KVVTP të marrë masa për rishqyrtimin e Vendimit nr. 197, datë 29.01.2016 ndodhur në proces ankimimi në gjykatë, rishqyrtim i cili të mbështetet në marrjen në konsideratë dhe kërkimin nga ZVRPP Peqin duke i kërkuar rishqyrtimin dhe Menaxhimin, ndarjen e çeljen e 20 KPP-ve individuale të përfshira dhe çelur në bashkëpronësi të jashtëligjshme në KPP nr. 117 volum 1, faqe 137, ZK nr. 3238 Rrozej, Peqin me sipërfaqe 40138 m^2 e llojit Ullishtë, si dhe të përcaktojë gjendjen juridike takuese të sipërfaqes ullishtë që i përket R5, të AMTP nr. 16, datë 10.2.1992, në emër të S. R. J.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan në Vendimin nr. 207, datë 24.5.2016 ne proces, dërguar në Gjykatën Administrative Durrës me datë 30.05.16, (për te cilën ka përfunduar gjykimi pritet vendimi), sipas të cilit kërkuar shfuqizimi në sipërfaqen ***tepër prej 529 m^2***, lidhur me AMTP nr. 93, datë 20.01.92 emër të S. S. L. për shkak të sipërfaqes mbi normë për frymë. Zbritja prej 529 m^2 nuk është e saktë pasi duhej të zbriste edhe 1278 m^2, kjo për shkak të mos konfirmimit të saktë nga ZVRPP Elbasan në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2 "c"; llogaritur si më poshtë: (nga 1807 m^2 në fakt, pra më pak 1278 m^2), bazuar ne normën për fryme llogaritur: 2023 m^2 x 7 fryme =14161 m^2 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.5 A.2, faqe 91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandim: KVVTP Prefekti Qarkut të marrë masa të rishqyrtojë Vendimin nr. 207, datë 24.5.2016, i ndodhur në proces gjyqësor, ku të përfshijë në zbritje për pavlefshmëri edhe sipërfaqen tepër prej -1278 m^2 sipërfaqe zbritur me pak me Vendimin nr. 207, datë 24.5.2016 si dhe e ndodhur ne pasurit nr. 115/1, volum 2, faqe 99, ZK. 1732 fshatin Gjergjan në pasurinë nr. 86/66, volum 2, faqe 69 ZK. 1732 fshatin Gjergjan, nr. 54/56, volum 3, faqe 82 ZK.1732 fshatin Gjergjan dhe ne nr. 15/3, volum 2, faqe 158 ZK. 1732 fshatin Gjergjan.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan në Vendimin nr. 215, datë 30.12.2016 dërguar në Gjykatën Administrative Durrës me datë 30.12.16, sipas të cilit ka kërkuar shfuqizimi në sipërfaqen tepër prej 1392 m^2 lidhur me AMTP nr. 40, datë 25.02.1992 në emër të Qemal Qosja fshati Rrenas, NJA Grekan Bashkia Belsh. Zbritja prej 1392 m^2 nuk është e saktë pasi duhej të zbriste edhe 1428 m^2, kjo për shkak të përdorimit të normës së pasaktë për frymë si dhe për shkak të mos konfirmimit të saktë nga ZVRPP Elbasan në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 "Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione", i ndryshuar, pika 2 "c" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.5 A.2, faqe 92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandim: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan të marrë masa të rishqyrtojë Vendimin nr. 215, datë 30.12.2016, duke u bazuar në Printim III, normën për frymë, duke zbritur dhe truallin 250 m^2, sipërfaqja tepër prej 1428 m^2 rezulton e llogaritur 19088 m^2 PIII- 16268 m^2 sipas normës = 2820 m^2 sipërfaqja tepër – 1392 m^2 zbritja e KVVTP = -1428 m^2 sipërfaqe zbritur me pak, ndodhur në pasurinë nr. 114/4, volum 1,faqe 232, ZK. 3223 Grekan dhe në pasurinë nr. 66/1, volum 1, faqe 229, ZK. 3223 Grekan.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: KVVTP Prefekti Elbasan ka marrë Vendimi nr. 119/1, datë 30.10.2015 ne proces, dërguar kërkesë padia në Gjykatën Administrative Durrës me datë 3.11.15, kthyer për të

meta e plotësim, vendim i marrë pas shqyrtimit të kërkesës (datë 24.2.2014 së një Individi për verifikimin e AMTP nr. 54, pa datë), sipas të cilit KVVTP ka kërkuar shfuqizim në sipërfaqen tepër ***prej 8220 m²,*** për shkak të mungesës dokumentit provë të qenit themelues. Ky vendim është marrë me mangësi të procesit të hetimit administrativ, së pari konfirmimi i ZVRPPP Elbasan është i pa plotë dhe së dyti mbështetur në faktin që me Vendim Gjykate nr. 323, datë 12.3.2002 z. **O. H. F.** (mbajtës i AMTP nr. 54, pa datë), ka ndryshuar emrin dhe mban emrin **Q. H. F.**, pra duke mos kërkuar *edhe konfirmimin nëse ka ndonjë AMTP tjetër në emrin (e ndryshuar) të **Q. H.F.;** kjo në ZVRPP Elbasan dhe në DAMT të Këshilli i Qarkut Elbasan (formulari nr. 6) (Më hollësisht trajtuar në pikën 7.5 A.2, faqe 93-94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandim: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan të marr masa të rishqyrtojë Vendimi nr. 119/1, datë 30.10.2015, duke plotësuar hetimin administrativ dhe **kërkuar, përveç** informacionit të plotë dhe sigurisë për të, edhe konfirmimi nëse ka ndonjë AMTP tjetër në emrin (e ndryshuar) të **Q. H. F.;** kjo në ZVRPP Elbasan dhe në DAMT të K. Q. Elbasan (formulari nr. 6).

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan **ka marrë 2 vendime (vendimet** nr. 157, datë 04.05.2015 dhe Vendimi nr. 193, datë 14.12.2015 ***) për shlyerje detyrimi të në vlerën 7,228,568 lekë për sipërfaqen e tjetërsuar 4746 m² (1709 m² me vlerën*** 6,974,837 ***lekë që i përket Vendimit nr. 157, datë*** 04.05.2015; dhe ***3037 m² vlerën prej*** 253,731 ***lekë që i përket*** Vendimit nr. 193, datë 14.12.2015), ***bazuar në nenin 9, pika 3 të*** ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" i ndryshuar dhe ***pika 4*** ku shprehet: .. "*Mënyra dhe afatet e shlyerjes së detyrimit për vlerën e tokës përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave*.." Në të dy këto Vendime ***nuk përcaktohet institucioni, llogaria dhe mënyra e derdhjes, gjë që sjell pamundësinë e ekzekutimit të Vendimit dhe të derdhjes së detyrimit financiar të mësipërm tek Shteti*** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.5 A.2, faqe 94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandim: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan të marrë masa ***për ekzekutimin e arkëtimit të detyrimit financiar në vlerën 7,228,568 lekë për sipërfaqen e tjetërsuar 4746 m² (1709 m² me vlerën*** 6,974,837 ***lekë që i përket Vendimit nr. 157, datë*** 04.05.2015; dhe ***3037 m² vlerën prej*** 253,731 ***lekë që i përket*** Vendimit nr. 193, datë 14.12.2015), pasi të përfundojë procesi në gjykatë i shprehur me vendimet përkatëse, duke ndjekur procedurat e duke hartuar dokumentacionin në zbatim të shkresës së MBZHRAU nr. 1526/2, datë 11.4.2016 "Mbi çeljen e numrit të llogarisë për pagesën e tokës" dhe sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr. 3435/1, datë 18.3.2016 "Çelje llogarie, në zbatim të VKM nr. 605, datë 05.09.2012 "Për Procedurat e Njoftimit dhe Mënyrën e Pagesës së Detyrimit Financiar ne Rastet e Pavlefshmërisë së Pjesshme të AMTP-ve, si Rezultat i Mosrespektimit të Normës për Frymë të Tokës Bujqësore".

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Për të gjitha dosje-vendimet-Kërkesë paditë e KVVTP (gjithsej 26 të ndodhura në gjykata prej të cilave 15 proces shkalla e I-rë dhe 11 në shkallën e dytë të gjykimit) konstatohen vonesa e zgjatje procedurash me shtrirje mesatare kohore 2-3 vjet, gjë që ka sjellë edhe zgjatje kohore të trajtimit të kërkesave, por sidomos të ecurisë së marrjes së formës përfundimtare të Vendimeve të KVVTP si dhe të përfundimit të vetë procesit të vlerësimit të titujve të pronësisë së tokës bujqësore.

a. KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan për periudhën 2013-30.9.2017 ka marrë 11 vendime shfuqizimi të AMTP-ve të cilat ndodhen në proces shqyrtimi gjyqësor në ***GJAA Tiranë*** prej të cilave 2 vendime ankimuar nga i padituri (pala mbajtëse e AMTP) dhe 9 vendime shfuqizimi janë ankimuar nga KVVTP Elbasan për sipërfaqen 93 671 m² sipas kërkesave ankimore përkatëse bazuar në nenin 9, pika 1 e ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për Shqyrtimin e Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore" i ndryshuar pasqyruar në tabelën

emërtuar "***Vendime të marra nga KVVTP por që janë në proces ankimimi në GJAA Tiranë (gjykimi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë dhe ecuria e procesit)"***
b. Mungojnë vendimet e GJA SH1-rë Durrës për Vendimet e KVVTP nr. 203,datë 31.3.2016, nr. 209, datë 23.09.2016 ndërsa kërkesat ankimore nr. 1209/57/10, datë 04.01.2017 nr. 3761/103, datë 23.12.2016, drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë janë të pa plota pasi nuk përcaktojnë numrin përkatës të vendimet e GJA SH1 Durrës, gjendje kjo që tregon marrëdhënie të parregullta ndërmjet Institucionit të KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan dhe GJA SH1 Durrës, gjë për të cilën KVVTP do të duhet të kërkojë zyrtarisht Vendimin, qoftë edhe duke e prezantuar këtë parregullsi pranë KLD ose edhe pranë Ministrisë së Drejtësisë, parregullsi që ka sjellë zvarritje e zgjatje të procesit të vlerësimit të titujve të pronësisë së tokës bujqësore *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.5 A.3, faqe 95-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
10.1. Rekomandim: KVVTP Prefekti i Qarkut Elbasan të marrë masa të plotësojë në mënyrë të rregullt kërkesat ankimore duke përcaktuar në to vendimin përkatës të GJA SH1 Durrës apo Gjykatës së Apelit që ankimohet, duke kërkuar dhe siguruar dorëzimin zyrtar të vendimit përkatës. Për këtë mungesë bashkëpunimi me gjykatat, KVVTP përveç se të kërkojë zyrtarisht Vendimin, duke e prezantuar këtë parregullsi pranë KLD ose edhe pranë Ministrisë së Drejtësisë, me synim shmangien e zvarritjes dhe zgjatjes së procesit të vlerësimit të titujve të pronësisë së tokës bujqësore.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi:.KVVTP ne lidhje me (nr. 3 sipas tabelës), Vendimin nr. 178, datë 30.10.2015, i ankimuar pranë GJAA Tiranë nga mbajtësi për AMTP nr. 623, datë 3.3.1998, në emër të B. S., me 3500 m^2 tokë arë, fshati Shtërmen Komuna Gostimë, ka mjaftuar vetëm me certifikatën gjendje datë 27.09.1991 lëshuar nga ZGJC Gostimë datë 10.10.14, pra që nuk ka qenë banor më datë 01.08.1991, dhe për pasojë nuk ka qenë subjekt i ligjit nr. 7501, pra nuk ka bërë të plotë Hetimin administrativ sepse nuk e ka shtrirë hetimin në kërkimin e të dhënave lidhur me verifikimin e faktit nëse ka qenë trajtuar më parë me tokë bujqësore nga fshati Rrasë (mbështetur ne certifikatën ku shprehet: *"Familja B. S. është zhvendosur nga ZGJC Rrasë në ZGJC Gostimë "*, vendi nga ku është transferuar pra në vendin e origjinës, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9948, VKM nr. 1269 dhe me ligjin 7501 (pasi nuk ka qenë subjekt i 7501, për të cilin mungon hetimi i plotë. Edhe këto mangësi mungesë faktesh kanë sjellë që vendimi nr. 178, datë 30.10.2015, dhe vendimi i GJA Shkalla I-rë Durrës nr. 93, datë 8.2.2016 të atakohet nga mbajtësi, duke sjellë që procesi të vazhdojë. Pra KVVTP ka mundësinë të plotësojë hetimin administrativ të kërkojë nga zyrat shtetërore fshati Rrasë, Bashkia Belsh dhe nga ZVRPP Elbasan nëse qytetari ka qenë trajtuar me parë me tokë bujqësore dhe ti paraqesë ato para gjykatës,si dhe të marrë në dorëzim tokën "shtet" prej 3500 m^2, në lidhje me Vendimin nr. 178, datë 30.10.2015 pranuar me vendimin e GJA Shkalla I-rë Durrës nr. 93, datë 8.2.2016 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.5 A.3, faqe 96-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
11.1 Rekomandim: KVVTP Prefekti i Qarkut Elbasan të marrë masa të plotësojë hetimin administrativ, të kërkojë nga zyrat shtetërore fshati Rrasë Bashkia Belsh dhe nga ZVRPP Elbasan nëse qytetari z. B. S. ka qenë trajtuar me parë me tokë bujqësore dhe ti paraqesë ato para gjykatës, si dhe të marrë në dorëzim tokën "shtet" prej 3500 m^2, në lidhje me Vendimin nr. 178, datë 30.10.2015 pranuar me vendimin e GJA Shkalla I Durrës nr. 93, datë 8.2.2016. Këto fakte KVVTP-ja t'i paraqesë zyrtarisht para Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: KVVTP për vendimin nr. 178, datë 30.10.2015, me sipërfaqe 3500 m^2, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj anëtarëve të Komisionit të Ndarjes së tokës të fshatit Shërmen Komuna Gostimë pasi ka tejkaluar kompetencat ligjore me trajtimin me tokë bujqësore pa qenë subjekt i ligjit nr. 7501, gjendje datë 1.8.1991, në papajtueshmëri me nenin

15 të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore".
- KVVTP ne lidhje me (nr. 7 sipas tabelës),Vendimin nr. 209, datë 23.09.2016, i ankimuar pranë GJAA Tiranë nga KV për AMTP nr. 274, datë s'ka, në emër të A. & H. Q., me 16000 m^2 tokë Ullishtë Sektori Karroq ish-NB Elbasan si Themelues, shfuqizim i pjesshëm për 7000 m^2, mbi normë në pasuritë nr. 1145/1, volum 4, faqe 32 ZK nr. 8527 me sipërfaqe 11748 m^2 sipas LN dhe 16000 m^2 sipas AMTP, nr. 1169/11, volum 4, faqe 33 ZK nr. 8527 me sipërfaqe 4232 m^2 sipas LN dhe –m^2 sipas AMTP konstatojmë:
Gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë për shkakun e mungesës së adresave për 3 prej trashëgimtarëve të K/Familjarit A. & H. Q. Dosja është e pa inventarizuar nuk ka fletë inventari. Mungon Vendimi i gjykatës, për mospranimin e padisë së KVVTP dhe lidhur me këtë, mungon dokumentacioni që të vërtetojë shkakun e mosplotësimit të metave (si adresa) të pretenduara nga gjykata. Këto mangësi sjellin si pasojë mungesën e argumentimit (me nje relacion) të pjesës fundore faqe 6-7 të kërkesës ankimore nr. 3761/103, datë 23.12.2016 drejtuar GJAA Tiranë dhe që zgjat procesin me pasojë që mbajtës i titullit vazhdon përdor në mënyrë të paligjshme sipërfaqen prej 7000 m^2 ullishtë, në kundërshtim me ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.5 A.3, faqe 97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
12.1. Rekomandim: KVVTP Prefekti i Qarkut Elbasan të marrë masa për ndjekjen e procesit gjyqësor në GJAA Tirane sipas kërkesës ankimore nr. 3761/103, datë 23.12.2016 drejtuar GJAA Tiranë, të plotësojë dokumentacionin për adresat e munguara të 3 trashëgimtarëve si dhe të plotësojë edhe me konfirmimet nga ZVRPP Elbasan dhe ti paraqesë ato para gjykatës. Gjithashtu të marrë në dorëzim tokën "shtet" prej 7000 m^2, tokë ullishtë sipas Vendimit nr. 209, datë 23.09.2016, rrëzuar me vendimin e GJA SH1 Durrës pa nr., datë 18.12.2016 dhe ankimuar me Kërkesën Ankimore nr. 3761/103,datë 23.12.16 në GJAA Tiranë.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Ecuria e procesit gjyqësor është mbajtur me shënime fletushka, nuk ka asnjë informacion për titullarin, megjithëse nga shënimet mbajtur në gjykatë datë 22.8.16, nga zj. A. K., dhe shënimet pa datë, shënimet datë 6.12.2016 dhe datë 19.12.2016 të zj. A. D., rezulton se janë zhvilluar 4 seanca gjyqësore pranë GJA Durrës dhe nuk kanë dhënë asnjë informacion tek Titullari, për ecurinë e procesit lidhur me kërkesë padinë nr. 3761/92, datë 29.9.2016, e cila lidhet me Vendimin nr. 209, datë 23.09.2016 të KVVTP për verifikim të AMTP nr. 274, pa datë, (në fakt ka dhe një tjetër AMTP me nr. 74, pa datë) me sipërfaqe 16000 m^2 Ullishtë në emër të të A. & H. Q., (Më hollësisht trajtuar në pikën 7.5 A.3, faqe 98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
13.1. Rekomandim: KVVTP Prefekti i Qarkut Ebasan të marrë masa të evidentojë, dokumentojë me informacione në çdo rast për ecurinë e seancave të procesit gjyqësorë dhe mbi bazën e informacioneve të përgatisë dhe paraqesë titullarit relacionet përkatëse mbi bazën e të cilave të përgatitet kërkesa ankimore për vendimet e atakuara në GJAA e tjera sipas rastit.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan Vendimin nr. 209, datë 23.09.2016, me 7000 m^2 ullishtë, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj anëtarëve të Komisionit të Ndarjes së tokës të Sektori Karroq ish-NB Elbasan, pasi ka tejkaluar kompetencat ligjore me trajtimin me tokë bujqësore mbi normë në kundërshtim me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, në papajtueshmëri me nenin 15 të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore".
- KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan për periudhën 2013-30.92017 ka marrë 43 vendime për mosshqyrtim të AMTP-ve, pasqyruar ne tabelën emërtuar "Vendime për mos shqyrtim të Vlefshmërisë ligjore të AMTP v. 2013-30.9.2017" si më poshtë:

Nga auditimi i 43 dosjeve rezulton se Vendimmarrja për mos shqyrtimin e 43 kërkesa-vendimeve është bazuar ne:
-UKM nr. 2, datë 13.01.2010, kapitulli i pikat 1.a ku shprehet: "… Kur në AMTP mungon një a me shumë element të formës a përmbajtjes, të përcaktuar ne pikën 1 të këtij udhëzimi. Në këto kushte KV vendos;
i) Mosshqyrtimin e kërkesës kur AMTP (origjinale, dokumenti i njësuar me origjinalin, dublikatë apo fotokopje e noterizuar), apo dhe në piken a),b) e ç) të Udhëzimit nr. 2, datë 08.04.2009
-Pika 1b e UKM nr. 2, datë 13.06.2013 "Për mënyrën e procedimit të Organeve të Administratës publike për pasuritë e Paluajtshme të fituara me AMTP", ku përcaktohet se: "AMTP-të duhet të përmbajnë disa element të formës e përmbajtjes, ndër të cilat pika 1 b "identifikimin e organit që e ka lëshuar AMTP-në, duke përfshirë nënshkrimin e Kryetarit të Komisionit të Ndarjes së Tokës", ndërsa pika 1ç) "AMTP duhet të përmbajë disa element të formës e përmbajtjes ndër të cilat njërën nga vulat e mëposhtme:
i. Vulën e komisionit ndarjes tokës të fshatit, ii. Vulën e Kryeplakut, iii. Vulën e Komunës/ Bashkisë, iii. vulën e ndërmarrjes bujqësore, iv. Vulën e Këshillit të Rrethit /të Qarkut."
Këto mangësi në dokumentacionin e AMTP-ve të evidentuara si shkaqe ligjore të mos shqyrtimit nga KVVTP të AMTP-ve për periudhën deri fund viti 2015, janë zgjidhur me delegimin e kompetencave dhe detyrimeve për trajtim nga bashkitë sipas VKM nr. 994, datë 09.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të AMTP-ve", për pasojë KVVTP Prefektit të qarkut mund dhe duhet tua bëjë të ditura zyrtarisht NJQV–ve përkatësisht Bashkive Elbasan, Librazhd, Përrenjas, Peqin, Cërrik *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 99-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
14.1. Rekomandim: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan të marr masa të bëjë me dije dhe dërgojë zyrtarisht 41 vendimet e marra për mos shqyrtim të Vlefshmërisë ligjore të AMTP v. 2013-30.9.2017 përkatësisht në Bashkitë Elbasan, Librazhd, Përrenjas, Peqin, Cërrik, për kompetencë e shqyrtim bazuar në VKM nr. 994, datë 09.12.2015 "Për Procedurën e Regjistrimit të AMTP-ve" sipas tabelës emërtuar: "Tabela Vendime për mos shqyrtim të Vlefshmërisë ligjore të AMTP viti 2013-30.9.2017"

Në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan -Mangësi ***në inventarizimin e dokumentacionit*** të 43 dosjeve, i cili aktualisht pasqyrohet me listë dokumentesh, por nuk ka fletën e inventarit standard-tip e cila të përfshije emërtimin e dokumentacionit përbërës me numër progresiv fletësh, mbylljen e dosjes, dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim në arkiv, gjendje kjo në mosplotësim të kërkesave të germës "dh" neni 9, 36, 40, 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.01.1993 dhe akteve nën ligjore përkatës *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
15.1. Rekomandim: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan të marr masa të bëjë inventarizimin e dokumentacionit në dosje me plotësimin e fletës inventarit standard-tip e cila të përfshije emërtimin e dokumentacionit përbërës me numër progresiv fletësh, mbylljen e dosjes, dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim në arkiv.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Në **3 raste** nga Komisioni vendor janë marrë vendime për shfuqizim të AMTP-ve në sipërfaqen prej 62900 m^2 të nxjerra nga KVVTP Elbasan, pas shqyrtimit gjyqësor nga gjykata administrative këto vendime janë shfuqizuar 3 vendime me një sipërfaqe 42700 m^2 me shkakun e provimit faktik të çështjes, duke mos marrë parasysh përcaktimet e shprehura në vendimet e KVVTP të bazuara në aktet ligjore të fitimit të titujve të pronësisë siç janë ligji nr. nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar, ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën", të ndryshuar, trajtuar në pasqyrën emërtuar vendime për pavlefshmëri të AMTP-ve, në proces ankimi të shfuqizuara në

shkallën e parë dhe ankimuar në apel, por nga auditimi me të zgjedhur i këtyre praktikave del se ka mos konfirmime të sakta të gjendjes juridike nga ZVRPP dhe për faktorët AMTP-LN dhe konkretisht për vendimet në vijim:
- Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me vendim nr. 151, datë 30.03.2015, ka vendosur shfuqizimin e plotë të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 107, datë s'ka, në emër të R. B. K., të sipërfaqes prej 2000 m^2 tokë bujqësore në sektorin fidanishte, Bashkia Elbasan dhënë në parcelën me nr. ngastre 430 e cila korrespondon me parcelën me numër pasurie 430/2 sipas hartës së ZVRPP Elbasan dhe kalimin e kësaj –parcele në pronësi të shtetit, pasi ky akt është dhënë në kundërshtim me ligjin nuk e ka kaluar në pronësi shtet, veprim në papajtueshmëri me germën a neni 1, të ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", të ndryshuar me nenin 2, 3, 4, dhe pikën 1 nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar dhe VKM nr. 255, datë 02.08.1991 "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore", të ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.4, faqe 72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

16.1. Rekomandim: KVVTP të vazhdojë procedurat gjyqësore në Gjykatën Administrative te Apelit për lënien në fuqi të vendimit nr. 151, datë 30.03.2015, për shfuqizimin e plotë të AMTP-së nr. 107, datë s'ka në emër të R. B. K., përkatësisht për sipërfaqen 2000 m^2 tokë truall dhe kalimin e parcelave në pronësi të shtetit.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me vendim nr. 164, datë 30.06.2015, ka vendosur shfuqizimin e plotë të Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 24, datë 25.06.1992, në emër të S. P., të sipërfaqes totale prej 6600 m^2 tokë në parcelat me nr. Kadastral 291 me sipërfaqe 6000 m^2 dhe nr. 391 me sipërfaqe 600 m^2, për pasuritë:
a) pasuria nr. 44 sipas hartës së ZVRPP Peqin, me sipërfaqe 3289 m^2;
b) pasuria nr. 89/10 sipas hartës së ZVRPP Peqin, me sipërfaqe 6500 m^2 dhe
c) pasuria nr. 89/11 sipas hartës së ZVRPP Peqin dhe kalimin e këtyre pasurive në pronësi të shtetit, pasi nuk ka qenë banor me darë 01.08.1991 deri më 15.10.1992, veprim në papajtueshmëri me germën a neni 1, të ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", të ndryshuar, me nenin 2, 3, 4, dhe pikën 1 nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar dhe VKM nr. 255, datë 02.08.1991 "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore", të ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.4, faqe 73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandim: KVVTP të vazhdojë procedurat gjyqësore në Gjykatën Administrative te Apelit për lënien në fuqi të vendimit nr. 164, datë 30.06.2015, për shfuqizimin e plotë të AMTP-së nr. 25.06.1992, datë s'ka në emër të S. Xh. P., përkatësisht për sipërfaqen 6600 m^2 tokë truall dhe kalimin e parcelave në pronësi të shtetit.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë me vendim nr. 221, datë 19.04.2017, ka vendosur shfuqizimin e pjesshëm të AMTP-së nr. 162, datë ska duke argumentuar se komisioni i ndarjes së tokës ka dhënë tokë jo bujqësore kjo në kundërshtim me nenin 3 të ligjit 7501, datë 19.07.1991 "Për Tokën" si dhe pika 1 e Udhëzimit nr. 5, datë 25.05.1993 "Për zbatimin e VKM nr. 161, datë 08.04.1993, pasi sipas konfirmimit nga ana e DAMT, këto sipërfaqe ndodhen në zërin kadastral tokë të pa frytshme dhe truall, veprim në papajtueshmëri me germën a neni 1, të ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", të ndryshuar me nenin 2, 3, 4, dhe pikën 1 nenin 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar dhe VKM nr. 255, datë 02.08.1991 "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore", të ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.4, faqe 74-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandim: KVVTP të vazhdojë procedurat gjyqësore në Gjykatën Administrative te Apelit për lënien në fuqi të vendimit nr. 221, datë 19.04.2017, për shfuqizimin e pjesshëm të AMTP-së nr. 162, datë s'ka në emër të Xh. H. (trashëgimtarët e tij), përkatësisht për sipërfaqen 34100 m^2 tokë e pa frytshme dhe truall në parcelat me nr. Kadastral 417, 418 dhe 419, me vendndodhje sektori Manas, NB Elbasan ZK nr. 8527 dhe kalimin e parcelave në pronësi të shtetit.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor nuk dispononte një evidentim dhe raportimi i kërkesave mujore e progresive sipas stadeve të trajtimit, pra mungon sistemi i evidencave dhe i raportimit të gjendjes së secilës kërkesë sipas stadit dhe gjendjes në fillim të çdo viti muaji etj, që tregon se:

a. Sistemi statistikor i evidentimit dhe i Raportimit nuk është real në pasqyrim të gjendjes që ka sjellë si pasojë mungesën e ndjekjes së ecurisë së procesit të vlerësimit të titujve të pronësisë dhe fenomenit në tërësi në rajonin juridiksional të Prefekturës, në funksion të kohës dhe kapaciteteve dhe mungesën e punës studimore sipas njësive territoriale.

b. Nuk krijon mundësinë e ndjekjes në kronologji të zgjidhjes e trajtimit të kërkesave, sipas procedurave dhe afateve kohore dhe uljen e mungesës së transparencës për cilësinë e shërbimit ndaj Publikut prej institucioneve dhe NJQV-të që kanë detyrimin ligjor për verifikim e vlerësim të titujve të pronësisë *(Më hollësisht trajtuar në faqet 72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

19.1. Rekomandim: KVVTP Prefekti i Qarkut Elbasan, të marrë masa për periudhën në vazhdim të ndjekë ecurinë e procesit të vlerësimit të titujve të pronësisë, në zgjidhjen dhe trajtimin e kërkesave dhe uljen e mungesës së transparencës për cilësinë e shërbimit ndaj publikut.

Në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në procesverbalin e mbledhjes në asnjë rast, nuk ka regjistruar diskutimet e Prefektit si në hapjen dhe mbylljen e mbledhjeve.

Prefekti, në asnjë rast, nuk ka thirrur në mbledhjen e komisionit drejtues të institucioneve shtetërore, që ushtrojnë veprimtari në juridiksionin e qarkut, drejtues të qeverisjes vendore, të cilët kanë lidhje dhe informacion me çështjet konkrete, që shqyrtohen, veprim në papajtueshmëri me pikën 6 kreu III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 "Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

20.1. Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të regjistroj në procesverbalin e mbledhjes diskutimet e Prefektit, si dhe Prefekti, të thërras në mbledhjen e komisionit drejtues të institucioneve shtetërore, që ushtrojnë veprimtari në juridiksionin e qarkut dhe drejtues të qeverisjes vendore, të cilët kanë lidhje dhe informacion me çështjet konkrete, që shqyrtohen, si dhe të regjistrohen diskutimet e anëtarëve të komisionit, të cilët duhet të shprehin mendimet e tyre, si dhe nuk ka përcaktuar arsyet që i bëjnë të pa vlefshëm ose absolutisht të pavlefshëm AMTP

Në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë për periudhën 01.01.2013 deri 30.09.2017 rezulton se, procesverbali i mbledhjeve nuk është mbajtur në një libër të sekretuar, me numër fletësh, të vulosur e firmosur nga punonjësi i Arkivit të Prefektit të Qarkut Elbasan, por me fleta format të thjeshta të pa sekretuara të cilat në fund të çdo mbledhje ishin të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e komisionit të pranishëm dhe prefekti, gjithashtu nuk janë të nënshkruara nga mbajtësi i protokollit, veprim në zbatim të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", gjithashtu në

këto procesverbale të mbledhjeve, në asnjë rast, nuk ka regjistruar diskutimet e anëtarëve të komisionit, të cilët duhet të shprehin mendimet e tyre, si dhe nuk ka përcaktuar arsyet që e bëjnë AMTP të pa vlefshëm ose absolutisht të pavlefshëm, veprim në papajtueshmëri me nenin 2, 3, 4, 13 dhe 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar dhe pikën 6 kreu III, të VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 "Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 68-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

21.1. Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, që procesverbali i mbledhjeve të mbahet në një libër të sekretuar, me numër fletësh, të vulosur e firmosur nga punonjësi i Arkivit të Prefektit të Qarkut Elbasan, në fund të çdo mbledhje të nënshkruajnë të gjithë anëtarët e komisionit të pranishëm dhe prefekti dhe nga mbajtësi i protokollit, në zbatim të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë në 235 raste, nuk ka bërë inventarizimin e dosjeve të dorëzuar në zyrën e arkivit, si dhe nuk ka përcaktuar dorëzuesin dhe marrësin në dorëzim, veprim në papajtueshmëri me germën dh nenin 9, 36, 40 dhe 64, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqe 102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

22.1. Rekomandim: Komisioni vendorë i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të bëjë inventarizimin e dokumentacionit në dosje, të përcaktoj sasia e fletëve që ndodhen në dosje, si dhe të nënshkruhet nga dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim i tyre.

Menjëherë

23. Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë nga viti 2008 deri me datë 30.09.2017 ka marrë 235 vendime, nga 1528 kërkesa individësh dhe institucionesh, ndërsa për periudhën nën auditim nga Komisioni Vendor nuk është marrë asnjë vendim në lidhje me programet vjetore të punës të hartuara për kontrolle të drejtpërdrejta, të ushtruar me nismën e vet, për tokat e ndërmarrjeve bujqësore, pasi nuk ka asnjë vendimmarrje për këtë qëllim, kjo për mungesë të dokumentacionit nga institucionet e tjera, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimin nr. 1, datë 13.01.2010 "Për mënyrën e verifikimit apo shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore te ish NB-ve", nenit 7, shkronja b, pika 2 të ligjin nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7.5, faqe 102-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

23.1. Rekomandim: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë të marrë masa, të zbatoj programin vjetorë për kontrollet e drejtpërdrejta, të ushtruar me nismën e vet, të miratuara nga Komisioni Qeveritar i Tokës Tiranë.

Në vijimësi

24. Gjetje nga auditimi: Në **3 raste** për periudhën 2013-2017 konstatohet se janë larguar ish-punonjësit nga puna pa bërë dorëzimi i detyrës me procesverbal, dokumentacionin shkresor, elektronik, gjithçka e krijuar gjatë punës në institucion, nuk janë zbatuar këto rregulla në largimet e punonjësve: z. V. B., ndërprerë marrëdhëniet e punës më 17.12.2013, me detyrë specialiste shërbimesh në nën/prefekturën Librazhd, z. I. Sh. me detyrë ish-drejtor i KV dhe më pas anëtarë komisioni, ndërprerë marrëdhëniet e punës më 28.10.2014, z. A. K. me detyrë ish-Sekretar i Përgjithshëm, ndërprerë marrëdhëniet e punës më 18.10.2013, veprimet e mësipërme bien në

kundërshtim me kërkesat e pika 13 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 19, 20 dhe 21 të VKM nr. 360, datë 14.07.2000 "Për lirimin nga shërbimi civil dhe Dorëzimi i detyrës", *pika 50 e* VKM nr. 171, datë 26.03.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil" dhe pika 3 e nenit 25, të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 27-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

24.1. Rekomandim: Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan të marrë masa që për rastet e largimit apo të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës të zbatohen kërkesat ligjore.

Menjëherë

25. Gjetje nga auditimi: Në **25 raste**, për vitet 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 9 mujorin e 2017 nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan janë kryer pagesa me një **vlerë me efekt financiar prej 20,806,409 lekë,** ndaj ish-punëmarrësve, të cilat rrjedhin nga vendime gjyqësore për largimet nga puna, ku rezultoi se ndërprerjet e marrëdhënieve te punës nga punëmarrësit ishin kundërshtuar në gjykatë të Shkallës Parë dhe të Apelit, pa u realizuar të tre shkallët e gjykimit, duke kërkuar kundërshtimin e urdhrave të largimit nga puna apo mos lidhje të kontratave të punës nga ana e ish-Prefektëve dhe pagesën e dëmshpërblimeve, sipas Pasqyrës së pagesave të ish-punonjësve të larguar, përfituar me vendime të Gjykatave për periudhën janar 2013 deri shtator 2017, **"ANEKSI nr. 1"**, bashkëlidhur Raportit Përfundimtare të Auditimit, veprimet e mësipërme bien ndesh me kërkesat e udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4.7, faqe 29-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

25.1. Rekomandim: Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan të marrë masa si për rastet e largimit apo të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës të zbatohen kërkesat ligjore, ashtu edhe për rastet e kryerjes së pagesave sipas vendimeve gjyqësore, të zbatohen kërkesat ligjore, për ndjekjen e procesit gjyqësor në të gjitha shkallët, të analizohen si të nxirret përgjegjësia administrative ndaj shkaktarëve.

Menjëherë

26. Gjetje nga auditimi: Në **3 nënprefektura** të Prefekturës së Qarkut Elbasan në lidhje me regjistrimin e ndërtesave në hipotekë, administrimi i tyre, dhe marrja në evidencë kontabile në bazë të VKM nr. 1691, datë 10.10.2007, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për Prefektët dhe administratën e tyre, Nënprefektët dhe administratën dhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencës civile (Drejtorisë së PMNZSH)", të ndryshuar del se:

a- Për zyrën e Nënprefekturës Librazhd, për truall dhe garazhe lagja nr. 1, Librazhd me **sipërfaqe 216 m^2**, 3 ambiente të dhëna me qira që ndodhen në katin e parë të ndërtesës së ish-Këshillit të rrethit me sipërfaqe të përgjithshme 549 m^2 dhe zyra e rekrutimit, që ndodhet në katin e III-të të ndërtesës së ish-Këshillit të Rrethit, pasuria 7/63, ZK nr. 2446, qyteti Librazhd.

b- Për zyrën e Nënprefekturës Gramsh, për **15 objekte me sipërfaqe 281m^2**, janë në përgjegjësi administrimi nga Prefektura Elbasan por që në fakt administrohen nga Institucione te tjera.

c- Zyra e Nënprefekturës Peqin, nuk është regjistruar objekti ndërtesë me sipërfaqe **diferencë prej 221.20 m^2,** në ZK nr. 2908 Peqin, si dhe nuk është dorëzuar pranë bashkisë Peqin 300 m^2 trualli dhe 110 m^2 ndërtesë, truall dhe ndërtesë zyrat e PMNZSH-së të përfituara sipas VKM nr. 1691 datë 10.10.2007, veprim në kundërshtim me shkronjat a, b të pikës 1 të VKM nr. 366, datë 18.05.2016 dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për

menaxhimin financiar dhe kontrollin" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 46-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

26.1. Rekomandim: Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan të marrë masa për regjistrimin e pasurive të paluajtshme të përfituara me VKM nr. 1691 datë 10.10.2007.

Menjëherë

27. Gjetje nga auditimi: Në **1 rast** për vitet 2014 dhe 2015 nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan është kryer pagesa prej 1,379,235 lekë ndaj 6 operatorëve ekonomikë, sipas vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr. 2101, datë 16.09.2009, lënë në fuqi vendimi i gjykatës së Apelit Durrës nr. 10-2013-1784, datë 20.11.2013.

Nga subjektet "Besmiri" shpk Elbasan, "Benardo" shpk Peqin, "Rezart" shpk Gramsh dhe "Hajdini" shpk, "Skenderi G", dhe "Çota" shpk, Librazhd, gjatë fund-vitit 2007 dhe fillim-vitit 2008, në mbështetje të një situate emergjente, kanë furnizuar me karburant (gazoil) PMNZSH-në Qarku Elbasan, në vartësi të Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan, me 10.329 litra gazoil, me një vlerë prej 1,379,235 lekë, pa kontratë dhe pa kryer procedurat e tenderimit, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar. Kjo sasi karburanti nuk është likuiduar për mos zbatim kërkesash ligjore si çeljen e fondit limit nga Ministria e Brendshme, për blerje karburanti, si e tillë veprimet janë kryer edhe pa aktmarrëveshje, në kundërshtim me kërkesat e nenit 1 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 2, datë 28.03.2013 "për procedurën e prokurimit me vlera të vogla", i ndryshuar. Gjithashtu doli se sasia prej 10.329 litra gazoil nuk është bërë hyrje e dalje në magazinë, veprim në kundërshtim me nenet 13 dhe14 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin i ndryshuar me ligjin nr. 110, date 15.10.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa", pika 44 e nenit 3 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar dhe pika 37 dhe 38 të dokumentimit e lëvizjes së aktiveve të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 59-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

27.1. Rekomandim: Institucioni i Prefektit të Qarkut Elbasan të analizojë rastin dhe të marrë masa për mospërsëritjen e rasteve të tilla në situate emergjence.

Menjëherë

II. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Baza për opinion të kualifikuar:

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në standardet e INTOSAI-t dhe Manualit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në Institucionin e Prefekti Elbasan, rezultuan devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret) dhe konkretisht:

a. Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë për periudhën nga data 01.01.2013 deri me datë 30.09.2017, per 3 vendime të cilat kane marr forme te prere ne Gjykate shfuqizimi i titujve të pronësisë është llogaritur me zbritje më pak për sipërfaqen **- 4746 m^2** dhe për 3 vendime të cilat ndodhen në vazhdim procedurash dhe shqyrtim te procesit gjyqësor shfuqizimi është llogaritur më pak për sipërfaqen prej **- 3314 m^2,** si dhe për **26 kërkesë padi** të KVVTP drejtuar gjykatave, 15 në Gjykatën e shkallës I-rë dhe 11 në shkallën e dytë të gjykimit; konstatohen vonesa e zgjatje procedurash me shtrirje mesatare kohore 2-3 vjet, me pasoja zgjatjes kohore të trajtimit të kërkesave, ecurisë së marrjes së formës përfundimtare të Vendimeve të KVVTP-së, por dhe shkelje të afateve të përfundimit të vetë procesit të vlerësimit të titujve të pronësisë së tokës bujqësore.

b. Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefekturës së Qarkut Elbasan në periudhën 2013-30.9.2017 ka marrë 11 vendime shfuqizimi të AMTP-ve për sipërfaqen 93671 m^2, të cilat ndodhen në proces shqyrtimi e ankimimi gjyqësor në Gjykatën Administrative të Apelit nga të cilat 2 vendime ankimuar nga pala mbajtëse e AMTP-ve dhe 9 vendime ankimuar nga KVVTP Elbasan. Lidhur me ecurine e procesit të shqyrtimit dokumentacionin të kërkesave ankimore për këto vendime u konstatuan mangësi si në dokumentacion, ashtu dhe në marrëdhëniet në plotësim të detyrimit ligjor ndermjet Gjykatës dhe KVVTP.

c. Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, për **7 vendime** me sipërfaqen e pavlefshme te titujve te pronesise e zbritur prej 16201 m^2 dhe kthyer "shtet" nga KVVTP nuk janë dërguar për njoftim dhe nuk janë marrë në dorëzim me proces verbal, pra nuk është vënë nën administrim të përfaqësuesit shtetëror sipërfaqja e kthyer "shtet".

Evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit të kualifikuar.

Që nën gjykimin profesional për dhënien e një opinioni të kualifikuar nga ana audituesve të pavarur të KLSH, vlerësojmë se përgjithësisht Institucioni ka përmbushur funksionet, detyrat e qëllimet ligjore dhe ka përdorur burimet duke i menaxhuar ato brenda kuadrit ligjor, rregullativ; ndërsa rastet sporadike të divijimeve të konstatuara nga rregullat dhe rregulloret, konstatuar kryesisht në aktivitetin e KVVTP (si aktivitet dytësor, diskret në kohë dhe i kushtëzuar me bashkërendimin e punës me institucione të tjera) vlerësojmë se nuk janë materiale dhe të pa riparueshme.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT